

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI XI (XXV) 2022, NR. 35 (188)

**Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare**

www.zaninalte.al

Tiranë, 2022

Zani i Naltë

Revistë shkencore, organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923, rifilluar në tetor 2012

VITI XI (XXV), korrik - dhjetor 2022 nr. 35 (188)

Nën kujdesin e: H. Bujar Spahiu

Drejtor: Dorian Demetja

Kryeredaktor: Dr. Genti Kruja

Bordi editorial: Prof. Dr. Ferdinand Gjana, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Rahim Ombashi, Universiteti Bedër
Dr. Skender Bruçaj, Universiteti Bedër
Dr. Brikena Smajli, Universiteti Bedër
Dr. Hasan Bello, QSA, Instituti i Historisë
PHD. Cand. Elton Karaj, Universiteti Bedër
H. Jusuf Zimeri, Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë së Veriut
MA. Ramadan Shkodra, Bashkësia Islame e Kosovës

Redaktor: Andrin Rasha

Në anglisht: Msc. Xhorxhina Seferi, Universiteti Bedër

Zani i Naltë

Bordi shkencor: Prof. Dr. Ayhan Tekines, Austri
Prof. Dr. Hajri Shehu, Tiranë
Prof. Dr. Qazim Qazimi, Kosovë
Prof. Dr. Sadije Bushati
Prof. Asoc. Tidita Abdurrahmani, Universiteti Bedër
Prof. Asoc. Dr. Fahrush Rexhepi, Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë
Prof. Asoc. Dr. Majlinda Peza-Perriu, Universiteti “Al. Xhuvani”, Elbasan
Doc. Dr. Fahredin Ebibi, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Naser Ramadani, Fakulteti i Shkencave Islame, Shkup
Doc. Dr. Ramadan Çipuri, Universiteti i Tiranës
Dr. Ana Uka, Universiteti Bedër
Dr. Agron Tufa, Zvicër
Dr. Ardian Muhaj, Instituti i Historisë, Qendra e Studimeve Albanologjike
Dr. Atakan Derelioglu, SHBA
Dr. Erlis Çela, Universiteti Bedër
Dr. Ilirjana Kaceli, Universiteti Bedër
Dr. Matilda Likaj, Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës
Dr. Xhemal Seferti, Universiteti Bedër
PhD. Cand. Ali Zaimi, Medreseja e Tiranës
PHD. Cand. Hysni Skura, Universiteti Bedër
MS/MA Fatos Kopliku, Washington DC, SHBA
MA. Sabri Bajgora, Instituti për Hulumtme dhe Studime Islame, Prishtinë
Msc. Agron Hoxha, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Msc. Lorela Shehu, Universiteti Florida
H. Resul Rexhepi, Prishtinë
Xhemal Balla, Tiranë

Fushat: Shkencat Islame / Tefsir / Hadith / Fikh / Sociologji / Filozofi / Gjuhësi / Letërsi / Psikologji / Histori / Kulturë / Art, etj.

Realizimi grafik: Erzen Carja

Fotoja në kopertinë: Xhamia e Karapicit, Tiranë, vitet 20', foto AQSH

Adresa: Komuniteti Mysliman i Shqipërisë
Rr. “George W. Bush”, Nr. 50, Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zaninalte.al

Web: www.zaninalte.al

Përmbajtja

Editorial

1. Në vend të lamtumirës dhe në prag të 100 vjetorit të themelimit të revistës shkencore “Zani i Naltë”, **Dr. Genti Kruja** 07

Shkenca Islame

2. Sistemi Gjyqësor në Islam, **Prof dr. Qazim Qazimi** 11

3. Ndikimi i Kur’anit Fisnik në Gjuhën Arabe,
Prof. dr. hfz. Hajredin Hoxha 28

Kur’ani dhe Shkenca

4. Komentimi i sures Fatiha nga dijetarët shqiptarë H. Vehbi Dibra - H. Ibrahim Dalliu - H. Ali Korça, **Xhemal Balla** 37

Studime

5. Bediuzzaman Said Nursi, Mrekullia e kohës II, **Dorian Demetja, Drejtorja e Kulturës, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë** 62

6. Një perspektivë islame mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale,
Abdullah Bulku 98

Përkthime

7. Jeta e Ebu Mensur El-Maturidiut dhe konteksti socio-politik dhe teologjik në Azinë Qendrore në shekullin X – Pjesa e parë, **Aref Chaker** 120

Recensë

8. Veprimtaria botuese e teologut boshnjak Enes Kariq e përkthyer në gjuhën shqipe, **Azmir & Behrim Jusufi, Prizren** 137

Personalitete

9. Haxhi Hafiz Mahmud Dashi 150

Retrospektivë

10. Njeriu dhe Gjithsia I 153

Abstracts in English 164

Rregullat e shkrimit 171



Në vend të lamtumirës dhe në prag të 100 vjetorit të themelimit të revistës shkencore “Zani i Naltë”

Dr. Genti Kruja*

Teksa gjendemi në prag të 100 vjetorit të themelimit të revistës “Zani i Naltë” dhe 10 vjetorit të rithemelimit të saj, kam vendosur se tashmë ka ardhur koha që ta dorëzoj stafetën e drejtimit të revistës si kryeredaktor the rithemelues i saj, duke shpresuar dhe uruar për suksese pa fund për këtë “zâ të naltë” të mendimit dhe qytetërimit islam në gjuhën shqipe.

* * *

U njoha me “Zanin e Naltë”, që fëmijë teksa ruheshin në fshehtësi gjatë regjimit komunist disa kopje të vjetra të botimit të saj në familjen tonë, së bashku me një libërth lutjesh e një abetareje Kur’ani me autor Hasan Tahsinin (mësuesin dhe kaligrafin shkodran të viteve 30-40

të shekullit të kaluar).

I rritur me dashurinë e gjysheve dhe bisedave të tyre për besimin, pata fatin që me familjen time të merrja pjesë në ceremoninë e parë të faljes së xhumasë, pas dekadash ndalimi, më 16 nëntor 1990 në xhaminë e Plumbit. Më pas në 1992 u themelua gazeta “Drita Islame”, të cilën e blija te gazetashitësit me plot zell e përmallim. Pas një farë kohe u abonova dhe numrin e radhës, atëmot të përdyjavshëm, e merrja nga imami i xhamisë së Bardhë, Perash, mësues dhe komshi me ne, i ndjeri Nazim Bërdica. Një ditë më tha: “A vjen me mua t’i shpërndajmë abonetë?” Ishte një gëzim i madh për mua. Edhe pse më pas u largova për studime jashtë Shqipërisë, vazhdova të isha i abonuar edhe në

vitet në vijim. Ndoshta kjo dashuri për “Dritën Islame”, mu kthye në një dhuratë nga Zoti, që kur u ktheva nga studimet në vitin 2003 të filloja punë si redaktor i gazetës për dy vite, për t’u rikthyer si drejtor i saj nga viti 2013 deri në 2017, kohë kur tashmë ishte kthyer në revistë me kontributin e kryeredaktorit dhe drejtorit të saj Agron Hoxha (2003-2013).

Gjatë viteve kur shërbeja si drejtor i Kulturës në Komunitetin Mysliman, nga viti 2010 deri në 2017, krahas botimit dhe ribotimit të disa librave origjinalë të dijetarëve myslimanë shqiptarë, e shihja të nevojshme ringjalljen e traditës së botimeve me autorë shqiptarë, pas botimit të përkthimeve të shumta, që kishin plotësuar një nevojë gjatë viteve ’90. Në ato vite kishim filluar të gjenim me vështirësi ndonjë botim të vjetër të revistës “Zani i Naltë”, ku së bashku me kolegët i fotografonim e më vonë skanonim për t’i pasur për ndonjë studim, apo ribotim të ndonjë artikulli. Kjo na e shtoi edhe më shumë dëshirën për t’i poseduar të plota të gjithë numrat, botuar në vitet 1923-1939. Kështu pas disa kërkimeve arritëm t’i gjenim shumicën e tyre në Bibliotekën e qytetit Shkodër, ku falë mbështetjes së drejtorit të atëhershëm Prof. Gjovalin Çunit dhe punës së znj. Sidita Hallunit, arritëm të dixhitalizonim shumicën e numrave të revistës “Zani i Naltë”. Pas kësaj pune, numrat që mungonin u

siguruan në Bibliotekën Kombëtare nëpërmjet mbështetjes së Prof. Aurel Plasarit dhe pjesa tjetër nga Prof. Hasan Bello, Prof. Persida Asllani dhe z. Ferit Hafizi, ndaj të cilëve mbetem mirënjohës për këtë kontribut të vyer për trashëgiminë tonë kombëtare. Më pas filloi puna për pastrimin dixhital të tyre falë punës së Bledar Xamës, Indrit Isufit dhe Hysen Voglit. Kështu u bënë gati për botim të gjithë numrat të ndara në 10 vëllime me rreth 5.000 faqe gjithsej, ku pas botimit të vëllimit të parë në 2012 me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë në 2013 doli nga botimi kolana e plotë “Zani i Naltë”, si një botim i përbashkët i tri bashkësive islame shqiptare, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Fetare Islame e Maqedonisë. Sot kjo kolana ka zënë vend në biblioteka të shumta, universitete dhe institucione të ndryshme akademike dhe jo vetëm për t’u studiuar e hulumtuar jo vetëm nga studiues të fushës, por edhe nga ata të fushave të ndryshme të hulumtimit.

“Zani i Naltë” ishte revista e parë zyrtare e Komunitetit Mysliman Shqiptar, themeluar në vitin 1923, menjëherë pas ngritjes së institucionit të KMSH-së, pas Kongresit të parë Mysliman Shqiptar. Periudha e parë e botimit të saj zgjati nga tetori i vitit 1923, deri në maj 1939, duke u bërë kështu një prej revistave më jetëgjatë në shqip (16 vite me 153 numra

gjithsej), si dhe revista e parë e këtij lloji për nga fushat që mbulonte.

Pas nxjerrjes nga hiri i botimeve të vjetra të revistës “Zani i Naltë” në tetor të vitit 2012 me rastin edhe të 100 vjetorit të ngritjes së flamurit vendosëm rithemelimin e kësaj reviste gati shekullore, duke përfshirë në redaksi personalitete dhe akademikë nga të gjitha trevat shqiptare. Me daljen e numrit të parë, u zhvillua dhe një ceremoni promovimi, duke ndezur edhe një herë te dashamirët e saj dëshirën për të kontribuar me botime artikujsh dhe shpërndarje në të gjithë Shqipërinë dhe përtej saj nëpërmjet abonimeve të përvitshme.

Periudha e dytë e revistës “Zani i Naltë”, që nga rithemelimi e deri më tani (2012-2022), përmban artikuj të mirëfilltë shkencorë me trajtime akademike në fushat e shkencave të ndryshme islame, por edhe në fushat e tjera sociale, duke u bërë kështu një trashëguese e denjë e emrit të vet, ashtu siç ishte që në themelimin e saj më 1923.

Kështu tashmë prej dhjetë vjetësh, revista shkencore “Zani i Naltë” është tribuna, ku shpalosen njohuritë e personaliteteve akademike nga Shqipëria dhe trojet kombëtare, Kosovë, Maqedoni dhe viset e tjera shqiptare, si dhe nga bota Islame, Evropa, SHBA, etj., në fushën e shkencave islame (legjislacioni islam, fikh, tefsir, hadith, etj.), si dhe në shkencat shoqërore (sociologji,

filozofi, psikologji, histori, gjuhë-letërsi, etj.), e pajisur gjithashtu dhe me ISSN.

Krahas këtyre, në çdo numër revista ka botuar të paktën nga një personalitet shqiptar të kulturës islame, i cili ka lënë gjurmë në historinë e vendit tonë dhe jashtë tij për kontributet e vyera në shumë fusha të jetës, në shërbim të Islamit dhe Atdheut, si dhe gjithashtu ka sjellë para lexuesit shqiptar ribotimin e një artikulli të zgjedhur nga numrat e vjetër të revistës “Zani i Naltë” (1923-1939) dhe revistës “Kultura Islame” (1939-1945) në rubrikën “Retrospektivë”.

Në këtë dekadë, pas rithemelimit më 2012, si një organ i përtremuajshëm dhe prej tre vjetësh i përgjashtëmuajshëm kanë dalë gjithsej 34 numra me rreth 4.000 faqe artikuj shkencorë, të ndara në më shumë se 30 rubrika të ndryshme, si dhe kanë shkruar dhe janë botuar 323 artikuj nga rreth 200 autorë të ndryshëm, si akademikë, profesorë e personalitete të shquara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Rubrikat më me shumë artikuj janë, Shkenca Islame, Histori, Studime të ndryshme, Personalitete, Retrospektivë, Gjuhë-Letërsi, Shkenca Komunikimi, Sociologji, si dhe rubrika të tjera si, Filozofi, Gjeografi, Jurisprudencë Islame, Mjekësi, Pedagogji, Përkthime, Psikologji, Shkenca dhe Besimi, Shkenca Ekzakte, Shkenca Politike, etj.

Bordi editorial i kësaj reviste shkencore përbëhet gjithashtu nga personalitete të njohura të botës akademike, edukative dhe kulturore nga të gjitha trevat shqiptare, por jo vetëm, duke e bërë këtë revistë si një “zâ i naltë” (zë i lartë) i studimeve dhe shkencave islame të gërshtuara dhe renditura së bashku me ato shoqërore.

Artikujt e saj dhe të gjitha numrat dixhitalë në formatin pdf gjenden online në faqen www.zaninalte.al ku krahas saj revista është e pranishme edhe në rrjetet sociale, Twitter, Facebook dhe kanalin Youtube.

Sot pas 10 vitesh kontribut njëherë si drejtor i revistës “Zani i Naltë” (2012-2017) dhe si kryeredaktor i saj (2017-2022), duke shpresuar dhe uruar për një zhvillim të mëtejshëm të saj, i jap lamtumirën, duke e dorëzuar stafetën si drejtues i saj, por duke vazhduar të jem një nga anëtarët e Bordit Editorial të revistës “Zani i Naltë”.

Në këto 10 vite, dua të shpreh mirënjohjen time për të gjithë bashkëpunëtorët ndër vite, autorët dhe dashamirësit e tij të shumtë, anëtarët e Bordit Editorial dhe Bordit Shkencor. Mirënjohje për tre kryetarët, të cilët mbështetën rithemelimin dhe vazhdimësinë e saj, H. Selim Muça (Zoti e mëshiroftë), Dr. Skender Bruçaj dhe H. Bujar Spahiu, drejtorin e Kulturës z. Dorian Demetja dhe pa dyshim redaktorin dhe bashkëpunëtorin e ngushtë të këtij rrugëtimi z. Andrin Rasha. Falënderime të gjithë kolegëve të tjerë dhe sidomos lexuesve, që na mbështesin dhe përkrahin ndër vite.

Jetë të gjatë e rrugëtim të hajrit “Zani i Naltë”.

* Kryeredaktor i revistës “Zani i Naltë” (2012-2022).

SISTEMI GJYQËSOR NË ISLAM

Prof dr. Qazim Qazimi

Abstrakt

Zoti i Madhërisëm e ka krijuar njeriun si qenie shoqërore e cila nuk mund të jetojë plotësisht e pavarur dhe e izoluar nga të tjerët. Krijesa njeri, në rrethin ku jeton, si e tillë, jeton në një ndërvarësi e cila shpeshherë shkakton grindje dhe përçarje, atëherë kur ndeshen interesat personale. Kjo gjë manifestohet edhe me konflikte, shkaku i të cilëve është privimi ose shkelja e të drejtave të individëve apo grupeve të ndryshëm.

Sundimi i ligjit, si parim, është i pranuar në gjithë botën e qytetëruar. Por, nëse bëhen krabasime mes interpretimeve dhe implementimeve të ndryshme rreth sundimit të ligjit, mund të vërehen dallime të konsiderueshme juridike-ligjore mes shteteve të ndryshme. As Kur'ani Fisnik dhe as Tradita Profetike nuk përkufizojnë ndonjë një formë të caktuar të qeverisjes. Përveç faktit që kërkohet, që forma e zgjedhur nga njerëzit të bazohet në punën e saj të drejtësisë ose edhe më mirë të Ligjet e Allahut (xh.sh.).

Ekspertët e ligjvënies në qeveritë bashkëkohore kujdesen që të shkruajnë dhe përmbledhin shënime shpjeguese për të sqaruar qëllimin e përgjithshëm të ligjit dhe qëllimet e secilit nen në veçanti. Pikërisht këto shënime shpjeguese, bashkë me të gjitha hulumtimet dhe debatet të cilat shënohen me rastin e propozimit dhe miratimit të një ligji, shërbejnë si ndihmesë për juristët dhe gjykatësit për të kuptuar ligjin përkatës dhe për ta zbatuar atë. Nga këto, mund të shohim se interesat e Sberiatit nuk kanë të bëjnë vetëm me aspektet personale të fesë ose riteve të adhurimit, por merren me të gjitha aspektet e jetës. Shteti që pretendon të jetë shtet islam e ka detyrim të mbështesë të drejtën dhe t'i kundërvihet të padrejtës. Shteti islam është përgjegjës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve të tij, myslimanë qofshin apo jomyslimanë. Ai duhet t'u sigurojë atyre nevojat bazë të jetës. Sot nuk ka ndonjë shtet islam ideal, por ka disa modele që në vazhdimësi po bëhen përpjekje sistematike që të ndërtohen sisteme islame adekuate, por, tani për tani, në horizont nuk shihet ndonjë dritë shpresëdhënëse në këtë drejtim.

Vetë Zotit i Madhërishëm e ka krijuar njeriun si qenie shoqërore e cila nuk mund të jetojë plotësisht e pavarur dhe e izoluar nga të tjerët. Krijesa njeri, në rrethin ku jeton, si e tillë, jeton në një ndërvarësi e cila shpeshherë shkakton grindje dhe përçarje, atëherë kur ndeshen interesat personale. Kjo gjë manifestohet edhe me konflikte, shkak i të cilëve është privimi ose shkelja e të drejtave të individëve apo grupeve të ndryshëm.

Sundimi i ligjit, si parim, është i pranuar në gjithë botën e qytetëruar. Por, nëse bëhen krahasime mes interpretimeve dhe implementimeve të ndryshme rreth sundimit të ligjit, mund të vërehen dallime të konsiderueshme juridike-ligjore mes shteteve të ndryshme. As Kur’ani Fisnik dhe as Tradita Profetike nuk përkufizojnë ndonjë një formë të caktuar të qeverisjes. Përveç faktit që kërkohet, që forma e zgjedhur nga njerëzit të bazohet në punën e saj të drejtësisë ose edhe më mirë të Ligjet e Allahut (xh.sh.).

Duhet të dihet se Sheriati, në rend të parë, është një ligj që rregullon marrëdhëniet mes myslimanit dhe Zotit të tij, ndaj shtetet demokratike nuk do të duhej që të vendosin ligje që pengojnë ushtrimin e lirë të fesë.

Edhe në disa shtete islame, e drejta e kodifikuar islame – Sheriati - është realitet që i kufizon disa të drejta të grave për gjykim, por pa diskriminim, nga vetë fakti se femra,

edhe nga aspekti biologjik, veçohet nga mashkulli, dhe për këtë arsye ndodh që të mos ketë qasje të njëjlojtë me burrat ndaj gjykatave. Islami i ka dhënë gruas mundësi që të ndihet e çliruar prej çdo lloj trysnie sociale që e privon atë prej barazisë gjinore. Myslimanët e kanë shembullin e tyre më të mirë në jetën e bashkëshortes së Profetit Muhamed, Aishes, e cila ishte një dijetare e avancuar më së miri, mësuese dhe një drejtuese e çmuar për kohën dhe bashkësinë në të cilën jetoi.

Ekzistimi i një sistemi gjyqësor, që parandalon padrejtësinë dhe shtypjen, është i nevojshëm në botën e qytetëruar. Ky sistem do i siguronte të dobët e të abuzuarit se gëzojnë të drejtat e tyre që ju takojnë, duke përcaktuar e veçuar të drejtën nga e padrejta. Kjo do të arrihet me sistemin gjyqësor që ka fuqinë e marrjes së vendimeve ligjore në rastet e ndryshme të konflikteve dhe cenimin e së drejtës.

Për këtë shkak ekzistimi i sistemit gjyqësor, në Fenë Islame, si dhe në fetë e shpallura para Islamit, konsiderohet obligim-detyrim fetar.

Në Kur’an gjejmë ajetin ku Allahu (xh.sh.) thotë:

لَقَدْ أَرْسَلْنَا رُسُلَنَا بِالْبَيِّنَاتِ وَأَنْزَلْنَا مَعَهُمُ الْكِتَابَ وَالْمِيزَانَ لِيَقُومَ النَّاسُ بِالْقِسْطِ

“Ne i dërguam të dërguarit Tanë me dokumente të qarta dhe Ne zbritëm me ata librin dhe drejtësinë që t’i përmbahen njerëzit të së drejtës.”²¹

1. Kur’ani, El-Hadid, ajeti 25.

1. Gjyqësori në periudhën e Profetit dhe hilafetit

Është realitet i dëshmuar se pushteti i Muhamedit (a.s.) ishte i bazuar në fe. Tek ai u bashkuan pushteti ligjdhënës (ngase ishte profet i shpallur ligjdhënës) dhe pushteti gjyqësor-El-Kada. Qeverisja e Profetit (a.s.) kishte të gjitha karakteristikat teokratike.

وَإِنْ حَكَمْتَ فَأَحْكُم بَيْنَهُم بِالْقِسْطِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُقْسِطِينَ.

“...Por nëse gjykon mes tyre, gjyko drejt; Allahu i do të drejtët.”²

Sipas burimeve islame, Allahu është dhe paraqet burimin themelor të ligjshmërisë. Ai është ligjdhënës, ndërsa Muhamedi (a.s.) ishte komentues e gjykues. Nga Kur’ani mësojmë edhe bazat themelore të demokracisë. Tek ai mësojmë të jetë porositur Muhamedi (a.s.) me Kur’an:

وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ فَإِذَا عَزَمْتَ فَتَوَكَّلْ عَلَى اللَّهِ إِنَّ اللَّهَ يُحِبُّ الْمُتَوَكِّلِينَ*

“Konsultohu me ta në çështje (të ndryshme), e, kur të vendossh, (për ndonjë gjë) atëherë mbështetu tek Allahu, se vërtet Allahu i do ata që i mbështetën”³.

Megjithëse Profeti (a.s.) ishte sovran në punët dhe vendimet e tij, ai për shumë punë aplikonte sistemin e Shuras, një (Bord Konsultativ), me sahabët e tij dhe, është vërtetuar t’u ketë thënë sahabëve se, ju jeni më të ditur se unë për çështje-punë të kësaj

jetë.

Ebu Hurejretu, njëri prej shokëve dhe njëri prej transmetuesve më të mëdhenj të haditheve të Profetit (a.s.) thoshte:

عن أبي هريرة قال ما رأيت أحدا قط كان أكثر مشورة لأصحابه من رسول الله صلى الله عليه وسلم.

“Nuk kam parë asnjëri që të konsultohet me shokët e vet më shumë se Profeti a.s.”⁴

Pas hixhretit (shpërnguljes) së Muhamedit dhe ndjekësve të tij për në Medinë, rolin e një gjykatësi për myslimanët e mori përsipër Muhamedi. Profeti, edhe pse ishte sundimtari real i Medinës, shkroi marrëveshjen e Medinës që sanksiononte se myslimanët do të gjykoheshin në bazë të Sheriatit ndërsa hebrenjtë sipas ligjit të Toras (Teuratit). Mesazhi kur’anor është që Profeti (a.s.) të jetë model e shembull për myslimanët:⁵

لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ
“Vërtet për ju në të Dërguarin e Allahut keni një shembull të mr ekullueshëm”⁶.

I dërguari i Allahut ishte gjykatësi më i drejtë që njeh historia, i cili këtë detyrë e ushtronte në qytetin e Medinës. Me gjykim prej sahabëve më të angazhuarit ishin: Umer bin Hattabi, Alij bin Ebi Talibi, Abdullah

4. Hadithin e transmeton Ahmedi dhe Shafiu me nr. 3271.

5. El-Meusu’a El-fikhijje, botimi I. Kuvajt 1995, vol. 32, f. 189.

6. Kur’ani, El-Ahzab, ajeti 21.

2. Kur’ani, El-Maide, ajeti 42.

3. Kur’ani, Al ‘Imran, ajeti 159.

bin Mesudi, Aishja (gruaja e Profetit a.s.) Zejd bin Thabiti, Abdullah bin Abbasi dhe Abdullah bin Umeri r.a.⁷ Më pastaj Profeti (a.s.), emëroi disa nga shokët e tij në post të gjykatësit dhe ata e ushtronin detyrën e tyre jashtë Medinës. Ishin Alij bin Ebi Talibi dhe Muadh bin Xhebeli ndër të parët që u ngarkuan me këtë detyrë nga Profeti (a.s.) kur u dërguan me punën e misionarit në Jemen.

Edhe në kohën e halifëve të drejtë (خلفاء الراشدين) sunduesi ishte ai që caktonte gjyqtarët, qeveriste me punën e tyre dhe mbronte pavarësinë e tyre. Ka raste kur disa sundues lokalë (të emëruar nga Halifi), por edhe dhe vetë halifët u nënshtroheshin gjykimit para gjyqtarëve të Shtetit Islam.

Bazuar në traditë e Profetit (a.s.) edhe halifët e parë kishin funksionin e gjyqtarëve për bashkësinë myslimane. Umer bin El-Hattabi ishte i pari që i dha pavarësi sistemit gjyqësor nga posti i Halifit dhe posti i sunduesit lokal Valiut. Më vonë, në periudhën e halifëve emevitë u vendosën gjykatës, të cilët ishin relativisht të lirë për dhënien e vendimeve, dhe të formulonin gjykimet sipas “re’jit” (mendjes-mendimit të vet) por duke mos rënë ndesh me Kur’anin, Sunetin (Traditën e Profetit) e as me

7. Ibnu Kajjim El- Xheuzijeh, “Alamu El-Muuaki’ine an Rab-bi El-Alemin” redaktuar nga Abdu Err-Rahma El-Uekil, shtypshkronja El-Medenij , Kajro, pjesa e parë, f. 12.

urfin-traditën zakonore vendore. Në këtë mënyrë, sipas traditës, sistemi gjyqësor vazhdoi të zhvillohet gjatë tërë periudhës emevite dhe në fillim të dinastisë abbasite. Në periudhën (dinastinë) abbasite do të promovohet për herë të parë edhe posti i kryegjykatësit, i cili ishte autoritet që kishte të drejtën të emëronte dhe shkarkonte gjyqtarët. Ai përcillte dhe mbikëqyrte sjelljen e tyre si dhe mënyrën e ushtrimit të detyrës. Njeriu-personaliteti i parë që u emërua në këtë posti ishte Ebu Jusufi, nxënësi i Imam Ebu Hanifes (r.a.). Më vonë ky institucion u përhap në gjithë botën islame dhe si i tillë rrugëtoi me batica e zbatice, po pa u sfiduar asnjëherë deri nga fundi i Perandorisë Osmane.

Historiku i gjyqësorit islam mban në mend dhe me respekt kujton emrat e shumë gjyqtarëve që përmenden si pishtarë dhe simbole të drejtësisë e integritetit. Nga ata po përmendim Ijas bin Muauije, Shurejh bin Abdil-lah, El-Izz bin Abdi Es-Selam që në mënyrën më të mirë aplikuan mësimet islame në fushën e drejtësisë.

Ata ishin një model i përhershëm dhe shembull se si duhet të sillet një gjykatës mysliman, i ndërgjegjshëm për punën dhe përgjegjësinë që ka marrë.

Kur flitet për sistemin gjyqësor në Islam, patjetër duhet përmendur fakti se Islami vendos direktiva të gjera dhe parime themelore që kanë

të bëjnë me jetën dhe se shumë rrallë angazhohet me detaje të hollësishme të jetës.

Sheriati, për myslimanët, paraqet shprehjen normative të fesë së tyre, ligjet që për burim kryesor kanë shpalljen e Zotit, Kur'anin dhe Sunetin (Praktikën) e Profetit të Zotit.

2. Sheriati (Sistemi legjislativ)

Islami i ka kushtuar dhe vazhdon t'i kushtojë rëndësi të madhe jetës, sikurse edhe nevojave shpirtërore dhe materiale të njerëzve. Me ligje të mira dhe të drejta, që kanë premisa hyjnore, ka rregulluar të gjitha fushat dhe aktivitetet e jetës njerëzore. Në harmoni të plotë me ligjet natyrore të jetës dhe në këto relacione nuk ka ndërprerje e as mungesë harmonie. Parimet dhe ligjet islame janë më perspektivë dhe më të begatë se ligjet e hartuara nga njerëzimi. Duke i krahasuar ligjet dhe rregullat islame me ligjet dhe rregullat ligjore të njerëzimit, dëshmojnë përparësitë e pakufishme të ligjit të Zotit ndaj të tjerëve.

Duhet ditur se termi Sheriat, në arabisht “ Sheriatun- شريعة”, në kuptimin etimologjik, do të thotë: rrugë e qartë, rruga e drejtë, rrugë që shpie te burimi i ujit. Kuptimi gjuhësor i fjalës shariat ngjashëm reflekton edhe në kuptimin e tij terminologjik: Ashtu siç është i domosdoshëm uji për jetën e gjallë

biologjike, njerëzore, shtazore e bimore, po ashtu edhe qartësia dhe pastërtia e Sheriatit Islam është ushqimi jetësor i shpirtit dhe i mendjeve njerëzore.

Duhet theksuar se Allahu ka dërguar Profetë gjatë gjithë kohës dhe i pari njeri - Ademi a.s. - ishte edhe ai vetë Profet. Të gjithë Profetët e dërguar kishin të njëjtin mision, besimin në një Zot të vetëm, por e veçanta është te ligjet qiellore (shariatet) që ndryshonin në përshtatje me nevojat njerëzore që kishte çdo vend dhe kohë.

Derisa në shariatet e mëhershme, hetohet se, në disa aspekte, kanë pasur karakter të kufizimit kohor dhe lokal, Sheriati Islam është gjithëpërfshirës, i pakufizuar në hapësirë dhe kohë, i vlefshëm për çdo vend dhe kohë, i kapshëm dhe i përshtatshëm për gjithë njerëzit dhe ofron zgjidhje për të gjitha çështjet e jetës trupore dhe shpirtërore.

Sheriati pasqyron shpalosjet reale dhe shembullore të mëshirës hyjnore; Allahu i Lartësuar thotë:

لِكُلِّ جَعَلْنَا مِنْكُمْ شِرْعَةً وَمِنْهَا جَا وَلَوْ شَاءَ
 اللَّهُ لَجَعَلَكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَلَكِنْ لِيَبْلُوَكُمْ فِي مَا
 آتَاكُمْ فَاسْتَبِقُوا الْخَيْرَاتِ إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُكُمْ
 جَمِيعًا فَيُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ فِيهِ تَخْتَلِفُونَ

“Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj (shariat) dhe një rrugë të qartë (program jete). Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë

të mira! Të gjithë do të ktheheni tek Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti.”⁸

3. a. Objektivat e shariatit

Nuk ka dyshim se Sheriati vepron për lehtësimin e jetës së atyre që përpiqen të bëjnë një jetë të ndershme, që e kënaq Zotin, dhe atyre që kanë marrëdhënie dashamirëse dhe paqësore me familjarët, miqtë, fqinjët, etj. Por, në të njëjtën kohë, Sheriati ia vështirëson jetën një njeriu egoist, kryeneç, të vrazhdë, shfrytëzues, mashtrues, etj. Sheriati nuk shfaq mëshirë ndaj kësaj kategorie të njerëzve mëkatarë e keqbërës.

Konsiderojmë se qëllimet dhe synimet e Sheriatit shumë bukur i ka identifikuar Imam El-Gazaliu kur thotë:

“Objektiva kryesore e Sheriatit është promovimi i mirëqenies së shoqërisë, e cila ngërthen në vete ruajtjen e fesë së tyre, jetës, intelektit, familjes dhe pasurisë. Çfarëdo që garanton sigurinë e këtyre pesë gjerave i shërben interesit publik dhe është e dëshiruar.”

Sheriati është ligj me premisa hyjnore, të cilin Allahu e shpalli dhe e qartësoi për mbarë njerëzimin. Burimi i këtij ligji është shpallja nga Zotit, e cila shfaqet në Kur’an, si fjalë e Zotit, dhe në Sunet apo hadithe të të Dërguarit të Tij, (fjalët,

8. Kur’ani, El-Maide, ajeti 48.

veprat dhe miratimet e tij). Ai mbron interesat e njerëzve dhe realizon ato në mënyrën më të përsosur që është e mundur. Ibni Tejmije thoshte: *“Ligji islam ka ardhur të realizojë ato që janë të dobishme për njeriun në mënyrë sa më të plotë dhe t’i ndërpresë apo t’i pakësojë e zvogëlojë të dëmshmet.”*⁹ Islami thërret që të promovohet e mira dhe vlerat shpirtërore e morale dhe të demaskohet e keqja dhe antivlera.

Ekzistojnë edhe shumë e shumë fakte e dëshmi nga literatura islame që vërtetojnë se Ligji islam - Sheriati jep parametrat e një jete cilësore me të cilën realizohen interesat më të larta dhe arrihet mirëqenia më e lartë e mundshme për njeriun në këtë botë dhe në atë të përtejmen:

إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ وَالْإِحْسَانِ وَإِيتَاءِ ذِي الْقُرْبَىٰ وَيَنْهَىٰ عَنِ الْفَحْشَاءِ وَالْمُنْكَرِ وَالْبَغْيِ

“Vërtetë Allahu urdhëron drejtësi, bamirësi, ndihmë të afërmve, e ndalon nga imoraliteti, nga e neveritura dhe dhuna.”¹⁰

Duhet ditur se disa prej ligjeve të Sheriatit Islam janë ndërtuar, rregulluar dhe sanksionuar nga urdhra dhe sqarime të drejtpërdrejta me ajete të Kur’anit Fisnik, e disa të tjera kanë ardhur dhe janë sqaruar drejtpërdrejt nga udhëzimet e Profetit (a.s.). Madje, ka edhe disa burime të tjera - dytësore - që kanë ardhur si rezultat i ngjarjeve të

9. Ibnu Et-Tejmijeti, “Minhaxhu Es-sunneti En-Nebeuijjeti”, 2/131 (ابن تيمية «منهاج السنة النبوية»)

10. Kur’ani, En-Nahl, ajeti 90.

kaktuara gjatë jetës së tij.

Burimet e tjera, që vlerësohen të jenë si dytësore, bazohen te gjykimet e dijetarëve, të cilat i kanë mbështetur me konsensusin (ixhmain), traditën zakonore (urfin) dhe interesin e përgjithshëm (El-maslahatu). Edhe pse këto burime vlerësohen të jenë dytësore, nuk ka dyshim se edhe ato mbështeten në mënyrë deduktive nga Kur’ani dhe Suneti, duke përdorur metodën krahasuese me fjalët e Profetit (a.s.), veprimet dhe mënyra sesi ai veproi dhe zgjodhi për çështje analoge të kaktuara në jetë. Në rast se për to nuk ka prova as në Kur’an, as në Sunet dhe as në Ixhma të teologëve islamë, ato bazohen mbi mendimin e teologëve juristë - fukahave. Fikh-u, në këtë mënyrë, është shkenca e rregulloreve ligjore El-Ahkamu Esh-sherijjeti brenda sistemit juridik islam të sheriatit, nëpërmjet së cilës, në Fenë Islame, rregullohet çdo sferë e jetës private dhe publike.¹¹

Kështu pra, të gjitha ligjet e Sheriatit, së pari, bazohen te Kur’ani dhe Suneti dhe nëse nuk gjendet sqarim në këto dy burime, janë dijetarët ata të cilëve u takon e drejta e ixhtihadit (hulumtimit dhe gjykimet profesionale), që duke përdorur njohuritë profesionale

dhe inteligjencën e tyre arrijnë tek analogjia e saktë. Ashtu si në shumicën e kodeve ligjore, edhe këtu, disa çështje të veçanta-speciale, konkretisht u kalohen profesionalistëve ligjorë, siç janë dijetarët dhe gjykatësit.

Duhet pasur parasysh se drejtimitet e para juridike të fesë islame kanë lindur aty nga gjysma e dytë të shekullit të 8-të në Kufe dhe Basra të Irakut, në Sham - Siri po edhe në Medinë e Mekke, të cilat mund të ishin të ndryshëm nga njëri-tjetri, jo vetëm sipas të drejtës zakonore vendore, por edhe sipas interpretimit të materialit të trashëguar të haditheve - Traditës së Profetit Muhamed (a.s.).

Sistemi ligjor islam, i cili rrjedh nga (*sheriatit*), nuk e ka bazën vetëm te Kur’ani dhe Suneti i Profetit (a.s.). Të katër drejtimitet juridike sunite njohin burime të jurispruencës (أصول الفقه - *Usulu El-fikih*), që vlejnë si bazat e jurispruencës islame. **Fikhu** - فقه , gjuhësisht do të thotë: të kuptuarit e drejtë e asaj që synohet, njohja, të kuptuarit, thellimi në diçka. Në Këtë kuptim është thënë edhe hadithi:

(مَنْ يُرِدِ اللَّهُ بِهِ خَيْرًا يُفَقِّهْهُ فِي الدِّينِ).

“Atij që Allahu ia do të mirën, ia mundëson (thellimin) që ta kuptojë fenë.”¹² Fetarisht **Fik’hu** - الفقه i

11. El-Meusu’a El-Fikhijjetu, Botimi i Kuvajtit 1995, vol. 32, f. 193. J. Wensinck und J. H. Kramers: *Handwörterbuch des Islam* (Manuali i fesë islame). Brill, Leiden 1941, f. 130.

12. E transmeton Muauije, gjendet te Buhariu, (arabisht-anglisht), vëll. 4, f. 223-224, hadithi nr. 346; Muslimi Abdul Hamid Sidiki, *Sahib Muslim* (përkth. në anglisht.), Bejrut: *Dar al-Arabia* n.d., vëll. 3, f. 1061,

referohet tërësisë së ligjeve islame, të cilat deduktohen nga Sheriati sipas udhëzimeve hyjnore.¹³

Lindja e drejtimeve juridike, të cilat mbajnë përkatësisht emrat e themeluesve të tyre, është rezultat i aktiviteteve në lëmin e shkrimeve të hadith-it dhe të jurisprudencës në fillim të shekullit të 8-të. Kjo do të mundësojë të kuptojë thelbin e zhvillimit të *medh'hebeve* (Shkollave juridike islame) si dhe kontributin e tyre në lëmin e Fik'hut.

Me fjalë tjera, Fik'hu nuk mund të përcaktohet vetëm nga një shkollë e vetme e jurisprudencës islame. Të gjitha *medh'hebet* kanë qenë instrumente të rëndësishëm në sqarimin dhe aplikimin e Sheriatit. Sheriati dhe *fik'hu* së bashku duhet të jenë forca unifikuese, të cilat i bashkojnë të gjithë myslimanët, pa marrë parasysh vendin, kohën apo kulturën.

3. b. Dallimet mes fik'hut dhe sheriatit

1. Sheriat janë ligjet e shpallura nga Allahu (xh.sh.) në Kur'an dhe Sunet, ndërsa fikh janë ligjet e dedukuara nga Sheriati për situata të caktuara, të cilat nuk janë trajtuar drejtpërsëdrejti në Sheriat.

2. Sheriati është i prerë dhe i

hadithi nr. 4720; Tirmidhiu dhe të tjerët.

13. Muhamed Shallabi, *El-Med'hal fi et-Ta'rif bil-Fikh el-Islami* (Bejrut, *Dar en-Nebdah el-Arabijeh*, 1969), f. 28.

pandryshuar, kurse Fik'hu ndryshon sipas rrethanave në të cilat aplikohet.

3. Ligjet e Sheriatit janë, në shumicën e rasteve, të përgjithshme. Ato përcaktojnë parimet themelore. Në dallim nga kjo, ligjet e Fik'hut priren të jenë specifike. Ato demonstrojnë se si duhen aplikuar parimet themelore të Sheriatit në rrethana të caktuara.¹⁴

3. c. Periudhat nëpër të cilat ka kaluar zhvillimi i Sheriatit:

I. Periudha prej hixhretit 622 (e.r.) deri me vdekjen e Muhamedit (a.s.) 632 (e.r.). Kjo periudhë emërtohet si "Kohë e legjislacionit".

II. Periudha pas vdekjes së Muhamedit (a.s.) e deri në themelimin e shkollave të para juridike ose periudha e as'habëve (shokëve) dhe tabi'inëve (nxënësve) të Muhamedit (a.s.).

III. Periudha prej fillimit të shek. 2-të hixhri (sipas kalendarit mysliman), e deri në fund të shek. 3 hixhri ose periudha e formimit të katër shkollave juridike të "Ehlu Es-Sunneti" (Hanefij, Shafij, Malikij dhe Hambelij).

IV. Periudha prej fillimit të shek. 4 hixhri deri në kohën e autorit ose

14. MBUROJA.net -2 **Zhvillimi i Fikhut dhe i Medh'hebeve** (Hyrja) Autor: Dr. Bilal Philips. Titulli në original: *The Evolution of Fiqh (Islamic Law and the Madh-habs)* [version elektronik] ©International Islamic Publishing House, Riyadh, KSA, 2006.

periudha e taklidit (imitimit).

Duke vështuar nga aspekti historikut të së Drejtës Islame dhe trashëgimisë që kemi, do të vërejmë se ajo u zhvillua në dy rrafshje.

1. Në rrafshin administrativ të Hilafetit, që nënkupton të drejtën që u zhvillua nga institucionet e Hilafetit; si kadinitë, myftinitë, muxhtehidët - ekspertët e afërt me pushtetin, praktikat perandorake, duke përfshirë nganjëherë edhe vendimet e sovranit (halifit, emirit, sulltanit, etj.).

2. E drejta e zhvilluar në mesin e dijetarëve (shoqërisë civile) që nënkupton dijetarët të cilët nuk kanë ushtruar dukshëm funksione shtetërore por kanë qenë të lirë në punën e tyre dhe kanë ndërtuar edhe “medhhebet”, drejtimit juridike islame-doktrinat (shkollat e tyre):

Medhhebi hanefit me në krye imamin (Ebu Hanifen r.a. 699-767), Medhhebi Shafit, sipas imamit (Muhammed bin Idris Esh-Shafij r.a. 767-820), Medhhebi Maliki, themeluar sipas imamit (Malik bin Enesi r.a. 715-795) dhe Medhhebi Hambelit i prirë nga imami (Ahmed bin Hanbeli r.a. 780-855).

3. d. Burimet e shariatit

Siç është thënë edhe më herët që sistemi ligjor islam, rrjedh nga *shariat*, i cili bazë substanciale ka Kur’anin dhe Sunetin e Profetit (a.s.), por, katër drejtimit juridike sunite njohin katër

burime të jurisprudencës islame, të cilat, që prej sistematizimit të të drejtës islame (e shumta prej kohës së Esh-Shafit 767-820)¹⁵ vlejné si bazat e jurisprudencës islame.

Burimet e Sheriatit ndahen në:

1. Burime parësore për të cilat dijetarët kanë rënë dakord, dhe
2. Burime dytësore për të cilat dijetarët nuk kanë rënë dakord.

Burimet parësore - tradicionale - për të cilat dijetarët kanë rënë dakord

I. Kur’ani Fisnik - القرآن الكريم

Kur’ani i zbriti Muhamedit (a.s.) nga ana e Zotit nëpërmjet melekut Xhibril, gradualisht, në mënyrë kronologjike, në një interval kohor prej 23 vjetësh. Kur’ani është libri i fundit hyjnor që i zbriti Profetit të fundit Muhamedit (a.s.). Përmban 114 sure, që kanë gjithsej 6360 ajete, duke numëruar këtu edhe ajetin fillues të çdo kaptine “**Në emër të Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit**”. Thelbi i mesazhit të tij është konfirmimi i monoteizmit dhe shprehja e nevojës shpirtërore, morale e njeriut për Allahun.

Ajo që nuk vihet në dyshim është fakti se, Kur’ani është fjala e Allahut, dhe këtë e provon stili i tij i paarritshëm dhe elokuenca që

15. Sezgin, Prof. Dr. Fuat: *Geschichte des arabischen Schrifttums* (Historia e shkrimeve arabe). Vol. 1, f. 484-490. Leiden, Brill. 1967

ai mbart në vete. Baza kryesore e Kur'anit është me përmbajtje dhe karakter moral edukativ, human dhe me vlera mbarë njerëzore. Mirëpo, Kur'ani paraqet edhe një kushtetutë me norma në vazhdimësi aktuale dhe universale. Por, mbi të gjitha janë dispozitat udhërrëfyese dhe ligjet me të cilat ai ka ardhur, të cilat mbartin lumturinë e kësaj bote dhe të botës tjetër. Allahu i Lartësuar në Kur'an thotë:

يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ ﴿١٥﴾ يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ

“O ithtarët e Librit! Juve ju erdhi i Dërguari Ynë, i cili ju shpjegon gjëra nga ato që i keni fshehur ju prej Librave (Teuratit dhe Ungjillit) dhe ju fal shumë. Juve ju erdhi prej Allahut dritë (i Dërguari) dhe Libër i qartë (Kur'ani), me të cilin Allahu i drejton ata që ndjekin pëlqimin e Tij, në rrugën e shpëtimit, i nxjerr nga errësira në dritë me lejen dhe vullnetin e Vet dhe i shpie në rrugën e drejtë.”¹⁶

Kur'ani – Përfshin të gjitha dispozitat që ndërlidhen me njeriun, me jetën e tij të kësaj bote dhe asaj të përtejmes.

Dispozitat e përfshira në Kur'an janë:

16. Kur'ani, El-Maide, ajtetet 15-16.

Dispozita e besimit (akides) - Ilmul El-Kelami (Apologjëtika);

Dispozita etiko-morale - Ilmu El-Ahlak (Etika);

Dispozita praktike - Ilmu El-Fikhi dhe (Usuli Fikhit) i cili ndahet në dy lloje:
- Dispozita e ibadeteve - rregullon marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin, obligimet si: namazi, ramazani, haxhi, zekati, etj.

- Dispozitat që kanë të bëjnë me marrëdhëniet e përditshme njerëzore.

Në Kur'an gjenden 500 ajete apo 1/13 pjesë e Kur'anit rregullon këto marrëdhënie. Sipas autorit egjiptian Abduluehab Hal-laf theksohet se të drejtës familjare i përkasin 70 ajete, të drejtës civile 70 ajete, të drejtës penale 30 ajete, gjyqësisë dhe procedurës gjyqësore 13 ajete, të drejtës kushtetuese 10 ajete, marrëdhëniet ndërkombëtare 25 ajete dhe ekonomisë dhe financave 10 ajete.¹⁷

“Nuk ekziston asnjë libër, i cili i përfshin të gjitha teoritë shkencore, qofshin ato matematikore, e që nuk bie në kundërshtim dhe kontradiktë me shkencën. Madje edhe librat që janë shkruar në shekullin e njëzetë kanë përjetuar mossakses dhe janë tejkaluar në të gjitha aspektet, përveç njërit libër - KUR'ANIT”. | *Filozofi francez Pleks Lozjen*

17. من جمادى الآخرة ١٣٧٥هـ - 5 في = يناير 19٥٦م - عبد الوهاب خلافاً: توفي - رحمه الله - في

II. Tradita Profetike (السنة النبوية)

Tradita e Profetit Muhamed (thëniet-porositë, ndalimet, lejimet, veprat, miratimet dhe braktisjet e disa veprave). Suneti - السنة - Tradita Profetike, mënyra e veprimit të tij, është sasia e thënieve dhe veprimeve të trashëguara të Profetit të fesë islame, duke paraqitur materialin më voluminoz të jurisprudencës islame.¹⁸ Suneti është trashëguar në formën e haditheve- autentike, të cilët janë fiksuar që herët me shkrim ose janë trashëguar gojarisht, duke paraqitur materialin më voluminoz të jurisprudencës islame.

Suneti është burimi i dytë parësor, është Tradita Profetike ku vetë Kur'ani vë në dukje rolin e Profetit a.s. kur thotë:

وَأَنْزَلْنَا إِلَيْكَ الذِّكْرَ لِتُبَيِّنَ لِلنَّاسِ مَا نُزِّلَ إِلَيْهِمْ وَلَعَلَّهُمْ يَتَفَكَّرُونَ

“Ndërsa ty (o Muhamed) të zbritëm Përkujtesën (Kur'anin), me qëllim që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur dhe që ata të mendojnë.”¹⁹

Shpjegimi vjen nëpërmjet asaj që ka folur, bërë e miratuar Profeti (a.s.). Edhe vetë Profeti a.s. ka folur rreth kësaj çështje duke thënë:

عن مالك أنه بلغه أن رسول الله صلى الله عليه وسلم قال: تركت فيكم أمرين لن تضلوا ما تمسكتن بهما كتاب الله وسنة نبيه.

18. Në lidhje me kuptimin dhe përdorimin e këtij termi shih: M. M. Bravmann: *The spiritual background of early Islam*.

19. Kur'ani, En-Nahl, ajeti 44.

“Kam lënë tek ju dy gjëra, që nëse kapeni pas tyre nuk do të humbisni kurrë pas largimit tim: Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit të Tij.”²⁰

Suneti - Paraqet veprimet e Muhamedit (a.s.), qofshin ato veprat e tij, deklaratat, apo miratimet duke heshtur (cilësitë e tij sipas muhadithinëve). Roli i sunetit në ndërtimin e shoqërisë dhe të së drejtës është i patejkalueshëm dhe i domosdoshëm, ngase vetëm në traditën e tij mësojmë në praktikë fenë dhe të drejtën e Sheriatit. Suneti është burim i sheriatit, ka bazën e vet ligjore në vetë Kur'anin ku Zoti i Lartëmadhërisshëm thotë:

وَمَا آتَاكُمُ الرَّسُولُ فَخُذُوهُ وَمَا نَهَاكُمْ عَنْهُ فَانْتَهُوا

“Çka ju jep (urdhëron) i dërguari (Muhamedi a.s.) merreni, dhe atë që ju ndalon ai largohuni nga ajo...”²¹

Muhamedi (a.s.) ka kryer katër funksione: Pranimin dhe kumtimin e shpalljes së Zotit, dhënia e sqarimeve për çështje fetare apo opiniononi, zgjidhja e grindjeve dhe udhëheqja e punëve publike të bashkësisë së re islame.

Dy funksionet e para kanë qenë specifike të Muhamedit (a.s.), ndërsa dy funksionet e fundit ka mundur t'i ushtrojë Halifi (udhëheqësi) pasardhës pas tij.

20. Transmetim i Enes bin Malikut në “El-Muuetta - 1395 الموطأ”.

21. Kur'ani, El-Hashr, ajeti 7.

III. Konsensusi- (الإجماع)

Ixhmai - konsensusi, është pajtimi, marrëveshja e teologëve, juristëve rreth një çështjeje ligjore. Ixhmai përkufizohet si konsensus, në një kohë të caktuar, i të gjithë dijetarëve myslimanë, të nivelit të ixhtihadit (hulumtimit dhe gjykimit profesional), rreth një dispozite të caktuar. Nëse Ixhmai është i mundur, me unifikimin e të gjithë dijetarëve rreth një dispozite, atëherë ai kufizohet brenda çështjeve të qarta që janë në pajtim me Kur'anin dhe Sunetin. Ixhmai, që të quhet i tillë, duhet të përmbushet sipas përkufizimit që përmendëm dhe në momentin që ai përmbushet konsiderohet si argument i prerë. Profeti (a.s.) ka thënë;

«لا تَجْتَمِعُ أُمَّتِي عَلَى ضَلَالَةٍ»، رواه أحمد في مسنده ، والطبراني
 “Umeti (komuniteti) im nuk unifikohet për diçka që do t'i shpie në humbje.”²²

Legjitimiteti i ixhmailt si burim për jurisprudencën bazohet në konceptin parimor se konsensusi mes teologëve nuk mund të jetë kurrë në kundërshtim me Kur'anin dhe Sunetin. Është meritë e Shafiut që parimi i konsensusit është rrënjësor si burimi i tretë i rëndësishëm për jurisprudencën në sistemin juridik islam.²³

Ixhmai - Parimi i konsensusit,

22. Transmetim i Ahmedit, Taberaniut dhe të tjerë me nr. 1235.

23. Miklos Muranyi (1987), f. 306-307.

dakordësimi i dijetarëve të një kohe nga umeti i Muhamedit (a.s.) për një çështje legjitime të sheriatit.

IV. Analogjia (القياس) Analogjia e juristëve (gjykimi i një materie, çështje të caktuar analoge me një tjetër të asaj natyre).²⁴

Gjatë procesit të zhvillimit të jurisprudencës, në shekujt 8 dhe 9, nuk arritën të zgjidhen në mënyrë të kënaqshme të gjitha çështjet ose aspektet përbërëse të praktikës së kultit me anë të tre burimeve të përmendura më lart. U bë e nevojshme që rregullat ligjore të nxjerra nga tre burimet e para të transmetohen me anë të analogjisë-krahasimit-ngjashmërisë me raste ose çështje të reja.

Kijasi është një procedure efektive në deduktimin e dispozitave, që kanë të bëjnë me çështjet e reja të panjohura në periudhat e mëhershme, si p.sh. drogat e ndryshme që tani janë krahasuar, janë analoge me pijet alkoolike dhe janë konsideruar si të ndaluara nëpërmjet kijasit, ku për analogji është marrë ndalimi i përdorimit të pijeve dehëse, siç përmenden në Kur'an. Dispozita në këtë rast mbështet te pasoja e ngjashme, që vjen si rrjedhojë e dozës së ngjashme që mbartin të dy

24. Ibnu Kajjim El- Xheuzijeh, “A'lamu El-Muuakiine an Rabi El-Alemin” redaktuar nga Abdu Er-Rahma El-Uekil, shtypshkronja El- Medenij , Kajro pjesa e parë, f. 140-164.

elementët e krahasuar.

Kijasi dhe procedurat e tij të larmishme, përdoren për t'i mundësuar gjykatësit të kuptojë arsyet dhe shkaqet kryesore të dispozitave të Kur'anit dhe Sunetit. Gjithashtu ndihmon në trajtimin e situatave njerëzore që ndryshojnë vazhdimisht dhe mundëson vënien në praktikë të dispozitave të reja më të përshtatshme.

Kijasi (Analogjia) bën krahasimin e një çështje që për dispozitën e saj të shariatit nuk ka argument parësor, me një çështje për dispozitën e së cilës ekziston argument për shkak se të dyja çështjet janë të barabarta në motivin e dispozitës.

Burimet dytësore- logjike për të cilat dijetarët nuk kanë rënë darkord

1. Tradita-zakonore - العرف - është ai veprim i cili nuk bie ndesh me burimet parësore të Islamit (Sheriatit) e të cilin njerëzit e kanë pranuar si të vetin dhe i njëjti ka zënë vend të thellë në shpirtrat e tyre.

E drejta zakonore medinase ka luajtur këtu një rol të madh por edhe praktikant administrative dhe ligjet në fuqi në territoret e lira.

2. Miratimi - الإستحسان (Preferencat e Arsyetimit Juridik). Ky burim vlerësohet i vlefshëm nëse një dijetar, ekspert i një fushe, braktis dispozitën që është kuptuar nga analogjia e qartë dhe miraton një

dispozitë tjetër që është kuptuar nga një analogji e fshehtë.

3. Interesi - المصلحة (Arsyetimi Juridik i bazuar në Interesat e Përgjithshme). Dijetarët e Islamit besojnë se Sheriati ka ardhur për të përmbushur interesat e njeriut për mirëqenie të tij dhe për ta ruajtur atë nga të këqijat dhe lëndimet. Ajo që provohet katërcipërisht se është e dobishme për myslimanët, si për fenë ashtu edhe për mirëqenien e njeriut në këtë botë, konsiderohet pjesë e përligjur nga Sheriati; po kështu ajo që provohet se është e dëmshme, si për fenë ashtu edhe për jetën e kësaj bote, konsiderohet e ndaluar.

El-Maslahatu El- Murseletu - المرسله المصلحة Dobia - interesi, është brenda qëllimeve të ligjdhënësit, kur nuk ka argument që dëshmon se ligjdhënësi një gjë të tillë e konsideron si të dobishme apo nuk e konsideron si të tillë.

4. Istis'habi - الإستصحاب - Arsyetimi juridik i bazuar në një gjendje të mëhershme për vazhdimësi; është vazhdim i një dispozite në gjendjen e mëparshme (në variantin e parë), përderisa të sillet një argument tjetër që do ta ndryshonte atë dispozitë.

5. Medh'hebi - المذهب shkolla juridike islame apo drejtim juridik islam i njohur ndërkombëtarisht (gjithandëj botës Islame).

6. Sheriati i atyre që ishin para nesh - shpalljet e mëhershme, që nuk bien ndesh me burimet parësore

të Islamit.

XI.2. e. Dispozitat e shariatit.

Dispozitat e Sheriatit ndahen në: Urdhëresa dhe Ndalesa.

Urdhëresat:

1. Farzi - الفرض obligim i prerë i sjellë nga Ligdhënësi (Allahu)

a. Farzi ajn - فرض العين obligim personal (individual)

b. Farzi kifaje - فرض الكفاية obligim kolektiv (shoqëror)

2. Vaxhibi - واجب detyrim absolut.

Veprimet e kategorive të sipërshënuara shpërblehen ndërsa moskryerja e tyre ndëshkohet!

3. Suneti - السنة النبوية Tradita Profetike - Veprime të rekomandueshme.

4. Mustehabi - مستحب vepër e preferuar. Për këto veprime ka shpërblime e moskryerja e tyre nuk ndëshkohet.

5. Mubahu - مباح veprime të lejueshme dhe indiferente, pa shpërblim e pa ndëshkim.

Ndalesat - المحرمات:

Haram - حرام vepër rreptësisht e ndaluar, autori i tyre ndëshkohet.²⁵

Kerahetun - كراهة e urryer,

veprime të ulëta, të papranueshme.

-Kerahetu Et-Tahrimijje -

التحريمية كراهة - urrejtje e fortë

- Kerahetu Et-Tenzihijje - التنهيزية

كراهة - urrejtje e butë.

3. Mufsid - مفسد e prishur (e shkatërruar).

Kerahetet dhe Mufside janë veprime të cilat shariatit nuk i ndëshkon por moskryerja e tyre lavdërohet. Sheriatit përfshin çdo aspekt të jetës së njeriut. Indeksi udhëzues i Sheriatit zakonisht ndahet në katër kode të cilat janë:

1. Kodi që lidhet me adhurimet individuale (El-Ibadat - العبادات) Jurisprudenca e adhurimit

2. Kodi që lidhet me shkëmbimet ndërnjerëzore (El-Muamelat - المعاملات) Transaksionet.

3. Kodi që lidhet me martesën dhe divorcin (En-Nikah - النكاح) Jurisprudenca e martesës.

4. Kodi që lidhet me ndëshkimet penale (El-Hudud - الحدود) Sanksionet.

Nisur nga ajo që thonë dijetarët e Sheriatit Islam, mund të themi se, që të përmbushet mirëqenia e njerëzve është e nevojshme që jeta e tyre të mbështet tek:

a. Domosdoshmëritë

b. Nevojat dhe

c. Plotësimet (përmirësimet)

Domosdoshmëritë

Vepra të detyruara që duhet të kryhen dhe të shoqërohen me qëllimin

25. Ignaz Goldziher: *Die Zabiriten*. Ihr Lehrsystem und ihre Geschichte. Ein Beitrag zur Geschichte der muhammedanischen Theologie. (*Zabirët. Sistemi i doktrinës dhe historia e tyre. Studim mbi historinë e teologjisë muhamedane*) Leipzig 1884. f. 66-70.

e mirë dhe në përputhje me njetin e njeriut, për të cilat ka edhe shpërblim. Domosdoshmëritë janë nevojat jetike tek të cilat bazohet jeta e njeriut në këtë botë si dhe besimi i tij fetar.

Me veprime të preferuara ose të pëlqyera synohen ato vepra që këshillohen të kryhen, ndërkohë të urryera ose të papëlqyera janë ato që nuk këshillohen të veprohen. Mos marrja e tyre në konsideratë e çon njeriun drejt rrënimit të papërballueshëm në këtë jetë ose të ndëshkimit në botën tjetër.

Sipas parimeve islame domosdoshmëritë njerëzore janë pesë:

1. Ruajtja e Fesë

FEJA - përfaqëson vullnetin apo dëshirën e Zotit për rregullimin e besimit dhe sjelljes së njerëzve në tokë, duke përfshirë çdo aspekt të jetës. Allahu i Madhërishëm ua ka bërë detyrim njerëzve besimin në një Zot dhe adhurimin e Tij. Pikërisht për të garantuar ruajtjen e saj janë vendosur dispozitat që kanë lidhje me respektimin e mësimave fetare dhe transmetimin e tyre. Sipas Kur'anit dhe Sunetit, Zoti ka shpallur një fe të vetme.

إِنَّ هَذِهِ أُمَّتُكُمْ أُمَّةً وَاحِدَةً وَأَنَا رَبُّكُمْ فَاعْبُدُونِ

“Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe (e shpallur), kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua.”²⁶ Mbrojtja e fesë është

26. Kur'ani, El-Enbija', ajeti 92.

detyrë për çdo mysliman, sepse feja është thelbi dhe fryma e jetës.

2. Ruajtja e ekzistencës njerëzore

Për të vazhdimësinë e qenies njerëzore, Allahu e ka bërë të ligjshme martesën mes dy njerëzve të gjinive të ndryshme, dhe ka urdhëruar mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të njeriut. Për të ruajtur këtë krijesë Ai ka ndaluar çdo gjë që e dëmton dhe rrezikon jetën e njeriut, si dhe ka përcaktuar ndëshkime për cenimin e të drejtave të tij. Një nga mëkatet më të rënda në Islam është privimi nga jeta, pra vrasja e njeriut të pafajshëm.

وَلَكُمْ فِي الْقِصَاصِ حَيَاةٌ يَا أُولِي الْأَلْبَابِ لَعَلَّكُمْ تَتَّقُونَ

“Kjo masë e dënimit (kisasitacioni) është jetë për ju, O ju të zotët e mendjes, ashtu që të ruheni (nga mbytja e njëri-tjetrit).”²⁷

3. Ruajtja e arsyes

Allahu dëshiron për njerëzit që ata të lartësohen sa më shumë që të jetë e mundur, me anë të mendimit e të arsyes, dhe Ai ka ndaluar çdo gjë që e dëmton dhe e dobëson mendjen e njeriut, si p.sh. përdorimin e pijeve alkoolike dhe drogave, sepse arsyeja dhe mendja e shëndoshë është baza e përgjegjësisë morale, që Allahu i ka dhuruar njeriut.

Mbrojtja e arsyes (diturisë) arrihet duke lexuar, mësuar, studiuar andaj edhe mesazhi kur'anor është

27. Kur'ani, El-Bekare, ajeti 179.

“lexo, mëso”, janë fjalët e para që i janë zbritur Muhamedit (a.s.)

اقْرَأْ بِأَنفُسِكُمْ الَّذِي خَلَقَ خَلْقَ الْإِنْسَانِ
مِنْ عَلَقٍ اقْرَأْ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ

“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi. Krijoi njeriun prej gjakut të ngjizur. Lexo për Zotin tënd Bujar!”²⁸

4. Ruajtja e pasardhësve

Sheriati mbron pasardhësit dhe trashëgiminë. Martesa është ligjësuar për të mbrojtur vazhdimësinë e racës njerëzore; çdo marrëdhënie intime, që del jashtë kufijve të martesës, është e ndaluar dhe i janë vendosur rregulla edukuese, për të garantuar pasardhësit dhe ruajtur vazhdimësinë e racës njerëzore. Për këtë arsye edhe lidhjet paramartesore dhe jashtëmartesore janë të ndaluara dhe të dënuara. Sheriati nuk e ndalon vetëm prostitucionin dhe kurvërinë por edhe çdo gjë që çon deri aty.

وَلَا تَقْرُبُوا الزَّوْجَىٰ إِنَّهُ كَانَ فَاحِشَةً وَسَاءَ سَبِيلًا

“Dhe mos iu afroni amoralitetit (zinasë), sepse vërtetë është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë e keqe.”²⁹

5. Ruajtja e pasurisë

Pronësia gjithashtu mbrohet me Sheriat. Allahu e ka urdhëruar myslimanin të kujdeset ekonomikisht për veten dhe familjen e tij, duke e mbrojtur pasurinë e tij dhe duke

e shtuar atë. Ka vendosur kode që rregullojnë tregtinë dhe shkëmbimet tregtare mes njerëzve, pikërisht për të garantuar një marrëdhënie të drejtë, për të përmbushur drejtësinë financiare dhe për të parandaluar padrejtësinë dhe mosmarrëveshjet. Natyrisht, që të ekzistojë ndjenja e sigurisë, njeriu duhet të ndiejë se produktet e punës së tij janë të mbrojtura dhe se nuk janë objekt i shkatërrimit, dëmtimit apo keqpërdorimit.

يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا لَا تَأْكُلُوا أَمْوَالَكُم بَيْنَكُم بِالْبَاطِلِ إِلَّا أَنْ تَكُونَ تِجَارَةً عَنْ تَرَاضٍ مِنْكُمْ وَلَا تَقْتُلُوا أَنْفُسَكُمْ إِنَّ اللَّهَ كَانَ بِكُمْ رَحِيمًا

“O ju që besuat, mos e hani mallin e njëri-tjetrit në mënyrë të palejuar, përpos tregtisë në të cilën keni pajtueshmëri mes vete, dhe mos mbytni veten tuaj (duke mbytur njëri-tjetrin). Vërtet, Allahu është i mëshirshëm për ju.”³⁰

Shpeshherë shprehjet e teksteve të burimeve të Sheriatit aludojnë në më tepër se një kuptim, apo përmbajnë më shumë se një aspekt kuptimor. Është e mundur të ndodhë që për probleme të caktuara të mos gjendet ligj përkatës në tekstet e Sheriatit që do t’i zgjidhë probleme të caktuara, ndërsa njerëzve u intereson gjykimi apo qëndrimi i Sheriatit në lidhje me to. Atëherë, në këto raste, për të dhënë përgjigje duhet të njihen qëllimet e përgjithshme të Sheriatit që të nxirren gjykime të reja në dritë

28. Kur’ani, El-‘Ale, ajetet 1-3.

29. Kur’ani, El-Isra’, ajeti 32.

30. Kur’ani, En-Nisa’, ajeti 29.

të tyre dhe në pajtim me shpirtin e këtyre objektivave.

Ekspertët e ligjvënies në qeveritë bashkëkohore kujdesen që të shkruajnë dhe përmbledhin shënime shpjeguese për të sqaruar qëllimin e përgjithshëm të ligjit dhe qëllimet e secilit nen në veçanti. Pikërisht këto shënime shpjeguese, bashkë me të gjitha hulumtimet dhe debatet të cilat shënohen me rastin e propozimit dhe miratimit të një ligji, shërbejnë si ndihmesë për juristët dhe gjykatësit për të kuptuar ligjin përkatës dhe për ta zbatuar atë. Nga këto, mund të shohim se interesat e Sheriatit nuk kanë të bëjnë vetëm me aspektet personale të fesë ose riteve të adhurimit, por merren me të gjitha

aspektet e jetës. Shteti që pretendon të jetë shtet islam e ka detyrim të mbështesë të drejtën dhe t'i kundërvihet të padrejtës. Shteti islam është përgjegjës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve të tij, myslimanë qofshin apo jomyslimanë. Ai duhet t'u sigurojë atyre nevojat bazë të jetës. Sot nuk ka ndonjë shtet islam ideal, por ka disa modele që në vazhdimësi po bëhen përpjekje sistematike që të ndërtohen sisteme islame adekuate, por, tani për tani, në horizont nuk shihet ndonjë dritë shpresëdhënëse në këtë drejtim.

Ndikimi i Kur'anit Fisnik në Gjuhën Arabe

Prof. Dr. Hfz. Hajredin HOXHA

Abstrakt

Çdo gjuhë, siç thonë hulumtuesit, vazhdon në varësi të folësve të saj; ajo ngrihet me ngritjen e tyre dhe dobësohet me dobësimin e tyre. Ky imazh shoqëror i nënshtrohet ligjit të evolucionit. Historia na raporton për shumë gjuhë dhe kultura të cilat shijuan fatin e hidhur të humbjes dhe zhdukjes, gjë që nuk i ndodhi kulturës islame dhe gjuhës arabe, të cilën e ruajti Kur'ani Fisnik. Kështu, gjuha arabe mbeti gjuha më e fortë në qëndrueshmërinë ndaj sfidave dhe vështirësive, në kohën kur arabët u përzien me të huajt, falë elementeve kulturore dhe civilizuese që ka fituar në sajë të të qenët gjuhë e Kur'anit.

Kështu mund të konstatohet se vlera e Kur'anit dhe ndikimi i tij i madh nuk ka qenë vetëm në gjuhën arabe dhe në ruajtjen e pasurimin e saj, por në çdo gjë: kozmos, krijesa dhe botë.

Cdo gjuhë, siç thonë hulumtuesit, vazhdon në varësi të folësve të saj; ajo ngrihet me ngritjen e tyre dhe dobësohet me dobësimin e tyre. Ky imazh shoqëror i nënshtrohet ligjit të evolucionit. Historia na raporton për shumë gjuhë dhe kultura të cilat shijuan fatin e hidhur të humbjes dhe zhdukjes, gjë që nuk i ndodhi kulturës islame dhe gjuhës arabe, të cilën e ruajti Kur'ani Fisnik. Kështu,

gjuha arabe mbeti gjuha më e fortë në qëndrueshmërinë ndaj sfidave dhe vështirësive, në kohën kur arabët u përzien me të huajt, falë elementeve kulturore dhe civilizuese që ka fituar në sajë të të qenët gjuhë e Kur'anit.

Njerëzimi, përgjatë gjithë historisë, nuk ka njohur ndonjë gjuhë që është përjetësuar falë librit të saj fetar. Kur'ani i ka vënë kurorën e jetës dhe sekretin e ekzistencës gjuhës arabe dhe pikërisht prej

tij gjuha arabe mori shpirtin e vendosmërisë dhe guximshmërinë e jetës. Kur'ani Fisnik është shpirti që e bëri arabishten letrare gjuhë të të gjitha kohëve. Për çdo të mirë arabishtja, së pari, i detyrohet Kur'anit. Allahu qoftë i falënderuar fillim e mbarim!¹

Ndikimin dhe gjurmët e Kur'anit në gjuhën arabe do të mund t'i përmbledhim në pikat në vijim:

1. Ruajtja e gjuhës arabe nga humbja

Ndikimi i Kur'anit në gjuhën arabe, në aspektin e formës dhe përmbajtjes, ka qenë vërtet i madh. Tekstet e Kur'anit janë të shenjta dhe të përjetshme, kështu që me ekzistencën e vazhdueshme të teksteve kur'anore edhe gjuha arabe vazhdoi të jetë e gjallë dhe aktive gjer në ditët tona. Dr. Jusuf Sherbexhi është munduar të përmbledhë disa nga sekretet që qëndrojnë pas përjetësisë së gjuhës arabe:

“Sekreti që qëndron pas përjetësimin të gjuhës arabe dhe ruajtjes së saj është ndikimi i madh i Kur'anit në jetën e umetit arab, të cilin, nga një umet i humbur, ai e shndërroi në një umet të ndershëm e të fortë, dhe këtë për hir të mbajtjes së tij pas këtij libri (Kur'anit), i cili

1. Për më shumë shih: *Lebexhatu'l arab fi'l Kur'ani'l Kerim – dirasetun istikraijjetun tabliijjetun*, f. 210.; *Etberu'l Kur'ani'l Kerim fi'l lugati'l arabijeh*, Ahmed Hasen Bakuri, Darul mearif, Egjipt, ..., f. 28-32.

gdhendi (përsosi) shpirtat e tyre, fuqizoi karakterin e tyre, pastroi mendjet e tyre nga papastërtia e idhujtarisë, bashkoi zemrat e tyre dhe unifikoi fjalët e tyre e rrjedhimisht edhe idealet, kështu që për hir të tyre ata sakrifikuan edhe jetët. Kur'ani largoi edhe padrejtësitë ndërmjet tyre si dhe shkuli nga gjokset e tyre urrejtjen, smirën, mërinë dhe inatet... Kur'ani ishte sikurse një kodër e lartë që i sfidonte ndikimet dhe kurthet që ngriheshin kundër gjuhës së tij, e mbronte atë dhe ruante pragun e saj... E meqë Kur'ani ka këtë pozitë, atëherë nuk është çudi pse myslimanët iu qasën atij dhe e mbrojnë atë, duke konsideruar se çdo armiqësi ndaj Kur'anit është armiqësi edhe ndaj arabishtes dhe anasjelltas. Kësisoj, sekreti i qëndrimit të Kur'anit deri më sot, e me lejen dhe dëshirën e Allahut gjer në amshim, fshihet pikërisht në mbrojtjen që Ai i bën Kur'anit, ngase mbrojtja e tij nënkupton edhe mbrojtjen e saj... Këtë gjë më së miri mund ta kuptojë ai që përcjell gjuhët dhe fatin e tyre. Sa e sa gjuhë kanë qenë të ngritura, madje edhe në nivel ndërkombehtar, por më pas kanë humbur. Si shembull për këtë shih gjuhën latine, e cila dikur ishte gjuhë, kulturë dhe fuqi, por sot nuk ka mbetur asgjë përveç gjurmëve të saj. Gjuha arabe nuk e pati fatin që të ishte as fuqi, as gjuhë kulture e as prodhimi; ajo ishte gjuhë shkretëtire dhe analfabetësh dhe larg shkencave

e njohurive, por falë Kur'anit Famëlartë, ruajtjen e të cilit e mori përsipër vetë Allahu, ajo u ruajt, për dallim nga librat e tjerë dhe gjuhët e tyre që nuk e patën këtë fat dhe u shuan...”²

2. Forcimi i gjuhës dhe veprimi në drejtim të përkryerjes së saj

Askush nuk dyshon se Kur'ani është burim i forcës, fuqisë dhe gjallërisë së gjuhës arabe, ndryshe, sikur ky potencial hyjnor të mungonte, atëherë gjuha arabe, sigurisht, nuk do t'i dispononte këto domethënie të shumta, shprehje të zhvilluara, struktura të reja dhe metoda të larta që ka. Shkencëtari i madh, Rafiu, thotë: “*Kur'ani u shpall asisoj që shumica e pakica e tij (tekstet e gjata e të shkurtra) sfidojnë. Ai është i ngjashëm me nurin (dritën) në mbarësbhtimin (renditjen) e tij, ngase drita është dritë në tërësi dhe edhe kur ndahet nuk del jashtë natyrës së saj. Kur'ani në çdo pjesë të tij është tërësi, që nuk kanë kundërbënie ndërmjet vete, përveç nëse krijon qiell tjetër nga ky dhe tokë tjetër nga kjo. Kjo është arritur falë faktit se Kur'ani e filtroi gjuhën arabe nga shakullinat (zhiblat) dhe arriti që ta demonstrojë thelbin dhe esencën e fshehtësive të saj publikisht, kështu që me ujin e bukurisë*

2. Shih: Bakuri, Ahmed Hasen, *Etheru'l Kur'ani'l Kerim fi'l-lugati'l arabijeh*, f. 23; <http://www.al-maqha.com/t7344.html> Webfaqja është shfletuar më datë 20/05/2010.

erdhi më i mbushur se reja, me gjallërinë fizike më i mirë se rinia... Pastaj, në trajtimin e domethënies delikate dhe të thukëta, të cilat i shfaq nëpërmjet I'xhazit dhe të cilat i portretizojnë me të vërtetën dhe i shpreh me alegorinë, për të vazhduar me atë elasticitetin që ia ka dhënë për ndërrimin e metodave dhe shndërrimin e strukturave, në të gjitha këto Kur'ani ka shfaqur një pamje imponante që të mahnit, jo vetëm për gjeneratën e arabëve por për tërë historinë. Këtu ka qenë fshehtësia e shtangies së tyre derisa të vërtetonin se a ishin duke dëgjuar zë të së tanishmes, zë të së ardhmes apo zë të përjetësisë, ngase arabishtja ishte gjuha që ata e njihnin.”³

Me gjithë sulmet e pamëshirshme ndaj gjuhës arabe dhe përhapjes së dialekteve popullore në formën e plan-programeve nëpër shkolla dhe universitete, madje në disa universitete amerikane dhe arabe u themeluan edhe departamente të veçanta, ata e pranuan se gjuha arabe disponon një fuqi, gjallëri dhe përhapje të shpejtë.

Orientalisti Ernest Renan thotë: “*Ndoshta gjëja më e çuditshme që ka ndodhur në historinë e njerëzimit, – sekreti i së cilës është vështirë të zbulohet, – është përhapja e gjuhës arabe. Kjo gjuhë në fillim ishte e panjohur dhe befaz u shfaq shumë madhështore. Fillim e çfarë fillimi, pasuri e çfarë pasurie. E përsosur në kuptimin e asaj se, deri në ditët tona, nuk ka ndodhur ndonjë ndërrim i rëndësishëm i saj; ajo nuk ka fëmijëri dhe as pleqëri; që në*

3. Err-Rafiu, Sadik, *Tarihu adabi'l arab*, v. 2, f. 74.

fillim u shfaq e plotë dhe qëndrueshme, e ndoshta ajo që më së shumti të mahnit është mbjellja e saj në një shkretëtirë dhe arritja e përsosmërisë pikërisht në shkretëtirë, madje duke kaluar simotrat e saj me shprehje të shumta, domethënie precize dhe strukturë fenomenale...”

Ndërsa Xhorxh Sartoni thotë: “Gjuha e Kur’anit, duke e llogaritur atë si gjuhë të arabëve, me këtë reformim ka qenë e plotë. Profeti [alejhis salatu ues selam] i dha fleksibilitet aq sa e bëri të aftë të kodifikojë madje edhe shpalljen hyjnore në mënyrë shumë precize dhe ta shprehë atë me shprehje të bukura dhe të forta. Kështu, Kur’ani arrin ta lartësojë gjuhën arabe në pozitën e ‘shembullit më të lartë’ (methelu’l a’la) në shprehjen e qëllimeve.”

Kurse Broklemani (Brookleman) shton: “Falë Kur’anit, arabishtja arriti një shtrirje të tillë që thujse nuk e ka asnjë gjuhë tjetër. Myslimanët janë të vetëdijshëm dhe besojnë se gjuha arabe është e vetmja gjuhë që lejohet të përdoret në lutjet (namazet) e tyre. Kjo i ka mundësuar arabishtes që të fitojë një pozitë të lartë ndaj të gjitha gjuhëve të botës...”

Prof. Dr. Hasen Dijaud-din Ater, në studimin e tij përkitazi me mrekullinë më të madhe të Kur’anit, përmend edhe disa pika të tjera me rëndësi për ndikimin e Kur’anit në gjuhën arabe, të cilave po iu referohem shkurtimisht:

- Kur’ani i Madhërisëm i shpëtoi arabët nga dallimet e ndryshme dhe të shumta dialektike, kështu që ndikoi në drejtim të

përafrimit dhe unifikimit të gjuhës së tyre, për të folur me dialektin më letrar të arabishtes...

- Kur’ani e pastroi arabishten nga shprehjet e huaja dhe të paqarta dhe e shndërroi atë në një gjuhë të kulluar dhe tërheqëse.

- Kur’ani solli domethënie të reja që arabët nuk i njihnin dhe as nuk dinin t’i shprehnin, si: *Islam, iman, furkan, shirk, keuf, nijak, saum, salat, zekat*. Krahas kësaj ai solli edhe aspekte përmbajtjesore ndijore interesante dhe të përjetshme, siç është – fjala vjen – tërheqja e vëmendjes për *melekutus semauati ue’l erd – madhësitë e qiejve e të tokës* – dhe përfitimi i argumenteve logjike që dëshmojnë Njëshmërinë, Madhështinë dhe Fuqinë e Zotit, si dhe obligimin e adhurimit vetëm të Tij... Allahu i Gjithëditur e shpalli Kur’anin në 114 pjesë, me një elokuencë dhe retorikë të pakrahasueshme në shprehjet dhe domethëniet e tij, si dhe në formën dhe përmbajtjen e tij...

- Arabët e patën bërë zakon që në stinë dhe tregje të ndryshme të organizonin gara letrare. Në të shumtën e rasteve, te konkurrentët ndodhnin mospajtime për shkak të mungesës së një shembulli letrar më të lartë, të cilin do të mund ta merrnin për kriter vlerësimi. E kur Kur’ani i befasoi ata me madhështinë e elokuencës së tij, epërsinë e retorikës së tij dhe pozitën e pakonkurrueshme të tij,

ata iu nënshtruan dhe u bindën se ai nuk mund të sfidohej. Aftësitë dhe kapacitetet e tyre letrare iu nënshtruan atij dhe ata filluan të merrnin prej tij. Ata iu qasën studimit të karakterit të bukur letrar që ai solli, prej të cilit formuan një mori rregullash retorike dhe letrare. Me një fjalë, Kur'ani ishte modeli më i mirë i mundshëm dhe peshorja më e saktë.

- Gjurmët e Kur'anit ende vazhdojnë të shfaqen qartë në letërsinë arabe: në poezi, prozë, urtësi, ligjërim e çfarëdo tjetër qoftë. Në të shfaqen shprehje dhe forma të shkëputura direkt prej Kur'anit, por ka edhe të atilla që janë formuluar duke shikuar në formalen dhe mënyrën e tij. Ndërsa sa i përket temave, disa janë tërësisht të reja, si: sofizmi dhe asketizmi, por ka edhe të atilla që janë reformuar dhe iu është dhënë forcë dhe gjallëri, si entuziazmi, por që të gjitha këto tema janë ndikuar qartazi nga Kur'ani, gjë për të cilën nuk ka dyshim. Kjo mund të vërehet në vlerat e reja e të shumta shpirtërore, intelektuale, shoqërore dhe njerëzore që këto tema kanë marrë nga Kur'ani...

- Kur'ani mbizotëroi mbi kapacitetet letrare dhe tërhoqi interesimin dhe kujdesin e tyre. Sigurisht që nderi i krijimit dhe zhvillimit të shkencave gjuhësore i takon Kur'anit. Kur'ani është arbitri i këtyre shkencave, fjala e të cilit është gjithçka për to dhe jo anasjelltas. Vërtet është për t'u

çuditur me punën e disa injorantëve që duan të bëjnë pikërisht të kundërtën, të krijojnë paqartësi rreth teksteve kur'anore dhe rregullave të gjuhës arabe. Këta natyrisht që e neglizhojnë faktin se Kur'ani është gjykues i këtyre shkencave. Argumenti kur'anor është vendim i prerë për mendimet kundërthënëse në të gjitha shkencat gjuhësore... Si rezultat i kësaj u shkruan disa vepra madhështore, si *Nudhumu'l Kur'an e Xhahidhit, Delailu'l I'xhaz* dhe *Esraru'l belagah e Abdu'l Kadir Xhurxhanit*, etj.

- Kur'ani, siç mund të jetë e qartë për ty lexues i nderuar dhe për çdo studiues, është lënda që vë në lëvizje kritikën letrare tek arabët dhe është hulumtuesi kryesor drejtuar atyre dhe studimeve retorike në përgjithësi. Po u ndale të analizosh studimet kritike dhe peshojat e tyre në artet e fjalës (*funun el kaul*) do të gjesh se të gjitha i janë nënshtruar mënyrës kur'anore, të cilën na e kanë paraqitur studimet e I'xhazit të Kur'anit, sikurse janë thirrur në argumentin apo faktin kur'anor, i cili ka qenë shembulli më i mirë dhe modeli vlerësues më i pranuar. Prej mënyrës dhe formës së tij (Kur'anit), bëhet edhe gjykimi për vlerat e metodave ndaj njëra-tjetrës...

- Kur u intensifikuan studimet, përkitazi me komentimin (tefsirin) e Kur'anit dhe aspektit të I'xhazit në retorikën e tij, atëherë hulumtimet u thelluan në masë të konsiderueshme

në shkencën e artit ekspresiv apo shprehimor (ar. *Ilmu'db-Dheuk*⁴), kështu që doli në shesh ndikimi i Kur'anit në zhvillimin e shijes letrare arabe.

3. Unifikimi i dialekteve arabe

Është e ditur se dialektet e gjuhës arabe ishin të ndryshme; ato përmbanin pjesë të çmuara letrare, por kishin edhe gjëra krejtësisht të pavlera. Kur'ani u shpall në shtatë shkronja (dialekte), në mënyrë që leximi dhe recitimi i tij të ishte i lehtë për të gjithë. Padyshim, dialektet dallonin edhe nga shkalla dhe niveli i aspektit letrar, gjë që bëri që Osmani [*Allahu qoftë i kënaqur me të*] të nxirrte një dekret që, me rastin e kodifikimit apo përmbledhjes së Kur'anit brenda një mus'hafi, po që se ndodhte ndonjë diskutim rreth shprehjeve, atëherë për bazë të merrej shprehja e kurejshëve, ngase Kur'ani që shpallur në gjuhën e tyre.

Gjuha [apo dialekti] e kurejshëve ishte më e qarta, më e lehta dhe më e ëmbla, ndaj të gjitha dialekteve të Gadishullit, vlerë të cilën mundohet ta shpalosë para nesh edhe Imami i shquar, Sujuti [*Allahu e mëshiroftë*], i cili thotë: "... të folurit e kurejshëve është më i lehti dhe më i qarti, ndërsa të

folurit e arabëve është paksa i vrazhdë dhe i pakuptueshëm. Për këtë shkak, arabët i afrohen asaj dhe duan ta përvetësojnë atë, sidomos kur kanë parë se bukurinë dhe ëmbëlsinë e saj e ka shtuar edhe Kur'ani. Ata, kur panë këtë bukuri, iu qasën Kur'anit për ta dëgjuar atë dhe, përkundër vullnetit dhe dëshirës së tyre, thanë: Vërtet, qenka i ëmbël dhe elegant (magjepsës); lartësia e tij është frytdhënëse, ndërsa pjesa e poshtme e tij gufuese. Vërtet, ai triumfon, ndërsa mbi të nuk mund të triumfohet!"⁵

Myslimanët vazhduan ta lexojnë Kur'anin ditë e natë, derisa e vërtetuan në praktikë se vërtet ata janë njerëzit më të mirë të dalë ndonjëherë në sipërfaqen e dheut, duke e lexuar atë që të gjithë, arabë dhe joarabë, me një gjuhë të vetme, gjuhë që i unifikoi ata, duke shkrirë deri diku ato dallimet që i kishin para shpalljes së Kur'anit në dialektet e tyre. Kësisoj, ata hynë në një etapë të re historike, në të cilën u bë unifikimi i gjuhëve të tyre..⁶

Mbase është e njohur se arabët, para shpalljes së Islamit, kishin dallime në të folur. Ata mblidheshin për çdo vit në tregun Ukkadh, sikurse edhe gjatë kohës së Haxhit, në të cilat merrnin pjesë një grup i madh ligjëruesish, poetësh dhe gojëtarësh. Në këtë kongres tregtar shkencor

4. Fjala *Dheuk* në letërsi nënkupton një ndjenjë kuptimore në bazë të së cilës bëhet vlerësimi i ndikimit letrar apo artistik. Shih: Mes'ud, Xhubran, *Err-Rraid – mu'xhemun luganijun asrijun*, Darul Ilm lil melajin, Bejrut, f. 376 (shën. i përkth.).

5. Këto në fakt janë fjalët e Utbe Ibn Rabias të thëna me rastin e dëgjimit të leximit të kaptinës Fussilet nga Profeti [alejhis salatu ues selam]. Shih: Tefsiru Ibni Kethir, 3/150.

6. Sujuti, *el-Muz'bir fi ulumi-l-lugati-l-arabijeti*, 1/129.

– nëse mund të quhet kështu – ata shkëmbejnë dhe diskutonin me njëri-tjetrin, formë kjo e njohur për pasurimin e dialekteve, derisa në skenë u paraqit Islami, libri i të cilit u shpall në gjuhën e kulluar arabe, duke shkaktuar kështu një revolucion shkencor dhe linguistik të ri, metodën dhe stilin e të cilit arabët nxituan ta përvetësojnë pa hezitim⁷. Së shpejti Kur’ani u bë qendër referuese për vlerësimet gjuhësore dhe afrimin ndër-dialektor. Në të kaluarën shkrirja në një dialekt tjetër konsiderohej turp, ndërsa me shpalljen e Islamit myslimanët e mësuan gjuhën nga Kur’ani dhe nga metoda e tij, dhe jo vetëm arabët. Kësisoj, dialektet do të hidheshin në koshin e plehrave të historisë, ndërsa gjuha arabe me çlirimet islame do të bëhej edhe gjuhë e atyre vendeve, siç ishte rasti me Shamin, Irakun, Egjiptin, Persinë, etj. Statusi i saj do të ndërrohej nga gjuhë fetare në gjuhë popullore dhe shteti.⁸ Ajo u bë gjuha e vetme për të gjithë myslimanët në botë, me të cilën ata mund ta adhurojnë Zotin e tyre. Imamët e katër medh’hebeve janë pajtuar njëzëri se nuk lejohet falja e namazit me gjuhë joarabe.

4. Transformimi i arabishtes në gjuhë botërore

Gjuha, siç dihet, është paraqitja

7. Shih: *Lehxebat el-arab fi-l-Kur’ani-l-Kerim – dirasetun istikraijjetun tahlilijjetun*, f. 207.

8. Po aty.

më korrekte e jetës së atyre që e flasin atë dhe, në rastin e arabëve, para shpalljes së Kur’anit, ajo nuk ishte e njohur ngase arabët nuk shquheshin për diç apo nuk kishin ndonjë pozitë të popujt, në mënyrë që njerëzit t’i qaseshin mësimi të gjuhës së tyre apo të lidhnin bashkëpunim me ta. Gjuha e tyre nuk ishte gjuhë e shkencës dhe dijes, e krahas kësaj arabët nuk kishin ndonjë civilizim a prodhimtari të caktuar. Tërë kjo bëri që arabishtja të mos mund të dilte jashtë Gadishullit Arabik. Kësisoj jetuan arabët derisa erdhi Kur’ani, i cili solli parimet dhe normat më të përkryera që njeh shoqëria njerëzore. Kur’ani ia garantoi arabishtes jo vetëm mbijetesën por edhe zhvillimin dhe jetëgjatësinë, dhe ja, arabishtja sot është e gjallë dhe shumë e fortë, është gjuhë e miliona njerëzve në mbarë botën. E duke e ditur se arabishtja është qenësore për të mbajtur fenë dhe për ta kuptuar saktë atë, njerëzit iu qasën mësimi të saj si gjuhë e Kur’anit. Andaj, nëse themi se po të mos ishte Kur’ani arabishtja nuk do ta kishte këtë fat, nuk gabojmë.

5. Shpikja e disa shkencave që nuk do të ekzistonin pa Kur’anin

U shpikën shkenca të reja në disa fusha, si në rrafshin fetar: Hadithi, Fikhu, Usuli Fikhu; në gjuhë: Sintaksa, Morfologjia, Elokuenca, Të kuptuarit e gjuhës (fiku-l-lugah); në shkencat filozofike:

Logjika, Filozofia Islame, Teuhidi, Apologjietika e shkenca të tjera.

6. Mbizotërimi ndaj gjuhëve fqinje

Këtë të vërtetë e kuptojmë atëherë kur bëjmë krahasime të arabishtes me gjuhët e tjera, si: anglishtja, frëngjishtja, gjermanishtja, etj.

Ndërsa sa i përket ndikimit të Kur'anit në shpirtat e besimtarëve e jobesimtarëve, atëherë fol e mos ki frikë fare. E si mund të mos ndikohet shpirti i njeriut prej Kur'anit, kur edhe bota inorganike, kodrat dhe malet, ndikohen prej tij?! Një prej atyre që kanë folur vërtet bukur për këtë çështje është edhe Prof. Dr. Salah Abdu'l Fettah el-Halidi, në studimin e të cilit gjenden mësimet e dobi të shumta, prej të cilave, për t'i dhënë një pamje më komplete punimit, por edhe një koncept më të shtjelluar lexuesit, mendoj se ia vlen të shkëpusim ca paragrafë:

“Kur’ani ka një ndikim të jashtëzakonshëm në shpirtin e njeriut, gjë që dëshmon se është fjalë e Allahut, ndryshe, ndikim të tillë te njeriu nuk mund të lë kurrë fjala e njeriut. E vërteta, të folurit elokuent ndikon te shpirtat e ndërgjegjshëm, qofshin këto fjalë prozë a poezi, dhe sa herë që elokuencia është më e theksuar, edhe ndikimi rritet, por asnjëherë sikurse ndikimi nga fjala e Allahut. Kur’ani ka aluduar në ndikimin e tij që është ekskluziv për nga lloji, që madje sikur Allahu t’iu drejtohej me të edhe

krijesave inorganike, ato do të ndikobeshin prej tij. Allahu ka thënë:

“Sikur Ne ta zbritnim këtë Kur’an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të struktur e të çarë prej frikës nga Allahu. Këta janë shembuj që ua shkoqisim njerëzve, që ata të mendojnë.”⁹

Mosbesimtarët janë të privuar nga Kur’ani ndikues, e sikur Allahu t’ia shpallte këtë Kur’an ndonjë kodre, do ta shihje kodrën teksa përulej dhe çabej nga frika e Allahut. Por jo, Allahu nuk iu drejtua me të kodrave. Ai iu drejtua njeriut, i cili gjithsesi duhet të ndikohet prej Kur’anit dhe, rrjedhimisht, edhe t’ia ketë frikën Allahut. Fatkeqësisht, jo të gjithë njerëzit janë ndikuar prej tij. Ka të atillë madje që edhe ia kanë kthyer shpinën. Kur e dëgjojnë atë, ata ikin prej tij, e kështu zemrat e tyre bëhen më të forta se guri. Ata e pengojnë depërtimin e Kur’anit në zemrat e tyre dhe kështu bëjnë krim ndaj vetvetes. Allahu thotë:

“Kur ti e lexon Kur’anin, në mes teje dhe atyre që nuk e besojnë botën tjetër, Ne vëmë një perde të padukshme. Ndërkaq, në zemrat e tyre vëmë një mbulesë dhe shurdhim të thellë të veshëve të tyre që nuk mund ta kuptojnë atë. E kur e përmend ti në Kur’an Zotin tënd, vetëm Atë, ata ikin mbrapa dhe largohen.”¹⁰

Në fakt, mosbesimtarët e dinin ndikimin e Kur’anit në shpirta, kështu që frikësobeshin që ta dëgjonin atë, andaj edhe

9. Kur’an, El-Hashr, 21.

10. Kur’an, El-Isra’, 45-46.

'e këshillonin' njëri-tjetrin që të qëndronin sa më larg tij, e po të ndodhte që të lexohej në prani të tyre, atëherë ata të shushuritnin e të pëshpëritnin vetëm e vetëm që të mos dëgjohej ai. Allahu na flet për këtë:

“Ata që nuk besuan thanë: ‘Mos e dëgjoni këtë Kur’an dhe kur të lexohet ai, ju bëni zhurmë (bërtitni) ashtu që ta pengoni!’”¹¹

Kur’ani patjetër që ndikon te njerëzit. Mu për këtë Islami kërkon prej ithtarëve të tij që t’ua lexojnë Kur’anin mosbesimtarëve dhe t’i bëjnë ata ta dëgjojnë Kur’anin, ngase do të ndikohen prej tij.

“E nëse ndokush prej idhujtarëve të kërkon strehim, ti strehoje në mënyrë që t’i dëgjojë fjalët e Allahut (Kur’anin), e mandej përcille deri në vendin e tij të sigurt. Këtë, ngase ata janë popull që nuk e di (të vërtetën e fesë islame).”¹²

Kjo kishte të bënte me ndikimin te mosbesimtarët, ndryshe te besimtarët, që i kanë zemrat të hapura për dritat e Kur’anit, ndikimi është i madh.

“Allahu e shpalli të folmen më të mirë, librin, të ngjashëm në mrekulli, të përsëritur herë pas here (me këshilla e dispozita), që prej (dëgjimit të) tij rrëqethen lëkurët dhe zemrat e tyre. Ky (libër) është udhëzim i Allahut, me të udhëzon atë që do. E atë që Allahu e lë të humbur, për të nuk

ka ndonjë udhëzues.^{13,14}

Dr. Halidijj-i ka sjellë edhe shembujngandikimipraktikiKur’anit në shpirtat e mosbesimtarëve, si tregimi i tre liderëve kurejshë që e dëgjuan Kur’anin te Qabeja tri net radhazi. Pastaj ka sjellë shembuj nga ndikimi i Kur’anit te sahabët, si tregimi i pranimit të Islamit nga Omer Ibn Hattabi, [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], pastaj tregimi i martirit Sejjid Kutbit me gruan jugosllave në vitin 1949, e cila u ndikua shumë nga ajetet kur’anore gjatë udhëtimit me anije nga Egjipti në SHBA.

Si rezyme të këtyre fjalëve, në fund të këtij shkrimi, do të mund të konstatojm se vlera e Kur’anit dhe ndikimi i tij i madh nuk ka qenë vetëm në gjuhën arabe dhe në ruajtjen e pasurimit e saj, por në çdo gjë: kozmos, krijesa dhe botë.

Kjo është dhurata e Zotit, që Ai ia jep kujt të dojë, e Allahu është Dhurues i Madh, ndërsa lutja jonë e fundit është:

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

13. Kur’an, Ez-Zumer, 23.

14. Shih: Salah, Abdu’l Fettah el-Halidijj, *I’xhazu’l Kur’an el-bejanijj ue delailu masdaribi’rr Rrabbaniijj*, f.491-492; *Min axhaibi’l Kur’ani’l lugaujijeti* të Dr. Fuad Mahmud Muhammed Senedi, f. 41-101.

11. Kur’an, Fussilet, 26.

12. Kur’an, Et-Teubeh, 6.

Komentimi i sures Fatiha nga dijetarët shqiptarë H. Vehbi Dibra - H. Ibrahim Dalliu - H. Ali Korça

Xhemal Balla

Abstrakt

Të shpjegosh fjalën e Allahut është një punë jashtë fuqisë sonë. Do të përpiqem, - thotë Haxhi Vehbi Dibra, - që ta zhvilloj e ta shkoqis atë që do të jetë e mundur mbi kuptimin e lartë të kësaj sureje. Pas nesh do të vijnë edhe të tjerë e do të flasin brez pas brezi; jeta do të marrë fund e tefsiri i Kur'anit nuk ka për të marrë fund, sepse është fjala e lartë e Zotit, e meqenëse Zoti nuk ka fund, edhe fjala e lartë e Tij pra nuk ka fund. Kjo tregon për kapacitetin që nevojitet për të interpretuar e komentuar Kur'anin.

Hafiz Ali Korça në komentin e tij thotë: "Kjo sure nga fjalët është fort e shkurtër por nga përmbajtja e saj është fort e thellë. Zoti në këtë sure tregon sundimtarin e lumturuesin e të dy jetëve. Ai me madhësinë e vet na mëson si duhet ta lëvdojmë; na urdhëron të themi: Të mirat që na ke falur s'kanë fund, nuk mund të numërohen. Lavdërimet e përbershme e mirënjohjet e përgjithshme Ty të kanë hije. Ti i shikon pa kursim dhe kujdesesh për çdo gjë të gjallë.

Në tefsirin e tij, Hafiz Ibrahim Dalliu, bën një koment më të gjatë për mënyrën se si mund të shoqërojmë një punë apo veprim. Kjo është fjala "Bismil-lah — بسم الله" që do të thotë: "Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit po lexojmë..."

Surja "El-Fatiha" ka zbritur në Mekë. Ka shtatë ajete. Emërtohet Fatiha, sepse me të fillon Kur'ani dhe namazi. Sipas Haxhi Vehbi Dibrës, kjo sure

ka shumë emra, por emri i parë është "Fatihatul kitab", që do të thotë: "Çelësi i librit Hyjnor". Ajo njihet edhe me shumë emra të tjerë si:

a- "Um-mul Kur'an" Nëna e

Kur'anit, Shtylla e Kur'anit, Rrënja e Kur'anit. Është interesant fakti se pse ajo u quajt “Nëna e Kur'anit”. Kur'ani ka zbritur për të njoftuar e për të shpjeguar katër pika kryesore: Divinitetin = Ekzistencën Hyjnore; Ahiretin = Botën e Përtejme; Meadin = Caktimin dhe paradijen Hyjnore; dhe Nubuvetin = Misionin profetik.

Këto katër çështje me rëndësi, të cilat i ka zbërthyer dhe i ka shpjeguar gjerë e gjatë Kur'ani, i gjejmë në këtë sure në një formë të shkurtër e të përmbledhur.

“El-hamdu lil-lahi Rabbil-alemin, Err-rrahmanirr-rrahim” trajton çështjen e Divinitetit; “Maliki jeumid-din” flet për Ahiretin; “Tj-jake na'budu ue ij-jjake neste'n” tregon kompetencën e paradijes Hyjnore, që në terminologjinë islame quhet Kaza (Kada) dhe Kader; “Ihdinas-siratal-mustekim” e deri në fund përfshin misionin profetik.

Sipas Hafiz Ibrahim Dalliut, në tefsirin e tij, emri “Um-mul Kur'an” – do të thotë Themeli i Kur'anit, sepse përfshin në vetvete qëllimet e mëdha të Kur'anit, si lavdërimin e Zotit, nënshtrimin tonë ndaj Tij, duke zbatuar urdhrat e ndalimet e Tij, etj. Kjo sure është si një burim i madh, ndërsa suret e tjera janë vija të këtij burimi.

Ndërsa Hafiz Ali Korça, në tefsirin e tij, për këtë emër, “Nëna e Kur'anit”, thotë se ka përmbledhur ç'ka Kur'ani brenda tij, si nga lavdet, që i kanë hije Zotit, po ashtu edhe

nga ibadetet (adhurimet), faljet që i duhen robit, për të cilat është i detyruar ndaj Zotit, si nga urdhrat e ndalimet, ashtu dhe nga sihariqet e qortimet, etj.

b- Titulli i tretë me të cilin njihet kjo sure është “Sebu'l methani”. Sipas Haxhi Vehbi Dibrës, këtë titull e ka vendosur vetë i Madhi Zot në këtë ajet:

وَلَقَدْ آتَيْنَاكَ سَبْعًا مِّنَ الْمَثَانِي وَالْقُرْآنَ الْعَظِيمَ

“Ue lekad a'tejnake seba'n minel-methani uel-kur'anel-adhim” (15-87) “[O i dashtun Resul.] Beto hem në madhësinë Time, se ty të kam dhënë suren ‘seba'l-methani’ dhe Kur'anin e madhnueshëm”¹. Pastaj ai tregon arsyen përse iu kumtua ky urdhër i lartë e hyjnor, duke thënë:

“Njëherë Profeti i Allahut, Hazreti Muhamedi Alejhis-selam, po qëndronte me disa shokë të tij. Aty përpara kaluan shtatë karvanë të kurejshëve. Këta karvanë po vinin nga Shami (Damasku) dhe ishin të ngarkuar plot me ushqime e sende të tjera me vlerë. Në këtë rast, shokët e të Dërguarit Alejhis-selam, të cilët ishin të varfër, thanë: ‘Ah sikur të na plotësoheshin edhe ne nevojat tona në këtë mënyrë?!’ Hazreti Muhamedit iu pikëllua zemra për mjerimin e tyre dhe i erdhi shumë keq që s'kishte se si t'ua plotësonte dëshirat. Në këto momente engjëlli i Zotit, Hazreti Xhibrili Alejhis-selam, shpejtoi dhe i kumtoi urdhrin

1. Kur'an, El-Hixhr 15:87.

Hyjnor Hazreti Muhamedit Alejhisselam: “Shtatë karvanë të mërzhitën, o i dashuri Resul! Por po të bëj be në madhështinë Time dhe po të siguroj se të kam dhënë kaptinën e Kur’anit, që quhet “sebu’l-methani” e bashkë me të edhe Kur’anin e Madhnueshëm, që janë shumë më të mirë e më të vlefshëm se shtatë karvanet e kurejshëve”... Me këtë vërtetohet se Zoti xhel-le she’nuhu nuk ka nevojë për adhurimin tonë. Ai është “Rabbul-alemin” – Zoti i të gjithëve, që dhuntitë e Veta nuk i jep si shpërblim kundrejt adhurimit. Edhe sikur e tërë bota të bëhen ateistë, kjo nuk e cenon aspak madhështinë e Zotit. Besimtarët do të shpërblehen e do të lumturohen me të mira në jetën e pasosur, ndërsa mohuesit do të ndëshkohen.

Për këto arsye kësaj sureje iu dha titulli “Seb’ul-methani” që në gjuhën shqipe do të thotë “Shtatë të dyta, shtatë gjysma ose shtatë të dyshave”.

Hafiz Ibrahim Dalliu për këtë emër apo titull “Seb’ul methani” shprehet se ka shtatë ajete me fjalë binjake.

Titulli apo emri i katërt është “Suretud-dua”, që do të thotë “Kaptina e lutjes” apo “Suretus-salat” apo “Kreu i namazit”. Me këtë emër, Haxhi Vehbi Dibra, në tefsirin e tij, sjell një hadith kudsij që shpjegon këtë sure dhe sqaron më tej titullin “Seb’ul-methani”, në të cilin thuhet:

“Suren Fatiha e ndava ndërmjet

meje e robit Tim. Kur robi im thotë: ‘El-hamdu li-lahi Rab-bil-alemin’, i madhi Zot thotë: ‘Më lavdëroi robi Im’; kur thotë robi Im ‘Err-rahmanirr-rahim’, i madhi Zot thotë: ‘Më madhëroi robi Im’; kur thotë robi Im ‘Maliki jeumid-din’, i madhi Zot thotë: ‘Më lartësoi robi Im’; kur thotë robi Im ‘Ij-jake na’budu ue ij-jake neste’in’, i madhi Zot thotë: ‘Kjo është mes Meje e robit Tim’. (Në një transmetim tjetër thuhet: “Robit Tim i dhashë çfarë kërkoi.”)”

Sipas këtij hadithi kudsij, Zoti e ka ndarë suren Fatiha në shtatë të dyta, shtatë ajete të ndara në dy pjesë “Seb’ul-methani”; gjysma e të cilave i përket lavdërimit, madhësisë, lartësimit e adhurimit të Zotit; gjysma tjetër i përket përkrahjes, udhëheqjes, lumturisë dhe shpëtimit që Zoti i fal robit të urtë, i cili lavdëron, madhëron, lartëson dhe adhuron Krijuesin e vet. Gjysma e kësaj sureje deri te fraza “Ij-jake na’budu” është e Zotit dhe prej fjalës “ij-jake neste’in” deri në fund është e jona.

Titulli i pestë i sures Fatiha është “Suretul-uafije”, që do të thotë, sure besnike, sepse lexohet e gjitha në një rekat namazi dhe nuk mund të ndahet. Haxhi Vehbi Dibra vazhdon edhe me tituj të tjerë, me të cilët emërtohet kjo sure, si:

- “Suretul-kafije”, që do të thotë e mjaftueshme për t’u falur vetëm me këtë sure.

- “Suretul-esasi”, që do të thotë sureja e themelit, sepse, veç të tjerash, kjo sure është themeli i tri diturive të larta që lumturojnë dhe shpëtojnë njeriun. Ato dituri janë:

1. “Ilmul-usul” – Katekizmi.
2. “Ilmul-furu” – Adhurimi.
3. “Ilmul-ahlak” – Etika e mistika.

E para flet për cilësitë hyjnore, e dyta për mënyrën se si adhurohet Zoti, e treta për sjelljen e njerëzve e për dashurinë ndaj Zotit.

Myslimani i vërtetë kur të thotë në namaz ajetin “Ihdinas-siratal-mustekim” bie në kontakt me jetën e Amshuar dhe shijon lumturinë e saj, përpara së cilës lumturia e kotë dhe e gënjeshtërt e botës lëndore e humb fuqinë e vet.

- “Suretush-shifa”, që do të thotë kaptina e shërimit, sepse ajo ka fuqi të shërojë sëmundjet morale e fizike, sikurse urdhërohet e thuhet në Kur’an: “Ne shpallim nga Kur’ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shton vetëm humbje.” (Isra’ 17:82). Ndërsa në një hadith thuhet: “Surja Fatiha shëron sëmundjet e helmit”.

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ
 الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ
 الرَّحِيمِ
 مَا لِكَ يَوْمَ الدِّينِ
 إِيَّاكَ نَعْبُدُ
 وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ
 اهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ
 صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ
 غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ
 وَلَا الضَّالِّينَ

“Bismil’lahirr-Rrahmanirr-

Rrahijm. El hamdu lil’lahi rabbil alemijn. Err-Rrahmanirr-Rrahijm. Maliki jeumid-dijn. Ij-jake na’budu ue ij-jake neste’ijn. Ihdinas-siratal-mustekijm. Siratal-ledhijne en’amte alejhim, gajril-magdubi alejhim ue led-dal’lijn.” Amin.

Sipas Hafiz Ibrahim Dalliut kuptimi i kësaj sureje është: “Çdo lavdërim është vetëm për Allahun, Zotin e të gjitha botëve. Mëshirues i madh e shumë përdëllimtar. Zoti i Ditës së Gjykimit. Vetëm Ty (o Zot) të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Drejtona në rrugë të drejtë. Në udhën e atyre që u ke bërë mirësi, jo në udhën e të dënuarve e jo në udhën e atyre që janë të humbur”.

Pranoji lutjet tona o Zot i Madh e i vërtetë.

Ndërsa Haxhi Vehbi Dibra thotë: “Lavdërimi është i posaçëm vetëm për Allahun, Edukuesin e gjithësisë, Bamirësin e madh e Mëshiruesin e pamasë, të Zotin e dritës së fesë, vetëm Ty të falemi e vetëm Ty të lutemi që të na ndihmosh. Na e fal rrugën e drejtë, atë rrugë që ua fale atyre (të mirëve) e jo rrugën që ndoqën gazepët, as atë të të prapëve”.

Të shpjegosh fjalën e Allahut është një punë jashtë fuqisë sonë. Do të përpiqem, - thotë Haxhi Vehbi Dibra, - që ta zhvilloj e ta shkoqis atë që do të jetë e mundur

mbi kuptimin e lartë të kësaj sureje. Pas nesh do të vijnë edhe të tjerë e do të flasin brez pas brezi; jeta do të marrë fund e tefsiri i Kur'anit nuk ka për të marrë fund, sepse është fjala e lartë e Zotit, e meqenëse Zoti nuk ka fund, edhe fjala e lartë e Tij pra nuk ka fund. Kjo tregon për kapacitetin që nevojitet për të interpretuar e komentuar Kur'anin.

Hafiz Ali Korça në komentin e tij thotë: “Kjo sure nga fjalët është fort e shkurtër por nga përmbajtja e saj është fort e thellë. Zoti në këtë sure tregon sundimtarin e lumturuesin e të dy jetëve. Ai me madhësinë e vet na mëson si duhet ta lëvdojmë; na urdhëron të themi: Të mirat që na ke falur s’kanë fund, nuk mund të numërohen. Lavdërimet e përhershme e mirënjohjet e përgjithshme Ty të kanë hije. Ti i shikon pa kursim dhe kujdesesh për çdo gjë të gjallë.

Në tefsirin e tij, Hafiz Ibrahim Dalliu, bën një koment më të gjatë për mënyrën se si mund të shoqërojmë një punë apo veprim. Kjo është fjala “Bismil-lah – بِسْمِ اللّٰهِ” që do të thotë: “Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit po lexojmë...”

Allahu me madhësinë e vet, për të na mësuar se si duhet të urojmë njëri-tjetrin me emrin e Tij të madhërueshëm, se si duhet ta falënderojmë Atë për të mirat që na ka dhënë e na jep pa ndërprerje dhe se si të kërkojmë ndihmën prej

Tij, në çdo rast u ka zbritur njerëzve “Bismil-lah” dhe Fatihanë, për ta thënë me gjuhën e tyre para fillimit të çdo pune e çdo veprimi. Prandaj H. Dalliu shprehet:

“Thoni o njerëz, me emrin e Allahut – قولوا باسم الله - Kulu Bismil-lah” (lexojmë deri në fund).

Bismil-lah thuhet e shoqëruar nga pas me një veprim, si ta lypë vendi, p.sh.:

“Bismil-ahi nekreu; eu nektubu; eu ne’kulu; eu neshrehu – Me emrin e Allahut ... po lexojmë; ose po shkruajmë; ose po hamë, etj.

Themi se Bismil-lah përmendet para veprimit që i përshtatet kuptimit të kësaj fjale. Kështu tregon veprim të posaçëm sipas rregullave të gjuhës arabe (hasr).

Atëherë përdorimi i kësaj shprehjeje domethënë: Vetëm me emrin e Allahut po lexojmë, po shkruajmë, etj. Me këtë kuptim e kërkon veprimi, pasi është vendi për të treguar se vetëm me emrin e Allahut urohemi dhe refuzojmë thëniet e mushrikëve (politeistëve) – Atyre që i bëjnë shok Allahut.

Bismil-lahi është një ajet i vetëm i Kur'anit, me të cilin ndahen suret.

“All-Ilahu – الله”

Fjala e madhërueshme “Allah” është një nga emrat e bukur të Zotit. Me këtë emër përmendet vetëm i Adhuruari me të drejtë, Zoti, ekzistenca e të Cilit është e domosdoshme.

Allah nuk quhet askush tjetër veç Zotit. Kur themi Allah, na vjen ndërmend autoriteti i Zotit, i pajisur me të gjitha vetitë e plota që janë të merituarra për madhësitë e Tij “Xhel-le xhelaluhu – جل جلاله” dhe pa asnjë të metë.

Allahu i madhërueshëm përmendet edhe me shumë emra të tjerë dhe secili emër tregon njërin prejtributeve të Tij. Le të marrim dy emrat e përmendur pas Bismillah: “Err-rrahman Err-rrahim – الرحمن الرحيم”. Dy emrat nënkuptojnë se Allahu është mëshirues i madh, është shumë i dhembshur, është dhënës i madh për robtë e Vet në dynja e në Ahiret. Këta dy emra kanë si rrënjë fjalën “Rahmet”, që do të thotë: kur shikon nevojtarin duhet të të dhimbset dhe duhet t’i dhurosh atij diçka.

Si rregull, nga emri “Rahman” dalin tre kuptime:

1. Të kujdesesh për nevojtarin.
2. Të të zbutet zemra.
3. T’i dhurosh atij diçka e t’i plotësosh nevojën që ka.

Pra, kur themi për Allahun se Ai është “Rahman”, duhet të nënkuptojmë se është Ai që e sheh nevojtarin dhe që i mbaron hallin që ka. Kuptimi i dytë i fjalës është zbutja e zemrës. Por nuk na vjen ndërmend aspak zemra, sepse e dimë që Zoti nuk është trup (xhism), që të ketë organe që janë jetike për njerëzit.

Askush dhe asgjë në univers nuk i përngjan Zotit tonë... por

dhembshuria e Tij është që t’i dhurojë nevojtarit sa të dëshirojë e kur të dëshirojë dhe zemërimi i Tij është të ndëshkohen fajtorët me aq sa e meritojnë. Pra, fjalët “Rahman” e “Rrahim”, që janë në shkallën sipërore, kanë kuptimin: Allahu është shumë dhënës.

Disa dijetarë kanë thënë se “Rahman” do të thotë: Allahu është furnizuesi me ushqim në këtë botë për të gjitha krijesat pa përjashtim, të mirë e të këqij, fetarë e jofetarë. Kurse fjala “Rrahim” do të thotë se në ahiret Ai është falës vetëm i fajeve të besimtarëve dhe dhënës i të gjitha të mirave vetëm për ta.

Pasi u shpjegua e u interpretua nga tre dijetarët e nderuar shprehja “Bismil’lahirr-Rrahmanirr-Rrahim”, H. Dalliu vazhdon me interpretimin e ajetit: “El hamdu lil’lahi rabbil alemin - الْحَمْدُ لِلَّهِ رَبِّ الْعَالَمِينَ”, që do të thotë: Lavdërimi i të gjithë lavdëruesve është vetëm për Allahun, Krijuesin e gjithësisë. Fjala “Hamd”, do të thotë, të lavdërosh dikë që ka bërë ndonjë punë të bukur me vullnetin e vet. Prandaj të thuhet, e lavdërova aksh njeri për dijen, për bujarinë e tij, është e pëlqyeshme, por të thuash lavdërova filanin për bukurinë e tij, nuk është e pëlqyeshme, sepse bukuria nuk është diçka e fituar prej tij, por është e dhuruar.

Fahri Raziu dhe Bejzaviu thonë se fjala “Hamd” do të thotë të lavdërosh e të falënderosh Allahun për mirësitë e dhuruara. Elif dhe

lam, të cilat janë dy shkronjat e para të fjalës “Hamd” dhe që tregojnë llojin, ose përfshirjen; pra fraza “El hamdu lil’lahi - الْحَمْدُ لِلَّهِ” do të thotë se të gjitha lavdërimet e falënderimet janë vetëm për Allahun, sepse është Ai që i krijoi të gjitha të mirat dhe jo dikush tjetër, ashtu siç përmendet në një ajet: وَمَا بِكُمْ مِّنْ نَّعْمَةٍ فَمِنَ اللَّهِ

“Ue ma bikum min ni’metin feminall-llah”, pra “Të gjitha mirësitë që gjenden te ju, janë prej Allahut” (Nahl 16:53)

Prandaj, të gjitha falënderimet duhet t’i drejtohen vetëm Atij dhe askujt tjetër. Sa për falënderimet që dikush i bën një tjetri, kur sheh ndonjë të mirë prej tij (si p.sh. nxënësit që falënderojnë mësuesit e tyre, apo popujt që falënderojnë profetët), sado që duket se po falënderohet edhe dikush tjetër veç Zotit, falënderimi, në të vërtetë, i shkon Zotit, pasi Krijuesi i gjithkujt dhe i gjithçkaje është vetëm Allahu, prandaj me të drejtë thuhet: “El hamdu lil’lahi - الْحَمْدُ لِلَّهِ - Falënderimi i çdo njeriu është vetëm për Allahun xhel-le xhelaluhu”.

Lavdërimi për të mirën bëhet pasi të njohësh mirësitë e mirëbërësit. Pra, njeriu mund të marrë parasysh veten e tij, si është formuar e çfarë mrekullish ka në trupin e vet, sidomos të vështrojë gjymtyrët e tij të dukshme, si sytë, veshët, gojën, duart, këmbët, etj.; atëherë ka për të parë mijëra e mijëra mirësi të Allahut, që me të vërtetë

nuk mund të numërohen. Pastaj le të vështrojë rreth e rrotull në ato të mira që janë për të mbrojtur trupin e tij dhe të mendojë se i vetmi Krijues është Allahu, atëherë nuk do të gjejë fjalë për falënderim, veçse të thotë “El hamdu lil’lahi - الْحَمْدُ لِلَّهِ”, gjithë lavdërimet e falënderimet janë vetëm për Allahun xhel-le xhelaluhu.

Bejzaviu thotë: Fraza “El hamdu lil’lah” tregon se Zoti ynë është i gjallë, i ditur, i fuqishëm dhe vepron me dijen e vet. Atëherë falënderimi, - ashtu siç u tregua më sipër, - bëhet për të mirën që del me vullnetin e bamirësit. E ai që nuk është i gjallë, që nuk është i ditur e i fuqishëm dhe që nuk vepron me dëshirën e vet, nuk ka mundësi kurrsesi t’i bëjë ato punë. Prandaj, kur thuhet: “Falënderimi është vetëm për Allahun”, kuptohet se Zoti është i pajisur me vetitë e lartpërmendura.

Haxhi Vehbi Dibra në tefsirin e tij, frazën “El hamdu lil’lah” e analizon si më poshtë:

Në këtë frazë kemi katër fjalë: “el”, “hamd”, “li”, “Allah”. Për të hyrë në brendinë e kësaj fraze, së pari duhet t’i marrim e t’i studiojmë një nga një këto katër fjalë.

“El” në gjuhën shqipe është nyjë e mbrapme, por në gjuhën arabe vendoset para emrit dhe quhet “Lamu ta’rif”, nyje shquese. Kjo ia ndërron kuptimin emrit në tri forma: “xhins”, “istigrak” dhe “ahd”.

Në kuptimin “xhins” tregon llojin, për këtë arsye emri “hamd”

merr kuptimin: Çdo fjalë, çdo gjest, çdo sjellje, çdo vepër që numërohet nga lloji i lavdërimit.

Në kuptimin “istigrak” përmbledh të gjithë llojin që e ka këtë emër dhe merr kuptimin: Secili lavdërim, sa lavdërimë që bëhen në botë – Zotit ose njerëzve.

Në kuptimin “ahd” tregon një send që është përmendur më parë dhe që është i njohur. Kjo merr kuptimin: “Lavdërimi që dihet”.

Pastaj, Haxhi Vehbi Dibra bën studimin e fjalës “hamd”. Kjo fjalë, - thotë ai, - është sinonim me fjalët “med’h” e “shukur” dhe që të tria e kanë kuptimin “lavdërim”, por që përdoren në vende të ndryshme.

Fjala “med’h” është e përgjithshme se përdoret për lavdërimin e njerëzve, kafshëve dhe çdo sendi tjetër, kurse fjala “hamd” përdoret vetëm për njerëzit.

Fjala “shukur” përdoret për të lavdëruar një bamirës, pasi na ka bërë mirë, ndërsa fjala “hamd” përdoret edhe pa prituri diçka në këmbim të saj.

Fjala shoqëruese e “hamd” është “li-lah”. Këtu kemi parafjalën “li” dhe emrin e lartë të Zotit “Allah”. E para tregon posaçmëri, ndërsa e dyta, “Allah”, është emri i madh i Vetes së Amshuar me të gjitha cilësitë e posaçme vetëm për Të.

Pas këtij shpjegimi, Haxhi Vehbi Dibra jep konkluzionin e shprehjes “El hamdu lil’lahi - الْحَمْدُ لِلَّهِ”, e thotë: “Lavdërimi, çdo lloj lavdërimi, secili

lavdërim, sa lavdërimë që bëhen në botë e në gjithësi janë të posaçme vetëm për Allahun, i përkasin vetëm Zotit të Amshuar. Edhe lavdërimet që njerëzit i bëjnë njëri-tjetrit i përkasin vetëm Zotit, pasi Ai i shtyn këta që t’i bëjnë mirë njëri-tjetrit dhe iu jep mjetet e duhura”.

Hafiz Ali Korça në tefsirin e tij thekson: “Zoti me Madhështinë e vet na mëson se si duhet ta lëvdojmë, na urdhëron të themi: Të mirat që na ke falur nuk kanë të sosur dhe nuk mund të numërohen. Lavdërimet e përhershme dhe mirënjohjet e përgjithshme Ty të kanë hije. Ti ndihmon pa kursim dhe kujdesesh për çdo qenie të gjallë.” Pastaj ai vazhdon me interpretimin e fjalës “Rabb – رَبِّ” – Zoti i botëve, Ai që ka në dorë dhe kontrollon çdo gjë. Përpara shpalljes hyjnore, politeistët besonin në idhuj, pra secili kishte një zot. Por fjala “Rabb”, në suren Fatiha, tregon se të gjitha botët kanë vetëm një Zot.

Hafiz Ibrahim Dalliu, në tefsirin e tij, fjalën “Rabb – رَبِّ” e analizon dhe e shpjegon në mënyrë të hollësishme. Sipas tij, rrënja e kësaj foljeje është “masdar”, që do të thotë “të edukosh”, por këtu është përdorur si emër i Zotit në kuptimin “i Zoti”, e është thënë kështu, sepse Ai është plotësuesi i çdo gjëje. Fjala “Rabb” ka edhe kuptime të tjera si: krijues, ushqyes, rregullues, pranues dhe zotëruar.

Zoti me madhështinë e vet e ka

cilësuar veten e Tij të madhërueshëm që në fillim të librit me këtë cilësi të bukur, për të theksuar se më e madhja e cilësive të Zotit është edukimi.

Nëse nuk do të ishte edukimi, me të cilin çdo send plotësohet gradualisht, duke arritur qëllimin e krijimit, padyshim që sendet e krijuara do të mbeteshin të meta.

Sipas Haxhi Vehbi Dibrës, në tefsirin e tij, fjala “Rabb” tregon një emër të lartë të Allahut, që tregon se Zoti edukon, domethënë e drejton një send dalëngadalë drejt plotësimit. Pra, “Edukues i vërtetë është vetëm Zoti. Edukata hyjnore ndryshon nga edukata njerëzore. Njeriu edukon me shpresë, Zoti edukon me mëshirë. Mësuesi edukon se paguhet me rrogë, Zoti edukon vetëm për të fituar i edukuari, e për veten e Tij nuk ka nevojë që të kërkojë shpërblim, sepse Ai nuk ka nevojë për askënd dhe për asgjë.

Ky është Zoti i meritueshëm për lavdërim. Ai nuk ka nevojë për lavdërimet tona, por jemi ne që kemi nevojë, sepse janë për të mirën tonë. Zotit nuk i shtohet asgjë nga besimi ynë, por edhe nga mosbesimi Atij nuk i pakësohet asgjë.

Tani i erdhi radha fjalës “El-Alemin – العالمين”. Sipas Hafiz Dalliut, kjo fjalë është shumësi i fjalës “alem” dhe që përdoret për çdo gjë të krijuar, përveç Zotit, qoftë ajo pak apo shumë, e madh apo e vogël, fizike apo metafizike. Pra, “alem” quhet çdo lloj gjëje e

krijuar, e cila është shenjë - argument për ekzistencën e Zotit. Çdo gjëje i thuhet “alem” – botë (si p.sh. botë trupore, botë shpirtërore, etj.).

Zoti ynë, për të treguar se nuk ka mbetur asnjë grimcë jashtë edukatës së Tij, fjalën “alem” e ka sjellë në numrin shumësi e me një shquese “el”, çka tregon gjithëpërfshirje. Çdokush le të mendojë se çdo grimcë e të gjitha botëve ka nevojë për edukimin e Zotit, prandaj le të falënderojë vetëm Madhërinë e Tij.

Fraza “Rabbul alemin – رب العالمين” tregon se krijesat, kur krijohen, kanë nevojë të domosdoshme për një krijues. Ajo tregon gjithashtu se, që të të kenë jetëgjatësi, krijesat kanë nevojë për një mbrojtës. Pra fraza “Rabbul alemin – رب العالمين” do të thotë: Allahu është shpikësi e mbrojtësi i të gjitha botëve.

Për të treguar se mëshira e Tij përfshin të gjitha krijesat, Zoti urdhëron e thotë: “Err-rahmanirr-rahim – الرحمن الرحيم”, që do të thotë se Ai është shumë i mëshirshëm, është shumë falës e shumë dhurues. Gjithkujt në këtë jetë i dhuron të mira dhe pas vdekjes, në jetën e pasosur, u jep pa masë të gjithë atyre që besojnë të vërtetën.

Fahri Raziu thotë se fjala “rahmet”, do të thotë t’u japësh nevojtarëve të gjitha llojet e të mirave dhe t’i shpëtosh ata nga çdo lloj fatkeqësie. Pra, ai që ka sadopak mend, nuk dyshon aspak se Allahu

me Madhërinë e vet i dhuron të mira njeriut qysh në barkun e nënës e deri sa të vdesë dhe e ruan atë prej sëmundjeve e urrejtjeve. Prandaj ai falënderon vetëm Allahun.

Megjithëse dy emrat e bukur “Rrahman” dhe “Rrahim” Zoti ynë i ka përmendur edhe në “Bismillah”, për të theksuar se mëshira e Tij është shumë e gjerë, i përsërit sërish edhe në këtë sure.

Të qenët e Zotit “Rrahman” dhe “Rrahim” tregon qartë se vetëm Ai e meriton falënderimin, vetëm Ai është dhuruesi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i të gjitha të mirave.

Haxhi Vehbi Dibra, në tefsirin e tij, për ajetin “Err-rahmanir-rahim – الرحمن الرحيم”, thotë: “Të dy këta emra, si “Rrahman” edhe “Rrahim” në pikëpamje të etimologjisë rrjedhin nga fjala “rahmeh”, që e ka kuptimin mëshirë. Atëherë pyesim: ‘Pse Perëndia e përmend dy herë në këtë verset emrin e mëshirës së Vet?’ Këtu përmendet një hollësi letrare me kuptim shumë të lartë. “Rrahman” tregon mëshirën e Zotit në këtë botë lëndore, ndërsa “Rrahim” tregon mëshirën e Zotit në jetën e pasosur, Ahiretin. Emri “Rrahman” simbolizon mjetet e jetës fizike, ndërsa “Rrahim” simbolizon mjetet e jetës së lumtur të amshimit. Kush përpiqet vetëm për këtë jetë, fiton vetëm këtë jetë. Kush përpiqet vetëm për jetën e amshuar, fiton vetëm jetën e amshuar, ndërkohë, ai që përpiqet për të dyja jetët, i fiton

të dyja.

Pra Allahu, i Cili na i ka falur gjithë këto të mira, është i meritueshëm për t’u lavdëruar. Vetëm Atij i përkasin lavdet dhe askujt tjetër.

Ndërsa Hafiz Ali Korça, në tefsirin e tij, thotë: “Prej emrave “Rrahman” dhe “Rrahim” kuptojmë se përveç kësaj bote, ekziston edhe një botë tjetër e përhershme, ku do të ndahet i miri nga i keqi. Sikur të mos ekzistonte një botë tjetër, këto cilësi nuk do të kishin vlerë. Zoti është shumë i mëshirshëm dhe nuk ia humb mirësitë askujt; do ta ringjallë njeriun ashtu siç e krijoi për herë të parë; do ta gjykojë atë dhe do të japë vlerësimet, për shpërblim të mirëve dhe ndëshkim të këqijve.”

Hafiz Dalliu thotë se Allahu me madhërinë e vet, pasi tregoi se Ai është dhënësi i të gjitha të mirave në këtë jetë e në ahiret dhe për të treguar se Ai është edhe Zoti i Ditës së Kiametit, urdhëroi e tha: “Maliki jeumid-dijn – مالك يوم الدين”, shpikësi e mbrojtësi i gjithësisë, dhuruesi i çdo të mire, Allahu me madhërinë e vet është Zoti i Ditës së Gjykimit dhe i botës së Ahiretit.

Në Ahiret zotëruesi e përdoruesi i çdo sendi është vetëm Allahu me madhërinë e vet. Në atë ditë, përveç Tij, nuk ka pronar tjetër.

Allahu është Zot edhe i kësaj bote, por meqenëse këtu përkohësisht e formalisht sundojnë edhe njerëzit, ka treguar qartë se i vetmi Zot i Ahiretit është Allahu me

madhërinë e vet.

Fjala “dijn – دین” në frazën e lartpërmendur është përdorur me kuptimin “xheza”, shpërblim – ndëshkim, megjithëse ka edhe kuptime të tjera si sheriat, bindje, etj. “Xheza” do të thotë ndëshkim për shkelësit dhe shpërblim për mirëbërësit. Pra sipas kuptimit të ajetit “Maliki jeumid-dijn – مالك يوم الدين”, vepra e atyre që kanë sunduar në këtë jetë, do të ngelet si një ëndërr e kaluar dhe për të gjithë njerëzit vendi se ku do të futen e ku duhet të luten, do të jetë vetëm mirësi e Allahut.

Zoti ynë e cilësoi veten e Tij të madhërishtëm me vetitë që u përmendën më lart, për të treguar se lavdërimi e falënderimi është vetëm për Të dhe për të theksuar se Ai meriton me të drejtë të adhurohet.

Në ajetin e fundit, Allahu thekson se Dita e Kiametit dhe veprat për Ahiretin, janë për të ndëshkuar fajtorët e shkelësit dhe për të shpërblyer besimtarët e bindur. Në këtë mënyrë, Allahu i fton njerëzit në bindje. Ai njeri që beson se do të ndodhë dita e shpërblimit dhe e ndëshkimit, ajo ditë e vështirë, ajo ditë kur do të shihen punët një për një e do të ndëshkohen të ligjtë, duhet patjetër që të vijë në udhë të mbarë, që të mos turpërohet përpara Allahut e para gjithë botës.

Kurse njeriu që nuk beson në Ahiretin dhe nuk ka frikë prej përfundimit të tij, guxon të nxitojë

të kryejë çdo punë të keqe, nuk sprapset e nuk ndalet.

Hafiz Ali Korça, në tefsirin e tij, për këtë ajet thotë se veç Zotit dhe sifateve (cilësive) të Tij çdo gjë quhet “alem (botë)”. “Malik” dhe “Melik” quhet Zoti i gjësë, domethënë Ai që e ka në dorë dhe nën urdhër çdo gjë.

“Melik” ka edhe kuptimin mbret, sundues. “Dijn” Dita e Kiametit, dita e sundimit, dita e gjykimit dhe shpërblimit për mirë ose për keq.

Në këtë botë ke mëshirë të madhe dhe të dhimbset çdo gjë. Të gjithë botën e sheh me një sy të mëshirshëm, por në atë jetë, mëshirën e ke vetëm për miqtë e tu. Gjykimet, llogaritë, pyetjet, shpërblimet dhe dënimet e Ditës së Kiametit janë vetëm në dorën tënde; i vetmi gjykatës je ti; atje s’ka kush të të përkrahë.

Sipas Haxhi Vehbi Dibrës, ajeti “Maliki jeumid-dijn – مالك يوم الدين” ka kuptimin “i Zoti i ditës dhe i natës së Fesë”. Arabët natës i thonë “lejl” e ditës “nehar”, të dyjave bashkë u thonë “jeum”.

Prej këtij ajeti të bekuar kuptohet se Zoti me madhërinë e vet ka caktuar një ditë gjyqi për të kërkuar llogari nga robtë e vet e për të treguar se deri në ç’gradë i kemi kryer veprimet tona në përputhje me dispozitat e larta të fesë së vërtetë, me dispozitat e larta të Kur’anit të Madhërishtëm. Duhet pasur parasysh se në këtë botë nuk erdhëm kot, por për të kryer detyrimet e ngarkuara

nga vetë i Madhi Zot.

Dijetarët i kanë klasifikuar detyrat në disa grupe e kategori si: Detyra patriotike, detyra shtetërore, detyra fetare, detyra personale, detyra familjare, detyra shoqërore, etj. Për të gjitha këto detyra jemi përgjegjës para Zotit. I Madhi Zot ka për të na kërkuar llogari për çdo veprim tonin. Prandaj feja islame, Kur'ani i Madhërisëm, nuk ka vënë ndonjë kufi midis detyrave. Ajeti “Etij’u-llahë ue etij’u-rresule ue ulil-emri minkum – أَطِيعُوا اللَّهَ وَأَطِيعُوا أُولِي الْأَمْرِ مِنْكُمْ”² urdhëron që t’ju bindeni Zotit, profetit dhe sundimtarit. Ajeti “Ue shaurhum fil-emri – وَشَاوِرْهُمْ فِي الْأَمْرِ”³ cakton misionin e përfaqësuesve të masës. Ajeti “El-ledhij ju’tij malehu jetezekka – الَّذِي يُؤْتِي مَالَهُ يَتَزَكَّى”⁴ lavdëron Hazreti Ebu Bekrin që sakrifikoi tërë pasurinë e tij për shpëtimin e Atdheut. Ajeti “In-nall-lahe je’muru bil-adl – إِنَّ اللَّهَ يَأْمُرُ بِالْعَدْلِ”⁵ cakton detyrën e gjykatësve. Ajeti “Ja ejuhel-ledhijne amenu ku enfusekum ue ehlijkum nara – يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا قُوا أَنْفُسَكُمْ وَأَهْلِيكُمْ نَارًا”⁶ përmbledh detyrat familjare. Hadithi profetik “Hajrun-nasi enfe’uhum – خَيْرُ النَّاسِ خَيْرُهُمْ”⁶ përmbledh detyrat shoqërore.

Sa u tha më lart, kuptohet se asnjë vepër e jona nuk mund t’i

shpëtojë kontrollit të Allahut. Për çdo vepër jemi përgjegjës përpara Tij. Prandaj Kur’ani Fisnik nuk bën krahasime ndërmjet detyrave. Dashuria e Atdheut në fenë islame ka një vlerë të madhe, për të cilën profeti Muhamed a.s. ka thënë: “Hub-bul-uatan minel-ijman – حُبُّ الْوَطَنِ مِنَ الْإِيمَانِ” Dashuria për Atdheun është degë e besimit. Nga ky hadith sherif kuptojmë se i Madhi Zot ka për na matur edhe masën e dashurisë që kemi për Atdheun. Prandaj të kemi kujdes vëllezër e motra e të mos gabojmë e të bëjmë ndonjë tradhti ndaj Atdheut.

Për çdo vepër Zoti do të na kërkojë llogari në Ditën e Fesë, i Zoti i së cilës është Ai vetë. Dita e Fesë pra është dita e gjyqit të Amshueshëm. Në këtë gjyq gjykatësi është vetë i Amshuari. Aty nuk ka këshilltarë e avokatë; aty nuk ka hile e gënjeshtër; aty fiton meritë kush paraqitet me ndërgjegje të pastër e me vepra të mira. Domosdo nuk do të jenë të barabartë i miri me të ligun. Do të vihet në vend urdhri i Zotit, Ai është “i Zoti i Ditës së Gjyqit”.

Mund të ketë njerëz jobesimtarë që nuk e pranojnë Allahun si Zot i Ditës së Gjyqit të Amshueshëm, por edhe këta duhet të dinë se Allahu është më i Dituri e prandaj, në këtë ajet, përmendet fjala “jeum” e jo “nehar”, që do të thotë se Ai është i Zoti “i ditës” e “i natës” së Fesë, e jo vetëm i ditës. Nga kjo kuptohet se të mirët do të gjykohen në “dritë” e të

2. Kur’an, En-Nisa 4:59.

3. Kur’an, Al ‘Imran 3:159.

4. Kur’an, El-Lejl 92:18.

5. Kur’an, En-Nahl 16:90.

6. Kur’an, Et-Tahrijm 66:6.

ligjtë në “errësirë”.

Tani le të vijmë në ajetin: “Ij-jake na’budu ue ij-jake neste’ijn — وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ وَإِيَّاكَ نَعْبُدُ وَ” O Zot, vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.

Hafiz Ibrahim Dalliu vazhdon me komentimin e ajetit: “Ij-jake – Ty” Deri tani ai që lexon Fatihanë i ka sjellë fjalët në vetën e tretë dhe tha: Lavdërimi është vetëm për Allahun, Zotin e të gjithë botëve, Ai është Mëshirues i Madh. Ai është Zoti e sundimtari i Ditës së Gjykimit. Tani fjala është sjellë në vetën e dytë dhe i drejtohet Zotit sikur Atë ta ketë para syve dhe i thotë: O Zot, vetëm Ty të adhurojmë.

Lexuesi i Fatihësë tha ashtu për të treguar se Zoti, me mëshirën e Vet, pasi u cilësua me vetitë e larta, u shqua krejt në sytë e Tij. Në këtë mënyrë ligjëratat do të thotë: O Zot, më parë të njihja Ty me mendje e arsye, por tani njohja ime ka arritur në atë shkallë sa më duhet sikur të shikoj me sy. Nëse lexuesi do të thoshte: “Vetëm Atë adhurojmë”, thënia do të ishte e pasaktë.

Fjala “Na’budu — نَعْبُدُ”, ne të adhurojmë Ty e askënd tjetër.

Lexuesi i Fatihësë, edhe pse është një njeri i vetëm, nuk tha: “Të adhuroj Ty”, por e solli fjalën në trajtën e shumësit, për të treguar se jo vetëm ai, por edhe bashkëfolësit, Zotin e adhurojnë. Lexuesi e solli fjalën në këtë trajtë, sepse ai i shoqëron vetes edhe vëllezërit e

motrat e fesë në faljet dhe në lutjet e tij dhe, meqenëse ndër ta gjenden edhe engjëjt e njerëzit e devotshëm, ai ka shpresë të madhe që t’i pranohet falja e lutja nga Zoti. Për këtë urtësi është urdhëruar që falja të bëhet me xhemat.

Fjala ka ardhur në trajtën e shumësit për të theksuar se vepra e mirë që bëhet bashkërisht është më e pëlqyer dhe e vlerësuar te Zoti sesa ajo që bëhet vetëm.

Fjala “ibadet — adhurim” do të thotë: Ta çosh në vend një punë ashtu siç është urdhëruar dhe ta nderosh urdhëruesin.

Me fjalë të tjera “adhurimi” është madhërimi i Zotit deri në fund me bindje të plotë.

E madhërimi deri në fund, bëhet duke e kryer adhurimin vetëm për Zotin. Ndryshe, në qoftë se njeriu ka në mendje gjëra të tjera, adhurimi i ti është i mangët. Këtë lloj adhurimi nuk e meriton madhëria e Zotit. Pra, kur të adhurojë Zotin, njeriu duhet të zbrazë zemrën nga çdo gjë tjetër.

Dihet se pasi të kryejë detyrat njerëzore, njeriu mund të merret me çdo lloj pune të arsyeshme.

Fjala “isti’aneh” do të thotë të kërkosh ndihmë për të gjitha punët e kësaj bote dhe të Ahiretit. Atëherë kuptimi i frazës “ue ij-jake neste’ijn — وَإِيَّاكَ نَسْتَعِينُ وَ” është: O Zot, ndihmona. Në çdo punë ndihmën e kërkojmë vetëm prej Teje e jo prej dikujt tjetër.

H. Ibrahim Dalliu vazhdon:

Fahri Raziu thotë se ky ajet i madhërishtëm përmbledh në vetvete të gjitha detyrat e njeriut ashtu si fjala “ibadet – adhurim”, e cila përfshin të gjitha urdhëresat e ndalimet. Kjo do të thotë: sikurse çdo detyrë e çdo çështje e përmendur në librat e Sheriatit, përfshihen në fjalën “ibadet”, ashtu edhe çdo lutje përfshihet në fjalën “isti’aneh”. Pra Zoti ynë, të gjitha rregullat e ligjit të fesë i ka futur në këto dy fjalë, të cila janë si dy burime që nuk shterojnë kurrë.

Bejzaviu thotë se në këtë ajet përshkruhen punët e njohësit të vërtetë të Zotit, prandaj atij i qartësohen udha që do të ndjekë dhe detyrat. Puna e parë e njohësit të vërtetë të Zotit është të përmendë Zotin, të mendohet e të meditojë për kuptimin e emrave të bukur të Tij, të vështrojë në mrekullitë e Zotit dhe, pasi ta kuptojë mirë e më mirë Atë, ta adhurojë siç e meriton madhëria e Tij, të njohë fuqinë e plotë të Zotit, e cila është e mjaftueshme për t’i plotësuar njeriut nevojat e tij në çdo punë e në çdo rast, pastaj të shpejtojë e të kërkojë ndihmë prej Allahut. Allahu me mirësinë e vet, për t’u treguar njerëzve se si duhet të luten, porosit: Ai që dëshiron të kërkojë ndihmë prej Zotit, në radhë të parë duhet të cilësojë Zotin me vetitë që janë të merituarat për Të, pastaj të falënderojë të madhin Zot dhe të pohojë se vetëm Ai është i fuqishëm t’i japë atë që do të kërkojë.

Thuhet se çdo lutje e arsyeshme që bëhet sipas mënyrës së treguar më sipër, është e pranueshme tek Allahu.

Në të dy pjesët e ajetit me parafjalën “Tj-jake – اَلْحَمْدُ”, Zoti thekson se ashtu siç nuk vlen t’i bëhet adhurim dikujt a diçkaje tjetër përveç Zotit, po ashtu nuk vlen edhe të kërkohet ndihmë prej të tjerëve. Në punët e dynjasë lejohet të merren mjetet e dhura dhe të kërkohet ndihmë prej disa njerëzve; por kërkuesi duhet të dijë se ajo është ndihmë e sipërfaqshme, sepse ndihmuesi i vërtetë është Allahu me madhërinë e vet dhe është Ai që krijon mundësinë si në mjete ashtu edhe në njerëz.

Allahu i ka thënë Daudit: “O Daud. Pasha madhërinë Time, nëse vjen të kërkosh ndonjë send vetëm në derën Time, nuk lë pa ta mbaruar atë punë, sikur të kesh armik botën mbarë. Por, pasha madhërinë Time, nëse shkon nëpër dyer të tjera, dije se nuk të kryhet ajo punë, sikur gjithë botën ta kesh mik”.

Prej kësaj fjale të shenjtë kuptohet se kushdo që është i detyruar të kërkojë ndihmë prej dikujt, duhet të dijë me zemër se, me vullnetin e Zotit, nevoja e tij do të plotësohet e jo ndryshe.

Hafiz Ali Korça, në tefsirin e tij, për këtë ajet thotë: “Vetëm Ty të falemi dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë”. Vetëm Ty të falemi, veç Teje nuk njohim Zot tjetër dhe në çdo punë të mirë vetëm prej Teje

kërkojmë ndihmë, sepse veç Teje nuk ka kush tjetër të na ndihmojë. Është përdorur në shumës, sepse punët që bëhen bashkërisht kanë më shumë vlerë. Fjala vjen: Na urdhëron të themi: Zot, vetëm Ty të falemi, vetëm Ty po të përulemi, me gjithë të mirat e mangësitë që kemi, na fal dhe na dhuro. Mos lë askënd jashtë mëshirës Tënde, por na fal të gjithëve. Në çdo punë të mirë vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë, na ndihmo, mos na lë jashtë se të gjithë ne myslimanët jemi një trup i vetëm dhe jemi të gjithë një shpirt.

Haxhi Vehbi Dibra, në tefsirin e tij, për ajetin që po flasim: “Ij-jake na’budu ue ij-jake neste’ijn – اِيَّاكَ – نَسْتَعِينُ اِيَّاكَ نَعْبُدُ وَ” është zgjeruar më shumë duke thënë në fillim kuptimin: “Vetëm Ty, o Zot, të falemi dhe vetëm Ty, o Zot, të lutemi që të na ndihmosh”. Ai vazhdon: Ky ajet i madhërishtëm urdhëron që myslimani i vërtetë duhet t’i falet e t’i lutet vetëm Allahut të vërtetë, vetëm Atë duhet ta njohë për Zot, për krijues e për bamirës të vërtetë, vetëm tek Ai duhet të ketë shpresë e vetëm prej Tij duhet të kërkojë e të presë ndihmë për të realizuar qëllimet e veta.

Vetëm për këtë njeri mund të thuhet se e ka njohur Zotin si duhet e vetëm ky mund t’i afrohet Atij.

Në versetin “Ij-jake na’budu – اِيَّاكَ نَعْبُدُ – Vetëm Ty, o Zot, të adhurojmë”, kemi dy detaje:

1- Më përpara përmendet “i

Adhururari” e pastaj “adhurimi”. Kjo tregon se “i Adhuruari” është qëllimi dhe “adhurimi” është mjet për arritjen e qëllimit. Pra edhe adhurimin nuk duhet ta konsiderojmë si veprën tonë, por si një mjet që vetë Zoti na fali me mirësinë e Tij, për të na afruar ndaj Vetes së Tij.

2- Krahasimi i lartësisë së H. Muhamedit me lartësinë e H. Musait. Këtu Haxhi Vehbi Dibra tregon ngjarjen kur H. Muhamedi u shpërngul nga Meka për në Medine bashkë me shokun e tij besnik, H. Ebu Bekrin. Armiqtë i ndoqën nga pas dhe gjurmët i çuan deri te një shpellë me emrin “shpella e Pëllumbit”. Mrekullia e Zotit ndodhi – shpellën e rrethoi me një pëllhurë merimange dhe në hyrje një pëllumb kishte ndërtuar një fole brenda së cilës ndodheshin tri vezë. H. Ebu Bekri kur dëgjoi zhurmën e armiqve u frikësua për jetën e Profetit a.s., por ai e kuptoi dhe i tha: “La tahzen in-nall-llahе meа’na – لا تحزن إن الله معنا – Mos u mërzit, se Allahu është me ne”. Kjo tregon se H. Muhamedi fillimisht përmendi “Zotin” e pastaj veten e tij e shokun pranë. Ndërsa H. Musai thotë: “In-ne me’ije rab-bij sejhdiyn – إن معي ربي سيهدين – Bashkë me mua është Zoti im që do të më drejtojë”. Këtu H. Musai më përpara përmend veten e tij e pastaj Zotin. Kjo tregon shkallën më të lartë të H. Muhamedit ndaj H. Musait.

Pastaj vazhdon me komentimin e ajetit duke thënë se këtu kemi një “hasr” – hasri është një figurë letrare pas së cilës atributi i një fraze përmblihet krejtësisht në një qëllim të veçantë. Hasri në gjuhën arabe bëhet në shumë trajta; këtu kemi trajtën e hartimit të zhdrejtë. Ka qenë “na’buduke ue neste’jnuke”, që do të thotë: “Të adhurojmë Ty, kërkojmë ndihmë prej teje”, e është bërë “Ij-jake na’budu ue ij-jake neste’ijn” për të dhënë kuptimin “Vetëm Ty të adhurojmë e jo tjetërkënd dhe vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë e jo prej tjetërkujt”. Siç shihet, hasri ka dy anë: anën pohuese dhe anën mohuese.

Një tjetër figurë e përdorur në këtë ajet është “përdorimi i foljeve në numrin shumës”. Kjo ka një kuptim të veçantë dhe me rëndësi: kur falemi me xhemat (bashkërisht) është e drejtë të thuhet “adhurojmë e kërkojmë”, por kur falemi vetëm pse duhet të shprehemi në numrin shumës? Duhet sepse bashkë me ne janë edhe engjëjt, por nuk mund të harrojmë edhe të gjithë myslimanët, që të lutemi edhe për ata, me qëllim që Zoti t’u dhurojë mirësi nga mirësitë e Tij. Ndërsa kur falemi me xhemat, shumë myslimanë së bashku i drejtojnë lutjet Zotit, e ndër ta mund të jetë ndonjë besimtar me zemër të pastër e më të afërt te Zoti, e bëhet shkak që lutja e tij të bashkohet me të tjerat e të pranohet te Zoti, sepse çdo falës lutet për të gjithë.

Një shenjë tjetër treguese, - thotë H. Vehbi Dibra, - është se shpirti shpërndan rrezet e tij në të gjithë trupin dhe në falje – adhurim duhet të bashkohet e t’i drejtohen Dritës së të Madhit Zot, me shprehjen: “Vetëm Ty, o Zot, të falemi”. Të falurit nënkupton “të madhërosh e të nderosh deri në gradën më të lartë”. Kjo mënyrë të faluri është e meritueshme vetëm për Allahun e Lartësuar.

Një pikë me rëndësi që tregohet në këtë ajet është apostrofi, një figurë letrare që i jep fuqi fjalës dhe në momentin e faljes besimtari është në kontakt të drejtpërdrejtë, pa ndërmjetës me Krijuesin e tij – Zotin e Lartësuar.

Në të katër ajetet e parë të kësaj sureje u përmendën katër cilësi të larta të Zotit të Amshuar:

- 1- Uluhij-jeti – Hyjnija.
- 2- Rububij-jeti – Zotësia.
- 3- Rahmanij-jeti – Dhantija.
- 4- Rahimij-jeti – Mëshira.

Këto katër cilësi grisin katër perdet e egoizmit, të cilat janë:

a- Em-mareh – Grada e ambicies pa fre.

b- Leu-uameh – Grada me të cilën njeriu fillon të njohë gabimin e të pendohet.

c- Mulhimeh – Kur njeriu kthehet nga virtyti.

d- Mutmein-neh – Kur njeriu zhvishet fare nga veset negative dhe bëhet i virtytshëm duke iu nënshtruar plotësisht vullnetit të Zotit, e thotë:

“Vetëm Ty, o Zot, të falemi e vetëm Ty, o Zot, të lutemi për ndihmë”.

Një tjetër figurë kemi në fjalën “Na’budu”, e cila ka dy kuptime: “ibadeh” dhe “ubudeh”. E para ka kuptimin adhurim – të falurit – ku bëjnë pjesë të gjitha detyrat e adhurimet, ndërsa e dyta – ubudeh – ka kuptimin robni. ‘Ubudeh vjen nga “‘abdi-jeh”, kurse “‘ibadeh” prej “‘abidi-jeh”. I pari është më i madh se i dyti. Robnija nënkupton nënshtrimin ndaj urdhrat të Zotit pa kushte.

H. Vehbi Dibra pasi komentoi deri në këtë pikë frazën “Ij-jake na’budu”, vijon me frazën tjetër të ajetit “ue ij-jake neste’ijn – Vetëm Ty, o Zot, të lutemi që të na ndihmohet”. Këtu merr si shembull H. Ibrahimin kur mbreti Nemrud vendosi që ta digjte në zjarr, ai iu mbështet kaderit të Zotit dhe nuk kërkoi asnjë ndihmë tjetër. Zoti iu përgjigj mbështetjes së H. Ibrahimit dhe e urdhëroi zjarrin: “O zjarr, bëhu i ftohtë e shpëtoje Ibrahimin”. Ai shpëtoi; zjarri nuk e dogji, prandaj besimtari duhet të mbështetet vetëm te Zoti që t’ia ndriçojë zemrën, me të cilën e shuan zjarrin e Xhehenemit.

Haxhi Vehbi Dibra shpjegon se kemi dy lloje ndihmash:

- 1- Ndhimë e domosdoshme.
- 2- Ndhimë jo e domosdoshme.

E para është e domosdoshme, sepse pa të nuk mund të kryhet asnjë lloj pune. Sipas “Usuli Fikhut” kjo ndihmë është dhuratë e të Madhit

Zot, që na ka bërë të aftë për të kryer detyrat. Pikërisht këtu vjen edhe përgjegjësia e njeriut përpara Krijuesit të tij, se për çdo vepër që do të kryejë, do të japë llogari.

Prandaj Allahu i Lartësuar kërkon nga njeriu besim me ndërgjegje të pastër, me moral të lartë dhe në tërë veprimtarinë e tij çdo gjë duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e dispozitat e shpalljes hyjnore, Kur’anit dhe Synefit të Profetit Muhamed a.s.

Ndërsa ndihma jo e domosdoshme është lehtësuese. Kjo e ndihmon njeriun me mjete lehtësuese për ta kryer më mirë detyrën. Për shembull, Haxhi është detyrë që ta kryejnë të pasurit dhe me shëndet të mirë. Kjo është detyrë e domosdoshme; kurse sot ka mjete lehtësuese për të arritur në vendin e shenjtë – Mekë, që nga makina, treni e deri te avioni. Por, mungesa e tyre nuk e shkarkon përgjegjësinë e njeriut për kryerjen e Haxhit.

Prandaj kur lexojmë frazën e ajetit: “Ij-jake neste’ijn”, del edhe kuptimi: “O Zot, vetëm prej Teje kërkojmë të na dhurosh ndihmën e domosdoshme dhe ndihmën lehtësuese”. Të dy këto ndihma janë dhuratë e të Madhit Zot, e para të jep fuqi, kurse e dyta të jep lehtësim. Por edhe puna është krijesë e Perëndisë dhe njeriut nuk i mbetet në dorë veçse iniciativa për të pëlqyer të mirën, e pastaj të tjerat vijnë nga i Madhi Zot.

Njeriu është qendra ku jeta e amshuar bie në kontakt me jetën lëndore. Pra, ai ka marrëdhënie me të dyja jetët. Në jetën lëndore ai nuk mund të mbyllet në vetmi, por duhet të ndërtojë jetën në përputhje me ligjet e Islamit, duke mos lënë pas dore edhe detyrimet fetare. Kontakti i drejtpërdrejtë me jetën e amshuar është adhurimi i sinqertë, me devotshmëri, në kohë të caktuara sipas ligjeve të shariatit islam. Pra, myslimani që e pastron zemrën dhe i përulet Zotit në falje, i lutet: “Vetëm Ty, o Zot, të falemi e vetëm prej Teje, o Zot, kërkojmë ndihmë”, vetëm ky njeri besimtar merr fuqi nga i Madhi Zot për të përballuar të gjitha vështirësitë e kësaj bote dhe është i përgatitur për jetën e amshuar – Ahiretin.

Atëherë ky ajet merr kuptim më të gjerë: “O Zot, për çdo çështje, për çdo problem e për çdo punë tonën vetëm prej Teje kërkojmë, lusim, shpresojmë e presim ndihmë dhe prej askujt tjetër; ne nuk njohim tjetër zot veç Teje, o Allah.”

Në këtë ajet, fjalët “Ty të falemi” e “Vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë” janë folje në numrin shumës. Kjo edhe njëherë na detyron që të ndërtojmë marrëdhënie vëllazërore me njëri-tjetrin, si për punët e kësaj bote, ashtu edhe për punët e Ahiretit, në adhurim me xhemat, sepse këtu është begatia më e madhe.

Hafiz Ibrahim Dalliu vazhdon dhe thotë: “Allahu, me madhërinë

e vet, pasi tregoi se adhurimi, me të drejtë i bëhet vetëm Atij dhe ndihma i kërkohet vetëm Atij, na thotë edhe se çfarë duhet të kërkojnë robtë herën e parë. Për këtë Ai urdhëron e thotë: “Ihdinas-siratal-mustekijm-*أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ*”, që do të thotë: “O Zot, na drejto në udhë të mbarë”. Kuptimi: “O Zot, na forco në udhën e drejtë ku jemi. Na bëj të qëndrueshëm në fenë islame. Vetëm Ti na udhëzon në të drejtën dhe përveç Teje s’ka tjetër që të na orientojë.

Ky ajet është si përgjigja e njerëzve për pyetjen që u bëhet atyre nga ana e Zotit: “Çfarë ndihme kërkoni? Në çfarë pune t’ju ndihmoj?” Njerëzit përgjigjen: “O Zot, drejtona në udhë të mbarë”.

Hidajeti, udhëzimi, është shumëllojsh, por sipas Bejzaviut ato reduktohen në tre:

1. T’i kërkosh Zotit fuqinë mendore, ndjesitë e jashtme dhe gjymtyrët e trupit, me të cilat njeriu arrin qëllimin.

2. T’i caktojë Zoti njeriut arsyet mendore dhe historike me të cilat ai dallon të drejtën nga e shtrembra.

3. T’u dërgojë Zoti njerëzve pejgamberë, t’u zbresë atyre libra dhe t’iu hapë zemrat për në udhën e drejtë.

Sipas këtij kuptimi, drejtimi dhe udhëzimi i Zotit në udhën e drejtë për robin e vet, ekziston në çdo kohë.

Pastaj H. Dalliu vazhdon me

analizën: “siratal-mustekijm – صراط المستقيم”. Fjala “sirat” do të thotë “udhë”, kurse “mustekijm” do të thotë “e drejtë, e rrafshët”. Udhë e drejtë është udhë e Allahut, udhë për në fenë me të cilën erdhi Muhamedi a.s., për në fenë islame, për dispozitat e fesë islame, si dhe për dispozitat e sheriatit, që janë për të përmirësuar moralin dhe për vepra të mira. Atëherë, kuptimi i ajetit është: “O Zot, na drejto në dispozitat e fesë e të sheriatit me të cilën erdhi Muhamedi a.s.”.

Fjala “ihdina” është lutje në formën urdhërore, sepse urdhërimi që i bëhet të lartit prej të ulët, nënkupton lutje. Kjo lutje, në qoftë se del prej gojës së atij që nuk e ka gjetur udhën e drejtë, bëhet për të kërkuar drejtimin në atë udhë. Në qoftë se lutja del prej atij që është në udhën e drejtë, do të thotë se ai kërkon forcimin e vazhdimin në udhën e drejtë.

Ndërsa Hafiz Ali Korça, në tefsirin e tij, thekson: O Zot, ti po na mëson si të të lutemi. Na bëj kurdoherë të qëndrueshëm në rrugë të drejtë, në atë rrugë që ndoqën pejgamberët, në atë rrugë që ndoqën njerëzit e mirë, të cilëve u çele perden e syrit dhe e gjetën të vërtetën. Zot, nuk të them udhëzomë vetëm mua në rrugë të drejtë, por të lutem të na udhëzosh bashkë me të gjithë robtë e të gjithë botën, domethënë po të kërkoj një “hidajeh ixhtima’ij-je” e jo “hidajeh infiradij-je”, se në

udhëzimin e përgjithshëm ndodhem edhe unë.

Haxhi Vehbi Dibra, në tefsirin e tij, bën një shpjegim më të gjatë të ajetit “Ihdinas-siratal-mustekijm – Na ço o Zot në rrugë të drejtë”. Ai thotë se në këtë ajet kemi katër fjalë:

Fjala e parë “Ihdi” është kallëzues foljor në mënyrën urdhërore që shfaq lutjen, dëshirën dhe kërkesën tonë ndaj Zotit.

Fjala e dytë “na” është përemër i vetës së parë në numrin shumës dhe del kundrinor i zhdrejtë i fjalisë.

Fjala e tretë “es-sirat” është emër dhe kundrinor i drejtë ose plotësor vendi sipas gjuhës shqipe.

Fjala e katërt “el-mustekijm” është mbiemër që cilëson emrin.

Atëherë kuptimi i ajetit del kështu: “Na trego o Zot rrugën e drejtë”, ose “Na ço, o Allah; na pri, o Zot; na udhëhiq, o Krijues, në rrugën e drejtë”.

Njeriu është ngarkuar me detyrën për të njohur Zotin, që është misioni më i lartë i tij, por kjo nuk mund të arrihet pa njohur dhe “robninë tane”. Njohja e Zotit nuk ka vlerë në qoftë se ne nuk e dimë veten të jemi robtë e Tij dhe që gjithmonë kemi nevojë për Të.

Ne e kemi njohur Zotin në qoftë se kemi kuptuar mirë katër ajetet e para të sures “Fatiha” deri tek ajeti “Maliki jeumid-dijn – Ti, o Allah, je Zoti i Ditës së Gjyqit”. Kemi njohur robninë tonë, paaftësinë tonë dhe nevojën që kemi për Zotin, në qoftë

se e kemi kuptuar mirë versetin “Ij-
jake na’budu ue ij-jake neste’ijn –
Vetëm Ty, o Zot, të falemi e vetëm
prej Teje, o Zot, kërkujmë ndihmë”.

Kur t’i kemi bashkuar këto dy
etapa të njohjes sonë, kur ta kemi
njohur të Madhin Zot pa harruar
edhe robninë tonë, vjen koha të
shijojmë pemën e prej saj, atëherë
themi: “Ihdinas-siratal-mustekijm”
– Na udhëhiq drejt “siratal-
mustekijm”, na oriento në rrugën e
drejtë.

Pastaj H. Vehbi Dibra vazhdon
me kuptimin e fjalës “hidajeh”.
Sipas kadi Bejzaviut r.a. kjo fjalë e ka
kuptimin “të tregosh rrugën më të
mirë e më të lehtë”. Llojet e hidajetit
janë shumë, por të ndalemi vetëm në
katër prej tyre:

1. Mendja dhe shqisat, me të
cilat dallojmë të mirën nga e keqja.
2. Argumentet, me të cilat
dallohët e vërteta nga gënjeshttra.
3. Profetët dhe librat e shenjtë.
4. Të dallosh në zemër të
fshihat dhe prapaskenat me të cilat
kuptojmë realitetin e objekteve.

Që njeriu të arrijë këtë udhëzim
të vërtetë së pari duhet të bëjë
një luftë pa kompromis me veset
negative, ta ruajë veten të mos
përfshihet në gjërat e ndaluara sipas
shariatit, haramet dhe ato që janë të
dyshimta.

Njeriu, në shumicën e rasteve,
nuk e di se është një pasqyrë për
cilësitë e Zotit. Pejgamberi a.s.
urdhëron: “Men arefe nefsehu fekad

arefe rab-behu – Kush njeh vetveten,
(që është një pasqyrë për cilësitë e
Zotit) e njeh me të vërtetë Zotin”.
Duhet ndjekur rruga e Kur’anit dhe
shembulli i profetit Muhamed, paqja
e bekimi i Zotit qofshin mbi të.

Rruga e drejtë që përmendet në
këtë ajet, është një rrugë që nuk ka
fund, që e çon njeriun në disa grada
të larta vetëm me ndihmën e Zotit.
Ata që udhëtojnë për në rrugën e
Zotit janë dy llojesh:

1. Ata që e kanë marrë rrugën
dhe janë në udhëtim e sipër, që në
gjuhën arabe quhen “salikijn”.
2. Ata që kanë mbërritur në
destinacion dhe po shëtisin, që në
gjuhën arabe quhen “uasilijn”.

Por duhet ditur se udhëtimi për
te Zoti nuk është në formë materiale
dhe nuk ka vend që të ecet. Kjo do
të thotë se njeriu duhet të zbatojë
urdhëresat dhe porositë e Zotit të
përcaktuara në Shpalljen Hyjnore, të
mbrohet nga sendet e ndaluara, që
quhen “haram”. Çdo njeri që fillon
një punë të mirë, Zoti ia plotëson
shpërblimin edhe në qoftë se nuk e
mbaron, si pasojë e pengesave që i
dalin përpara.

“Siratal-mustekijm – rruga
e drejtë” është vetë feja islame.
Atëherë kuptimi i ajetit “na udhëhiq
në rrugën e drejtë” e ka domethënien
“na udhëhiq në fenë islame”. Kur
jemi në fenë islame, atëherë i lutemi
Zotit që të na bëjë të qëndrueshëm
në të dhe të na ngrejë në shkallët më
të larta të saj.

Ajetin e fundit “Siratal-ledhijne en’amte alejhim – صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ – O Zot, na drejto në udhën e atyre që Ti u ke falur mirësi”, H. Dalliu e komenton në fraza të veçanta dhe thotë: “Prandaj na drejto edhe ne në rrugën e tyre”. Pastaj pyet: “Kush janë këta njerëz, të cilët i ka nderuar Zoti dhe i ka përmendur në këtë ajet?” Shumica e dijetarëve kanë thënë se njerëzit e nderuar janë peygamberët, evliatë, dëshmorët dhe të mirët e besimtarëve. Po cila është mirësia (ni’meh - nimeti) i përmendur në këtë ajet? Mirësia është feja, që na është dhënë (ni’metud-dijn), sepse në çdo kohë feja është ajo që i çon njerëzit në lumturinë e të dyja jetëve. Prandaj njeriu meriton të kërkojë një fe të vërtetë dhe të lutet që të jetë i qëndrueshëm në të. Për këtë, Zoti me madhërinë e Tij i ka mësuar robtë e Tij në suren e parë të Kur’anit të luten sipas saj; prandaj Fatihaja është nga suret e para të Kur’anit.

Ajetet e para të Kur’anit janë:

أَقْرَأَ بِاسْمِ رَبِّكَ الَّذِي خَلَقَ ﴿١﴾ خَلَقَ
الْإِنْسَانَ مِنْ عَلَقٍ ﴿٢﴾ أَقْرَأَ وَرَبُّكَ الْأَكْرَمُ
﴿٣﴾ الَّذِي عَلَّمَ بِالْقَلَمِ ﴿٤﴾ عَلَّمَ الْإِنْسَانَ مَا
لَمْ يَعْلَمُ ﴿٥﴾

“Ikre’ bismi rab-bikel-ledhij khaleka. Khalekal-insane min alekin. Ikre’ ue rab-bukel-ekremul-ledhij al-leme bilkalemi. Al-lemel-insane ma lem ja’lem – 1. Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (gjithçka), 2. e krijoi njeriun nga një droçkë gjaku. 3. Lexo se Zoti yt është Bujari më

7. Kur’an, El-‘Alak 96:1-5.

i madh, 4. i Cili, me anë të penës ia mësoi, 5. ia mësoi njeriut ato që nuk i dinte.”

Për të theksuar se njeriu duhet të hulumtojë për të gjetur fenë e vërtetë e për të hyrë në udhën e mbarë, Zoti thotë se njerëzit, përpara çdo gjëje, duhet të kërkojnë të vërtetën dhe qëndrueshmërinë në udhën e drejtë.

Allahu me madhërinë e Vet, pasi tregoi se udha e të nderuarve meriton të kërkohet, urdhëron e thotë: “Gajril-magdubi alejhim ue led-dal’lijn – لَا الضَّالِّينَ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَ – Mos na drejto, o Zot, në udhën e atyre që kanë merituar zemërimin dhe as në udhën e të humburve”.

Kuptimi i fjalës “zemërim – gadab” është: Të ndizet gjaku prej hidhërimit kur sheh diçka të keqe dhe dëshiron të ndëshkosh keqbërësin. Kur kjo fjalë i atribuohet Zotit, i jepet edhe kuptimi i parë edhe i fundit.

Pra kur themi “Njerëzit që e kanë merituar zemërimin e Zotit”, nënkuptojmë: Njerëzit që janë ndëshkuar, sepse kanë vepruar keq. Po kush janë të ndëshkuarit dhe kush janë të humburit? Mendimi më i saktë, për shumicën e dijetarëve është: Të ndëshkuarit janë shkelësit e fajtorët e çdo populli, kurse të humburit janë ata që nuk dinë si duhet ta njohin Zotin e vërtetë dhe që kanë mbetur në errësirën e paditurisë.

Hafiz Ali Korça, në tefsirin e

tij, thekson: “Na udhëzo në udhën e drejtë, në udhën e atyre që u fale të mira, mos na udhëzo në rrugën e të mallkuarve, atyre që i ke marrë mëri dhe as në rrugën e atyre që i ke lënë në errësirë”.

Zoti na urdhëron t'i lutemi kështu: Na drejto e na bëj të qëndrueshëm në udhën e drejtë, në atë udhë që ke udhëzuar ata që u ke plotësuar mirësitë, si pejgamberët dhe evliatë, etj. Mos na ço në atë rrugë të faqezinjve, që nga ligësitë që punuan i nëme e i mallkove. Mos na mbaj as në atë rrugë të atyre fatkeqëve, që mbetën në errësirë duke të shoqëruar Ty bij e bija, etj.

Pra të lutemi të na ndihmohet në çdo mënyrë, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër; mbështetja jonë është vetëm tek Ti. Zot, me anën e mendjes që na ke falur mendohemi dhe e shohim botën të ndarë në tri pjesë:

1. Zotërinj të pafajshëm, por të mirë.
2. Të mallkuar.
3. Besim-ngatërruar, të mbetur në errësirë.

Të qofshim falë, o Zot. Ti po na mëson të lutemi kështu: Udhëzona e na bëj të qëndrueshëm kurdoherë në rrugë të drejtë, në atë rrugë që ndoqën pejgamberët, në atë rrugë që ndoqën njerëzit e mirë, të cilëve u çele perden e syrit dhe e gjetën të vërtetën.

Haxhi Vehbi Dibra, në tefsirin e tij, zgjerohet më shumë në komentin

e ajetit në fjalë, kur thotë: “O Zot, na drejto në rrugën e atyre mbi të cilët ke dhënë shumë të mira”. Këtu thekson ai, përsëritet fjala “sirat” që është një figurë letrare dhe sipas gjuhës shqipe është ndajshëm, që përdoret për ta sqaruar e përforcuar më shumë atë që është thënë më përpara “siratal-mustekijm”, që do të thotë feja islame. Ata që e kanë ndjekur me të vërtetë këtë fe, kanë përfituar shumë të mira nga i Madhi Zot. Prandaj edhe ne i lutemi të Madhit Zot duke thënë: “O Zot, lutemi na drejto në udhën e mbarë të fesë islame, në udhën e atyre të cilëve iu fale shumë të mira”. Që Allahu të na fale shumë të mira, duhet të ndjekim pikë për pikë urdhërin e Tij dhe të Dërguarit të Tij, Muhamedit a.s. Për gabimet duhet të pendohemi dhe t'i kërkojmë falje Zotit, me qëllim që të na shoqërojë me njerëzit e mirë.

Pastaj ai shpjegon fjalën “ni'meh”, që do të thotë dobia që rrjedh nga puna e mirë. Çdo gjë që sjell dobi, si dhe ajo që na largon nga e liga, vjen prej të Madhit Zot.

Mirësitë e Zotit mund të përfytyrohen në tri mënyra:

1. Mirësia që vjen direkt prej Zotit, pa ndërmjetës, siç është krijimi njeriut.

2. Mirësia indirekte, që vjen nga ndonjë shok dhe pa ndërmjetës, burimin përsëri e ka nga i Madhi Zot, i Cili është Krijuesi i të mirave.

3. Mirësia që vjen nga adhurimi, falja e lutja, e cila, përsëri, vjen nga i

Madhi Zot.

Mirësia më e madhe është krijimi i njeriut e pastaj mjetet e jetesës për ta mbajtur gjallë deri në caktimin e Zotit. Për këtë arsye njeriu ka nevojë për ndihmën e Zotit në çdo moment të jetës, për ta pastruar atë nga veset e liga, që janë në kundërshtim me urdhrat e Tij.

Pastaj vazhdon me pjesën tjetër të ajetit duke i dhënë kuptimin përfundimtar: “O i Madhi Zot, na drejto në rrugën e atyre mbi të cilët ke bërë shumë mirësi e jo në rrugën e atyre që mbi ta ka rënë zemërimi Yt, e as në rrugën e atyre që kanë humbur rrugën e drejtë dhe janë larguar nga e vërteta.

Fraza e fundit e ajetit:

“Gajril-magdubi alejhim ue led-dal’lijn – لَا الضَّالِّينَ غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ – وَ” , tregon karakteristikat e popujve të kaluar, që nuk iu bindën predikimeve të profetëve të Allahut.

Popujt e kaluar ndahen në dy grupe:

1. Ata që kanë besuar të Dërguarit e Zotit dhe iu bindën këshillave të tyre.

2. Ata që nuk besuan të Dërguarit e Zotit dhe nuk iu bindën këshillave të tyre.

Grupi i parë fitoi mirësitë e Zotit, ndërsa grupi i dytë zemërimin e Tij. Prandaj kur falemi i lutemi Zotit të na çojë në rrugën e të parëve e jo në rrugën e atyre që i ka përfshirë zemërimi i Tij. Nga kjo kuptohet se rruga e të mirëve është e besimtarëve

të devotshëm. E mira më e madhe e tyre është “imani”, besimi në Zotin. Ky është edhe misioni i njeriut, i caktuar nga Zoti, amaneti hyjnor për të. Fjala “emaneh” nënkupton perceptimin, besimin dhe praktikimin e detyrimeve fetare si: Besimi në Zotin, në jetën e pasosur, të falurit, zekati, agjërimi, vajtja në Haxh, e të tjera virtyte të larta morale. Plotësimi i këtyre detyrimeve fetare nga besimtari tregon dashurinë ndaj Zotit. Ndërsa ata që nuk besuan e nuk zbatuan këshillat e profetëve do t’i përfshijë zemërimi Zotit. Në të vërtetë, me zemërim kuptojmë rezultatin e drejtësisë Hyjnore, e cila ndëshkon të padrejtët dhe ata që nuk kanë zbatuar detyrat e ngarkuara. Pra, “gadabi” rrjedh nga shpërdorimi i detyrës dhe “dalaleti” rrjedh nga shpërdorimi i arsyes. Kush e di detyrën, por nuk e kryen, fiton “gadabin – zemërimin” dhe kush nuk e di detyrën, duke pasur mendje në kokë, ka shpërdoruar logjikën dhe arsyen.

Në fund, H. Vehbi Dibra jep interpretim përfundimtar të shkurtuar të sures Fatiha, ku thotë: “Çdo lavdërim i përket vetëm Allahut, sepse vetëm Ai është Zoti i të gjitha krijesave. Vetëm Ai është Bamirësi e Mëshiruesi i Madh; vetëm Ai është Zot i Ditës së Gjyqit të Amshuar. Vetëm Ty, o Zot, të falemi e vetëm prej Teje kërkojmë ndihmë. Na fal, o Allah, rrugën e drejtë, rrugën e atyre mbi të cilët derdhe të gjitha të mirat

e Tua e jo rrugën e atyre që i more në gadab (u zemërove me ta), as atë të atyre që mbetën në errësirën e paditurisë. Amin.”

Sipas H. Ibrahim Dalliut fjala “Amijn” do të thotë: “Pranoje lutjen tonë, o Zot i madh e i vërtetë”. Fjala “amin” nuk është fjalë e Kur’anit, por ka ardhur si një lutje e dytë për pranimin e lutjeve që përfshin surja “Fatiha”. Kështu na ka mësuar zotëruesi i shariatit: “Amijn” thuhet në fund të çdo lutje për të kërkuar që ajo të na pranohet. Ai njeri që e mbaron këndimin e Fatihasë e ka synet të thotë “Amijn”, sepse Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kur mbaroi së kënduari Fatihanë, Xhibrili më mësoi të them ‘Amijn’”. Kjo fjalë është si vula në hartë.

Pastaj Hafiz Dalli u jep konkluzionet përfundimtare për suren Fatiha ku thekson të gjitha dispozitat e Kur’anit Fisnik, që janë:

Zoti dhe vetitë e Tij të larta, punët e profecisë, punët e Ahiretit, detyrat e njeriut ndaj Zotit, në të cilat përfshihen të gjitha urdhrat e ndalimet, lutja vetëm Allahut dhe kërkitimi i ndihmës vetëm prej Tij, ngjarjet e pejgamberëve dhe të popujve të kaluar, gjendjet (ahual) e shkelësve e të fajtorëve dhe shkaqet e zhdukjes së tyre. Sipas kësaj renditjeje:

Qenien e Zotit Krijues e Mbrojtës i gjithësisë, Allahu e ka theksuar në ajetin:

“El hamdu lil’lahi rabbil alemijn.

الْحَمْدُ لِلَّهِ — رَبِّ الْعَالَمِينَ ﴿١﴾ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Detyrat që përfshijnë të gjitha urdhrat e ndalimet i ka theksuar në ajetin:

“مَالِكِ يَوْمِ الدِّينِ”.

Dispozitat për të kërkuar ndihmë e për të shfaqur nevojat i ka theksuar në ajetin:

“وَإِلَّا كُنْتُمْ تُعْبَدُونَ”.

Lutjet që janë për largimin e fatkeqësive e për të sjellë të mirën, i ka theksuar në ajetin:

“إِهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ —

Rrëfimet për pejgamberët dhe njerëzit e mirë, i ka theksuar në fjalët e madhërueshme:

“Siratal-ledhijne en’amte alejhim — صِرَاطَ الَّذِينَ أَنْعَمْتَ عَلَيْهِمْ”.

Edhe ndodhitë e atyre popujve që nuk e kanë gjetur udhën e drejtë, por kanë mbetur të shushatur në buzë të greminës së humbjes e janë ndëshkuar me zemërimin e Zotit, i ka theksuar në fjalët e fundit të sures:

“gajril-magdubi alejhim ue led-dal’lijn — غَيْرِ الْمَغْضُوبِ عَلَيْهِمْ وَلَا الضَّالِّينَ”.

Me qëllim që të nxjerrim mësim e të largohemi prej punëve të liga, Allahu me Madhërinë e Vet, na porosit e na nxit, qysh në fillim të Kur’anit, që të studiojmë punët e popujve të kaluar dhe të hulumtojmë se me çfarë pësimesh u goditën ata. Pra, të merresh me studime historike, është punë shumë e rëndësishme.

Siç u tha më sipër, Fatihaja përfshin në thelb kuptimin e gjithë Kur'anit, i cili në brendinë e vet ka kuptimet e librave të mëparshëm. Kjo do të thotë se surja Fatiha përmbledh në brendinë e saj kuptimet e të gjithë librave të Zotit.

Prandaj ajo është më madhështorja e të gjitha sureve të tjera.

H. Ibrahim Dalliu e mbyll me shkurtimin e interpretimit (tefsirit) të Bismilahit dhe të Fatihës, ku thotë:

O robtë e Mi, thoni: “Me emrin e Allahut, Mëshirues i Madh këndojmë Kura'nin:

Çdo lavdërim e falënderim është vetëm për Allahun, Krijuesin e Mbrojtësin e të gjithë botëve. Ai

është Dhënësi në dynja i ushqimit e i të mirave të tjera për të gjitha krijesat dhe në Ahiret, Ai është Falës dhe Nderues, veçanërisht për besimtarët e vërtetë; Ai është Zotëruesi e Sunduesi i Ditës së Gjykimit. O Zot, Ti që je i shquar me këto veti të larta, vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje, në çdo rast ndihmë kërkojmë. Ti, me Madhërinë Tënde na udhëzo e na bëj të qëndrueshëm në udhën e drejtë. Në udhën e atyre njerëzve të ndershëm që kanë arritur mirësitë e amshueshme të Zotit dhe janë të siguruar prej dënimit e humbjes (gadabit e dalaletit).

O Zot i madh e i vërtetë pranoji lutjet tona.

BEDIUZZAMAN SAID NURSI

Mrekullia e kohës II

Dorian Demetja

Abstrakt

BediuZZaman Said Nursi ishte dijetar i një kalibri të lartë me origjinë kurde, lindur më 1878 në Turqinë Lindore. Ai jetoi në dekadat e fundit të Perandorisë Osmane, përjetoi rrëzimin dhe copëtimin e saj pas Luftës së Parë Botërore, si dhe jetoi edhe 37 vjet pas formimit të Republikës Turke më 1923. Të qenët gjatë gjithë jetës dhe misionit të tij si një person me gradë të lartë shpirtërore, ishte rezultat i të vepruarit në përputhje me Kur'anin e Sunetin, si dhe të respektimit të arsyes e logjikës. Ai i qëndroi besnik kauzës së tij me aq fisnikëri, sa që nuk kërkonte asgjë tjetër, përveç mundësisë për të plotësuar nevojat minimale për mbijetesë. Shumë botime dhe konferenca i janë kushtuar cilësive të dallueshme të BediuZZamanit, si devotshmëria ndaj idealeve të larta, perceptimi i tij i thellë për botën e sotme, thjeshtësia, humanizmi gjithëpërfshirës, besnikëria ndaj shokëve të tij, delirësia, modestia, përulësia dhe mjaftueshmëria me pak.

BediuZZaman Said Nursi gjatë gjithë jetës është ndeshur me sprova nga më të vështirat, kjo për arsye se ai u ballafaqua dhe u përpoq të ndeshej me anarkinë, e cila bazohej në mosbesim dhe ateizëm, duke e përkuftizuar atë si problemin më domethënës që kishte nevojë të zgjidhej urgjentisht. Ai jetoi në një kohë, kur një pjesë e mirë e njerëzimit ishte zhytur në ateizëm, për shkak të abuzimit me shkencën e filozofinë, dhe kur truri shpëlabej me komunizëm. Ai urrente mosbesimin, tiraninë dhe largimin nga feja, ndaj edhe luftoi fort kundër despotizmit. Ai thotë: “Para meje është një zjarr i madh. Flakët e tij po arrijnë në kupë të qiellit. Në atë zjarr po më digjet fëmija im, besimi më ka marrë flakë. Po vrapoj që ta shuaj atë zjarr dhe të shpëtoj besimin. Dikush ma pengon këmbën në rrugë, ç’rëndësi ka? Përballë këtij zjarri të madh, a ka vlerë kjo ngjarje e vogël?! Mendime të cunguara! Pikëpamje të ngushta!...”

BediuZZamani analizoi tre faktorë madhorë që kishin të bënin me thelbin e problemeve të atëhershme, por që mbetën të tillë edhe në kohën tonë: Injoranca në sensin e indiferencës

ndaj Zotit dhe Profetit, varfëria dhe përçarja shoqërore. Bediuzzaman ia kushtoi jetën luftës ndaj këtij virusi fatal. Në syrin e tij, shpresa e shpëtimit për umetin do të ishte e kotë, përderisa ideologjia e rreme e të devijuara do të mbizotëronin dhe derisa shoqëria të mos ndriçohet me dritën e të mësuarit, dijes dhe mendimit sistematik. Ai i frymëzoi brezat e rinj me siahariqin e rilindjes dhe i udhëhoqi ata drejt shtigjeve që të shpinin te mendimi islam. Ai gjithmonë i referohej dijes dhe aktivizimit të mendjes, punonte shumë për lindjen e një shoqërie të përsosur e të shëndoshtë. Për arritjen e një ideali të tillë, Bediuzzamani mendonte se edukimi përbënte udhërrëfyesin kryesor, tek i cili do të përfshiheshin xhamitë, shkollat, garnizonet, rrugët, këndet e lojërave, madje edhe burgjet.

Bediuzzamani shkroi shumë libra, por në fokus ishin veprat e titulluara “Risale-i Nur” (Mesazhet e Dritës). Ato janë fryt i përpjekjeve serioze, të cilat shpjegojnë dhe i paraqesin njeriut të sotëm parimet bazë të besimit dhe të vërtetat e Kur’anit. Vetë Bediuzzamani në një ligjëratë u shpreh: “Tani unë e shoh qartë se pjesa më e madhe e jetës sime është komanduar e drejtuar jashtë aftësisë së perceptimit tim, që do të nxirrte këto mesazhe për t’i shërbyer çështjes së Kur’anit, thua se e gjithë jeta ime si studiues, të kishte kaluar në parapërgatitjen për këto shkrime, të cilat demonstrojnë mrekullinë e Kur’anit.”

Në shekujt e XIX-të dhe XX-të, sulmet ndaj themeleve të besimit të ndërmarra nga materialistët, ateistët e të tjerët, në emër të shkencës e progresit, e bënë Bediuzzamanin që të kuptonte nevojën urgjente e themelore, e cila konsistonte në ruajtjen dhe forcimin e besimit. Metoda e tij analizon besimin e mosbesimin dhe demonstroi përmes argumenteve të qarta logjike se, duke ndjekur metodën e Kur’anit, jo vetëm që është e mundur t’i provosh në mënyrë të arsyeshme të gjitha të vërtetat e besimit, por demonstroi gjithashtu, se këto të vërteta kanë të vetmin shpjegim racional për ekzistencën, njeriun dhe universin. Me këtë metodë që zhvilloi, Bediuzzamani i shpjegoi të vërtetat e besimit me një gjuhë që mund të kuptohet nga njerëzit e të gjitha shtresave, duke paraqitur unitetin e mendjes, zemrës dhe ndjenjave. Kështu, duke ndërthurur teologjinë, misticizmin dhe shkencat pozitive, ai paraqiti një perspektivë krejt të re dhe synoi të eliminonte ndarjen e shkollës, medresesë dhe teqesë. Veprat e tij janë lexuar vazhdimisht me mjaft kujdes, me ndjenja të sinqerta vlerësimi dhe do të vazhdojnë të jenë të një rëndësie të veçantë sa më shumë që kalon koha.

Bediuzzamani besoi se burimi, shkaku i problemeve të njeriut në kohën e sotme me të cilat përballëj bota islame, do të mund të kurohej, në mënyrë të veçantë, vetëm nëpërmjet përtëritjes së besimit. Kështu, Bediuzzamani u ktheu shpinën politikave të kohës dhe ia kushtoi të gjithë përpjekjen e tij këtij qëllimi. Me njohjen e thellë të shkencave fetare dhe moderne, rruga e re për tek e vërteta, që Bediuzzamani hapi me veprat e “Risale-i Nurit”, ishte aq e suksesshme në ruajtjen dhe forcimin e besimit, sa që ai u pranua nga shumë personalitete të ishte ripërtëritësi i fesë, premtuar nga Profeti Muhamed (a.s.) se do të vinte në çdo shekull në hadithin e mirënjohur: “Pa dyshim që Allahu do t’i dërgojë këtij umeti në çdo fillim shekulli një muxhedid, i cili do të ripërtërijë çështjet e fesë.”

PERIUDHA E SAIDIT TË TRETË (1950-1960)

“Saidi i Tretë” përcaktohet përgjithësisht me fjalët e ndryshimeve që Bediuzzamani bëri në rrugën me të cilën pati modeluar jetën e tij për shumë vite, si dhe me përfshirjen e tij më afër zhvillimeve shoqërore e politike. Afjoni i shërbeu çështjes së “Risale-i Nurit” edhe në mënyra të tjera, ashtu siç patën shërbyer para tij Eskishehiri dhe Denizli, ku njëri prej këtyre shërbimeve ishte edhe ai për unifikimin e lëvizjes së tyre. Nxënësit e “Risale-i Nurit” nga e gjithë Turqia shkuan në Afjon për të parë proceset gjyqësore dhe për t’u dhënë mbështetje morale shokëve të tyre që po gjykoreshin, dhe në këtë mënyrë ata arritën të njihnin njëri-tjetrin e të vendosnin lidhje të forta, si dhe u informuan më mirë rreth Bediuzzamanit, “Risale-i Nurit” dhe metodës së shërbimit të tij.

Ashtu si tregonte shpesh Bediuzzamani, pavarësisht të gjitha provokimeve dhe përpjekjeve për t’i implikuar e përfshirë nxënësit e “Risale-i Nurit” në trazira për të prishur rendin, asnjë nxënës i tij nuk ishte pikasur në këtë drejtim. Rruga e “Risale-i Nurit” dhe e nxënësve të tij ishte shërbimi ndaj besimit dhe Kur’anit me mjete paqësore dhe me të vepruarit pozitivisht. Ishte një rrugë paqësore ose xhihadi i fjalës (xhihad ma’nevi) kundra mbrapshtive dhe shthurjes së ateizmit dhe të mohimit,

ishte xhihadi për të ngulitur besimin e sigurt në zemrat dhe mendjet e njerëzve, i cila pati si rezultat ruajtjen e rendit publik dhe stabilitetit.

Shfaqja e “Saidit të Tretë” përkoi afërsisht me humbjen e Partisë së Popullit Republikan në zgjedhjet e përgjithshme të majit 1950 dhe me ardhjen në fuqi të Partisë Demokratike. Bediuzzamani i shikoi demokratët si “ndihmës” të nxënësve të tij në luftën kundra komunizmit dhe pafesisë, i pa si “ndihmues” për të formuar një barrierë kundra rreziqeve të ndryshme, si dhe një mundësi për të riparuar dëmin moral e shpirtëror që ishte shkaktuar me vite. Me fundin e sundimit tiranik të Partisë së Popullit Republikan, kufizimet për lëvizjen e Bediuzzamanit ishin hequr dhe ai i kaloi këto vite në Emirdag dhe Isparta, me vizita në Stamboll, Ankara dhe në vende të tjera, siç kërkohej nga aktivitetet që shtriheshin gjithnjë e më shumë lidhur me “Risale-i Nurin”, ose për t’u paraqitur në gjyq; sepse pavarësisht qeverisë së re, burokracia dhe struktura qeverisëse e vendit ishte përgjithësisht akoma në duart e mbështetësve të regjimit të mëparshëm. Kështu, kopjet e “Risale-i Nurit” vazhduan të konfiskoheshin, Bediuzzamani dhe nxënësit e tij vazhdonin të vuanin shtypjen, po ashtu, edhe proceset gjyqësore vazhdonin.

Procese gjyqësore të ndryshme

Me lirim e tij nga burgu i Afjonit më 20 shtator 1949, Bediuzzamani u shoqërua nga dy oficerë të policisë për te një shtëpi në qytet, e cila ishte marrë me qira nga disa nxënës të tij, që ishin liruar nga burgu më herët. Përpara shtëpisë bënin roje dy policë, të cilët mbanin shënim emrat e të gjithë vizitorëve. Aty Bediuzzamani qëndroi 2 muaj para se të rikthehej te shtëpia e tij e mëparshme në Emirdag. Me ardhjen në fuqi të Partisë Demokratike, rreth 6 muaj pasi Bediuzzamani u rikthye në Emirdag, kufizimet për lëvizjet e tij ishin hequr teorikisht dhe në atë vit, përveç ndarjes së gëzimit të të gjithë vendit për shfuqizimin e ligjit që ndalonte thirrjen e ezanit në gjuhën arabe¹, ai pati mundësi t'i bashkohej xhematit të xhamia e Çarshisë për faljen e namazit të teravisë gjatë 30 netëve të Ramazanit.

Në shumë raste, kopjet e “Risale-i Nurit” rrëmbeheshin në mënyrë të paligjshme. Jo pak herë Bediuzzamani sulmohej dhe kërcënohej për shkak të veshjes së tij, madje u dërgua para gjykatës në Emirdag në verën e vitit 1951, për

1. Në kohën kur ishte në pushtet e vetmja parti në atë kohë, Partia e Popullit Republikan, viti 1932 u shpall viti i reformave në fe. Kështu, më 30 janar 1932 fillon të këndohet ezani në gjuhën turke, që zgjati deri më 16 qershor 1950, për t'u kënduar përsëri në gjuhën arabe me ardhjen në pushtet të Partisë Demokratike.

shkak se refuzoi të vishte kësulën strehë-gjerë të tipit evropian. Në fillim të vitit 1952, një proces gjyqësor u ngrit kundra Bediuzzamanit dhe një nxënësi të ri, i cili kishte botuar me shkronjat e reja (alfabet latin) në Stamboll broshurën “Gençlik rehberi” (Priçësi i rinisë). Ai proces gjyqësor përfundoi me dhënien e pafajësisë. Disa vite më vonë, kryegjyqtari i këtij procesi gjyqësor tha për atë ditë: “Ai (Bediuzzamani) ishte një njeri inteligjent. Ai e parashikoi rezultatin e gjyqit nga mënyra si po ecte. Ai nuk shfaqti as shenjën më të vogël të shqetësimit dhe të tronditjes, ai ishte i qetë e i çiltër, sikur po fliste me shokët në shtëpinë e tij. Ai foli me një theks të lindjes.”.

Në vitin pasues u hap një tjetër proces gjyqësor në qytetin Samsun, në të cilin Bediuzzamani nuk mundi të merrte pjesë për shkak të shëndetit të tij, por që përfundoi me dhënien e pafajësisë. Në vitin 1956, një proces gjyqësor u ngrit kundra Bediuzzamanit dhe 89 nxënësve të “Risale-i Nurit” në Isparta për “Formimin e një shoqërie sekrete”, akuzë e cila u hodh poshtë për mungesë provash. Pastaj, në Ankara, Isparta dhe në shumë vende të tjera, pati procese të tjera gjyqësore kundra nxënësve të “Risale-i Nurit” dhe që të gjitha ato përfunduan me dhënien e pafajësisë. Lidhur me këto akuza, Bediuzzamani i shkroi disa peticione presidentit dhe ministrave, si dhe

deputetëve fetarë të Asamblesë Kombëtare, për t'u treguar të vërtetën e çështjes.

Në lidhje me të gjitha mundimet, internimet, burgimet apo vuajtjet që ai ka hequr në jetë, Said Nursi shprehet: *“Përgjatë 80 viteve të jetës sime, nuk di të kem jetuar asgjë në emër të kënaqësive të kësaj bote. Jeta më ka kaluar veç në fushat e betejës, qelitë e burgimit e në shumë vende të tjera vuajtjesh. Nuk ngeli dhimbje pa jetuar dhe shtypje pa provuar. Nga gjyqet ushtarake pashë veç sjellje torturuese, u internova trevë më trevë sikur të isha një rrugaç. Në të gjitha vendet e internimit m'u ndalua të takoja edhe njerëzit. Më helmuan disa herë, e po ashtu më fjen në mënyra të ndryshme. Pati raste të tilla që, më tepër desha të vdisja se të jetoja. E nëse nuk do të ishte feja ime që të më pengonte prej vetëvrasjes, ndoshta sot Saidi do të ishte duke u tretur nën dhe.”*²

Vizita dhe takime

Pas marrjes së pafajësisë, Bediuzzamani u kthye në Emirdag, në mars të vitit 1952. Shumë miq dhe dashamirës kërkonin ta takonin, mirëpo ai u shkroi një letër ku shprehte dëshirën e madhe për t'u takuar me ta, por për shkak të pleqërisë, shëndetit të lig dhe dobësisë prej helmimit, ai nuk kishte fuqi dhe nuk mund të fliste shumë. Megjithatë ai shkroi: *“Unë ju them se secila pjesë e ‘Risale-i Nurit’ është një Said. Cilëndo pjesë që do të lexoni prej saj,*

2. Bediuzzaman Said Nursi, *Jetësberimi*, f. 610 (Analizat).

*ju do të përfitoni dhjetë herë më shumë se takimi me mua personalisht. Gjithashtu, ju kështu do të më takoni në mënyrën e vërtetë.”*³

Një nga ngjarjet që nuk duhet të lihet pa përmendur, ishte vizita që i bëri Bediuzzamanit zv/ministri i qeverisë së Pakistanit Sejjid Ali Ekber Shah, i cili në atë kohë ndodhej për një vizitë zyrtare në Turqi. Bediuzzamani i shpjegoi vizitorit veprat e “Risale-i Nurit” dhe metodën e tij të shërbimit. Zv/ministri mbeti shumë i kënaqur për vizitën dhe shprehu vlerësimin e tij me nota të plota. Kur u kthye në Pakistan, ai u përpoq shumë për ta bërë të njohur Bediuzzamanin dhe veprat “Risale-i Nur”. Në fakt, ai e pati ftuar Bediuzzamanin në Pakistan për t'i dhënë atij qasje në të gjithë median, por Bediuzzamani iu përgjigj se fronti i tij ishte në Turqi, meqenëse sëmundja bazë kishte nisur atje. Sejjid Ali Ekber Shah, më vonë emërohet rektor i universitetit të Sindit dhe mban korrespondencë me nxënësit e “Risale-i Nurit” në Turqi, duke vazhduar në këtë mënyrë t'i shërbejë çështjes.

Gjatë viteve 1950, vepra “Risale-i Nur” gjeti shumë nxënës dhe lexues të rinj në shumë vende të ndryshme të botës. Pjesa e fundit e biografisë zyrtare të Bediuzzamanit, i kushtohet këtyre zhvillimeve dhe përfshin letra nga nxënësit e “Risale-i Nurit” nga

3. Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, f. 508.

vende të largëta si Finlanda dhe Uashingtoni, si dhe nga vende të ndryshme islame. Artikujt nisën të shfaqeshin në vende të largëta si Iraku dhe Pakistani. Gjithashtu, disa nga nxënësit e “Risale-i Nurit” udhëtuan në vende të huaja me qëllim që të bënin të njohur atë dhe të vendosnin lidhje, për shembull në Hixhaz, Siri dhe Iran. Në vitin 1954 Bediuzzamani e dërgoi nxënësin e tij, Muhsin Alev, në Gjermani për të botuar librin “Mrekullitë e Kur’anit”. Ai qëndroi në Berlin, duke i shërbyer aktivisht çështjes së “Risale-i Nurit”. Bediuzzamani dërgoi në Gjermani librin “Dhulfikar” dhe pjesë të tjera të veprës “Risale-i Nur”, të cilat u pritën me shumë vlerësime.

Ai pati vizita edhe prej dijetarëve e figurave fetare të botës islame. Një nga qëllimet e tij përfundimtare nisi të realizohej. Ai ishte ripërtëritja dhe forcimi i lidhjeve mes myslimanëve në Turqi dhe në vendet e tjera të botës nëpërmjet veprës “Risale-i Nur”. Në fakt, ishte Salahudin Çelebi nga Inebollu, i cili me leje të Bediuzzamanit, dërgoi tek imami i xhamisë në Berlin librin “Dhulfikar”. Ai gjithashtu, dërgoi kopje të tjera në universitetin e El-Ezherit në Egjipt, tek ambasadori pakistanez, si dhe te Papa në Romë. Në përgjigje të kësaj të fundit, Bediuzzamani mori një letër falënderimi nga Vatikani që daton më 22 shkurt 1951. Bediuzzamani përherë mbështeti dhe u përpoq për pavarësinë e

botës islame ndaj perëndimit dhe ruajtjes së integritetit të kulturës së saj. Ai parashikoi bashkëpunimin e sinqertë të myslimanëve dhe të krishterëve kundër ateizmit agresiv. Në këtë aspekt duhet të shihet edhe vizita e Bediuzzamanit te patriarku ortodoks grek i Stambollit, patriarku Athenagoras, vizitë të cilën ai e bëri në Stamboll në pranverën dhe në verën e vitit 1953.

Rrugëtime dhe veprimtari

Në gusht të vitit 1953 Bediuzzamani rikthehet në Isparta. Shtëpia që mori me qira kishte kopsht në të dyja anët dhe ishte gjithashtu e gjerë, me dhoma të mjaftueshme për vete dhe për ata nxënës të tij, të cilët tashmë qëndronin vazhdimisht me të. Nxënësit më të afërt si Zubejir Gyndyzalp, Tahir Mutllu, Mustafa Sungur, Bajram Jyksel dhe Xhejlan Çallëshkan kujdeseshin për nevojat e tij personale. Ata lejoheshin të hynin në dhomën e tij kur lindte nevoja për ta ndihmuar, duke qenë se Bediuzzamani tani po u afrohej të tetëdhjetave të moshës. Ai u jepte shumë rëndësi këtyre nxënësve të rinj, shumica e të cilëve ishin të mirë-arsimuar, dhe po i trajnonte me metodën e “Risale-i Nurit” për rolet e tyre të rëndësishme që mund të merrnin në të ardhmen.

Në këtë kohë, Bediuzzamani nisi të mbante lexime dhe shpjegime për veprat “Risale-i Nur” në grup. Kjo praktikë u ndoq nga nxënësit e

tij anembanë vendit dhe u bë veçoria kryesore e lëvizjes së tyre. Pas vizitës së Bediuzzamanit në Stamboll më 1953, nxënësit e “Risale-i Nurit” formuan një grup dhe ndërmorën aktivitete të ndryshme për botimin dhe shpërndarjen e këtyre veprave, aq sa e lejonin mjetet e tyre të kufizuara. Ata përdorën një shtëpi afër xhamisë Sulejmanie, ku mundën të vendosnin makina shumëfishuese, sigurisht në një fshehtësi të madhe, sepse ndiqeshin vazhdimisht. Kjo shtëpi u bë qendra studimore e parë e “Risale-i Nurit” në Stamboll dhe ishin po këta që formuan bërthamën e nxënësve aty, duke mbajtur lexime të përbashkëta të veprave “Risale-i Nur” në shumë zona të qytetit me grupe njerëzish të fushave të ndryshme.

Pjesën tjetër të jetës, Bediuzzamani do ta kalonte duke vizituar miqtë e tij në vendet ku është internuar dhe burgosur. Kështu që, herë pas here, me qëndrime të shkurtra shkonte në Isparta, Afjon, Emirdag, Eskishehir, Egridir dhe Barlla. Mirëpo, me kalimin e viteve, këto udhëtime u bënë të vështira për Bediuzzamanin dhe ai ndjente nevojën që çdo ditë të dalë në fshat për të marrë ajër të pastër. Kështu, nxënësit e tij kryesorë në Isparta, Inebollu dhe Emirdag, u grumbulluan bashkë dhe i sollën një makinë që ta ndihmonte për udhëtimet e ndryshme.

Bediuzzamani shikonte tani frytin e punës dhe të përpjekjeve të 30 viteve të internimit të tij, të burgosjes dhe torturës. Kur veprat e “Risale-i Nurit” nisën të botoheshin në shtypshkronjat moderne të Ankarasë dhe të Stambollit me shkronjat e reja më 1957, ai deklaroi: “*Tani është koha e festivalit të ‘Risale-i Nurit’.* Detyra ime ka përfunduar. *Kjo është koha që kam pritur gjatë. Tani unë mund të largohem.*”⁴. Ai u mbush aq shumë me gëzim, sa që nuk mund të qëndronte më në një vend. Dëshironte të bënte shëtitje në Egridir, në liqen, në Barlla dhe në të gjitha vendet e bukurisë përreth Ispartës, qoftë me kalë apo makinë.

Në kohën kur veprat e tij filluan të botohen me shkronja latine, Bediuzzamani kujdesej shumë që të mos kenë ndonjë gabim në botim. Deri në fund të jetës së tij, ai e kontrollonte vetë çdo botim. Në vitin 1958, nxënësit e afërt të Bediuzzamanit, kryesisht Mustafa Sungur dhe Zubejir Gyndyzalp, përgatitën biografinë zyrtare të tij në një libër të titulluar: “*Tarihçe-i Hayat*” (Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit). Duke dashur që vëmendja të përqendrohej mbi veprat e “Risale-i Nurit”, Bediuzzamani hoqi nga libri shumicën e pjesëve që përshkruanin jetën e tij personale dhe qëndrimet e tij. Kështu, ai bëri rregullimet e duhura dhe ia bashkëngjiti këtë vepër koleksionit “Risale-i Nur” (Mesazhet e Dritës).

4. Nursi, *po aty*, f. 519.

Metoda pozitive e shërbimit dhe mesazhi i Bediuzzamanit

Megjithëse ende nën kërcënimin e policisë, botimi legal dhe i hapur i veprave të “Risale-i Nurit” ishte një fitore shumë e madhe për Bediuzzamanin dhe nxënësit e tij, ndaj atyre të cilët për 30 vite kishin përdorur çdo mjet për t’i eliminuar e për t’i heshtur.

“Risale-i Nuri” dhe metoda e tij e të vepruarit pozitivisht, lufta e duruar dhe e heshtur për të shpëtuar e forcuar besimin në Zot, si dhe përpjekja në këtë drejtim me mjete paqësore, kryesisht me atë të fjalës së shkruar dhe me mos përfshirjen në politika, pati mposhtur forcat që kërkonin që të çrrënjosnin Islamin dhe ta nënshtronin me dhunë kombin turk ndaj komunizmit dhe pafesisë. Funkzioni unik e i veçantë i “Risale-i Nurit” në ripërtëritjen e besimit dhe rigjallërimin e Islamit, kërkonte këtë metodë që pati pak të ngjashme në botën islame, ku përpjekjet për t’i shërbyer Islamit shpesh ishin me metoda politike, të drejtpërdrejta dhe të dhunshme.

Rruga e “Risale-i Nurit” ishte xihadi paqësor ose xihadi i fjalës (xihad ma’nevi) në luftën kundra ateizmit agresiv dhe pafesisë. Duke punuar vetëm për përhapjen dhe forcimin e besimit, duhej të punoje gjithashtu edhe për ruajtjen e rendit, qetësisë dhe stabilitetit në shoqëri, përballë rrënimit moral e shpirtëror të komunizmit dhe përballë forcave

të pafesisë, të cilat synonin të destabilizonin shoqërinë dhe të prodhonin anarki.

Në mesazhin e Bediuzzamanit lexojmë se ai nuk ishte për një revolucion islam apo për formimin e një shteti islam. Fokusi i tij nuk ishte shteti por njeriu, sepse feja islame nuk i ka zbritur shtetit, por njerëzve. Individët nuk i formon shteti, por shteti është reflektim i individëve. Sipas mendimit të tij, revolucioni më i madh realizohet atëherë kur te njerëzit sundon vetëdija dhe kur veprohet sipas parimeve të saj. Qëllimi i Bediuzzamanit ishte që njeriut t’i hapë derën e Islamit dhe t’i garantojë kuptimin e njohjes së Islamit. Dhe “Risale-i Nuri” e bëri këtë.

Bediuzzamani e pa Partinë Demokrate në fuqi, si një mundësi të mirë për myslimanët dhe sidomos për botimin dhe përhapjen e veprave të “Risale-i Nurit”. Ndryshe nga grupet dhe individët e tjerë, nxënësit e “Risale-i Nurit” ndoqën metodën pozitive në shërbim dhe qeveria demokrate nuk u përpoq të frenonte lëvizjen, duke ja lejuar kështu botimet haptazi, pafajësia e të cilave ishte marrë nga gjykata e Afjonit më 1956.

Bediuzzamani vazhdoi t’i mbështesë demokratët dhe veçanërisht kryeministrin Menderes gjatë 10 viteve që ishin në fuqi, përballë opozitës dhe disa qarqeve islame e fetare. Ai është përpjekur

ta këshillojë Adnan Menderesin nëpërmjet letrave dhe i ka nxitur nxënësit e tij t'i mbështesin ata. Ai thotë: *“Adnan Menderes është një hero i fesë. Ai ka kryer shërbime të mëdha për fenë dhe do të kryejë, por ai nuk do t'i shohë frytet e asaj që dëshiron. Edhe unë gjithashtu kam kryer shërbime për fenë. Unë nuk mund ta fsheh atë, dhe si Adnan bej, edhe unë gjithashtu nuk do t'i shoh rezultatat. Frytet e të dyve do të bëhen të dukshme në të ardhmen”*.⁵

Udhëtimet e Bediuzzamanit në Ankara, Stamboll e Konja

Në dhjetor të vitit 1959 dhe në janar të vitit 1960, Bediuzzamani ndërmoi disa udhëtime për në Ankara, Konja dhe Stamboll. Megjithëse i dobët nga shëndeti, këto udhëtime tregojnë më shumë se çdo gjë tjetër ngulmimin e tij të jashtëzakonshëm dhe vetë-sakrificën në vazhdimin e “luftës” kundra mosbesimit dhe qasjes për t'i shërbyer besimit dhe Kur'anit nëpërmjet “Risale-i Nurit”. Ai vizitonte nxënësit e tij dhe qendrat studimore të “Risale-i Nurit”, që ishte edhe arsyeja e tij e ngutshme për udhëtimet. Ai merrte ftesa të përsëritura e ngulmuese nga nxënësit e tij anëmbanë Turqisë, që të shkonte t'i vizitonte dhe udhëtimet e tij ishin në përgjigje të tyre. Në të njëjtën kohë, ato kishin edhe karakterin e vizitave të lamtumirës. Ankaraja dhe Stambolli ishin qendrat

5. Nursi, *po aty*, f. 522.

kryesore të botimit dhe Konja një qendër e rëndësishme e aktivitetit. Bediuzzamani e vizitoi Stambollin njëherë gjatë dy muajve, Konjën tre herë, dhe Ankaranë katër herë.

Udhëtimet e tij për Ankara kishin edhe një qëllim tjetër të rëndësishëm. Ai donte të paralajmëronte kryeministrin Menderes dhe demokratët për rreziqet që kanoseshin para tyre, si dhe për të sugjeruar disa mënyra për t'i shmangur “retë e fatkeqësisë” që po grumbulloheshin në Turqi. Një përpjekje për grusht shteti ishte zbuluar dhe parandaluar më 1958. Të pamundur për t'iu përshtatur liberalizimit, lirive fetare dhe rishfaqjes së Islamit që ishin frytet e sundimit demokrat, përkrahësit e regjimit të mëparshëm, të përfaqësuar tani nga Inony dhe partia e Popullit Republikan, po përgatiteshin të rimerrnin pushtetin me forcë. Kjo, sepse ata nuk mund ta arrinin këtë me anë të votës apo mjeteve ligjore. Çështja nuk ishte vetëm për të shpëtuar demokratët, por ishte një çështje për të shpëtuar vendin ndaj rënies nën sundimin e forcave armiqësore karshi Islamit dhe favorizuese të pafesisë. Megjithatë, kjo ishte vetëm një arsye për udhëtimet, të cilat si një qytetar, Bediuzzamani kishte të drejtë të plotë që t'i bënte, ashtu siç kishte të drejtë t'u jepte edhe këshilla politikanëve.

Domethënë, Bediuzzamani shikoi se rruga e vetme që demokratët

të shpëtonin nga pasojat, pasi kishin rënë në një pozitë dobësie dhe disavantazhi përpara Inony dhe Partisë së Popullit Republikan, ishte të ngriheshin e të bënin deklarata të guximshme lidhur me parimet që ata besuan, dhe në shërbimin e të cilëve, pra parimeve, qëndronin sukseset dhe popullariteti i tyre i mëparshëm. Bediuzzamani, kur pa se këshilla e tij nuk mori përgjigje nga Menderes, iu bind kërkesës së autoriteteve dhe qëndroi në Emirdag, pastaj në Isparta dhe në fund u nis për Urfa në mars të vitit 1960.

Dëshira e Bediuzzamanit për një varr të panjohur

Për të ruajtur singjeritetin në mënyrë maksimale, aty ku qëndron edhe fuqia e “Risale-i Nurit” dhe sekreti i sukseseve të tij, Bediuzzamani ka pohuar herë pas here se dëshironte që vendi i varrit të tij të mbetej sekret, të njëjët vetëm nga një ose dy prej nxënësve më të afërt. Ai e pati shkruar këtë edhe në testamentin e vet, të cilën e bënte në raste të ndryshme. Fillimisht këtë e bëri në Emirdag në vitin 1948, para se të dërgohej në Afjon, duke treguar se ishte një Sunet i profetit Muhamed (a.s.) të bëjë një testament, meqë exheli (koha e vdekjes) ishte i panjohur. Për këtë, ai caktoi disa prej nxënësve të tij, të cilëve donte t’u linte gjërat personale dhe volumet e “Risale-i Nurit”. Në dëshirat e tij të mëvonshme, ai përcaktoi dy

pika, njëra ishte çështja që varri të mbetej sekret dhe tjetra ishte që të paguheshin ata nxënës që punonin vetëm për “Risale-i Nurin”, që nuk kishin të ardhura të tjera. Shumë nxënësve u jepte të njëjtën porosi duke u thënë:

“Varri im të jetë në një vend shumë të fshehtë, përveç një apo dy nxënësve mos ta dijë kush tjetër, sepse ashtu si në kohët e hershme, nga dëshira për emër e famë, Faraonët e kethyen vëmendjen e njerëzve drejt vetëve të tyre nëpërmjet statujave, pikturave dhe mumieve. Gjithashtu, në këtë kohë të frikshme, nëpërmjet pakujdesisë që ajo prodhon, egoizmi e drejton të gjithë vëmendjen drejt kësaj bote nëpërmjet statujave, portreteve dhe gazetave. Përpara, varrezat vizitoheshin për hir të Allahut, ndërsa tani, vizitorët e kanë qëllimin kryesor ndaj pozitës së të vdekurit, pra vetëm nga pamja materiale. Për këtë arsye, që të mos thyhet singjeriteti maksimal i ‘Risale-i Nurit’, u detyrova të marr këtë vendim, që të mos më dëhet varri. Ndërsa i vdekuri, qoftë në lindje apo perëndim, sevapet e Fatihasë së kënduar i shkojnë kudo që të jetë. Adhuresit e botës nuk i dinë rregullat e vizitës së varrezave. Kërkojnë ndihmë nga varri dhe kejo vepër është shirk.”⁶

Në vitin 1950, Bediuzzamani dërgoi disa gjëra personale në qytetin Urfa, nëpërmjet njërit prej nxënësve të tij, duke i thënë se edhe vetë ai do të shkonte atje. Ndër këto gjëra, përfshihet edhe xhybja e dijetarit

6. Ballxhë, *po aty*, f. 250-251; Nursi, *po aty*, f. 535-536.

Meulana Halid Bagdadi, e cila i ishte dhënë atij në Kastamonu.

Vdekja dhe varrimi

Ramazani i atij viti e gjeti Bediuzzamanin shumë të sëmurë, sidomos në gjysmën e dytë të muajit, ku nxënësve u falte vetëm jacinë dhe për teravi printe shoku i tyre Tahiri. Në një moment ai u thotë nxënësve: *“Bijtë e mi, bijtë e mi, në asnjë mënyrë mos u bëni pesimistë. ‘Risale-i Nur’ ia ka thyer belin të pafëve dhe masonëve. Ai është gjithmonë triumfues. Unë do të largohem me shumë gëzim.”*⁷ Megjithëse i sëmurë rëndë dhe me temperaturë të lartë, ai u kërkoi nxënësve ta dërgonin në qytetin Urfa. Pasi përgatitën makinën dhe ndenjësën e pasme e bënë si krevat për Bediuzzamanin, më 20 mars 1960, në një kohë me shi të rrëmbyeshëm, dy nxënësit e tij Bajram Jyksel dhe Zybejir Gyndyzalp u nisën së bashku me të për në Urfa. Ai ishte udhëtimi i fundit për Bediuzzamanin.

Më 21 mars u vendosën në hotelin Ipek Palas. Me të marrë vesh, policët erdhën shpejt dhe kërkuan me urdhër nga lart që Bediuzzamani të kthehej menjëherë në Isparta. Kur banorët e Urfës u informuan për ardhjen e tij, u mblodhën me qindra vetë përballë hotelit dhe shkonin me radhë dhe me padurim për ta takuar. Pavarësisht dobësisë së skajshme dhe në kundërshtim me praktikën e tij të mëparshme, Bediuzzamani

7. Ballxhë, *po aty*, f. 246.

i priti të gjithë ata që erdhën. Ai i tregoi nxënësit të tij, Abdullah Jeginit rëndësinë e Urfas, duke folur për shërbimin ndaj Islamit dhe njerëzve të saj, të cilët duke qenë me kombësi turq, arabë dhe kurdë, do të shërbenin si një bosht për unitetin dhe vëllazërinë islame. Ndërkohë që vazhdonte këmbëngulja e policëve për kthimin e tij në Isparta, Bediuzzamani më 23 mars 1960, ditën e mërkurë, ndërroi jetë në orën 03.00 në dhomën e hotelit me numër 27.

Lajmi për vdekjen e tij u përhap menjëherë rreth Urfas. Banorët e Urfas i mbyllën të gjitha dyqanet dhe mbushën rrugët. Zubejri, Hysniu dhe Abdullahu shkuan për të telefonuar e për t’u dërguar telegrame nxënësve të “Risale-i Nurit” në Emirdag, Isparta, Stamboll dhe në të gjithë Turqinë. Trupi i Bediuzzamanit u la dhe u pastrua nga Molla Abdulhamid Efendiu për t’u dërguar tek Ullu Xhami, ku do të qëndronte deri sa të varrosej. Kur’ani dhe lutjet këndoheshin vazhdimisht. Varrimi do të bëhej të premtën, por numri i njerëzve që po vërshonin për në Urfa nga e gjithë Turqia dhe jashtë saj, u bë shumë i madh. Prefekti i Urfës i thirri nxënësit e Bediuzzamanit dhe u tha se ata duhej ta varrosnin atë të enjten pas namazit të ikindisë. Ata ranë dakord dhe njoftimi u bë me altoparlantë.

Falja e xhenazes u krye në oborrin e Ullu Xhamisë. Kështu, me

pjesëmarrjen e mijëra njerëzve, të prefektit dhe kryetarit të Bashkisë, xhenazja u fal ditën e enjte pas namazit të ikindisë. Pastaj arkivoli u ngrit lart, duke u kaluar nga turma dorë më dorë ashtu siç ishte zakoni, për në vendin e quajtur Halil'urr-rrahman. Atë natë, këndimet e Kur'anit vazhduan pandërprerë te varri. Bediuzzamani tashmë po pushonte i qetë, megjithëse ai do të ishte vetëm një vendpushim i përkohshëm për të.

Zhvarrimi

Grushti ushtarak i shtetit, të cilin e kishte parashikuar Bediuzzamani më parë, ndodhi më 27 maj të vitit 1960. Me në krye Menderesin edhe anëtarët kryesues të qeverisë së tij, deputetët demokratë, zyrtarë e simpatizantë, të gjithë u arrestuan dhe u vendosën në kampe e burgje të ndryshme. Filloi një fushatë kundra "Risale-i Nurit" dhe lëvizjes së tij. Kërkimet, konfiskimet, arrestimet, burgosjet dhe proceset gjyqësore nisën përsëri. Qindra nxënës të "Risale-i Nurit" iu nënshtruan kësaj vale të re të represionit hakmarrës. Tani vendi qeverisës nga i ashtuquajturit Komiteti i Unitetit Kombëtar (ushtarakët) dhe u mor vendimi për t'i lëvizur eshtrat e Bediuzzamanit për në një vend të panjohur. Ata s'do ta linin të qetë as në varr, ashtu siç e kishin bezdisur e përndjekur deri në çastin e fundit të jetës.

Vëllain e Bediuzzamanit, Abdulmexhidin, e morën pa pëlqimin e tij në Konja për ta çuar në Urfa. Më 12 korrik 1960, forcat ushtarake mbërrijnë tek oborri i xhamisë ku ishte varrosur Bediuzzamani, thyen varrin dhe e nxorën kufomën e tij, e cila qëndronte plotësisht e paprishur. Pastaj e vendosën në një tabut dhe e hipën në një avion ushtarak bashkë me vëllain e tij, Abdulmexhidin, duke i dërguar drejt Afjonit. Natën, tabutin e hipin në një makinë ushtarake dhe e dërgojnë drejt Ispartës për ta varrosur në një vend të paditur, madje as nga vëllai i tij. Varri i Bediuzzamanit akoma edhe sot nuk dihet.

Testamenti dhe porositë

Bediuzzamani tregon se si nëpërmjet bereqetit që rezultonte nga kursimi dhe mjaftueshmëria, ai pati qenë në gjendje të siguronte nevojat e nxënësve, pa e thyer rregullin e tij të vetëmjaftueshmërisë. Një e pesta e shumës së parave që sigurohej nga shitja e kopjeve të "Risale-i Nurit", ishte e mjaftueshme për të furnizuar shumë nxënës. Ai thotë: "*E falënderoj shumë Krijuesin e Gjithëmëshirshëm dhe Mëshirëplotë, që për studimet e diturisë, e sidomos për dijet e shkencave të besimit, nuk më detyroi që t'i lyp ndokujt lëmshë dhe të prish parimet që kisha qysh nga fëmijëria. Megjithëse shumë i varfër, përpigësja që të furnizoja edhe rreth 30 nxënës. Në këtë mënyrë, edhe nxënësit e Saidit nuk u detyruan që ta shesin dijen*

për interes...”⁸

Për sa i përket porosive të tij, ai i shkroi dhe i bëri të qarta ato në një testament, sepse i shikonte edhe vetë mundësitë fizike e shëndetësore: “... *Personalisht unë nuk kam më forcë për të zbatuar detyrat që lidhen me ‘Risale-i Nurin’.* Ndoshta për mua nuk ka më nevojë. Për shkak të qenies i helmuar disa herë dhe për shkak të moshës shumë të madhe, si dhe sëmundjes, unë nuk kam më durim për të vazhduar të jetoj. Madje, edhe në qoftë se vdekja, për të cilën jam shumë i përmalluar, nuk vjen tek unë, më konsideroni të vdekur nga ana e jashtme...”⁹

Pasi ndërroi jetë Bediuzzamani, erdhi këshilltari juridik i pasurive personale dhe shënoi gjërat e tij personale, së bashku me vlerën e tyre. Sipas raportit, kjo vlerë ishte 551 lira e 50 kurush. Këto sende ishin: Një orë, një xhybe, një palë pantallona, një sixhade, një këmishë pambuku, një palë çorape të leshta, 3 shami, një busull, një fes të gjelbër me çallmë, një jastëk, një jorgan, një ibrik, një termos, një çadër, një çantë, një legen i vogël dhe një rrip prej një stofi të vjetër. Përveç këtyre, Bediuzzamani nuk kishte asgjë tjetër në këtë botë si pronë. E gjithë pasuria e tij me vështirësi mbushte një valixhe. Me kërkesat e nxënësve, vetëm vëllai i Bediuzzamanit u bë trashëgimtar për gjërat personale.

8. Ballxhë, *po aty*, f. 252.

9. Nursi, *po aty*, f. 537.

BEDIUZZAMANI ME GJUHËN E NXËNËSVE TË TIJ

Nxënësit e Bediuzzamanit japin shumë detaje rreth tij në shumë aspekte. Kjo përfshin pjesën personale të tij si ushqimi, veshja, pastërtia etj., deri te adhurimet, marrëdhëniet me njerëzit dhe vlerësimi i kohës. Më poshtë po rendisim disa nga fjalët e nxënësve për mësuesin e tyre:

E gjithë jeta e Bediuzzamanit ka kaluar në modesti, mënyra e jetesës dhe veshja e tij ka qenë shumë e thjeshtë, kurse morali, fisnikëria dhe sjellja e tij kanë qenë jashtë mase të larta, duke mos i dhënë fare vlerë gjërave të përkohshme. Ai e ka mbrojtur nderin e diturisë, duke ia bërë vetes parim që kurrë mos t’i përulet askujt. Megjithëse herë pas here parashtroheshin begati të kësaj bote, ai i përçmonte ato pa i kushtuar vëmendje. Ne nxënësit e tij, dëshmojmë se ai kurrë nuk ka marrë zekat, sadaka apo dhuratë prej dikujt. Madje, kur ishte në Kastamonu, për të paguar qiranë e shtëpisë, shiti jorganin e vet dhe përsëri nuk pranoi dhuratën e dikujt.

Namazi i mësuesit, gjendja e tij e veçantë kur falej, përluja dhe kërkimi i suksesit nga Allahu (xh.sh.) ishte e jashtëzakonshme. Ai i kryente pesë namazet e detyruara sapo hynte koha e vet. Edhe në të ftohtin e ashpër nuk i braktiste namazet e tehexhudit dhe të duhasë. Çdo natë,

4-5 orë para sabahut angazhohej me namaz, dua, duke e përfunduar natën me disa pjesë të përzgjedhura nga Kur'ani Famëllartë dhe në fund, nuk ndjente lodhje. Një herë i kishte thënë njërit prej nxënësve të tij: *“Për të bërë adhurim gjatë natës, 20 vjet kam luftuar me nefsën tim, pastaj nuk pata më nevojë.”*¹⁰

Në muajin e Ramazanit flinte fare pak, ndërsa në muajt e tjerë, maksimumi 5 orë. Madje, në një Ramazan, duke qenë shumë sëmurë dhe disa ditë pa ngrënë, përsëri nuk i braktisi adhurimet dhe agjërimin. Komshinjtë e tij dëshmojnë se: *“Në 8 vjet pa ndërprerë, verë-dimër, deri në mëngjes, dëgjonim zërin e bukur të mësuesit tuaj që i lutej Allahut të Madhëruar”*.

Mësuesi vazhdimisht përpiquej që të mbulojë gabimet e të tjerëve. Askënd nuk merrte nëpër gojë, po ashtu, pengonte edhe të tjerët që ta bënin një gjë të tillë. Ai ishte mjeshtrë për të edukuar veset e nefsit dhe asnjëherë nuk i shërbeu dëshirave të tij. Ngrënia e tij ishte aq e pakët, saqë nuk ishte e mundur që ajo t'i mjaftonte një njeriu.

Nga fytyra e tij shfaqej një dritë mes seriozitetit dhe buzëqeshjes. Ai nuk fliste shumë, fliste përmbledhtazi, ku me diturinë e tij gjeniale dhe me pak fjalë, jepte shumë për të kuptuar. Nganjëherë bënte edhe shaka që të mos mërzhiteshim. Pavarësisht se nuk i kishin mbet dhëmbë, përdorte

10. Ballxhë, *po aty*, f. 227.

misvak.

Mësuesi ynë, duke qenë vet larg vetive të të dukurit në sytë tjerëve, edhe nxënësit i këshillonte vazhdimisht të mos i afrohen asaj, sepse është një peshë e rëndë dhe nuk është gjë tjetër, veçse mendjemadhësi, që bie në kundërshtim me sinqeritetin. Ndaj secilit dhe veçanërisht ndaj të moshuarve, fëmijëve dhe të varfërve afrohej me mëshirë, dashamirësi dhe vëllazërim të sinqertë.

Kur dilnim për shëtitje në fshat, mësuesi studionte librin e madh të universit dhe na nxiste që edhe ne ta shihnim në atë mënyrë. Nxënësit e tij e përshkruajnë mënyrën se si ai kursente shumë, si dhe mirësinë e dhembshurinë e mësuesit ndaj kafshëve, interesim dhe mëshirë kjo që shtrihej tek të gjitha krijesat që haste, duke filluar nga qentë deri tek milingonat.

Mësuesi ynë ka qenë shumë i kujdesshëm ndaj pastërtisë dhe përherë me abdes. Kohën e ka vlerësuar shumë dhe vëmendje e kujdes të veçantë i ka kushtuar veprës së tij *“Risale-i Nurit”*. Ai e shkruante dhe u merrte vazhdimisht me korigjimin e tij. Madje edhe gjatë rrugës, korigjonte dhe dëgjonte mësimet tona që na kishte mësuar më parë. Ai ka thënë: *“Që prej 20 viteve, përveç Kur'anit dhe ‘Risale-i Nurit’, nuk kam lexuar ndonjë libër tjetër.”*¹¹

11. Ballxhë, *po aty*, f. 174.

VEPRAT KRYESORE TË BEDIUZZAMANIT

Bediuzzamani gjatë jetës së vet shkroi shumë vepra dhe shkrime nëpër gazeta e revista. Ai mbajti predikime, ligjërata dhe fjalime para tubimeve të mëdha e të vogla. Për 28 vjet me radhë, deri në prag të dhjetëvjeçarit të fundit të jetës së tij, gjatë viteve në mërgim e izolim, Bediuzzamani vendosi të shkruante veprën kryesore të tij të titulluar: “Risale-i Nur Külliyati” (Koleksioni Mesazhet e Dritës) dhe ta përhapë anembanë Turqisë e më gjerë. Metoda me të cilën u hartua koleksioni “Risale-i Nur” ishte e veçantë, ashtu siç ishin të veçanta forma dhe mënyra e tij e shpjegimit. Bediuzzamani i demonstroi të vërtetat e fesë në formën më të lehtë të të kuptuarit, nëpërmjet krahasimeve, shpjegimeve dhe provave të arsyeshme. Në fakt, ai me veprat e tij provoi se zbulimet mahnitëse të shkencës lidhur me universin, vërtetojnë e përforcojnë të vërtetat e fesë. Ai thotë: “*Ata që nuk po i kuptojnë veprat e ‘Risale-i Nurit’, më konsiderojnë si një hoxhë skolastik dhe nuk kanë fare dijeni se unë i kam studiuar shumë nga shkencat bashkëkohore, madje në këtë lëmë kam zgjidhur problemet më të vështira të tyre. Deri aty, sa lidhur me këto probleme të shkencave fizike, kam shkruar edhe disa libra.*”¹²

Në këtë koleksion synohet

12. Ballxhë, *po aty*, f. 281.

mbrojtja e besimit fetar të popullit nga rrymat mohuese si materializmi dhe pozitivizmi, si dhe interpretimi i Kur’anit në një mënyrë që njerëzit e sotëm, të ndikuar nga teoritë shkencore, të mund ta kuptojnë. Koleksioni “Risale-i Nur” u drejtohet jo vetëm myslimanëve, por gjithë njerëzimit, sepse është shkruar në harmoni me mentalitetin e njeriut të kohës sonë. Ato vepra u përgjigjen shumë prej dyshimeve që provokon filozofia materialiste, po ashtu, u përgjigjen edhe pyetjeve që arrin të bëjë mendja e mprehtë e njeriut. Bediuzzamani thotë: “*Meqë ‘Risale-i Nur’ në dorën e Kur’anit Famëlartë është një shpatë diamanti për të mundur edhe armiq të mënatë, ai është gati për t’i dhënë ilaç zëmrave, shpirtrave dhe shqisave, sepse ka buruar vetëm nga barnatoret e Kur’anit dhe është një kumtues i vërtetë i tij.*”¹³

“Risale-i Nuri” u inspirua drejtpërdrejt nga Kur’ani në atë kohë, kur me në krye Turqinë, pjesa më e madhe e botës islame ishte nën presionin e huaj, duke vuajtur nga përçarja e konflikti i të gjitha llojeve. Po të merren parasysh vitet e internimit dhe burgimit të autorit gjatë shkrimit të këtyre veprave, duke mos pasur libër tjetër përveç Kur’anit, kupton edhe një herë se koleksioni “Risale-i Nur” është shkruar me inspirimin e Mëshirës Hyjnore. Bediuzzamani shkruan: “*Ndryshe nga veprat e tjera, koleksioni ‘Risale-i Nur’ nuk është marrë nga*

13. Ballxhë, *po aty*, f. 230.

*shkencat dhe nga degët e njohjes, dhe as nga librat e tjerë, ai nuk ka burim tjetër përveç Kur'anit. Autori i tij nuk kishte libër tjetër me vete kur po shkruhej 'Risale-i Nuri'. 'Risale-i Nuri' u inspirua drejtpërdrejt nga shkëlqimi i Kur'anit.'*¹⁴

Bediuzzamani, nëpërmjet koleksionit "Risale-i Nur" na udhëzon për tek konceptimi i drejtë i Kur'anit dhe i Sunetit të pastër profetik. Ai na paralajmëron për rrezikun e rënies në bidate, risi, në ekstreme dhe në greminat e humbjes, rreziqe që janë të shumta në kohën tonë. Ai jep shpjegime të shumta dhe të hollësishme në domosdoshmërinë e ndjekjes së njërës nga katër medhhebet, të cilat përfaqësojnë mendimet e sakta të dijetarëve të mëdhenj të Ehli Sunetit uel-Xhemaah. Gjithashtu, ai paralajmëron për rreziqet e rënies në kthetrat e sekteve devijuese, në kurthet e lëvizjeve negative që synojnë të realizojnë qëllime të mbrapshta të kësaj dynjaje, duke shfrytëzuar fenë, si dhe paralajmëron për rrezikun e rënies në grackat e grupeve heretike.

Bediuzzamani la mbrapa si trashëgimi 6000 faqe nga koleksioni "Risale-i Nur", të përkthyer mbi 20 gjuhë të botës dhe miliona ndjekës të tyre, gjithashtu, rreth veprave të tij janë bërë shumë punime akademike, teza doktrature, etj. Disa nga gjuhët e përkthyer mund të përmendim: Gjuhën angleze, gjermane, arabe, 14. Nursi, *po aty*, f. 270.

shqipe, boshnjake, kineze, perse, frënge, holandeze, kurde, malajziane, urdu, tatare, ruse, etj.

Koleksioni "Risale-i Nur" është një koment i Kur'anit, i filtruar nga mendja, në përshtatje të plotë me kohën, shtylla kurrizore e të cilit përbëhet nga veprat e quajtur Sözlër, Mektubat, Lem'alar dhe Şualar. Veprat e tij janë shumë, por poshtë po citojmë veprat që gjenden te koleksioni "Risale-i Nur":

Sözlër - Fjalët: Është libri me vëllimin më të madh në koleksionin "Risale-i Nur" dhe përbëhet prej 33 fjalëve (tematikave). Pjesa më e madhe e librit është shkruar në Barlla të Ispartës, kurse pjesa tjetër në Kastamonu dhe në burgun e Eskishehirit. Ky libër përmban më së shumti temat e besimit dhe adhurimit, si besimi te Zoti dhe ringjallja, namazi, ahireti, kaderi, miraxhi, dritaret që hapen drejt njohjes së Zotit, mrekullitë e Kur'anit, flet për sahabët, medhhebet, ixhtihadin, për shpirtin dhe engjëjt etj. Ai mund të konsiderohet si një libër që rinovon strukturën epistemologjike të Islamit nën dritën e Kur'anit, brenda integritetit logjik dhe ndryshimit të mënyrës së të menduarit dhe qasjeve intelektuale në besimin islam. Për trajtesat e temave si, ekzistenca e Allahut, jeta pas vdekjes, ngritja në qiell, ekzistenca e shpirtit dhe e engjëjve, profetësia, etj., shpjegimet e të cilave ndryshojnë nga veprat e tjera islame në këtë aspekt, janë

të natyrës që japin një kontribut të rëndësishëm për trashëgiminë e përbashkët të njerëzimit.

Mektubat - Letrat: Është një libër, i cili bashkon përgjigjet që Bediuzzamani u ka dhënë pyetjeve që i bëheshin dhe letrave të dërguara atij, si dhe përfshin pikëpamjet e mendimet e tij për çështje të diskutueshme. Libri përmban kryesisht përgjigje për pyetjet rreth çështjeve islame dhe besimit, si dhe letra që shërbejnë për orientimin e njeriut në ditët e sotme. Me përgjigjet e dhëna për pyetjet që hutojnë mendjet, për sa i përket temave në lidhje me sekretin e veprimtarisë së vazhdueshme në univers, besimin në një Zot, mrekullitë e profetit Muhamed (a.s.), reformën në Islam, nacionalizmin, agjërimin etj., konsiderohet një nga veprat më të rëndësishme të “Risale-i Nurit”. Autori në libër, përveç tematikave islame, ka përfshirë edhe qëndrimin e tij ndaj politikës.

Lem’alar - Shkreptimat: Ky libër përbëhet nga 33 kapituj dhe përmban tema si, profetët, Suneti, bidati, urtësia e lutjeve, mjaftueshmëria, sinqeriteti, refuzimi i materializmit natyror, sëmudjet dhe pleqëria. Kjo vepër, e cila fillon me historitë e profetit Junus dhe Ejub, vazhdon me trajtesat në lidhje me ekonominë, sinqeritetin, natyrën, mbulesën e femrës, të sëmuret dhe të moshuarit. Diskutohen tema të tilla si, parimet

e paqes në jetën familjare, parimet që përforcojnë vëllazërinë e besimit, analiza psikologjike e mëkatit dhe mënyrat e shpëtimit prej saj. Krahas analizës së detajuar të temave të përmendura, tregohen edhe mësimet që do të marrim prej tyre. Autori përpiqet që lexuesi ta shohë jetën dhe fenomenet rreth saj në një këndvështrim pozitiv.

Şualar - Rrezet: Përveç urtësisë së ajeteve të Kur’anit, në këtë libër përfshihen tema si ekzistenca e Allahut, manifestimet e Emrave të Bukur të Allahut, llogaritjet *ebxbed* dhe *xhefr* që lidhen me disa ngjarje, karakteristikat e “Risale-i Nurit” dhe mbrojtjet e bëra në gjykata lidhur me këto vepra. Ky libër përmban vëzhgimet e një udhëtari që pyet universin për Krijuesin e tij, prova të teuhidit nga gjuha e të gjitha qenieve, urtësinë dhe qëllimin e dërgimit të njeriut në këtë botë. Është një libër i rëndësishëm, që përmban shpjegimin e natyrës së subjekteve të mëdha si Dexhalî dhe Sufjan¹⁵, të cilët do të vijnë në fundin e kohës, si dhe shpjegimin e haditheve për këtë temë.

15. Sufjan: Personi që mbart epitetin “Sufjan” është njëri prej dexhalëve. Vetëm se ky epitet, përdoret për ta përcaktuar atë si “Dexhalin Islam”. Siç thuhet në hadithet autentike, ai është një person i frikshëm dhe hipokrit, i cili do të vijë në kohën e fundit dhe do t’i sjellë ditë të zeza umetit, si dhe do të përpiqet të shkatërojë idealin e Islamit. (Kenzu’l-Ummal, 11/125; İsmail Hakkı, Ruhû’l-Bejan, Stamboll, 8/197).

Mesnevi-i Nuriye - Përmbledhja e Dritës: Është e përbërë nga 12 broshura të shkruara në periudha të ndryshme, të cilat Bediuzzamani i përmbloodhi në një libër të vetëm. Në këtë libër, çështjet islame dhe ato të besimit zakonisht shkruhen me shprehje koncize dhe jo me shpjegime të gjata. Shumë nga broshurat e vogla janë shkruar në arabisht dhe më vonë janë përkthyer nga vëllai më i vogël i autorit, Abdulmexhid Nursi. Kjo është një nga veprat e para të Bediuzzamanit, në të cilën përfshihen rrugët e njohjes së njeriut me Zotin e tij, parimet që njeriu do të ndjekë në luftën e tij me nefsin, si dhe shpjegimet e të vërtetave të besimit. Ky libër konsiderohet si një lloj farë dhe fidanishte e “Risale-i Nurit”.

Isharatu-l I'xhaz - Shenjat e Mrekullisë: Është një libër që përmban komentimin e 33 ajeteve të para të sures Bekare. Bediuzzamani e ka shkruar këtë libër gjatë luftës së parë botërore në arabisht dhe është përkthyer në turqisht nga vëllai i tij i vogël Abdulmexhid Nursi. Ky libër shfaq kuptime dhe komentime shumë të holla të Kur'anit, duke i treguar të vërtetat hyjnore në koherencë me zbulimet e shkencës. Ai e shpjegon mrekullinë e Kur'anit me të gjitha aspektet e tij. Bediuzzamani për librin Isharatu-l I'xhaz përdor shprehjen: “Kjo është një kryevepër”.

Asayı Musa - Shkopi i Musait:

Libri fokusohet në shpjegimin e çështjeve të besimit dhe në vërtetimin e besimit në teuhid, kundrejt ideve si “devijimi, shirku”, pra, përqendrohet mbi provën e besimit se Allahu është i vetmi Krijues i gjithësisë. Është një libër që shqyrton qeniet përreth nesh nga pikëpamja fetare. Përveç kësaj, diskutohen edhe marrëdhëniet ndërmjet adhurimit, rinisë, ringjalljes pas vdekjes, besimit në ahiret dhe lumturisë në dynja.

Barla Lahikası - Shtojca e Barllës: Është njëra nga tri “Shtojcat” që gjenden te koleksioni “Risale-i Nur”. Ky libër përbëhet kryesisht nga letra të shkruara nga Bediuzzamani, i cili i përgjigjet pyetjeve të nxënësve të tij gjatë qëndrimit në Barlla të Ispartës. Në këtë libër, Bediuzzamani përqendrohet mbi kuptimin, përbërjen dhe qëllimin e veprave “Risale-i Nur”. Gjithashtu, ky libër përcakton sistemin dhe metodën e shërbimeve që i bëhet besimit dhe Kur'anit nëpërmjet “Risale-i Nurit”.

Kastamonu Lahikası - Shtojca e Kastamonut: Është një libër i përbërë nga letra të ndërsjella që Bediuzzamani ka shkëmbyer me nxënësit e tij në Kastamonu. Metodat e përcjelljes së mesazhit hyjnor dhe të predikimit, janë temat kryesore të trajtuara në këtë libër. Këtu, Bediuzzamani tërheq vëmendjen për rregullat dhe parimet që duhen pasur parasysh në kryerjen e shërbimit të besimit dhe të Kur'anit. Përveç kësaj,

tema të tilla si letra e devotshmërisë, biseda për hipokrizinë, mësimet që u jepen të rinjve, arsyet e shmangies nga politika dhe interpretimi i disa haditheve të rëndësishme, përfshihen gjithashtu në “Shtojcën e Kastamonut”.

Emirdağ Lahikası - Shtojca e Emirdagut: Libri mori këtë emër, sepse ishte shkruar në zonën e Emirdagut, ku Bediuzzamani ishte i dënuar. Ai përbëhet nga letrat dhe broshurat që Said Nursiu shkroi për të informuar nxënësit e tij për tema të ndryshme, gjatë viteve kur i ishte nënshtruar qëndrimit të detyrueshëm në këtë vend. Në këtë libër, Bediuzzamani flet për çështje të tilla si mungesa e shiut dhe urtësitë e tij, mallkimi i njerëzve si Jezidi dhe Velidi, Ehl-i Bejtî, Alevizmi, kundërshtimet mes sahabëve, xihadi shpirtëror, lëvizjet pozitive etj.

Tarihçe-i Hayat - Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit: Është një libër biografik i Bediuzzamanit që është përpiluar nga nxënësit dhe dashamirësit e tij. Ai u shkruajt në vitin 1958, nën mbikëqyrjen e Bediuzzamanit dhe duke u korrigjuar prej tij. Ky libër paraqet me një stil të thjeshtë edukimin e Said Nursiut që nga lindja deri në vdekje, shërbimin, përpjekjen, luftën dhe sakrificën e tij. Përveç kësaj, në libër janë përfshirë letrat dhe mbrojtja e Said Nursiut nëpër gjyqe. Gjithashtu, veprës iu

shtuan edhe broshurat islame si “Ajetu’l Kubra” dhe “Munaxhat”.

İman ve Kûfür Muvazeneleri - Krahasimet midis Besimit dhe Mosbesimit: Në këtë libër, ligjet e Kur’anit krahasohen me ligjet e qytetërimit. Si rezultat, aty shpjegohet se sa të arsyeshme dhe me urtësi janë parimet e Kur’anit. “Krahasimet midis Besimit dhe Mosbesimit” ka veçorinë e një libri përmbledhës. Në këtë libër, Bediuzzamani u lë vend edhe temave që i nevojiten njerëzve të shekullit tonë, e veçanërisht myslimanëve.

Sikke-i Tasdik-i Gaybi: Ky libër nuk ka një veçori më vete, por më tepër përbëhet nga historitë e shkëlqyera të “Risale-i Nurit” dhe disa nga letrat e tij të bukura. Bediuzzamani, në çështjen e urtësisë së përsëritjeve të Kur’anit, pranon se, edhe disa tema të “Risale-i Nurit” u përsëritën nga nevoja e madhe.

Muhakemat - Argumente të Arsyeshme: Si vëllim, është libri më i vogël në koleksionin “Risale-i Nur”. Megjithatë, për nga përmbajtja flet për çështje të thella, të sakta dhe të mprehta. Said Nursiu e quajti këtë libër edhe “Recetë për dijetarët”, sepse donte të kontribuonte në eliminimin e disa dallimeve të mendimeve mes dijetarëve. Libri synon të ndriçojë lexuesin duke sjellë mendimet dhe vlerësimet konfuze që ndodhën në përkthime, kelim dhe libra të tjerë të shkruar nga dijetarët islamë deri në atë kohë.

Në shqip janë përkthyer këto vepra të Bediuzzamanit:

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Sözler - Fjalët*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Mektubat - Letrat*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Lem'alar - Shkreptimat*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Şualar – Rrezet*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *İşaratu-l i'xbaz - Shenjat e mrekuallisë*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Tarihçe-i hayat - Jeta dhe vepra e autorit të risale-i nurit*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Mesnevi-i nuriye – Përmbledhja e dritës*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Asa-yi musa - Shkopi i musait*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Zülfikar - Dhulfikar*,

Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *İman ve küfür muvazenerleri - Krahësimet midis besimit dhe mosbesimit*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Siraciin-nur - Llamba ndriçuese*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Gençlik rehberi - Prijësi i rinisë*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Tilsimler - Misteret e Kur'anit*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

► Nga Koleksioni i Risale-i Nurit, *Muhakemat - Argumente të arsyeshme*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti.

● Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Fjalë të vogla me domethënie të mëdha*, Bediuzzaman Said Nursi, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

● Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Frutat - Argumentet e besimit*, Bediuzzaman Said Nursi, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

● Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Ringjallja*, Bediuzzaman Said Nursi, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

● Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Profeti Muhammed (a.s.) dhe rruga*

e tij, Bediuzzaman SAID NURSI, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Përgjigje natyralistëve*, Bediuzzaman Said Nursi, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Ngushëllimi dhe shpresa për të sëmurët*, Bediuzzaman Said Nursi, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *“Ajdërimi i Ramazanit, ekonomia dhe falënderimi”*, Bediuzzaman Said Nursi, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Vëllazërimi*, Bediuzzaman Said Nursi, shqipëroi nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Dritaret e së vërtetës*, Bediuzzaman Said Nursi, përktheu Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Udhëzuesi i grave*, Bediuzzaman Said Nursi, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Fjala e njëzetetretë - Bukuritë e besimit islam*, Bediuzzaman Said Nursi, përshtati nga gjuha turke Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Lutje*, Bediuzzaman Said Nursi, përktheu Abdylkadir Haktanër.

- Nga përmbledhja Risale-i Nur, *Ajetul kubra - Shenja e madhe*,

Bediuzzaman Said Nursi, përktheu Muhjiddin Hoxha.

Koleksioni “Risale-i Nur”, një tefsir i Kur’anit

Në një kohë kur mësimi i shkencave fetare u dobësua dhe ndihma e njerëzve e koha që ata mund t’i kushtonin shkencave fetare u pakësua, me rëndësi ishte që puna të fillonte nga pozita më e fortë. “Risale-i Nur” është një komentim i Kur’anit nga Bediuzzamani rreth bazave të fesë. Ai bëri shpjegime të hollësishme për ekzistencën, unitetin dhe cilësitë e Allahut (xh. sh.), për engjëjt, librat, profetësinë, shpalljen dhe jetën në Ahiret. Gjatë shpjegimit të tyre, ai nuk sqaroi aspekte të shkencës së Kur’anit si, shkaqet e zbritjes, leksikon, veçoritë e elokuencës, jurisprudencën, etj., si në tefsire të tjera. Ai veprroi kështu, jo sepse këto ishin çështje të parëndësishme, por sepse ai i referoi ato të shiheshin në komente të gjera me shpjegime të hollësishme mbi këtë temë.

“Risale-i Nur” është në formën e një “komentimi shpirtëror” të Kur’anit, po jo siç mendojnë disa njerëz, nuk është “komentim mistik”, por është një mënyrë komentimi e Kur’anit që bazohet në kuptim dhe jo në fjalë, pra, duke tentuar të shpjegojë kuptimet e tij. Bediuzzamani thotë: “*Risale-i Nur është një komentim shumë i fuqishëm dhe i saktë i Kur’anit. Tefsiri është dy llojesh:*

Njëri është tefsiri i njohur që tregon, sqaron dhe vërteton kuptimin e frazës, fjalëve dhe fjalive të Kur'anit. Lloji i dytë është tefsiri që deklaron, vërteton dhe shpjegon të vërtetat e besimit me prova të forta. Ky i dyti ka shumë rëndësi. Siç e dini, tefsirët e njohur, ndonjëherë i referohen kësaj pjese në mënyrë të përmbledhur. Megjithatë, 'Risale-i Nur' mbështet drejtpërdrejt këtë lloj të dytë të tefsirit. Është një tefsir shpirtëror që i mbyll në heshtje filozofët inatçi në një mënyrë unike."¹⁶

Kur Bediuzzamani ishte duke shkruar veprat e tij, ai nuk kishte burim tjetër përveç Kur'anit Famëlartë. Ndonjëherë, ai thellohej tek ajetet që flasin për një temë, i lexonte ato vazhdimisht, merrte mesazhe të reja në çdo përsëritje, pastaj i frymëzuar nga Kur'ani e shpjegonte atë temë shpejt dhe i thoshte nxënësve të tij ta shkruanin. Ai thotë: "*Risale-i Nur, i cili është një elektricitet shpirtëror, nuk është një dritë e marrë nga dituritë e Lindjes, apo nga filozofia dhe shkenca e Perëndimit. Më saktë, ai është marrë nga niveli i lartë i Kur'anit qiellor, mbi Lindjen dhe Perëndimin.*"¹⁷

Sipas Bediuzzamanit, ka argumente se "Risale-i Nuri" është frymëzuar nga Kur'ani, si: Aftësia e lartë e tij bindëse, adresimi që u bën njerëzve në nivele të ndryshme

dhe mundësimi që secili të përfitojë sipas gjendjes së vet, pasuria në përmbajtjen e tij, fakti që autori e fliste shpejt sikur po e lexonte nga diku, fakti që u shkrua shpejt nga nxënësit pranë tij, si dhe fakti se "Risale-i Nuri" ka një gjerësi shumë më të madhe se intelijenca e autorit.

Ky koleksion, me shembujt që sjell dhe disa veçori të tjera, i tregon të vërtetat e thella të besimit edhe për njerëzit e thjeshtë. Mirëpo, "Risale-i Nur", këto të vërteta i shpjegon në mënyrë efektive dhe emocionale, ndërkohë që dijetarë të mëdhenj, e kanë pasur të vështirë t'i shpjegojnë ato, jo masës së njerëzve, por edhe njerëzve me njohuri të larta. Pra, shpjegimi i thjeshtë në "Risale-i Nur" është padyshim një vepër e ndihmës së Zotit dhe nuk mund të jetë mjeshteri e autorit të saj.¹⁸

Bediuzzamani e nis pothuajse çdo çështje me një ajet. Kështu, ai tregon se çështjet që do të shkruajë janë disa pjesë të begatisë së atij ajeti. Gjatë shpjegimit, ai tregon argumente që i flasin mendjes, herë me shembuj dhe herë me përmendjen e historive. Nuk i referohet asnjë burimi tjetër përveç Kur'anit. Kur është e udhës, ai transmeton hadithet përkatëse nga kujtesa e tij. Kjo mund t'i atribuohet edhe faktit se ai kaloi 35 vitet e fundit të jetës së tij në internime dhe burgje.

Në lidhje me komentimin e Kur'anit, ai mendon se, sado dijetarë të jenë individët, ata nuk

16. Bediuzzaman Said Nursi, Şualar, Şahdamar Yayınları, İstanbul 2007, f. 505.

17. Bediuzzaman Said Nursi, *Sikke-i Tasdik-i Gaybi, Risale-i Nur Külliyatından*, Söz BasımYayıncılık, İstanbul 2000, f. 65.

18. Nursi, *Mektubat*, f. 421.

mund të bëjnë komentime perfekte të Kur'anit. Prandaj, për këtë punë duhet të formohet një komision i lartë, i përbërë nga ekspertë të fushave të ndryshme.

ÇFARË KANË THËNË PËR JETËN DHE VEPRËN E BEDIUZZAMANIT

Jetën dhe veprën e Bediuzzamanit e kanë vlerësuar personalitete të shkencave të ndryshme, si profesorë, akademikë, studiues dhe hulumtues nga shumë vende të botës, të cilët i kanë kumtuar mendimet e tyre në simpoziume ndërkombëtare të zhvilluara gjatë viteve në Turqi, SHBA, Egjipt, Jordani, Gjermani, Malajzi, Marok, etj. Më poshtë po paraqesim të përmbledhur disa nga mendimet e tyre në këtë drejtim:

PËR JETËN E TIJ

Për të shpëtuar nga problemet e pa zgjidhura të kohës, jo vetëm të lexoni veprat e Bediuzzaman Said Nursiut, por duhet të hulumtoni edhe jetën e tij të përjetuar në vitet 1920-1930, si më të vështirat në aspektin sociologjik. Kjo, sepse në atë kohë është zbatuar një politikë e tillë, që pothuajse të gjithë rruzullin tokësor e bëri si një popull apo shtet të vetëm. Said Nursiu, kësaj lëvizjeje të së ardhmes, i dha përgjigje të pathyeshme me anë të frymëzimit të marrë nga Kur'ani Famëlartë. Kjo

ishte përgjigje e principit të “Lëvizjes pozitive”. Pra, kjo është një thirrje ndaj të gjithë njerëzve që janë me fe të ndryshme dhe të devijuar nga e drejta, dituria, logjika dhe bindja ndaj të vërtetave. Edhe mizorët më të mëdhenj kanë nevojë për drejtësinë dhe të vërtetën. Të mos harrojmë se mendja dhe zemra janë gjithmonë nga e drejta, po qe se e drejta paraqitet pa interes, pa tradhti, e pranueshme dhe e mjaftueshme, pa sakrifikuar nga nderi, pa u trembur dhe pa e hidhëruar jetën, atëherë, edhe logjika e detyron secilin që ta pranojë atë.

Dr. Ahmet Aries

Nursi, hidhërimet e popullit mysliman i ka ndjerë në thellësinë e zemrës. Pa e penguar vendi dhe koha, mesazhi i pakufishëm i Kur'anit, e ka ftuar atë që përsëri të ngjallë dashamirësinë, paqen dhe bashkëjetesën mes myslimanëve. Bediuzzaman Said Nursiu ka përdorur të gjitha llojet e xhihadit. Ai, ashtu siç i është drejtuar armiqve me armë, po ashtu i është drejtuar atyre edhe kundra veseve të këqija, i ka kundërshtuar me shkrim e me fjalë, si dhe ka ditur t'i shmangë dyshimet e paraqitura nga jobesimtarët e hipokritët. Ai ka thënë: “*Arma përdoret vetëm ndaj armiqve të jashtëm, grindjet e brendshme i pëlqejnë dhe janë shanse të armiqve të fesë islame.*” Sot, armiqtë përballohen vetëm me shërbime shpirtërore, të

cilat shndrisin mendjen e shpirtin, si dhe pastrojnë zemrat. Kjo përpjekje pozitive e Nursiut, e ka pikësynimin në përmirësimin e ngrëhinës shpirtërore. Në këtë pikë, në vend të armëve do të flasë lapsi, dituria, logjika dhe sinqeriteti. Në ditët e sotme, ka shumë dallim nga lufta e brendshme te lufta e jashtme. Nursiu me këto fjalë, në mënyrën më të bukur na ndriçon rrugën se si u bëhet ballë armiqve.

Prof. Dr. Vehbe Zuhejli

Nursiu ka pasur suksese të tilla, sa që brenda secilit njeri, do të gjendet një shqisë që t'i bëhet atij mik. Ai ka bërë të mundur që, vlerat themelore të humbura, të mbizotërojnë përsëri. Veprat e tij rreth besimit, janë modele të nevojshme, meqë ato së pari i ka përjetuar vetë autori. Sigurisht që nga ky besim, merr pjesë mendja, fillon të lëvizë zemra dhe shpirti... Me një shprehje tjetër, arsimtarët për arsye se janë ndikuar nga epoka e filozofisë së thatë, nuk kanë mundur të arrijnë sukses në edukatën e jetës shoqërore. Në shekullin e fundit, të zhveshur nga besimi ndaj Allahut (xh.sh.), myslimanët nuk kanë mundur të shpëtojnë nga shturja. Në këtë mënyrë, nga moszbatimi i urdhrave të detyruara, kanë pasuar përçarjet dhe fatkeqësitë. Me pak fjalë, Nursiu, me një ekspertizë të fortë, i ka vendosur diagnozën sëmundjes së popujve myslimanë,

duke ia bërë të ditur atyre se nga rrjedh kjo sëmundje e rrezikshme, dhe më pas, plagët e myslimanëve i ka mjekuar me ilaçe të efektshme që burojnë nga Kur'ani Famëlartë.

Prof. Dr. Muhsin Abdulhamit

Në historinë e fesë islame, shumë pak janë ata, jeta e të cilëve u ka shkuar për hir të Zotit (xh.sh.) dhe në dobi të njerëzimit. Njeriu, duke lexuar jetën e njerëzve të mëdhenj, aftësitë e tij përsosen. Tani edhe vetë do të dëshmoni se mendimet dhe jeta e mësuesit Bediuzzaman, është në këtë drejtim. Kush lexon me kujdes jetën e tij, do të bindet se në këtë shekull plot me stuhi, vetëm atë do ta gjeni në këmbë të palëkundur. Ai është bërë një llambë ndriçuese në atë kohë, kur të gjitha anët i kishte mbuluar errësira, kur Turqinë kanë dashur ta shkëpusin nga feja, ndërkohë që në të kaluarën ai popull përhapte fenë islame në tre kontinente. Trimëria e tij është shfaqur edhe në çastet kur mizorëve u është përgjigjur me fjalë të ashpra plot sinqeritet. Në këtë mënyrë, është formuar ky rreth i dashamirësve të tij të pashkëputshëm. Kjo gjendje e Bediuzzamanit, na përkujton fjalët e dijetarëve të devotshëm, ato fjalë që për udhëzuesit e rrugës së drejtë kanë qenë një dritë, por për mizorët një zjarr.

Dr. Ahmed Halid Shukru

Bediuzzaman Said Nursiu ka

lindur në gjysmën e dytë të shekullit XIX në Turqinë Lindore. Ky njeri i veçantë, ka përjetuar momentet e tensionuara kur Turqia ka kaluar nga një gjendje në një tjetër. Në këtë kohë, çfarë duhej të bënte ky person?! Said Nursiu me të gjithë fuqinë e tij, është përpjekur për të rikthyer vlerat e humbura, në ringjalljen e shpirtit të fesë, besimin te Zoti dhe profeti Muhamed (a.s.) si i Dërguari i Tij, i cili ka ardhur për të shpëtuar njerëzimin dhe për të vendosur besimin në drejtësinë e pastër të fesë islame, drejtësi që i përket të gjitha kohëve. Me këtë qëllim, ai u përpoq t'u shkojë pranë individëve dhe grupeve me anë të zemrës, shpirtit, si dhe me anë të zjarrit që i digjej përbrenda për t'i shërbyer fesë. Dhe kështu mori në dorë shkrimin e veprave.

Ebu'l Hasan En-Nedvi

Ai është një prijës i veçantë që i ka të hapura dëshirat e zemrës, duke i paraqitur mesazhet e Kur'anit sipas kuptimeve të shekullit. Bediuzzamani ka parë se sëmundja më e madhe e kësaj kohe është sëmundja e rrezikshme që vjen nga filozofia materialiste. Kështu që, në fushën e udhërrëfimit ka ditur t'i ligjërojë mendjes, zemrës dhe ndërgjegjes me perspektivë kur'anore, duke i bindur me argumente dhe me një metodë të logjikshme. Në këtë mënyrë, dëshirën për të mësuar të vërtetat, e cila ekziston që me krijimin e njeriut,

e ka rinovuar me fjalë të ëmbla, “kaulun lejjin”, siç thotë Kur'ani, si dhe lexuesve të “Risale-i Nurit” u ka garantuar shije të paarritshme e të pakrahasueshme.

Dr. Nijazi Beki

Problemi më i madh i këtij shekulli është edukimi i individëve, sepse po përjetohet një kohë që po sundon modernizmi, e duke vrapuar pas tij, myslimanët kanë humbur identitetin e vet. “Risale-i Nuri” është një nga udhëzuesit më të mirë të myslimanëve për të shkuar tek e vërteta dhe për të lulëzuar dinamizmin e individëve. Bediuzzamani ka argumentuar të vërtetat e besimit në një formë të shkëlqyer, sipas inteligjencës së këtij shekulli. Themeli i jetës së Profetit (a.s.), mbështetet te besimi dhe të gjitha praktikatat e tij mblidhen në themelet e besimit. Feja Islame i hodhi hapat e saj të parë duke ftuar njerëzit në besim, dhe në këtë mënyrë, ajo është përhapur në gjithë botën. Njëlloj edhe mësuesi Bediuzzaman, e ka kuptuar gjendjen e vështirë të shekullit tonë, sipas të cilit besimi është dobësuar shumë, e për këtë arsye, ai gjithë kohën e ka kaluar duke i dhënë rëndësi besimit dhe argumenteve të tij. Kjo sepse, besimi është një dylbi që i tregon njeriut anën e bukur të të vërtetave dhe njëkohësisht është edhe një dritare që i tregon njeriut botët jetësore.

Prof. Dr. Ahmed Abdurrahim Es-Sajih

Lëvizja e Bediuzzaman Said Nursiut është një lëvizje e gjerë. Ai është një shembull i përkryer edhe për myslimanët e vendeve të tjera, për sa i përket zhvillimit dhe rinovimit. Kjo sepse, Bediuzzamani është një prijës model në ndjekjen e jetës sipas shembullit të Hz. Muhamedit (a.s.). Metoda e tij nuk është vetëm për disa popuj apo shtete të caktuara, përkundrazi, ajo është një metodë që mund t'i përgjigjet nevojave të secilit komb e shtet, sepse mban vlerat e metodës së Kur'anit Famëlartë që është parashtruar në Sunetin e Profetit (a.s.), si dhe në jetën e sahabeve të tij.

Dr. Hasan Abbas Zeki

Zoti e mëshiroftë Bediuzzamanin. Duke përfituar prova nga fraksione të politikës që bëjnë lojëra të ndryshme rreth vetes, ai u tërheq vëmendjen nxënësve të tij në këtë pikë: Ndërtimi i ngrehinës islame me një sinqeritet të plotë, për t'i ftuar njerëzit në rrugën e Allahut dhe për të sjellë te myslimanët dashurinë e fesë islame, ka lidhje me mosrënien pre e politikës, në moshyrjen në centrifugën e saj dhe në mosmarrjen pjesë në një grup, duke u bërë kundërshtar i të tjerëve. Pra, pas gjithë këtyre provave dhe vuajtjeve të vështira, Bediuzzamani e ka nxjerrë rezultatit e pastër në këtë mënyrë: “Unë padyshim theksoj se në popullin arab, apo në popujt

e tjerë myslimanë, është i ditur përfundimi i atyre që janë përzier me politikë”.

Shumica e grupeve që kanë dalë në emër të shërbimit islam, kanë rënë në batakun e politikës. Bediuzzamani na këshillon që të jemi të kujdesshëm, sepse politika i ka detyruar të bashkohen me ato fraksione që nuk kanë qëllim tjetër, përveçse partinë e vet, si dhe politikën e kanë mjet lëvizjeje dhe qëllim kryesor. Provat na tregojnë se pas njëfarë kohe, e hedhin poshtë mendimin e thirrjes në islam. Në fillim, mendojnë se politika i ndihmon shërbimit të fesë dhe rrugës së Allahut (xh.sh.), në momentin që i rrezikohet karrigia, fillojnë të luhaten e të ndeshen për pushtet. Për arsye se përkrahën këto rrugë të gabuara, bënë marrëveshje me njerëz të ndryshëm për të forcuar luftën ndaj të tjerëve. Por, nëse pyesni se cili është rezultati, mund t'ju them këtë se, mbeti e pavlerë fjala e atyre që premtuan se do ta shpjegojnë Zotin dhe do ta tregojnë fenë e Tij.

Të gjithë politikanët që titulloheshin shërbëtorë të fesë, u bashkuan me politikanët profesionistë dhe në këtë mënyrë bashkëvepruan në rrugën e politikës me metodën e tyre, duke u zier në një kazan. Rezultati i saj, politikanët profesionistë dhe shumë të tjerë, që punuan për liderin qeveritar, morën vend në radhën e atyre që gjoja përpiqeshin për Islam, dhe në këtë mënyrë ata sollën interesa

të ndryshme. Këta njerëz, për të arritur qëllimet e tyre, Islamit e bënë maskë për vete. Për të pasur sukses në punën e tyre, ecën me metoda të përbashkëta. Pastaj, me maskën islame puna e tyre lehtësohej shumë. Radhët u përzien, u bashkua tradhtia me të drejtën, e në atë gjendje erdhi një moment kur e vërteta nuk dallohej më nga gënjeshtria. Dhe pastaj shumica e popullit e humbi vetëdijen që të njohë të drejtën.

Prof. Dr. Muhammed Said Ramadan El-Buti

PËR VEPRËN E TIJ

Nën hijen e tregimeve të veprat e Bediuzzamanit, nga “Fjala e parë” deri tek e “tridhjetë e treta”, njeriu do ta ndjejë veten dhe universin krejtësisht në qendër të gjithësisë. Me tregimet e Bediuzzamanit, njeriu do t’i kuptojë më mirë dy librat e Allahut (Kur’anin që e lexojmë dhe gjithësinë që e sodisim). Librat “Fjalët”, “Rrezet”, “Letrat” dhe “Shenjat e mrekullive”, të cilat japin një kulturë besimi të gjerë, mbështetur mbi teuhid (njësimin e Zotit), i kthejnë gjykimet dhe karakterin e njeriut drejt një revolucioni mendimi. Këto libra e shtojnë njeriun drejt rrugës së mesme, e pengojnë atë nga veset e këqija dhe i japin atij përgjigjet e duhura.

Doc. Dr. Sami Arifi Hixhazi

Në librin “Fjalët”, Bediuzzamani më doli përpara me një besim sa

horizonti i paarritshëm. Shprehjet e Nursiut, duke filluar nga botët reale të qiejt dhe më tej, zgjatëshin deri te jeta e Ahiretit. Nga lëvizja e atomeve, arrinte deri te sistemet e yjeve. Fillon me ligjet, por të bind se diçka ekziston edhe jashtë ligjit. Prej mendjes kalon te ndërgjegjja. Prej krijesave të pashpirt tek ato me shpirt, prej bimëve të kafshët, prej kafshëve të njerëzit, të lumenjtë, kodrat, shkurtimisht, shpjegon për Librin e Gjithësisë. Këtë shëtitje e shoqëron me gjykimin e ajeteve kur’anore. Në këtë shekull materialist, Said Nursiu na çon të sodisim bukuritë e gjithësisë, prej aty të bukuritë e Kur’anit të pashuar, prej aty të bukuritë e Profetit (a.s.).

Prof. Dr. Abdurrezakk Abdurrahman Es-Sadi

Bediuzzamani ka ardhur fiks në kohën e duhur. Duke marrë parasysh gjendjen e shekullit tonë, fjala e Allahut na parashtrohet me fjalë të freskëta. Ai na parashton para syve tanë gjithësinë, rruzullin tokësor, botët ekzistuese, njeriun, e deri të lëvizjet e atomeve. Në veprat e Bediuzzamanit, rrjedhja e fjalëve i përngjan metodës së poezisë. Nursiu ka vajtuar jo për të afërmit e tij të vdekur, por për rininë myslimane që presin ndihmë. Ai u ka zgjatur dorën e mëshirës, duke paraqitur mijëra argumente për ekzistencën e Krijuesit dhe të Ringjalljes. Vepra e tij është rruga e Kur’anit dhe e Profetit (a.s.).

Bediuzamani, në formën më të bukur, ka kuptuar bukuritë e gjithësisë, duke vendosur urë mes nesh dhe universit. Ai shkon akoma më tej, hulumton sekretin e gjithësisë, duke zbuluar të vërtetat e të fshehtave.

Prof. Dr. Imaduddin Halil

Said Nursiu i ka vënë si detyrë vetes, se duke përparuar në diturinë e shkencave, do të kuptohen më mirë të vërtetat e Kur'anit. Pra, ai duke argumentuar mrekullitë e Kur'anit, është munduar që t'i kuptojë vetë këto të vërteta, pastaj ka bërë të mundur që t'i kuptojnë edhe të tjerët.

Shukran Vahide

Ndikimi i horizontit të “Risale-i Nurit” nuk është kufizuar vetëm me popullin turk. Said Nursiu me këto vepra, ia ka shpallur të vërtetat e Kur'anit të gjithë botës, duke përdorur një metodë të pranueshme për të gjithë shekujt, kulturat, madje të pranueshme edhe për kulturën moderne. Nga këto cilësi të bukura të tij, ashtu siç po përhapet “Risale-i Nur” me lehtësi nëpër shtetet e Evropës, njëlloj po përhapet edhe në ato vende që me periudha të gjata e kanë humbur kulturën e fesë islame, pra në Azinë e Mesme dhe në vendet ballkanike, duke u bërë kështu një derë shprese për ta.

Prof. Dr. Abdulaziz Shahbar

Bediuzzamani me gjuhën e “Risale-i Nurit” e ka hedhur poshtë

mendimin për çështjen e “politikës islame” që mbizotëron në botën islame. Pra, ne duke e parë botën islame, që nga Lindja e Largët, nga Irani deri në Algjeri, e shohim Islamin tërësisht të përbashkët me politikën. Po të mos ishte “Risale-i Nur”, ne përsëri shërbimin ndaj Islamit do ta kuptonim në këtë mënyrë. “Risale-i Nur” ka formuar një metodë pozitive, të kulluar dhe të pastër, duke na sjellë një alternativë tjetër, duke e hedhur poshtë alternativën e të përzierit të Islamit me politikë. Duhet të qëndrohet me ngulm në këtë pikë.

Dr. Imtijaz Jusuf

Pa u takuar dhe njohur më parë me asnjë mysliman, u njoha nëpërmjet internetit me veprat “Risale-i Nur” dhe u bëra myslimane. Unë jam vetëm në fillimin e një rruge të gjatë. Jam myslimane njëvjeçare. Veprat e Said Nursiut i kuptova qartë dhe pastër, duke u mahnitur nga argumentet e fuqishme. Me leximin e këtyre veprave, kuptova se fillimisht duhet të mjekojmë zemrën tonë, pastaj edhe të gjithë shoqërinë. Nursiu dëshiron prej nesh të jetojmë në një mënyrë paqësore me shoqërinë, natyrën dhe gjithësinë.

Prof. Dr. Kelton Cobb

Në një botë të zvogëluar sa një ekran kompjuteri, rrugët e shërbimit të myslimanëve për përhapjen e besimit, janë rritur sa vetë bota. Nga

kjo pikëpamje, globalizmi shërben edhe në favor të myslimanëve. Bediuzzamani nuk e pranon në asnjë mënyrë teorinë e “përplasjeve të qytetërimeve” të hedhur nga Huntigtoni...

Dr. Furkan Aydın

Bediuzzamani ka paraqitur një dituri të përsosur kur’anore, e cila mbështetet në të gjitha argumentet, nga abstraktja në konkrete, si: Kur’anin që lexohet si libër, gjithësia që soditet dhe së treti, parashtron personin shembull, Hz. Muhamedin (a.s.), ku universi vetëm me ardhjen e tij ka mundur të japë frytin e duhur. Këto të treja i ka lidhur me një vetëdije, përshtatshmëri dhe përvojë të mrekullueshme. Ai nuk është mjaftuar vetëm me temat e vjetra të provave për ekzistencën e Allahut. Duke shkuar më tej, për të vërtetuar ekzistencën e Zotit, ka parashtruar njeriun dhe natyrën. Në këtë mënyrë, në lidhje me etapat e pararenditura, përballë çdo sistemi ideologjik perëndimor, ka sjellë në dritë një sistem modern teologjik.

Prof. Dr. Muhsin Abdulhamid

LUFTA DHE PAQJA NË GJYKIMIN E BEDIUZZAMANIT

Në të gjitha veprat e tij, Bediuzzamani thekson përkohshmërinë e jetës së kësaj bote dhe tregon se lufta, përplasjet dhe

grindjet nuk ia vlejné. Lidhur me paqen në marrëdhëniet me njerëzit ai thotë: “*Paqja është parim thelbësor për njerëzimin.*”¹⁹

“Saidi i Vjetër” ka marrë pjesë në mënyrë aktive në Luftën e Parë Botërore. Në vendin e quajtur “Kafkasja”²⁰, ai ka qenë udhëheqës i grupeve të ndihmës në shërbim të ushtrisë, duke kontribuar kështu në mbrojtjen e atdheut prej pushtimit Rus, gjë për të cilën ai u nderua me medalje luftime. Ai ka refuzuar të qëndrojë i strehuar pas topave të luftës dhe ka zgjedhur të luftojë duke kalëruar, gjë e cila nxjerr në pah karakterin e tij guximtar.

Pas 30 vitesh, Said Nursiu përjetoi Luftën e Dytë Botërore. Ndërkohë, “Saidi i Ri” përjetoi një udhëtim në atmosferën shpirtërore, ku situatat dhe ngjarjet e ndryshme të kohës, nuk mundën ta shpërqendrojnë atë nga studimi dhe analizimi me detaje i Kur’anit.

Ajo që duhet të kuptohet qartë prej koleksionit të “Risale-i Nur” (Mesazhet e Dritës), është se internimi i Said Nursiut në cepat e largëta të Rusisë si rob luftime, burgosjet dhe përjetimi i luftërave në vendlindjen e tij, kanë pasur një ndikim të veçantë në formimin e karakterit dhe vizionin e tij fetar.

Ashtu siç tregohet në disa vende

19. Nursi, *po aty*, f. 20.

20. Emri i rajonit që ndodhet mes Detit të Zi dhe Detit Kaspik, në kufirin e Evropës dhe Azisë.

te veprat “Risale-i Nur”, vendet e internimit dhe të burgimit kanë qenë për të një “Medrese-i Jusufije” (duke pasur për qëllim vuajtjet e profetit Jusuf në burg). Ai në këto vende, duke u larguar nga atmosfera e jashtme e kësaj bote dhe duke e mirëmenaxhuar kohën, arriti të përfitojë shumë nga ana shpirtërore²¹. Gjithashtu, rol të rëndësishëm në botëkuptimin e të vërtetave fetare të Said Nursiut, ka pasur ballafaqimi i shpeshtë me vdekjen, si dhe vuajtjet e shumta gjatë luftës.

Megjithëse besimtarët nxjerrin mësimet të rëndësishme nga realitetet çnjerëzore të luftës, një njeri që është i përkushtuar ndaj Zotit, nuk mund të mohojë shkaqet e këqija dhe pasojat e shëmtuara të luftës. Sipas Said Nursiut, njerëzit dhe qeveritë nuk morën mësimet e duhura nga Lufta e Parë Botërore dhe, pikërisht kjo indiferencë e çoi njerëzimin në një luftë të dytë akoma më të madhe. Mendimet e Said Nursiut duket sikur vërtetojnë fjalën e urtë popullore që thotë se: “Ata të cilët mohojnë të nxjerrin mësimet prej gabimeve të së shkuarës, janë të destinuar të përsërisin të njëjtat gabime”.

Said Nursiu e ka cilësuar Luftën e Dytë Botërore si një errësi e ligë, e cila e kaploi globin dhe solli shkatërrim, shpërdorim dhe një uri

të përgjithshme në popullatë.²² Sipas tij, përgjegjësit kryesorë për këto pasoja dhe dhimbje të përgjithshme ishin politika dhe media.

Në shpjegimin e ajetit të katërt të sures Felek, ku flitet për dëmin e magjistarëve, Said Nursiu e ka komentuar në lidhje me politikanët që janë pro luftës, dhe me median, e cila, kjo e fundit, me anë të propagandës dhe intrigave diplomatike të saj, është nën kontrollin dhe shërbimin e politikanëve. Siç tregon dhe vetë ai se, përgjegjësit kryesorë të Luftës së Parë Botërore ishin po këta lloj politikanësh dhe pronarë mediash, që si pasojë njerëzimi mbeti i prapambetur dhe i pazhvilluar.

Ai thotë: “*Politikanët diplomatë, duke u bërë magji dhe duke i helmuar njerëzit me anë të gjuhës së radios, si dhe duke sugjeruar plane të fshehta për fatin e njerëzimit, përgatitën një të keqe e cila do të shkatërronte egërsisht zhvillimin e 100 viteve civilizim. Pikërisht këto gjë përngjason me plot kuptimin e fjalës, magjistarët që bëjnë magji dhe përgatisin të keqen e dikujt.*”²³

Fatkeqësisht, liderët nuk nxorën mësimet prej Luftës së Parë Botërore dhe përtej kësaj, përgjigja e tyre nuk ishte gjë tjetër vetëm se arrogancë, racizëm, mizori e pamëshirshme, diktaturë ushtarake, zullum dhe nacionalizëm ekstrem²⁴. E gjithë kjo lakmi dhe zili ishte një tradhti ndaj

21. Bediuzzaman Said Nursi, *Lem'alar, Risale-i Nur Külliyatından*, Yeni Asya Neşriyat, Germany, 1994, f. 258-265.

22. Nursi, *po aty*, f. 151.

23. Nursi, *Şualar*, f. 239.

24. Nursi, *po aty*, f. 260.

njerëzimit, ku dhe përgatiti terrenin për Luftën e Dytë Botërore.

Ligji i Zotit apo Fjala e Zotit, Kur'ani Fisnik, është e vetmja që mund t'i mundësojë njeriut rikthimin në qëllimin e vërtetë të jetës, ku do ta largojë atë nga gabimet, zemërimet, dëshira për hakmarrje, etj., veprime të cilat dëmtojnë si vetë atë, por dhe të tjerët rreth tij. Said Nursiu shpreson shumë në një të ardhme ku njeriu, duke dëgjuar thellësinë e zemrës së tij dhe duke jetuar një jetë të përshtatshme me Ligjin e Zotit (*Kelamullah*), do të mund të arrijë jetën e përhershëm, të cilën e do aq shumë.

Lufta tregon fytyrën e vërtetë të politikës, tregon se deri ku arrin kufiri i fuqisë njerëzore, po ashtu tregon edhe vdekshmërinë e jetës njerëzore. Allahu është më i Fuqishëm sesa dredhitë dhe kurthet që njerëzit bëjnë kundër njëri-tjetrit, e sigurisht që Ai është në gjendje t'ua ndriçojë dhe ndryshojë zemrat e liderëve dhe drejtuesve.

Said Nursiu nuk u dekurajua prej dobësive të dukshme të besimtarëve, të cilët përpiqeshin të jetonin një jetë të veçuar fetare, që më pas ai të mos arrinte të ndikonte për ndryshim në shoqëri, në mënyrë që njerëzimi të largohej nga vetëmashtrimi. Fuqitë fitimtare me anë të dhunës, forcës dhe ekonomisë, sado që duket sikur mbizotërojnë mbi jetët e njerëzve që vlerësojnë humanizmin, vlerat hyjnore dhe që përpiqen të jetojnë

një jetë mbi këto vlera, duhet ta dinë se nuk kanë për të mbizotëruar përgjithmonë, kjo sepse, ata janë duke vepruar kundër vullnetit të Allahut, i Cili ka fuqi për çdo gjë.

Said Nursiu në lidhje me çështjen e luftës thotë se, në fund fitimtar do të jenë njerëzit e sinqertë, që do të luftojnë për paqen dhe vlerat hyjnore. Ai citon: "*Le të nisë një fillim i ri, i pastër dhe i sinqertë. Pavarësisht se për momentin kjo botë e pavlerë mbizotërohet prej tyre, ata nuk kanë për ta fituar kurrë këtë luftë, kjo për vetë faktin se goditjen përfundimtare do ta japë fati i të drejtëve.*"²⁵

Detyra e parë e atyre që duan të vendosin paqe, është të kenë një mendim specifik dhe të qartë në lidhje me civilizimin që ata duan të vendosin. Cilat janë qëllimet tona? Çfarë synojmë? Ku duam të na çojnë përpjekjet tona?

Për Said Nursiun, ai civilizim, i cili merr si udhëzues vlerat hyjnore që ofron Islami, nuk mund të jetë një shoqëri ku funksionon ligji i xhunglës, ku i pasuri dhe i forti mund të zotërojnë çfarë të dojnë. Gjithashtu, nuk mund të jetë një shoqëri, ku ai që zotëron teknologjinë dhe pasurinë mund t'i përdorë të tjerët e t'i fusë nën shërbimin e tij si të dojnë.

Sipas Said Nursiut, etika që udhëheq vlerat hyjnore të ofruara nga Islami, bazohet në vërtetësi dhe drejtësi, të cilat, sipas botëkuptimit të

25. Prof. Dr. Thomas Michel, *Bediüzzamane göre Müslümanlık-Hıristiyanlık Münasebetleri*, Etkileşim Yayınları, İstanbul 2006, f. 142.

Islamit, konsiderohen si vlerat më të larta. Nuk ka përplasje civilizimesh midis myslimanëve dhe të krishterëve të vërtetë. Këtu nuk ka asgjë për tu habitur, sepse të dyja këto shoqëri kanë besim në një Zot të vetëm, ku në bazë të principeve dhe vlerave të mësuara prej Zotit, janë në kërkim të ndërtimit të shoqërisë.

Nëse ka një përplasje brenda një qytetërimi, atëherë kjo është mes besimtarëve, siç i cilëson Said Nursiu “muttekinët”, të devotshmit, dhe atyre të cilët në jetën e tyre të përditshme, si në politikë, ekonomi, marrëdhënie sociale, përpiqen dhe punojnë që ta mbajnë larg Allahun prej mendjeve të tyre, si dhe përpiqen që fenë ta reduktojnë në nivel individual, duke e cilësuar atë si një diçka ceremoniale pa ndikim, apo edhe si një element folklorik pa ngjyra.

Prandaj, hapi i parë që duhet të merret për të themeluar një civilizim mbi bazat e paqes dhe drejtësisë, është të kuptojmë se këtë gjë nuk kemi për ta arritur me anë të aftësive dhe përpjekjeve tona. Për të qenë të suksesshëm, ne kemi nevojë për udhëzimin dhe forcën që vjen nga Allahu. Paqja e vërtetë arrihet vetëm atëherë kur njerëzimi t'i bindet urdhëresave të Allahut dhe të kthehen me një pendim të sinqertë tek Ai.

Said Nursiu, në dëshirën e tij për paqe universale, shprehu gjithashtu se kjo gjë është njëkohësisht

mallëngjim i miliona njerëzve në mbarë botën. Ai e pa me sytë e tij shkatërrimin, hidhërimin dhe telashet që sollën të dyja luftërat botërore dhe kishte dëshirë të shikonte një epokë mirëqenieje e paqeje për të gjithë. Këtë gjë Said Nursiu e shikoi si një mision që Islami ka në faqe të tokës dhe si një detyrë që duhet ta realizojnë myslimanët.

Sipas Said Nursiut, në të ardhmen, kur me leje të Zotit do të kemi një Islam të forcuar, atëherë fitimtar do të kemi një civilizim të bukur dhe të mirë, ku Islami do të sigurojë pastrimin e sipërfaqes së tokës nga papastërtitë dhe ku vazhdimisht do të sigurojë një paqe publike²⁶.

Said Nursiu thotë: “*Nuk jemi pro dhe nuk i mbështesim urdhrat e një komandanti, i cili në emër të ligjit vepron sipas dëshirës së tij. Gjithashtu, edhe ne vetë nuk e veprojmë diçka të tillë. Megjithëse për rreth 20 vite personalisht jam torturuar, përndjekur dhe jam përballur me padrejtësitë më të rënda, si dhe përtej faktit që kemi pasur me qindra mijëra ndjekës, ne nuk jemi futur as në politikë dhe as në administratë, nuk e kemi prishur rendin publik dhe nuk është shënuar asnjë incident që ne të kemi prishur ndonjëherë rendin e ditës.*”²⁷

Së fundmi, do të flasim për një çështje që Said Nursiu e përsëriste shpeshherë. Ajo është domosdoshmëria për një

26. Nursi, *Hutbe-i Şamiye*, f. 42.

27. Nursi, *Şualar*, f. 342.

marrëveshje të mirëfilltë afatgjatë për paqe. Kur dikush i bën një padrejtësi dikujt tjetër, apo kur një popull shkakton konflikt me një popull tjetër, përfundimi i kësaj nuk sjell vetëm se frikë, zemërim dhe shqetësim. Palës, që shkakton konflikt, i vishet ndjenja e fajit dhe kjo e fundit ka një dëshirë që veten ta nxjerrë sikur ka të drejtë.

Të gjithë elementet dhe organet kryesore mediatike si, kanalet televizive, gazetatat dhe botimet shkencore, përdoren për të orientuar botëkuptimin e opinionit publik drejt pranimit të lëvizjeve politike që bën një qeveri, por, pavarësisht kësaj, thelbi kryesor, që është shkaktar i konfliktit e dhunës me të tjerët, qëndron përgjithësisht tek egoizmi dhe lakmia që ka njeriu.

Said Nursiu mendon se kjo situatë ka vetëm një zgjidhje. Këtë zgjidhje e urdhëron Kur'ani, e vendos dhe e inkurajon Islami, njerëzimi, përshtatshmëria njerëzore, si dhe e vërteta, e cila është paqja dhe marrëveshja. Në momentin që nuk ka një marrëveshje paqësore, plagët e hapura mes marrëdhënieve njerëzore zënë mikrobe, thellohen dhe bëhen shkak për rikthimin e mosmarrëveshjeve dhe situatave armiqësore mes njerëzve. Mosmarrëveshjet lindin mosmarrëveshje, dhuna bëhet shkak për dhunë më të madhe dhe gjendja konfliktuale vazhdon pafundësisht.

Rrugëdalja e vetme prej këtyre

reagimeve të ndërthurura të dhunës, në formën e një cikli të vazhdueshëm, është vetëm marrëveshja paqësore. Marrëveshja paqësore arrin të kurojë dyshimet dhe zemërimet që burojnë prej gabimeve të bëra ndaj njërit-tjetrit, gjë të cilën kurrsesi nuk mund ta arrijnë fuqitë ushtarake. Siç thotë dhe Said Nursiu: *“Ajo fatkeqësi e vogël zmadhohet dhe bëhet e vazhdueshme. Nëse arrihet paqja, vrasësi pendohet dhe ai tashmë do të lutet për të vvarin. Duke e lënë pas të shkuarën, të dyja palët dalin fituese dhe do të bëhen sikur të jenë vëllezër me njëri-tjetrin. Në vend të një vëllai të humbur, ai arrin të fitojë disa vëllezër të tjerë, të cilët i bashkon besimi fetar.”*²⁸

Në këtë kohë që po jetojmë, në këtë tension të madh mes marrëdhënieve njerëzore, ne që jemi në kërkim të një paqeje botërore të qëndrueshme për mbizotërimin e drejtësisë, le t'i lutemi Allahut që gjithsecili prej nesh, dhe në veçanti udhëheqësit e kombeve, t'i dëgjojnë këto këshilla të logjikshme të “Risale-i Nurit”.

PËRFUNDIM

Bediuzzamani udhëtoi nëpër shumë provinca të vendit, duke nisur që nga koha kur Perandoria Osmane ishte akoma në fuqi. Ai vizitoi të gjitha zonat e banuara, që nga qytetet më të mëdha, deri në fshatrat më të largët, që nga zonat më të populluara, deri te zonat më të shkreta malore.

28. Michel, *po aty*, f. 147.

Bediuzzamani ndihej keq kur shikonte se në çdo vend ku ndalonte, mbizotëronte injoranca, masat popullore vuanin izolim të skajshëm dhe njerëzit pengonin e dëmtonin njëri-tjetrin për shkak të konflikteve të ndryshme. Si një intelektual i dalluar, i cili kishte aftësinë ta interpretonte aktualitetin e kohës në kuptimin më të lartë, ai dëshironte të frymëzonte masat e mjera dhe të dëshpëruara me shpirtin e dijes e të mësuarit. Ai nxori në pah shkaqet e varfërisë aktuale dhe problemet ekonomike, dhe paraqiti zgjidhjet e mosmarrëveshjeve brenda shoqërisë, duke bërë thirrje vazhdimisht për unitet e bashkëjetesë kolektive.

Bediuzzamani themeloi një front kundër ateizmit, herezisë tronditëse dhe besëtytnive, duke nxjerrë në pah qorrsoakun ku ato të shpinin. Ai e konsideronte tradhti ndaj vendit dhe popullit të tij fshehjen e të vërtetave, qofshin ato edhe të vogla. Ishte në natyrën e tij të shqetësohej kur vërente gjëra të këqija që hidhnin baltë mbi vlerat fetare. Në kohët më të egra, atëherë kur askush nuk guxonte të fliste një fjalë në lidhje me të vërtetat fetare, ai e paralajmëronte shoqërinë për rrezikun e zhgënjimit. Ai përkundër gjithë torturave, helmimeve dhe vuajtjeve të ndryshme, si dhe përballë ndëshkimeve me burgim e internim, ka qenë falës dhe ashtu ka këshilluar, madje, në porosinë e tij të fundit ka thënë: *“Shokët e mi, mos u hakmerrni*

*për mua.”*²⁹

Në një kohë të mbrapshtë, kur kombi turk ishte në gjendje të vështirë për shkak të intelektualizmit shterp, kur çdo problem shoqëror degjeneronte në kaos, kur njerëzve u duhej të përballeshin me qindra ngjarje që sillnin gjakderdhje në mbarë vendin dhe kur vlerat kombëtare e islame ishin shkatërruar, Bediuzzamani analizoi pareshtur sëmundjet shekullore, i diagnostikoi ato dhe paraqiti kurat përkatëse, duke ia kushtuar tërë jetën shërimit të tyre. Jeta e tij vetjake ishte e mbushur me entuziazëm që e manifestonte vazhdimisht me projekte e ide alternative për t’ua paraqitur ato më pas qeverive dhe shoqërisë. Bediuzzamani ishte gjithmonë i sinqertë në fjalët dhe veprat e tij, si dhe trim në shpalosjen e ideve të tij, që kishin të bënin me çështje të përbashkëta rreth vuajtjeve të njerëzve në mbarë botën.

Duke u vënë ballë për ballë me një botë të tillë kaotike, Bediuzzamani ishte plotësisht i ndërgjegjshëm në lidhje me përgjegjësinë e madhe që kishte mbi supe, ndaj ai e mbarti këtë barrë të tmerrshme pa u ankuar. Ai ishte një person me modesti të pashoqe dhe e njihte mirë Zotin e Fuqinë e Tij të pafundme, si dhe Mirësinë e Tij të pakufishme. Ai e kaloi tërë jetën nën hijen e Kur’anit dhe Traditës Profetike, si dhe nën krahët e përvojës e të logjikës.

29. Ballxhë, *po aty*, f. 256.

Ai ishte një njeri me gjykim të shëndoshë, i mbushur me dashuri dhe entuziazëm në një shkallë të pakrahasueshme.

Nëpër ligjërata të ndryshme Bediuzzamani është shprehur se ligji i fesë islame, i njeh të barabarta të drejtat e të krishterëve me ato të myslimanëve. Ai është i mendimit se për gabimin e dikujt, fëmija dhe të afërmit e tij nuk janë fajtorë; jeta e një të pafajshmi nuk sakrifikohet edhe nëse ajo është për shpëtimin e të gjithë njerëzimit. Ai gjithmonë ruajti nivelin e tij të jashtëzakonshëm, qoftë në veprat e tij të hershme, të cilat dëshmonin shenjat e para të zgjuarsisë së tij dhe sigurisht, në veprat e tij të mëvonshme, të cilat qenë secila fryt i një pjekurie, i një jete të mbushur plot me prova.

Duke e kuptuar në një moshë të re se shkenca do të dominonte në të ardhmen, ndryshe nga

dijetarët e tjerë fetarë, dhe në të vërtetë ai u kundërshtua për shkak të kësaj, Bediuzzamani studioi dhe perfeksionoi shumicën e shkencave moderne fizike e matematikore. Nëpërmjet inspirimit të Kur'anit, me veprat "Risale-i Nur", Bediuzzamani hapi një rrugë të drejtpërdrejtë për tek e vërteta, me anë të së cilës besimi i qëndrueshëm për të vërtetat e fesë, mund të fitohet në një periudhë kohe të shkurtër. Ai theksoi se me anë të këtyre veprave, myslimanët do të gjejnë një rrugë të mesme, si në aspektin fizik, ashtu edhe në atë shpirtëror. Në fund, mund të themi lirshëm se e gjithë përpjekja e Bediuzzamanit, gjatë gjithë jetës së tij, ishte për përparimin dhe lulëzimin e myslimanëve dhe të botës islame, për lumturinë e tyre në këtë botë e në tjetrën, si dhe për lumturinë e të gjithë njerëzimit.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- Alparslan Açıkgenç, *Said Nursi*, İslam Ansiklopedisi, TDV, V. 35.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Jeta dhe vepra e autorit të Risale-i Nurit*, Sözlere Neşriyat, shqipëroi Jusuf Salkurti, İstanbul 2010.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Sözler - Fjalët, Nga Koleksioni i Risale-i Nurit*, Sözlere Neşriyat, shqipëroi nga gjuha arabe Jusuf Salkurti, İstanbul 2006.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Mektubat, Risale-i Nur Külliyyatından (Terimli, Lüगतli, Kaynaklı, İndeksli)*, Söz BasımYayın, İstanbul 2004.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Şualar, Risale-i Nur Külliyyatından*, Şahdamar Yayınları, İstanbul 2007.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Lem'alar, Risale-i Nur Külliyyatından*, Yeni Asya Neşriyat, Germany, 1994.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Emirdağ Labikası, Risale-i Nur Külliyyatından (Lüगतli, Kaynaklı, İndeksli)*, Söz BasımYayın, İstanbul 2012.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Hutbe-i Şamiye, (Arapça Metin İlaveli)*, Yeni Asya Neşriyat, İstanbul 2016.
- Bediuzzaman Said Nursi, *Sikke-i Tasdik-i Gaybi, Risale-i Nur Külliyyatından*, Söz BasımYayın, İstanbul 2000.
- Bediuzzaman Said Nursi'nin Kronolojik Hayatı*, Risale-i Nur Araştırmaları Platformu, bediuzzaman-said-nursinin-kronolojik-hayati.pdf
- Bediuzzaman Said Nursi kimdir? (Uzun Biyografi)*, sorularlarisale.com, makale.
- Necmeddin Şahiner, *Bilinmeyen Tarafıyla Bediuzzaman Said Nursi*, Nesil Yayınları, İstanbul 1994.
- Niyazi Beki (Dr.), *Kur'an İlimleri ve Tefsir Açısından Bediuzzaman Said Nursi'nin Eserleri*, Timaş Yayınları İstanbul, 1999.
- Ramazan Ballxhë (Dr.), *Jeta dhe vepra e këshilltarit të shekullit Bediuzzaman Nursiut*, shtëpia botuese "Gelenek", përktheu Abdylkadir Haktanër, Stamboll 2003.
- Suat Yıdırım (Prof. Dr.), *Risale-i Nurun Kur'an tefsirindeki yeri*, risalehaber.com, makale.
- Tubanur Tarhan & Ayşenur Osmanoglu, *Bir Kitap Bediuzzaman Said Nursi: Entelektüel Biyografisi*, DergiPark Akademik, İktisat sayısı, Yıl 2017, Sayı: 3.
- Thomas Michel (Prof. Dr.), *Bediuzzamane göre Müslümanlık-Hristiyanlık Münasebetleri*, Etkileşim Yayınları, İstanbul 2006.

Një perspektivë islame mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale

Abdullah Bulku

Abstrakt

Trashëgimia kulturore materiale është një ekzistencë që përbën një dimension të rëndësishëm të genies së njeriut dhe të shoqërisë njerëzore përgjatë gjithë historisë. Në anën tjetër, njeriu, si krijesa më e lartë në këtë botë, që orientohet nga feja si dritë hyjnore, është një genie me shumë dimensione dhe me aftësinë për të perceptuar dhe krijuar marrëdhënie me të gjitha ekzistencat e tjera. Kështu ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale si një subjekt i rëndësishëm për perceptimin e njeriut dhe dimension i shoqërisë njerëzore përbën një problem thelbësor dhe të përbotshtëm për genien e njeriut.

Përpyekjet për të krijuar njeriun e ri, nën regjimin totalitar, gjatë shekullit të kaluar dhe konfuzionit, krizës e vlerave, e probleme të tjera të botës moderne, që kanë karakterizuar periudhën e tranzicionit, e kanë dëmtuar jo pak trashëgiminë kulturore materiale ashtu sikurse kanë ndikuar në zbehjen e aftësisë sonë perceptuese dhe njohëse në lidhje me këtë ekzistencë. Nëse përsiatja dhe reflektimi është pararendës i veprimt, atëherë lind nevoja për të përkufizuar kuptimin dhe rëndësinë që kjo ekzistencë ka për ne, në bazë të botëkuptimit që gjithsecili e percepton dhe e ndërton jetën e tij.

Në këtë punim jemi munduar të japim një qasje të përgjithshme për të kuptuar rëndësinë që ka ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale në këndvështrimin islam. Fillimisht trajtohet koncepti i fesë, kulturës dhe marrëdhënia midis tyre. Në vijim trajtohen disa aspekte dhe dimensione që shpalosen nëpërmjet trashëgimisë kulturore materiale, të cilat janë: Njohja e historisë, shumëllojshmëria kulturore, identiteti kulturor dhe kujtesa kolektive. Këto parime përbëjnë dimensione të rëndësishme të njeriut dhe shoqërisë si ekzistencë dhe ruajtja e tyre lidhet ngushtë me vetë-njohjen dhe emancipimin shpirtëror, intelektual dhe material të shoqërive në harmoni të plotë me natyrën e tyre dhe ekzistencat e tjera. Në pjesën tjetër jemi

përpyetur të japim një qasje etike mbi ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale. Fillimisht është bërë një hyrje në lidhje me rrënjët etike të këtij problemi. Në vijim është prezantuar një qasje etike në këndvështrimin islam, duke iu referuar konceptit të përgjegjësisë së njeriut si mëkëmbës i Zotit në tokë.

Njeriu është një qenie e pajisur me natyrën për të bashkëvepruar me njerëzit, gjallesat dhe mjedisin përreth në mënyrë që të plotësojë nevojat e tij në bazë të qëllimeve të caktuara që lidhen me rolin dhe perspektivën e tij për jetën. Si pasojë e këtij bashkëveprimi lindin gjendje të tjera, të cilat prodhojnë veprime me marrëdhënie të reja për të vazhduar jeta dhe çdo qenie të plotësojë nevojat e saj. Nëse veprimet e kafshëve motivohen nga instinktet, të cilat janë reagime në lidhje me gjendje të jashtme, të programuara të vazhdojnë në të njëjtën mënyrë pa ndryshuar, veprimi i njeriut është shumë kompleks. Përveç nevojave apo instinkteve të tij, veprimi është pasojë e një perceptimi të brendshëm. Kjo e bën njeriun qenie më të lartë në univers dhe rolin e veprimin e tij të rëndësishëm në të. Me anë të këtij perceptimi dhe vetë-perceptimit dhe botës përreth, njeriu shpalos veprimtarinë me vullnetin e tij të lirë. Tërësia e këtyre veprimeve në bazë të një koncepti të caktuar në lidhje me njeriun dhe jetën e tij formojnë kulturën. Me kalimin e kohës këto kultura trashëgohen ndër breza dhe fitojnë një natyrshmëri në jetën e shoqërisë, duke krijuar

një dimension të ri në qenien e njeriut. Kështu, edhe në kohën kur këto kultura humbin vitalitetin dhe rolin e tyre në vlerat që një shoqëri përfaqëson, ato vazhdojnë të ruajnë një vend dhe ndikim të rëndësishëm në jetën e saj.

Trashëgimia kulturore materiale është një nga format e kësaj kulture. Shenjat e saj janë në çdo vend, shoqëri dhe kulturë. Krahas qenësisë si ekzistencë materiale dhe përvojës që i përket së shkuarës, ato kanë një domethënie shpirtërore për njeriun në çdo kohë, si pjesë e pandashme e historisë dhe rrjedhimisht e qenies së tij. Kështu ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale është një domosdoshmëri, duke qenë se përbën një dimension të pazëvendësueshëm të shoqërisë dhe njeriut si qenie sociale. Ruajtja e saj lidhet me ruajtjen e mjeteve me anë të të cilave jeta e njeriut merr kuptim dhe rrjedhimisht mundëson rrugëtimin e tij drejt përsosmërisë.

Marrëdhënia midis fesë dhe kulturës

Feja është një sistem vlerash hyjnore, që orienton njeriun të përsosë moralin e tij për të arritur qëllimin e krijimit dhe ardhjes në këtë botë. Ajo është entitet themelor

në jetën e njeriut, duke qenë se është burimi hyjnor që i përgjigjet pyetjeve themelore në lidhje me ekzistencën dhe se si duhet t'i arrijë ato për të gjetur lumturinë e përrjetshme. Feja ka qenë pjesë e pazëvendësueshme e shoqërive njerëzore dhe burim i qytetërimeve botërore, që në fillimet e njerëzimit e deri në ditët e sotme. Në lidhje me këtë fenomen Bergson thotë:

“Ashtu siç ka ndodhur në të shkuarën edhe sot mund të gjenden shoqëri pa dituri, art dhe filozofi por nuk mund të gjendet një shoqëri pa fe.”¹

Fjala kulturë vjen nga latinishtja “colere” që do të thotë lëroj mbjell tokën, punoj dhe “cultura “ është sinonim i kësaj fjale.² Në lidhje me kulturën nuk ekziston një përkufizim i pranuar nga të gjithë shkencëtarët. Kultura është një term i ri, i zhvilluar pas rilindjes, për të cilën janë dhënë shumë përkufizime të ndikuar nga qëndrime të ndryshme filozofike dhe faktorë të ndryshëm social-politikë.³ Si përkufizim klasik mund të thuhet se kultura është një tërësi komplekse që përfshin njohuritë, artin, moralin, doket e zakonet, si dhe të gjitha aftësitë të cilat i fiton njeriu, si pjesë

1. Cebeci, Suat “Milli Kimlik Bağlamında Din - Kültür İlişkisi” Akademik İncelemeler Dergisi, 2008, Volume 3, Issue 2, f. 1-11, f. 8.

2. Pajaziti, Ali, “Fjalor i sociologjisë”, Logos-A, Shkup 2017:336.

3. Bullaç, Ali, “Historia, shoqëria dhe tradita”, Logos-A, Shkup 2003: 203-205.

e shoqërisë.⁴

Për fjalën kulturë në gjuhën arabe përdoret termi *thekafeh* që ka domethënie: talent, afnitet, art i hollë, art i bukur dhe emocionues, udhëheqja e potencialit logjik në pajtim me disa kriteret, baraspeshë në forcën e të menduarit, përsosuri njerëzore, stolisje, edukim apo stërvitje e njeriut sipas vlerave të larta ku synohet përsosuria.⁵ Krahas kuptimit leksikor duhet theksuar se ky term është importuar nga qytetërimi modern i zhvilluar pas rilindjes. Në terminologjinë islame, apo edhe në mendimin e Ibn Haldunit, nuk e gjejmë të përdorur një term të tillë.

Në këtë shkrim në lidhje me kulturën do t'i referohemi termit “Urf”⁶. Në enciklopeditë klasike të literaturës islame *Urf*-i përkufizon veprat të cilat feja dhe logjika e njeriut i konsideron të mira⁷ dhe gjithashtu arrijen në një konsensus

4. Pajaziti, po aty, f. 336-337.

5. Bullaç, po aty, f. 202.

6. Fjala “Urf” vjen në kuptimin e njohjes dhe është e kundërta e “nekr” që lidhet me mosnjohjen dhe mohimin e diçkaje. Ajo shpreh tërësinë zakoneve dhe marrëveshjeve të pranuar dhe miratuara nga njerëzit brez pas brezi. Ky term gjen një përdorim në shumë fusha të jetës si me shtetin, politikën, jurisprudencën dhe shprehjet që shënjojnë një kuptim të caktuar. Në këtë shkrim termin “urf” do ta përkthejmë si kulturë apo traditë.

7. Ragib Isfahani, H. (1991). *Al-mufradat fi gharib al-Quran*. Edited by Seyed Gilani M. Beirut: Dar al-Marifa, f. 168.

mes njerëzve për t'u konsideruar të tilla.⁸ *Urf*-i gjithashtu është një term i cili korrespondon me kulturën apo traditat⁹ në shkencën e jurisprudencës islame. Ai është një nga burimet që merret për bazë në nxjerrjen e gjykimeve në këtë shkencë. Ndërsa parimet fetare janë të pandryshueshme dhe të përbotshme, në gjykimet fetare merren parasysh karakteristikat e shoqërive apo situatave përkatëse për të arritur në qëllimet përfundimtare që synojnë këto parime.¹⁰

Duke iu referuar kuptimeve etimologjike të këtij termi¹¹ mund

8. Xhurxhani, Ali bin Muhamed "Muxhem et-tarifaf", Darul Fadilah 2004, f. 125.

9. Vlen të theksohet se duke iu referuar përdorimit të konceptit i traditës në Kuranin Famëlartë, ai ka dallim me konceptin e zakoneve. Tradita është koncept më gjithëpërfshirës ndërsa zakonet lidhen vetëm me veprimet në përgjithësi. Gjithashtu, zakonet mund të jenë të mira ose të këqija ndërsa ky koncept përdoret për emërtimin e traditave të mira.

Eyüpoğlu, Osman; Okuyan, Mehmet "Kur'an'ın Sosyo-Kültürel Koşulları Dikkate Alışı: Ma'rûf Kavramı Örneği", Ondokuz Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, Yıl 2008, Cilt 26 , Sayı 26-27, s. 175 – 213, f. 24-25.

10. Şaban, Z., & Esasları, İ. H. İ. (1990). çev. *İbrahim Kafi Dönmez*, 10, f. 175-179.

11. Nga folja arefe, jearifu - të njohurit dhe të kuptuarit e diçkaje në thelb në sajë të një përpjekje shpirtërore dhe intelektuale. Masdari (burimi, origjina) i saj është "irfan" dhe "marifet" që në Kur'anin Famëlartë dhe Traditën Profetike lidhen me njohjen e Zotit si një ideal në procesin e arritjes së përsosmërisë morale. Shiko: Ünal, Ali

të thuhet se kultura është produkt i aktivitetit njohës shpirtëror dhe intelektual të njeriut që përfshin të gjithë qenien e tij. Ky aktivitet nuk është thjesht një prodhim i instinkteve apo reagimeve ndaj jashtësisë, por një akt i cili buron nga perceptimi i jashtësisë nga brendësia e qenies së tij.¹² Formimi i kulturës është një aktivitet që ka si burim kryesor parimet që burojnë nga shpallja hyjnore. Kështu prodhimi i kulturës krahas ndërtimit të kësaj bote sipas një rendi dhe harmonie të caktuar, është një aktivitet që e edukon njeriun drejt përsosmërisë morale, për t'u afruar më shumë me Zotin.

Kultura dhe feja janë dy ekzistenca me funksione të ndryshme që ndërveprojnë me njëra-tjetrën. Në historinë e njerëzimit, në kultura të ndryshme, shikohen nuanca të fesë në jetën shoqërore, traditat, artin, arkitekturën, etj. Ndërsa kulturat i japin fesë gjuhën e tyre, fetë i japin një kuptim të fundmë çdo kulture.¹³ Studiuesi Ali Bullaç, kur flet për formimin e kulturës në këndvështrimin islam rendit këto burime: fenë, mjedisin natyror dhe trashëgiminë historike e kulturore të shoqërisë. Feja është burimi parësor

"Kuranda temel kavramlar", Beyan yayinlari, 1986, f. 313.

12. Ozakpënar, Jëllmaz "Kultura dhe qytetërimi", Logos-A, Shkup 2003, f. 15-17.

13. Kruja, Genti, "Shqiptarët Përballë Sfidave Të Mirëkuptimit Ndërfetar", Prizmi, Tiranë 2008, f.34.

i njohurive që frymon te njeriu një perceptim dhe botëkuptim për jetën, ndërsa burimet e tjera janë ekzistenca të domosdoshme të cilat përcaktojnë natyrën, veçoritë dhe karakteristika të caktuara të shoqërive në përgjithësi apo edhe individëve në veçanti.¹⁴

Bashkëveprimi i fesë me kulturën është një proces i natyrshëm në jetën e një shoqërie. Feja nuk mund të shprehet pa kulturën, ashtu sikurse nuk mund të reduktohet në kulturë. Feja, si udhërrëfyese për njeriun, ofron një perspektivë për ndërtimin e jetës individuale dhe shoqërore. Si pasojë e jetësimit të fesë, lind fenomeni i bashkëveprimit të saj me kulturën. Kështu kultura e shoqërisë, nevojat e saj dhe komunikimi me kulturat e ndryshme janë elementet me të cilët feja bashkëvepron për të mundësuar komunikimin me njeriun për ta udhëzuar atë drejt së mirës. Për shembull, nëse do t'i referohemi qytetërimit islam, do të vëmë re se ai karakterizohet nga njohja e shumëllojshmërisë së kulturave në bazë të unitetit të parimeve që ato përfaqësonin. Ky realitet, ku parimet fetare ndërthureshin me kulturën dhe traditat e popujve përkatës shpaloset që nga normat juridike deri tek arti dhe arkitektura. Kjo qasje ishte një ndër arsytet që i mundësoi qytetërimit islam të zhvillohej, përhapej dhe të përfaqësointe vlera të cilat e bëjnë ndër qytetërimet më të larta.¹⁵

14. Bullaç, po aty, f. 216-226.

15. Ramadan, Tariq "Radical Reform:

Bashkëveprimi midis fesë dhe kulturës është një proces kompleks dhe shumëdimensional. Një fenomen me të cilin njerëzit janë përballur në kohë të ndryshme gjatë historisë është kur kultura ka marrë rolin e fesë dhe anasjelltas. Kjo ka ndodhur kur nuk është njohur qartë kultura, feja dhe marrëdhënia midis tyre apo këto janë adaptuar për interesa të caktuara. Për shembull, në fetë lokale vihet re një mbizotërim i kulturës kundrejt fesë. Kështu feja i shërben mentaliteteve të caktuara dhe përdoret për t'i shërbyer klasave sunduese të shoqërisë.¹⁶ Në rastin e mbizotërimit të fesë mbi kulturën ndodh kur kuptimi thelbësor i fesë, i cili është universal, reduktohet në një kohë dhe vend të caktuar dhe monopolizohet një interpretim i vetëm në kohë dhe vende të ndryshme.¹⁷

Pse duhet ruajtur trashëgimia kulturore materiale?

Me trashëgiminë kuptohet përcjellja dhe të trashëguarit e diçkaje nga e shkuara në të tashmen. Pra, të trashëguarit e pasurisë intelektuale dhe shpirtërore të brezave të mëparshëm, të shprehur në forma të ndryshme, quhet

Islamic Ethics and Liberation", Oxford University Press; 1st Edition (November 17, 2008), f. 184-185.

16. Freyer, Hans "Sociologjia e fesë ", Logos-A, Shkup 2015; f. 105-106

17. Ramadan, Tariq, po aty, f. 184.

trashëgimi kulturore. Trashëgimia kulturore ndahet në atë jo materiale e cila konsiston në traditat, artet, historinë gojore, praktikat sociale, mjeshtërinë tradicionale, ritualet që janë praktikuar një shoqëri. Forma tjetër është trashëgimia kulturore materiale. Kjo trashëgimi konsiston në artefaktet materiale siç janë veprat artistike, ndërtesat, monumentet kulturore, etj.¹⁸ Trashëgimia kulturore materiale është objekt studimi për shumë shkencë si arkeologjia, antropologjia, dhe sociologjia.

Trashëgimia kulturore dhe studimi rreth saj është një fushë relativisht e re studimi, ku fillesat i ka në shekullin e XVIII. Në literaturën islame nuk gjejmë një referencë të qartë për nocionin e trashëgimisë kulturore. Por duhet theksuar se trashëgimia kulturore ka qenë ruajtur nëpërmjet parimeve si: toleranca kundrejt shumëllojshmërisë kulturore, ruajtja e burimeve njohëse, promovimi i zhvillimit dhe ndalimi i shkatërrimit.¹⁹

Nëse kthehemi në historinë islame, që në kohën e Profetit Muhamed a.s., është konsideruar e obligueshme ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale ku janë ruajtur ndërtesa apo objekte të kultit që

i përkisnin besimeve të tjera.²⁰ Gjithashtu, në ligjet e luftës, ndër të tjera, ndalohej dëmtimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore të vendeve në të cilat luftohej.

Njohja e historisë

“Lexo”, është fjala dhe urdhri i parë që Zoti iu drejtua njeriut në Kur’anin Famëlartë. Njohja është akti më i lartë që e karakterizon qenien njerëzore, e cila kulmon me gjendjen më të lartë me përjetimin e njohjes së Zotit. Burimet e njohjes mund t’i ndajmë në dy grupe: shpalljet hyjnore dhe njohuritë që përfton njeriu nga vëzhgimi i “librit të natyrës” nëpërmjet të cilit shpalosen cilësitë dhe ligjet e Zotit në këtë botë.

Historia si objekt studimi përbën një nga burimet më të rëndësishme për njeriun në këtë botë. Së pari është e rëndësishme sepse jeta e njeriut nuk mjafton për të njohur të gjitha ligje natyrore në lidhje me jetën individuale dhe shoqërore.²¹ Së dyti, sidomos në kohët moderne, ajo

20. Një nga shembujt që mund të përmendet, është statusi i privilegjeve të krishterëve nga Profeti Muhamed për murgjit e Manastirit të Shën Katerinës. Ky dokument përbehej nga disa klauzola të cilat mbulonin të gjitha aspektet e të drejtave të njeriut, ku ndër të tjera ndalonte dëmtimin e objekteve të kultit dhe çdo lloj padrejtësie mbi pronësitë e asaj popullate. Shiko: Kruja, po aty, f.115-116; Alshehaby, f. 23.

21. Şulul, Kasim, “İslam düşüncesinde tarih felsefesi”. Divân: İlmî Araştırmalar, 2001, f. 6.

18. <https://plato.stanford.edu/entries/ethics-cultural-heritage/>

19. Alshehaby, Fatimah, (2020). Cultural Heritage Protection in Islamic Tradition. *International Journal of Cultural Property*, 27(3), 291-322, f. 27.

është një burim i rëndësishëm me anë të së cilës njeriu njih shoqërinë, natyrën dhe ligjet e saj. Kështu njohja e historisë i mundëson njeriut vetë-njohjen; pra të njohë njeriun si qenie dhe natyrën e tij²² ku kjo konsiderohet si grada më e lartë e diturisë në fetë dhe filozofitë e ndryshme.

Allahu i Madhëruar në lidhje me njohjen e historisë së popujve të mëparshëm i drejtohet njeriut duke thënë:

“A nuk kanë udhëtuar nëpër botë e të shohin si kanë përfunduar ata para tyre?”²³

“Edhe Musanë e dërguam me argumentet tona: “Nxirre popullin tënd nga terri në dritë dhe tërhiq vërejtjen për ditët e Allahut! “Në këtë ka, me të vërtetë, argumente për secilin durimtar mirënjohës.”²⁴

“Prandaj sot do ta shpëtojmë vetëm trupin tënd që t’u shërbejë atyre që vijnë pas teje si argument. Megjithatë, shumë njerëz janë indiferent ndaj argumenteve tona.”²⁵

Koncepti i historisë ka një përdorim të gjerë në literaturën islame. Një pjesë e Kur’anit Famëlartë

22. Sinani, Gjergj, “Filozofia e historisë”, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 1999, f. 10.

23. Nahi, Hasan “Kur’ani i Madhërisëm”, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë 2006, Rrum 30:9.

24. Kur’ani, Ibrahim 4:5

25. Kur’ani, Junus 10:92.

përbëhet nga fragmente ngjarësh nga historia. Këto fragmente në të cilat nxirren në pah karaktere, gjendje dhe marrëdhënie të caktuara midis njerëzve shoqërohen me përcimin e normave morale. Qëllimi në këto fragmente nga historia është që njeriu, duke njohur ‘ligjet e Zotit’ në shoqëri, të udhëzohet në ndërtimin e një jete të virtytshme individuale dhe shoqërore.

Duke u nisur nga ky qëndrim, në historinë e mendimit islam është formuar dhe zhvilluar etika në lidhje me historinë. Fjala ‘tarikh’ që në gjuhën arabe përkthehet si histori ka hyrë më vonë nga greqishtja e vjetër. Ibn Halduni në veprat e tij për të shprehur historinë përdor termin ‘ibar’. Duke iu referuar kuptimeve etimologjike dhe përdorimeve të këtij termi në lidhje me historinë ai shërben si një urë lidhëse midis historisë dhe urtësisë. Pra studimi i historisë është një fushë që edukon njeriun për të kuptuar ligjet morale në historinë e njerëzimit.²⁶ Mësimi i saj i saj nuk përbën thjesht tregimin e ngjarjeve nga e shkuara por është një shkencë e kulturës me anë të së cilës studiohen shoqëritë. Sipas Ibn Haldunit, me studimin e aspektin të brendshëm të historisë mund të arrihet njohja e natyrës, zhvillimeve dhe origjinave e shkaqeve që

26. Mahdi, Muhsin, Ibn Khaldûn’s philosophy of history: A study in the philosophic foundation of the Science of culture, Routledge; June 2017, f. 63-73

shkaktojnë gjendje të caktuara në shoqëri.²⁷

Në qytetërimin islam historia ishte një burim maturie e vizioni dhe material i dobishëm për formimin e shkencave praktike. Të frymëzuar nga parimet hyjnore, mendimtarët myslimanë i këshillonin sundimtarët që të mësonin nga eksperiencia e së shkuarës, duke iu referuar ngjarjeve që kanë ndodhur në kohë dhe regjime të caktuara, në mënyrë që të ndërtonin qasjet dhe teoritë e caktuara politike.²⁸

Kështu nën dritën e këtyre parimeve mund të thuhet se trashëgimia kulturore materiale është burim njohjeje dhe objekt studimi për historinë. Qenësia e saj është një dimension i rëndësishëm i shoqërisë dhe i njeriut si qenie sociale me një përvojë të shkuar. Ruajtja e saj është një element i rëndësishëm i procesit të vetë-njohjes së njeriut për të kuptuar qenien e tij, raportin me qeniet tjera dhe për të mundësuar zhvillimin shpirtëror, intelektual dhe material të shoqërisë.

Shumëllojshmëria kulturore

Historia e njerëzimit përbëhet nga një larmi vlerash të shprehura nga shoqëri të caktuara në kontekste të ndryshme. Çdo shoqëri ka arritur t'i shprehë vlerat kulturore sipas natyrshmërisë së saj. Këto vlera kulturore, të njëjta apo të ndryshme,

përbëjnë një element të përsosjes së mozaikut kulturor që është formuar përgjatë historisë së njerëzimit. Kështu shumëllojshmëria kulturore përbën një parim të rëndësishëm të marrëdhënieve ndërmjet shoqërive.

Larmishmëria në thelb është një parim i Zotit në krijim, i cili reflekton edhe te krijimi i njeriut. Allahu i Madhëruar thotë:

“O njerëz, Ne ju kemi krijuar juve prej një mashkulli dhe një femre dhe u kemi bërë popuj e fise që ta njihni njëri-tjetrin. Më fisniku tek Allahu është ai i cili më së shumti i ruhet Atij; Allahu, me të vërtetë, është shumë i dijshtëm dhe i informuar mirë.”²⁹

“Nga argumentet e tij është edhe krijimi i qiejve dhe tokës, llojlojshmëria e gjuhëve tuaja edhe e ngjyrave tuaja; këto janë, njëmend, mësimet për ata që dinë.”³⁰

Ashtu si në krijimin e universit, larmishmëria ndërmjet njerëzve dhe mirësitë të cilat i ofron njeriut, tregohet si një shenjë për madhësinë dhe përsosmërinë e krijimit të Zotit dhe është një shenjë me anë të së cilës njeriu duhet të njohë Atë. Larmishmëria në gjuhë, ngjyrë, tradita, fe, prirje dhe aftësi ka për qëllim njohjen dhe bashkëpunimin duke qenë se lind nevojën e njerëzve për njëri-tjetrin për të plotësuar nevojat dhe

27. Mahdi, po aty, f. 158-159.

28. Mahdi, po aty, f. 139-140.

29. Kur’ani, Huxhurat 49:13.

30. Kur’ani, Rrum 30:22.

përgjegjësitë e tyre.³¹Si rrjedhojë, mund të thuhet se shumëllojshmëria kulturore në parim përputhet me natyrën e krijimit të njeriut dhe universit.

Allahu i Madhëruar në një ajet tjetër thotë:

“Dhe sikur të kishte dashur Allahu, Ai do t’ju kishte krijuar vetëm një popull, por Ai do t’ju sprovtojë me atë çka u jep, prandaj bëni gara për vepra të mira! Te Allahu do të ktheheni të gjithë dhe Ai do t’ju informojë për atë çka keni kundërshtuar.”³²

Shumëllojshmëria kulturore është një sprovë për njeriun. Ndryshimet që i karakterizojnë grupet shoqërore me të cilat ato identifikohen kthehen në shkaqë me të cilat njerëzit largohen apo armiqësohen. Gjatë historisë shumë luftëra të padrejta janë bërë në emër të fesë apo kulturës, etj. Megjithëse këto ekzistenca nuk promovojnë diçka të tillë, mosnjohja e tyre dhe epërsia e dëshirave dhe pasioneve mbi shpirtin dhe mendjen ka çuar në përfundime të tilla. Njohja dhe pranimi i larmishmërisë zhvillon te shoqëria modestinë dhe largimit nga fanatizmi. Kështu, si shumë shenja të tjera në krijimin e Zotit edhe larmishmëria shërben si mjet për përsosjen e moralit të njeriut.

Shumëllojshmëria kulturore

ndihmon grupet shoqërore për t’u mbrojtur nga teprimet e mundshme.³³ Një prej shfaqjeve të saj është fanatizmi fetar, kulturor apo kombëtar. Krahas vlerave që këto kanë në vetvete, te Zoti nuk ka vlerë përkatësia ndaj një grupi të caktuar por afërsia te Zoti ku gjykimi mbi këtë të fundit i përket diturisë së Tij. Shembuj të shumëllojshmërisë kulturore i gjejmë në qytetërimin islam ku promovimi i një tolerance shpirtërore dhe intelektuale, që reflektonte në fenomene si harmonia, bashkëjetesa dhe respektimi i të drejtave të popujve me përkatësi fetare dhe kulturore të ndryshme dhe pranimin e promovimin e diturive të ndryshme siç ishte edhe filozofia greke. Kjo tolerancë kundrejt shumëllojshmërisë kulturore ndikoi në zhvillimin, jetëgjatësinë dhe pranimin e këtij qytetërimi nga popujt e tjerë.

Promovimi i shumëllojshmërisë kulturore nuk duhet të çojë në zbehjen dhe shuarjen e identitetit të një shoqërie. Kjo qasje haset në rryma si postmodernizmi, sipas së cilës të vërtetat janë njëkohësisht të shumta dhe relative. Edhe pse në pamje të parë kjo qasje eliminon përplasjet kulturore dhe promovon paqen, në thelb njeriu nuk gjen paqen me qenien e tij, sepse ai gjithmonë kthehet te nevoja për kuptim dhe

31. Kutub, Sejjid “Fi dhilalil Kuran”, V.6, Daru Shuruk, Kajro 1968, f. 106-107.

32. Kur’ani, Maide 5:48.

33. Ramadan, Tariq “The quest for meaning: developing a philosophy of pluralism”, Penguin UK 2012, f. 68-69.

siguri në lidhje me kuptimin e jetës dhe rrjedhimisht për një shoqëri që i ndërton vlerat mbi bazën e këtij perceptimi.³⁴

Kështu mund të thuhet se shumëllojshmëria kulturore përbën një dimension të rëndësishëm të qenies së njeriut dhe shoqërisë. Ai lind nevojën e një komunikimi të thellë dhe njohës mes grupeve shoqërore. Si rrjedhojë, sjell njohjen e vetes dhe të tjerëve dhe rrjedhimisht të përbashkëtave dhe veçorive që janë shprehje e pasurive të vlerave apo mungesës së tyre. Kështu me komunikimin e kulturave shoqëria, në bazë të një etike të caktuar, shkëmben vlera që duke u sintetizuar me kulturën përkatëse i shton vlerat e saj dhe rrjedhimisht ndihmon shoqërinë në rrugëtimin e saj drejt përsosmërisë morale.

Trashëgimia kulturore materiale është një element që shpreh kultura të ndryshme të cilat reflektojnë shumëllojshmërinë kulturore që karakterizon historinë e njerëzimit. Larmishmëria dhe shumësia e vlerave të shprehura në mënyra të ndryshme përbëjnë një dimension të rëndësishëm në jetën e shoqërive njerëzore. Qenësia dhe ruajtja e kësaj trashëgimie në jetën e shoqërisë si pasuri e së shkuarës përbën një element njohës dhe udhërrëfyes për komunikimin dhe përvetësimin e vlerave që shpalosin këto shoqëri.

34. Ramadan, po aty, f. 26-27.

Identiteti kulturor

Njeriu është një qenie me natyrë sociale. Ai ka nevojën e shoqërizimit dhe përkatësisë për të plotësuar kërkesat shpirtërore dhe intelektuale. Identiteti kulturor nënkupton vetëdijen e përfaqësuesve të një grupi e cila u mundëson atyre të vetë-përcaktohen, t'i përcaktojnë grupet e tjera dhe të mbajnë qëndrime lidhur me to. Gjuha, besimi, traditat, arti dhe vlerat që lidhen me to përbëjnë elementë e identitetit kulturor.³⁵

Çdo 'unë' është dhe ka nevojë të jetë pjesë e një 'ne'. Kështu që njeriu për të zhvilluar personalitetin e tij ka nevojë për një identitet ku potencialet individuale të kombinohen me krijimin marrëdhënies me shoqërinë.³⁶ Në anën tjetër ky identitet nuk duhet të mbizotërojë duke penguar zhvillimin e potencialeve shpirtërore dhe intelektuale të individit.³⁷

Në këndvështrimin islam koncepti i "urf-it" pra kultura apo traditat e një vendi ka një rëndësi të veçantë. Kur'anit Famëlartë është një libër universal, për të gjithë kohët dhe popujt por ai ka zbritur në "gjuhën" e njeriut të një kohe të caktuar. Kështu Imam Shatibiu thekson se për komentuesin e Kur'anit një ndër

35. Pajaziti, po aty, f. 253.

36. Gulubovic, Zagoricka "Unë dhe tjetri: Shqyrtime antropologjike rreth identitetit individual dhe kolektiv", Logos-A, Shkup 2019, f. 35.

37. Gulubovic, po aty, f. 14.

fushat që duhet njohur janë traditat e arabëve të kohës kur është zbritur Kur’ani në lidhje me fjalët, veprat apo zakonet e ndryshme.³⁸

Në çdo fe apo filozofi kultura dhe traditat janë një element i rëndësishëm që merret parasysh në përcaktimin e ligjeve. Në Jurisprudencën Islame tradita është një nga burimet e nxjerrjes së gjyqimeve. Ajo shpreh një marrëveshje të caktuar të një shoqërie për një kohë relativisht të gjatë në lidhje me çështje të caktuara. Roli i traditës ndryshon në bazë të situatës. Ajo është një prej burimeve të gjyqimit në bazë të së cilës ndryshojnë edhe gjyqimet fetare.³⁹

Në jetën e Profetit Muhamed a.s. mund të shikohen tre qëndrime në lidhje me traditat të cilat janë refuzimi, pranimi dhe përmirësimi. Traditat që binin krejtësisht në kundërshtim dhe parimet islame u refuzuan siç ishin disa lloje të martesave apo adhurimeve. Një pjesë e traditave u pranuan siç ishin traditat e shpërndarjes së ushqimit nga hashimitët për vizitorët e Qabes. Një pjesë e traditave u përmirësuan, duke u pastruar nga pjesa që binte

në kundërshtim me parimet islame.⁴⁰

Kështu mund të thuhet se në këndvështrimin islam, identiteti kulturor është pjesë e përbërëse e shoqërisë dhe një dimension i rëndësishëm i saj. Njohja dhe bashkëveprimi i saj nën dritën e parimeve të caktuara etike është një domosdoshmëri për emancipimin dhe zhvillimin shpirtëror e intelektual të shoqërisë.

Njeriu ka një lidhje të natyrshme dhe të ngushtë me natyrën e vendit dhe kulturën të cilën jeton. Ibn Halduni shpjegon se si natyra fizike përcakton veçoritë fizike dhe psikike të njeriut dhe në anën tjetër potencialet e tij në formimin e kulturës.⁴¹ Ai thekson se si pasojë e lidhjes së natyrës së njeriut me natyrën e kulturës ka një lidhje të ngushtë midis qenies së tij dhe kulturës së prodhuar. Në anën tjetër çdo bashkësi njerëzore në bazë të kulturës dhe perceptimit të saj për qytetërimin ndërton jetën në këtë botë. Trashëgimia kulturore materiale e shprehur nëpërmjet teknologjisë, qytetit, urbanistikës, arkitekturës shpreh vlerat e përvetësuara nga shoqëria në bazë të këtij perceptimi.⁴² Ajo është një

38. Tan, Zeki “Kur’an’ın Anlaşılmasına Katkısı Açısından Kur’an Öncesi Mekke Toplumu”, 8. Tefsir Akademisyenleri Buluşması, İstanbul, Türkiye, 1 - 03 Temmuz 2011, f. 5.

39. Şimşirgil, Ahmet Ekrem;Ekinci, Buğra “Ahmet Cedet Pasa ve Mecelle”, KTB yayınları, İstanbul 2008, f. 116-124; 123-124.

40. Bullaç, po aty, f. 291-301.

41. Mahdi, po aty, f. 191.

42. Në qytetërimin islam ndërtimi i qyteteve, urbanistikës dhe arkitekturës bëhej në bazë të parimeve të frymëzuara nga Kurani dhe jeta e Profetit. Parimi i qendror ishte ai i Unitetit hyjnor që shpreh ‘ndërlidhjen e gjërave, integrimin e shumësisë në unitet

mishërim i botëkuptimit mbi jetën dhe e natyrës e veçorive unike që e karakterizojnë një shoqëri. Ruajtja e saj lidhet ngushtë me njohjen e identitetit dhe një përvojë të shoqërisë mbi të cilën ndërtohet ekzistenca e saj.

Krahas kësaj duhet theksuar se gjatë historisë, shoqëritë njerëzore kanë komunikuar vazhdimisht me njëra-tjetrën. Faktorët e këtij komunikimi kanë qenë si pasojë e qytetërimit që është realizuar nëpërmjet edukimit, shkencës artit ashtu edhe e mosmarrëveshjeve, pushtimeve, etj. Kështu origjina e trashëgimisë kulturore materiale mund të jetë e ndryshme dhe të shprehë ndikimin e një qytetërimi të caktuar. Por, krahas faktorëve të jashtëm, një kulturë nuk mund të mbijetojë, të përvetësohet dhe të ketë një rol në jetën e një shoqërie nëse nuk ka një pajtueshmëri shoqërore.⁴³ Nëse një kulturë ka bashkekzistuar me një shoqëri do të thotë se ajo është pranuar dhe ka fituar një natyrshmëri në jetën e saj. Kështu

dhe varësinë e plotë ontologjike të të gjitha qenieve nga i Vetmi, si dhe përkushtimin total të individit ndaj Vullnetit të të Vetmit⁴. Kështu çdo gjë ishte frymëzim, burim reflektimi dhe motivimi për të ndërtuar jetën në bazë të urdhrave të Zotit.

Shiko: Nasr, Sejjid Husein “Islami në botën moderne: I sfiduar nga Perëndimi, i kërcënuar nga fundamentalizmi, besnik ndaj traditës”, Logos-A 2017, f. 139.

43. Okten, Sadettin “Coca-cola në filxhanin tim”, Logos-A Shkup-2015, f. 207-212.

mund të thuhet se trashëgimia kulturore materiale buron nga një perceptim i brendshëm dhe qëllimi i formimit të saj është deklarimi i një identiteti nga shoqëria që është një nevojë e qenies së njeriut. Pavarësisht origjinës apo larmishmërisë që e karakterizon, ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale lidhet ngushtë me identitetin kulturor të një shoqërie.

Kujtesa kolektive

Çdo shoqëri ka nevojë për bashkëpunim dhe elemente unifikimi për formimin e kulturës dhe zhvillimin e saj në nivele më të larta. Kujtesa apo memoria e përbashkët është një element i rëndësishëm për ruajtjen e identitetit. Ajo bashkon shoqërinë për të ruajtur dhe promovuar vlerat e përbashkëta. Në këtë kontekst Durheimi (Durkheim) përdor termin ‘kujtesë sociale’ si një element themelor në ruajtjen e gjallërisë së shoqërisë. Sipas tij çdo shoqëri ka një lidhje të pamohueshme me të shkuarën dhe promovon një ndjenjë të vazhdimit të saj.⁴⁴ Nxënësi i tij Mauris Halbauk (Maurice Halbwachs) i cili përdor termin ‘kujtesë kolektive’ thekson se ka një lidhje të kujtesës sonë me shoqërinë. Sipas tij çdo kujtesë individuale formohet në komunikimin me të tjerët ku shoqëria në fjalë ka imazhe

44. Mizstal, Barbara “Durkheim on collective memory”, Journal of Classical Sociology, 2003, f.2;15.

të përbashkëta unifikuese.⁴⁵ Kështu kujtesa kolektive mundëson lidhjen midis brezave dhe rigjallërimin e vlerave që përcaktojnë identitetin e shoqërisë në të tashmen. Ajo është një element që mundëson bashkimin e shoqërisë dhe zhvillimin e saj në kultura më të larta. Në këtë kontekst mund të përmendet se shumë shoqëri të vogla dhe të pafuqishme kanë ruajtur identitetin e tyre nëpërmjet trashëgimisë kulturore të përbashkët. Ajo ka prodhuar një ndërgjegje kolektive nëpërmjet eksperiencës historike të përbashkët.

Në trashëgiminë islame mund t'i referohemi termit “asabijet” të Ibn Haldunit si një koncept i përafërt me kujtesën kolektive për nga natyra dhe qëllimi i tij. Koncepti i “asabijetit” nga studiuesit modern është kuptuar si ndjenjë e përbashkët, vetëdije kolektive, ndjenjë bashkëpunimi, shpirti i shoqërisë, etj. Arnold Toynbee e përkufizon si forma e parë shpirtërore e shoqërisë, meqenëse prej saj kanë lindur të gjithë institucionet politike dhe shoqërore.⁴⁶

Sipas Ibn Haldunit kujtesa kolektive apo solidariteti grupor

45. Hasanov, Behram “İbn Haldun’un Asabiyet Kavramında ‘Kolektif Hafıza’ Boyutu”, Bakü Devlet Üniversitesi İlahiyat Fakültesi’nin İlimi Mecmuası, 2014, nr: 21, f. 199-210, f. 4.

46. Geçit, Bekir “İbn Haldun’da Siyasal Gücün Kullanılmasında ‘Asabiyet’in Önemi”, Beytulhikme an international journal of philosophy, V.8(2), 2018, f. 4-6.

(sipas studiuesit Muhsin Mahdi), është dinamika kryesore që mundëson ndryshimin dhe zhvillimin e kulturës. Si pasojë e saj njerëzit kanë pranuar përgjegjësi dhe detyrime të përbashkëta dhe janë tubuar rreth një ideali të përbashkët, duke shfaqur forcën edhe epërsinë e tyre.⁴⁷ Mbijetesa dhe fuqia e një shoqërie qëndron në fuqinë e solidaritetit grupor. Forma primare e tij që shpreh konsensusin veprimor të anëtarëve të grupit është lidhja fisnore. Gjatë evoluimit të një shoqërie sunduese kjo dinamikë ndryshon dhe zhvillohet, duke filluar që nga solidariteti natyral, ai i formuar me anë të perceptimeve racionale dhe me anë të ligjeve hyjnore të cilat përkojnë me qeveritë primitive, racionale dhe ligjore.⁴⁸ Ndër llojet e solidaritetit Ibn Halduni thekson se ai që buron nga feja është më i fuqishëm, duke qenë se feja është më gjithëpërfshirëse dhe krijon më shumë imazhe të përbashkëta.⁴⁹

Kujtesa kolektive është një dimension i pandashëm i çdo shoqërie. E shkuara e përbashkët përbën një dinamikë kryesore që mundëson ruajtjen e ekzistencës dhe zhvillimin e shoqërisë dhe solidaritetin ndërmjet individëve. Kështu kujtesa kolektive është një element që lidhet me mënyrën se si njeriu ndërton vetëdijen për të

47. Mahdi, po aty, f. 261-163.

48. Mahdi, po aty, f. 261-163.

49. Hasanov, po aty, f. 5-6.

shkuarën, për të kuptuar të tashmen dhe për të hedhur hapa më të sigurt në të ardhmen e panjohur.

Trashëgimia kulturore materiale është një nga format ku shprehet më mirë kujtesa kolektive e një shoqërie, duke filluar nga materialet dhe objektet kulturore deri te qyteti i cili është organi më i mirë i kujtesës që ka arritur të krijojë njeriu.⁵⁰ Kjo trashëgimi ka një rol themelor për njohjen dhe vlerat që përcjellin në hapësirën fizike të një shoqërie, duke qenë se paraqitja e tyre në tre dimensione dhe mundësia e përjetimit dhe njohjes me të gjitha shqisat nuk mund të zëvendësohet me asnjë formë tjetër. Në aspektin psikologjik, objektet kulturore shprehin një identitet të caktuar, krijojnë një lidhje të nën-ndërgjegjshme me njeriun dhe përcjellin mesazhe të caktuara për ta.⁵¹ Ata lidhen me ndjenjën e përkatësisë të njeriu, duke krijuar një rehati në aspektin psikologjik me anë të cilës njeriu ndjehet si në shtëpinë

50. Berisha, Drilona. “Kujtesa kolektive nëpërmjet arkitekturës në qytetin e Prishtinës”, (2021), f. 7.

51. Këtu mund të shtojmë se ato që sot quhen arte minore ku bëjnë pjesë objektet si veshjet, endjet e qilimave, orënditë shtëpiake ishin arte të rëndësishme në qytetërimin islam. Përveç funksionit të tyre praktik estetika në bazë të cilës krijoheshin dhe arti i shprehur në to ishte një burim reflektimi dhe kujtimi për njeriun në lidhje me të vërtetat e jetës së tij. Shiko: Nasr, po aty, f. 126.

e tij.⁵² Kështu trashëgimia kulturore, si reflektim i dimensionit social të qenies së njeriut, përbën një rol aktiv në jetën tij. Ajo plotëson nevojat që lidhen me përkatësinë dhe identitetin në shoqëri dhe i siguron njeriut një gjendje më të qetë në aspektin psikologjik.

Xhorxh Oruell (George Orwell) thotë se ai i cili kontrollon të tashmen arrin të kontrollojë të shkuarën.⁵³ Trashëgimia kulturore materiale, si pjesë e së shkuarës, megjithëse ka ekzistuar, mund të manipulohet, harrohet nëse nuk ruhet. Kështu ruajtja e saj është një problematikë e së tashmes, sepse marrëdhënia e shoqërisë me të dhe vlerat e saj formojnë të ardhmen. Një fenomen i tillë mund të shikohet në historinë e njerëzimit ku një nga aktet që pushtuesit kanë kryer në vendet e zaptuara ka qenë zhdukja e objekteve kulturore.

Po ashtu në kohët moderne shpikja e traditave është një mënyrë për të zhdukur identitetin e një shoqërie dhe sunduar mbi të. Studiuesit Hosbaum dhe Ranger thonë se traditat e shpikura përdoren si mjete të fuqisë për të legjitimuar institucione dhe krijuar një kohezion social për t’i përshtatur njerëzit

52. Graham, Briam; Howard Peter, “The Ashgate Research Companion to Heritage and Identity”, Ashgate Publishing Ltd 2012, f. 51.

53. Graham, po aty, f. 20.

me sistemin e krijuar.⁵⁴ Ndërsa traditat e shpikura projektohen prej ideologjive të caktuara duke përdorur fragmente të caktuara nga e shkuara, traditat dhe zakonet e një populli si produkt përvojës historike që formësohen dhe zhvillohen në mënyrë të natyrshme kanë një lidhje qenësore me identitetin e një shoqërie dhe përbëjnë një dinamikë të rëndësishme në nën-vetëdijen e saj. Megjithatë, edhe pse vendosen në një shoqëri me vlera të ndryshme, traditat e shpikura krijojnë paqartësi në perceptimin e një shoqërie për identitetin e saj dhe ndikojnë sjelljet e njerëzve duke pasur si qëllim vlerat e synuara nga këto tradita.

Kështu ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale është një nga format për të ruajtur kujtesën kolektive. Qenësia e saj në të tashmen përbën një burim njohjeje, inspirimi dhe një dinamikë që krijon një kohezion social që shoqëria të ruajë ekzistencën, të promovojë vlerat e saj dhe të bashkëveprojë e unifikuar drejt zhvillimit dhe të mirave të përgjithshme.

Etika e ruajtjes së trashëgimisë kulturore materiale. Mbi rrënjët etike të problemit

Çdo gjë që ekziston ka thelbin, natyrën dhe vendin e saj në raport me ekzistencat e tjera, sipas një rendi të caktuar. Për të bashkëvepruar në mënyrë të drejtë dhe përdorur 54. Mizstal, po aty, f. 13.

rolin dhe aftësitë e tij në mënyrë të virtytshme, njeriu duhet të orientojë jetën dhe udhëzojë veten e tij sipas një etike të caktuar. Kështu njohja e vetes, rolit të tij në ekzistencë dhe raportit që ka me trashëgiminë kulturore materiale është hapi themelor që i mundëson njeriut të silllet në mënyrë të drejtë me të.

Trashëgimia kulturore materiale është pjesë e natyrës dhe ambientit që e rrethon njeriun. Ajo është një dimension tjetër i jetës së njeriut që formohet si pasojë e një marrëdhënie të gjatë dhe bashkëveprimit të tij me natyrën. Si pasojë e këtij bashkëveprimi dhe raportit që këto dy ekzistenca kanë me njeriun, ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale mund ta trajtojmë nën këndvështrimin e disa koncepteve dhe parimeve që trajtohet ruajtjen e natyrës.

Njeriu gjatë gjithë historisë, ka pasur një marrëdhënie komplekse me natyrën dhe trashëgiminë kulturore. Kushte të caktuara kulturore e social-politike kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në shkatërrimin e trashëgimisë kulturore natyrore dhe materiale që ka ndodhur masivisht gjatë historisë. Në kohët moderne, krahas këtyre faktorëve, zhvillimi material i shkëputur nga etika dhe “sundimi i së resë mbi të vjetrën” janë faktorë të rëndësishëm që kanë ndikuar në dëmtimin e shkatërrimin kësaj trashëgimie dhe humbjen e kuptimit dhe vendit të saj në

perceptimin tonë mbi jetën. Për ta kuptuar këtë çështje, duhet të zbresim në themelet e problemit, për të kuptuar filozofinë dhe etikën që ka lejuar zhvillimin e tij. Sejjid Nakib el-Attas thotë se në themel të këtij problemi qëndron humbja e *edebit*⁵⁵ dhe rrjedhimisht e disiplinës së marrëdhënieve midis njeriut dhe ekzistencave të tjera. Në rastin konkret kjo lidhet me zhveshjen e natyrës nga barra religjioze dhe ekzistencës së saj hyjnore që i lejojnë njeriut përdorimin e saj për përfitime vetjake.⁵⁶ Gjithashtu Seyyid Husseyn Nasr thekson se një problem i tillë lidhet me shekullarizimin e natyrës, shkencave që e studiojnë atë dhe absolutizimin e nevojave dhe të drejtave të njeriut.⁵⁷

Kështu metoda e bashkëveprimit të njeriut me natyrën dhe trashëgiminë kulturore duhet të përcaktohet në bazë të qëllimit të ekzistencës dhe konceptin në lidhje me njeriun dhe jetën e tij dhe marrëdhënien e tij me qeniet e tjera. Njohja dhe përcaktimi

55. Sipas el-Attasit ‘edebi’ është reflektimi i urtësisë që buron nga njohja transcendentale. Urtësia është njohja që i mundëson njeriut vënien e çdo gjëje në ekzistencë në vendin e saj. Kështu me vendosjen e edebit në marrëdhënien midis qenieve të caktuara në krijim veprimi i njeriut prodhon drejtësinë si virtyti më i lartë.

56. Nakib el Attas, Sejjid Muhamed “Islami dhe shekullarizmi”, Logos-A, Shkup 2006, f. 135.

57. Nasr, Seyyed Hossein “Man and Nature: The Spiritual Crisis in Modern Man”, Mandala paperbacks 1990, f. 6.

i shkencës në bazë të së cilës do të zhvillohet lidhja e njeriut me to është një burim themelor që duhet përdorur për arritjen e qëllimeve të synuara. Sipas S. H. Nasr-it ringjallja e metafizikës me bazë shpalljen hyjnore dhe integrimi i parimeve transcendentale në ri-përkufizimin e shkencave është një hap themelor për të arritur harmoninë midis njeriut dhe natyrës.⁵⁸ Në këtë mënyrë njeriu, duke përcaktuar rolin e tij në krijim, gjen harmoninë me vetveten dhe qeniet e tjera, si dhe siguron mjetet për arritjen e përsosmërisë morale.

Përgjegjësia e njeriut si mëkëmbës i Zotit

Trashëgimia kulturore materiale është pasuri e cila formohet si pasojë e bashkëveprimit të njerëzve, shoqërisë dhe natyrës për një kohë relativisht të gjatë. Ajo ka një marrëdhënie të ngushtë me njeriun dhe shoqërinë në mënyra, kohë dhe vende të ndryshme. Kjo lidhje midis njeriut dhe kësaj trashëgimie mund të analizohet me anë të rolit të njeriut si “halife” (mëkëmbës i Zotit) në tokë. Kjo çështje shpjegohet kështu në Kur’anin Famëlartë:

“Dhe kur u tha Zoti yt engjëjve: ‘Unë në tokë po caktoj një mëkëmbës!’ Ata i thanë: - A po bën aty dikë që do të bëjë turbullira e gjakderdhje, kurse ne Ty të madhërojmë e të lavdërojmë dhe të lartësojmë? Unë di – tha Ai

58. Nasr, po aty, f. 119.

– atë çka ju nuk e dini.”⁵⁹

Fjala “halife” vjen nga rrënja ha-le-fe që do të thotë të ardhurit më pas. Kjo fjalë ka kuptimin e mëkëmbësit dhe atij që zëvendëson dhe pason të parët. Në Kur’anin Famëlartë përdoret në disa kuptime por në rastin konkret flitet për rolin e njeriut në univers si drejtues, i cili, me anë të virtyteve dhe fuqive intelektuale, do të ndërtojë qytetërimin në përputhje me parimet hyjnore.⁶⁰

Për ta kuptuar më mirë këtë koncept duhet ta shikojmë në marrëdhënien dhe bashkekzistencën e njeriut me qeniet e tjera. Ndër nivelet e krijimit në këtë botë, njeriu është qenia më e lartë e krijuar. Ai është qenia me aftësinë për t’i reflektuar të gjithë emrat e Zotit. Kështu duke iu nënshtruar Zotit njeriu arrin të përfaqësojë rolin e Tij në tokë. Çdo gjë në natyrë përfaqëson cilësi të Zotit dhe është shenjë e Tij për njeriun. Kështu qëllimi i krijesave në univers është t’i shërbejnë njeriut që është qenia më e lartë në qëllimin e tij që është njohja e Zotit.⁶¹

Allahu i Madhëruar thotë në Kur’anin famëlartë:

“Ne u kemi ofruar amanetin qiejve, Tokës dhe maleve, ato ngurruan ta bartin atë dhe u frikësuan ta pranojnë atë, por,

59. Kur’ani, Bekare 2:30.

60. Ünal, po aty, f. 570-575.

61. Beka, Rezart “Halifullah: njeriu si mëkëmbës”, Erasmus 2007, f. 35-41.

njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu është zullumqar (për vete) dhe i padijshtëm.”⁶²

Duke iu referuar këtij ajeti mund të thuhet se njeriut si mëkëmbës dhe qenia më e lartë në tokë, i është dhënë besimi i sundimit, emane (amaneti), të sundojë sipas vullnetit dhe dëshirës së Zotit. Vetëdijesimi i njeriut për këtë përgjegjësi që i është ngarkuar për të jetuar në mënyrë të virtytshme dhe realizuar idealin e vetvetes mundëson përmbushjen e vullnetit të Zotit nëpërmjet veprave të njeriut, të kryera me vullnetin e tij të lirë.⁶³

Ndërsa njeriu është sundues në raport me qeniet e tjera, duhet kuptuar që në zanafillë ekzistenca e çdo gjëje, përfshirë edhe vetë njeriun, është e mundshme dhe është pronë dhe pasuri e Zotit. Në lidhje me këtë çështje Allahu i Madhëruar thotë:

“Vetëm të Allahut janë ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë. Allahu ka përfshirë çdo send.”⁶⁴

Zoti është realiteti i vetëm dhe çdo gjë e krijuar është reflektim i cilësive të Tij. Në anën tjetër, duke iu

62. Kur’ani, Ahzab 33:72.

63. Vullneti hyjnor në krijim përmbushet me anë të ligjeve natyrore dhe atyre morale. Me anë të ligjeve natyrore vullneti hyjnor përmbushet në mënyrë të detyrueshme të krijesat në bazë të disa ligjeve dhe një harmonie të caktuar. Ndërsa me anë të ligjeve morale përmbushet nëpërmjet njeriut i cili ka vullnetin e lirë për të vepruar. Shiko: Beka, po aty, 53-55.

64. Kur’ani, Nisa’ 4:26

referuar konceptit të kohës, nëse në këtë botë ajo konceptohet si lineare dhe ndahet në të shkuar, të tashme dhe të ardhme, në thelb koha reale shpalos në formë të vazhdueshme veprat e Zotit⁶⁵ Kështu, çdo gjë në krijim apo çdo gjë që prodhohet nga marrëdhënie e njeriut me të, i përket Zotit dhe është pasuri e Tij e cila i është dhuruar qenies së njeriut dhe rrjedhimisht të gjithë njerëzimit në këtë botë për t'u kujdesur dhe menaxhuar. Çdo njeri apo shoqëri që jeton në një kohë dhe vend të caktuar ka vetëm detyrën e përkujdesjes ndaj tyre. Njeriu si mëkëmbës është përgjegjës për të ruajtur qëndrueshmërinë dhe balancën⁶⁶ dhe t'i shmanget çdo veprë që promovon shkatërrimin.⁶⁷ Kështu ai duhet të ruajë trashëgiminë kulturore materiale, si një kontribut i dhënë nga njerëzimi në të shkuarën dhe ta përcjellë atë, duke e përmirësuar dhe zhvilluar atë për brezat që do të vijnë në të ardhmen.

Në marrëdhënien e tij me Zotin si Krijues njeriu është “abd”, rob i Tij; ai përpiqet që me çdo

vepër dhe adhurim të arrijë qëllimin e krijimit, njohjen e Zotit e për rrjedhojë lumturinë e përjetshme. Lloji dhe natyra e këtyre adhurimeve përcaktohet në bazë të kontekstit dhe përgjegjësive që njeriu ka në një shoqëri. Kështu roli i dijetarit është të edukojë, roli i drejtuesit të vendosë drejtësi, etj.⁶⁸ Në rastin konkret mund të thuhet se ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale është një adhurim dhe një përgjegjësi me natyrë eskatologjike për njeriun.⁶⁹ Ajo lidhet ngushtë me rrugëtimin e njeriut drejt përvetësimit të virtyteve, me llogaridhënien e njeriut në botën tjetër dhe arritjen e lumturisë së përjetshme. Ndërsa çdo individ mban përgjegjësi në raport me rolin që ai ka në një shoqëri, ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale, mbi të gjitha, është një përgjegjësi morale e shoqërisë si një ekzistencë që mundëson bashkëveprimin e individëve për të kontribuar në të mirën e përbashkët.

Çdo gjë që ekziston ka një kuptim dhe rol të rëndësishëm që njeriu të arrijë qëllimet e larta transcendentale. Allahu i Madhëruar thotë:

“Dhe ia mësoi Ademit emërtimet e të gjitha sendeve e

65. Mir, Mustansir “Ikbali: Nje jeteshkrim intelektual” Logos-A, Shkup 2009; f. 154.

66. Haque, Munawar “Ethics and fiqh for everyday life: an Islamic perspective”, IIUM press, 2010, f. 136-137.

67. “Dhe me atë që të ka dhënë Allahu, kërko (ta fitosh) botën tjetër, e mos lë mangët atë që të takon nga kjo botë, dhe bëj mirë ashtu siç të ka bërë Allahu ty, e mos bëj të këqija në tokë, se Allahu nuk i do çrregulluesit”. Shiko: Kur’ani, Kasas 28:77.

68. Shah Haneef, Sayed Sikandar “Principles of Environmental Law in Islam”, Arab Law Quarterly, V. 17, Nr. 3 (2002), f.6-7.

69. Robinson, Simon “The Spirituality of Responsibility: Fethullah Gulen and Islamic Thought”, Bloomsbury Publishing 2017, f. 89.

pastaj ua prezantoi engjëjve dhe u tha: ‘Më informoni për emrat e tyre, nëse flisni të vërtetën!’⁷⁰

Universi është libri kozmik i shenjave që përfaqësojnë Emrat e Zotit. Kështu njohja e tyre çon në njohjen e cilësive të Zotit, e cila në këtë ajet lidhet me njohjen e sendeve në thelb dhe cilësitë e Zotit që ato përfaqësojnë. Njeriu si qenia më e lartë dhe mëkëmbës i Zotit ka potencialin për të zbuluar misteret në natyrë, ligjet që karakterizojnë marrëdhëniet e tyre me qeniet e tjera dhe të kontribuojë duke i përdorur ato për qëllimin për të cilin janë krijuar. Kështu ai do të arrijë të reflektojë në dimensionin e tij njerëzor cilësitë e Zotit dhe të përfaqësojë rolin e tij si mëkëmbës. Në këtë kontekst mund të thuhet se përgjegjësia e njeriut për t’u kujdesur ndaj natyrës dhe trashëgimisë kulturore materiale është gjithashtu me natyrë teleologjike. Ajo shpalos Shenjat e Zotit dhe ligjet e Tij në historinë e njerëzimit. Ruajtja dhe njohja e tyre përbën një hap të rëndësishëm për ta orientuar njeriun në kuptimin e realitetit të gjërave me qëllim njohjen e Zotit.⁷¹

Njeriu si mëkëmbës i Zotit në tokë ka përgjegjësinë të veprojë në përputhje me vullnetin hyjnor, sipas një etike, duke i dhënë të drejtën e saj çdo gjëje në mënyrë që të arrijë të ruajë rendin dhe harmoninë në

ekzistencë. Kështu trashëgimia natyrore apo kulturore nuk mund të konsiderohet e paprekshme dhe e mbyllur ndaj zhvillimit. Njeriu në bazë të parimeve hyjnore dhe qëllimeve të amshueshme mund ta përdorë atë për qëllime pozitive⁷² për të plotësuar nevojat e tij më të larta. Kështu, në këndvështrimin islam ndërsa njeriu nuk duhet të dominohet nga natyra, sjellja e tij kundrejt saj duhet të balancohet në harmoni me natyrshmërinë dhe rolin e saj në krijim dhe jo vetëm sipas përfitimeve të tij. Në rastin e trashëgimisë kulturore materiale “ndërtimi i të resë mbi të vjetrën”, ku ndërtimi i jetës së shoqërisë sipas një botëkuptimi të caktuar bëhet në mënyrë të natyrshme, duke respektuar përvojën, kulturën dhe identitetin e saj, është një parim i rëndësishëm për zhvillimin kulturor dhe rrugëtimin e saj drejt një shoqërie të virtytshme.

Përfundime

Si përfundim, mund të thuhet se trashëgimia kulturore materiale është një ekzistencë dhe dimension i rëndësishëm i shoqërisë njerëzore. Qenësia e saj në jetën e një shoqërie përbën një burim përsiatje dhe reflektimi mbi të shkuarën dhe rrjedhimisht mbi qenien e njeriut në procesin e vetë-njohjes dhe përvetësimit të virtyteve të larta dhe

70. Kur’ani, Bekare 2:31.

71. Robinson, po aty, f. 90.

72. Robinson, po aty, f. 90.

krijimit të një shoqërie të virtytshme.

Trashëgimia kulturore materiale është një dimension i shumëllojshmërisë kulturore, e cila shpalos ligjet e krijimit të Zotit në tokë dhe është një aspekt i rëndësishëm i shoqërisë njerëzore. Në ditët e sotme ruajtja dhe respekti ndaj saj, përbën një çështje me rëndësi që ndërton ura komunikimi midis shoqërive dhe mundëson njohjen, marrëdhënien e ndërsjellë dhe bashkëjetesën e tyre, duke ruajtur paqen dhe ndërtuar një jetë akoma më të virtytshme në këtë botë.

Sfidat dhe problemet e ndryshme të botës moderne; ndër to edhe pasojat negative të globalizmit kanë sjellë edhe njëherë në vëmendje nevojën për të njohur dhe ruajtur identitetin kulturor si një përvojë unike e çdo shoqërie. Trashëgimia kulturore materiale përbën një nga format më të rëndësishme të shprehjes së këtij identiteti. Gjithashtu ajo është një ekzistencë

që shpreh më së miri kujtesën kolektive, e cila përbën një dinamikë themelore për të siguruar mbijetesën dhe elementët e nevojshëm që orientojnë një shoqëri në rrugëtimin e emancipimit në sfidat e saj drejt qytetërimit.

Rrugëtimi shpirtëror i njeriut në bazë të një botëkuptimi të caktuar për jetën, përcakton horizontin e veprimtarisë së tij në raport me veten dhe ekzistencat e tjera. Në këtë kontekst, koncepti i përgjegjësisë për njeriun, si mëkëmbës i Zotit në tokë, përbën një parim të rëndësishëm që e orienton njeriun të ruajë balancën ndërmjet ekzistencave të ndryshme në natyrë. Kështu ruajtja e trashëgimisë kulturore materiale është një detyrë morale dhe fetare me anë të së cilës njeriu përpiqet të ndërtojë një botë më të bukur; ku ka një rend dhe harmoni ndërmjet të gjithë ekzistencave, me qëllim që të arrijë kënaqësinë e Zotit dhe lumturinë e përjetshme.

Bibliografia

- Nahi, Hasan “Kur’ani i Madhërishëm”, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë 2006.
- Bullaç, Ali “Historia, shoqëria dhe tradita”, Logos-A, Shkup 2003.
- Pajaziti, Ali “Fjalor i sociologjisë”, Logos-A, Shkup 2017.
- Xhurxhani, Ail bin Muhamed “Muxhem et-tearifat”, Darul Fadilah 2004.
- Ünal, Ali “Kur’anda temel kavramlar”, Beyan yayınları, 1986.
- Ramadan, Tariq “Radical Reform: Islamic Ethics and Liberation”, Oxford University Press; 1st Edition (November 17, 2008).
- Ozakpënar , Jëllmaz “Kultura dhe qytetërimi”, Logos-A, Shkup 2003.
- Freyer, Hans “Sociologjia e fesë”, Logos-A, Shkup 2015.
- Mahdi, Muhsin “Ibn Khaldûn’s philosophy of history: A study in the philosophic foundation of the Science of culture”, Routledge; June 2017.
- Gulubovic, Zagoricka “Unë dhe tjetri: Shqyrtime antropologjike rreth identitetit individual dhe kolektiv”, Logos-A, Shkup 2019.
- Şimşirgil, Ahmet Ekrem;Ekinci, Buğra “ Ahmet Cedet Pasa ve Mecelle”, KTB yayınları, Istanbul 2008.
- Graham, Briam; Howard Peter, “The Ashgate Research Companion to Heritage and Identity”, Ashgate Publishing Ltd 2012.
- Nasr, Sejjid Husein “Islami në botën moderne: I sfiduar nga Perëndimi, i kërcënuar nga fundamentalizmi, besnik ndaj traditës”, Logos-A 2017.
- Okten, Sadettin “Coca-cola në filxhanin tim”, Logos-A Shkup-2015.
- Kutub, Sejjid “Fi dhilalil Kur’an”, V.6, Daru Shuruk, Kajro 1968.
- Ramadan, Tariq “The quest for meaning: developing a philosophy of pluralism”, Penguin UK 2012.
- Beka, Rezart “Halifullah: njeriu si mëkëmbës”, Erasmus 2007.
- Robinson, Simon “The Spirituality of Responsibility: Fethullah Gulen and Islamic Thought”, Bloomsbury Publishing 2017.
- Nasr, Seyyed Hossein “Man and Nature: The Spiritual Crisis in Modern Man”, Mandala paperbacks 1990.
- Nakib el Attas, Sejjid Muhamed “Islami dhe shekullarizmi”, Logos-A, Shkup 2006.
- Haque, Munawar “Ethics and fiqh for everyday life: an Islamic perspective”, IIUM press, 2010.
- Mir, Mustansir “Ikbali: Nje jetëshkrim intelektual”, Logos-A, Shkup 2009.
- Cebeci, Suat “Milli Kimlik Bağlamında Din - Kültür İlişkisi”, Akademik İncelemeler Dergisi, Year 2008, Volume 3 , Issue 2, f. 1-11.
- Eyüpoğlu , Osman; Okuyan, Mehmet “Kur’an’ın Sosyo-Kültürel Koşulları Dikkate Alışı: Ma’rûf Kavramı Örneği”, Ondokuz Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi Dergisi, Yıl 2008, Cilt 26 , Sayı 26-27, s. 175 – 213.
- Şulul, Kasim “İslam düşüncesinde tarih felsefes”. Dîvân: İlmî Araştırmalar, 2001.
- Mizstal, Barbara “Durkheim on collective memory” Journal of Classical Sociology, 2003.
- Geçit, Bekir “İbn Haldun’da Siyasal Gücün Kullanılmasında ‘Asabiyet’in Önemi”, Beytulhikme an international journal of philosophy, V.8(2), 2018.
- Hasanov, Behram “İbn haldun’da asabiyet kavramı – Maurice Halbwachs’in ‘kolektif

- hafıza' kavramı ile bir karşılaştırma", Elektronik sosyal bilimler dergisi, V:15 Nr.59, 2016.
- Hasanov, Behram "İbn Haldun'un Asabiyet Kavramında 'Kolektif Hafıza' Boyutu", Bakü Devlet Üniversitesi İlahiyat Fakültesi'nin İlmî Mecmuası, 2014, Nr: 21, f. 199-210.
 - Shah Haneef , Sayed Sikandar "Principles of Environmental Law in Islam", Arab Law Quarterly, V. 17, Nr. 3 (2002), f. 241-254.
 - <https://plato.stanford.edu/entries/ethics-cultural-heritage/>
 - Alshehaby, Fatimah. (2020). Cultural Heritage Protection in Islamic Tradition. *International Journal of Cultural Property*, 27(3), 291-322.
 - Sinani, Gjergj. "Filozofia e historisë", Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 1999.
 - Berisha, Drilona. "Kujtesa kolektive nëpërmjet arkitekturës në qytetin e Prishtinës." (2021).
 - Kruja, Genti, "Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar", Prizmi, Tiranë 2008.

Jeta e Ebu Mensur El-Maturidiut dhe konteksti socio-politik dhe teologjik në Azinë Qendrore në shekullin X

Dr. Aref Chaker

Abstrakt

Ebu Mensur El-Maturidiu është një nga teologët më me influencë në botën islame. Ai u shfaq në shekullin e dhjetë në Azinë Qendrore dhe themeloi shkollën e tij teologjike, el-Maturidijje; një shkollë që luajti dhe vazhdon të luajë një rol qendror në formimin e lëvizjes teologjike sintetike sunite në botën myslimane. Duke parë studimet e deritanishme që janë marr me Maturidiun ato nuk e kanë shqyrtuar dhe analizuar ndikimin e kontekstit socio-politik dhe teologjik të Azinë Qendrore mbi Maturidiun. Ky punim fokusohet në studimin e këtij aspekti të anashkaluar në teologjinë sunite. Ai vlerëson ekzistencën e çdo ndikimi të faktorëve socialë, politikë, kulturorë dhe fetarë në veprat e Maturidiut dhe identitetin e tij akademik. Ai shqyrton natyrën e këtyre ndikimeve, pozitive apo negative, duke ndërmarrë një analizë cilësore të përmbajtjes së të gjithë literaturës biografike, historike dhe gjeografike të rëndësishme për Maturidiun dhe Azinë Qendrore. Studimi zbuloi ndikimin e fortë që këta faktorë kishin tek ai. Këto ndikime ishin të gjitha pozitive në shumë prej shkrimeve të tij. Më e rëndësishmja, këta faktorë ndihmuan në formësimin e paradigmes teologjike sintetike që Maturidiu adaptoi në pjesën më të madhe të punimeve të tij.

Ebu Mensur El-Maturidiu (vd. 944 e.s.) ishte një dijetar i dalluar në shekullin X. Shumë myslimanë dhe jomyslimanë e kanë konsideruar atë si një nga baballarët e teologjisë sintetike sunite. Ky

vlerësim nuk është befasi që kur Maturidiu themeloi një nga dy shkollat kryesore të teologjisë në Islam: el-Maturidijje/maturidizmi, një institucion teologjik i nderuar, i cili është ndjekur dhe vazhdon të përqafohet dhe respektohet nga

miliarda myslimanë gjatë shekujve anembanë globit. Tash Kubra ka shkruar: "...duhet ditur se liderët e myslimanëve sunitë në teologji, janë dy; njëri prej tyre është Hanefi dhe i dyti është shafi'i. Ai Hanefi është Ebu Mensur El-Maturidi..."¹ Megjithatë, përkundër faktit se ai është një nga teologët e epokës, shkalla e përqendrimit në jetën dhe kontekstin e ngritjes së tij, në literaturën biografike dhe akademike, është aq modeste sa Bedeui e klasifikon atë si "të papërshtatshme dhe të padrejtë për kalibrin e tij".² Biografët që shkruan për të, si El-Lukneui, Es-Sam'ani, El-Kureshi, Ibn Kutlubugha, Tash Kubra, El-Bejadi, Ez-Zebidi, Ebu 'l-Mu'in En-Nesefi dhe El-Kefeui, ofrojnë skica të shkurtra të jetës së Maturidiut, dhe aq më pak mbi kontekstin socio-politik dhe teologjik të rajonit të tij, dhe ndikimin e tij në themelin e tij akademik.³ Rudolph e dëshmon këtë dhe pohon:

... pasi Maturidiu u bë i famshëm, biografët e tij ishin dukshëm në një situatë të vështirë për të gjetur

1. A. Tash Kubra Zadah, *Miftahu s-Se'adeh ue Mısbabu s-Sijadeh*, vëll. 2 (Bejrut: Dar l-Kutub el-'Ilmijeh, 1985), 151.

2. A. Bedeui, *Et-Turath el-Junani fi el-badareh el-Islamijeh* [The Greek Heritage in the Islamic Civilisation] (Kajro, Egypt: Mektebet l-Nahda, 1940).

3. Për shkak të limiteve të punimit nuk mund të sjellim pjesë nga këta biografë që kanë trajtuar aspektet e jetës së Maturidiut.

ndonjë raport të rëndësishëm për të... Kështu, burimet përkatëse nuk lexohen si biografi, por më tepër si lista të veprave që janë zgjeruar me deklaratat të shkurtra mbi personazhin e tij, dhe disa fjalë lavdërimi.⁴

Kjo pririje vazhdoi edhe në literaturën perëndimore, si Pessagno⁵, Rahman⁶, Tritton⁷, Nasir⁸ dhe Bruckmayr⁹, ndër të tjerë. Secili studiues studioi aspekte të veçanta të teologjisë së Maturidiut, por nuk u bë asnjë përpjekje për të shqyrtuar ose studiuar ndikimin e kontekstit të tij. Ceric i kushton një kapitull në tezën e tij studimit të jetës dhe veprave

4. Ulrich Rudolph and Rodrigo Adem, *Al-Maturidi and the Development of Sunni Theology in Samarqand*, (Leiden, NL: Brill: 2015), <http://site.ebrary.com/id/10992600>. 125.

5. J. Meric Pessagno, "The Uses of Evil in Maturidian Thought," *Studia Islamica* 60 (1984).

6. F. Rahman, *Islam and Modernity: Transformation of an Intellectual Tradition* (Chicago: The Chicago University Press, 1982).

7. A. S. Tritton, "An Early Work from the School of Al-Maturidi," *The Journal of the Royal Asiatic Society of Great Britain and Ireland* 3/4 (1966).

8. Sahilun, A. Nasir, "The Epistemology of Kalam of Abu Mansur Al-Maturidi," *Journal of Islamic Studies* 43, no. 2 (2005), <http://dx.doi.org/10.14421/ajis.2005.432.349-365>.

9. Philipp Bruckmayr, "The Spread and Persistence of Maturidi Kalam and Underlying Dynamics," *Iran and the Caucasus* 13, no. 1 (2009).

të Maturidiut.¹⁰ Puna e tij paraqet një përpjekje të lavdërueshme, por joadekuate, për sa i përket kontekstit të jetës së tij. Së pari, ai fokusohet në studimin e gjerë të vetëm njëres prej veprave të Maturidiut, *Kitabu't-Teuhid-it*, e kuptueshme pasi ajo është shtylla kurrizore e tezës së tij. Së dyti, i mungon një kritikë dhe analizë e plotë e të gjitha aspekteve biografike të jetës së tij; dhe së treti, nuk përpiqet të studiojë ndikimin e kontekstit mbi të, përveç një përmendjeje të shkurtër përshkruese të mbretërimit të samanidëve në rajon. Puna e Rudolfit ofron një analizë të lavdërueshme dhe kritike të jetës së Maturidiut. Megjithatë, qëllimi i punës së tij, së pari, përfshin të gjithë lëvizjen Hanefite në rajon, e cila, në mënyrë të pashmangshme, shkakton një humbje të përqendrimit në ndikimin e faktorëve rajonalë që ndikuan personalisht Maturidiun. Së dyti, ai mbështetet kryesisht në analizën e termave dhe përmbajtjes së traditave akademike të dijetarëve Hanefi për të nxjerrë mendimet e tij. Kështu, ai shpërfill shumë burime të tjera që kanë lidhje me të, duke përfshirë vepra të tjera të Maturidiut dhe tradita biografike, historike dhe gjeografike që lidhen me rajonin. A ka jetuar, studiuar dhe hulumtuar

Maturidiu në një mjedis miqësor akademik dhe fetar, apo ka krijuar rrugën e tij në kundërshtim me rrymën e përgjithshme të shoqërisë së tij? Në çfarë rrethanash politike dhe ekonomike ai mori njohuri, dha mësim dhe shkroi? A kishin rrethanat e tij ndonjë ndikim, pozitiv apo negativ, në motivimet dhe arritjet e tij akademike? Cila ishte gjendja intelektuale e shoqërisë dhe si ndikoi në mendimin dhe motivimet e tij? Ky artikull përpiqet të plotësojë një boshllëk serioz në literaturën akademike rreth Maturidiut. Ai shqyrton ndikimin e faktorëve shoqërorë, politikë, kulturorë, personalë dhe fetarë në motivimet, perceptimet dhe objektivat e tij, ndërkohë që rishikon dhe analizon në mënyrë kritike disa nga informacionet biografike që mund të gjenden rreth tij. Kjo realizohet nëpërmjet një analize kritike të literaturës historike dhe gjeografike dhe një ristudimi të literaturës tradicionale biografike që lidhet me Maturidiun dhe rajonin e tij, për të hedhur më shumë dritë mbi kontekstin e saj dhe ndikimin e tij që ajo pati mbi të.

JETA E HERSHME E MATURIDIUT

Maturidi është një njeri, të cilin, emërtimet dhe epitetet, e lënë në hije emrin e tij, një praktikë mjaft e zakonshme në literaturën islame.

10. M. Cerić, *Roots of Synthetic Theology in Islam: A Study of the Theology of Abu Mansur Al-Maturidi* (Kuala Lumpur: International Institute of Islamic Thought and Civilization, 1995).

Pseudonimet dhe titujt shërbejnë si shenja dalluese për njerëzit që kishin emra shumë të zakonshëm. Emri i plotë i Maturidiut ishte Muhamed, biri i Muhamedit, bir i Mahmudit.¹¹ Megjithatë, ai njihet gjerësisht me *kunjen*¹² Ebu Mensur dhe pseudonimin e tij El-Maturidi, që do të thotë “nga qyteti i Maturidit”, duke iu referuar vendlindjes së tij.¹³

Maturidiu u rrit në Azinë Qendrore. Ky rajon njihet në literaturën klasike arabe si *bilad ma*

11. Zebidi në librin e tij *Ithaf s-Sadeh*, këshillon që disa nga burimet akademike që ai lexoi për Maturidiun tregojnë se emri i stërgjyshit të tij të parë ishte gjithashtu Muhamed. Kështu, sipas Zebidit, emri i plotë i Maturidiut është Muhamed, biri i Muhamedit, biri i Muhamedit, birin të Mahmudit, duke i shtuar një emër tjetër familjes së tij. Për më shumë informacion, shih M. Zebidi, *Ithaf s-sadeh l-Mutekkin bi sberbi Ihja'i Ulumid-din*. (Bejrut: Dar el-Kutub el-Ilmijeh, 2002).

12. *Kunje* është një “emër prindi në emrat arabë, emri i një të rrituri që rrjedh nga fëmija i tij/saj i madh... Si rrjedhojë, ai mund të ketë gjithashtu referenca hipotetike ose metaforike, p.sh. një emër lufte ose një pseudonim, pa iu referuar fjalë për fjalë një djali ose një vajze.” Pedzaisi Mashiri, “Terms of Address in Shona: A Sociolinguistic Approach,” *Zambezia*, 26 (1999).

13. Maturidiu ishte i njohur për një numër historianësh të famshëm myslimanë, si Sam’ani, Jakut dhe Ibn El-Ethir. Sam’ani e përshkruan atë si një qytet “nga i cili janë shfaqur një numër dijetarësh të virtytshëm”. Për më shumë informacion, shihni A. El-Sam’ani, *El-Ensab*, vol. 12 (Bejrut: Dar el-Fikr), <http://shamela.ws/browse.php/book-12317/page-763>, 3.

uera’ en-nehr (tokat përtej lumit), duke iu referuar një lumi të referuar në arabisht si Xhejhun, i cili është i famshëm në antikitetin klasik si lumi Oxus.¹⁴ Ashtu siç shpjegon Hugh Kennedy, “këto tokakonsideroheshin si pjesë e Khurasanit¹⁵, provincës së gjerë që përfshinte gjithashtu Iranin Verilindor,”¹⁶ e cila kishte një rëndësi të madhe strategjike, politike dhe ekonomike. Natyra e pasur dhe bujare e rajonit lehtësoi ndërtimin e qyteteve me rëndësi politike, kulturore dhe ekonomike. Në të njëjtën kohë, ajo tërhoqi vëmendjen e ekspeditave myslimane që po zgjeroheshin në Azinë Qendrore.

Për më tepër, vendndodhja gjeografike e këtij rajoni i lejoi banorët e tij të kishin marrëdhënie të forta me shumë qytetërime përreth, si bizantin, sasanid dhe ai kinez.¹⁷

14. Sot ky lumë njihet si Amu Darja ose Lumi Amu. Për më shumë të dhëna shih Percy Sykes, *Persia* (Oxford: Clarendon Press, 1922); William C. Brice, *An Historical Atlas of Islam* (Leiden: E.J. Brill, 1981).

15. Khurasan është një term i përdorur “në kohët para-islame dhe të hershme islame, termi ‘Khurasan’ shpesh kishte një kuptim shumë më të gjerë, duke mbuluar gjithashtu pjesë të Azisë Qendrore dhe Afganistanit”. Për më shumë shih “Khurasan,” në *The Encyclopaedia of Islam*, ed. C.E. Bosworth, E. van Donzel, W. P. Heinrichs and G. Lecomte (Leiden: Brill, 1997).

16. H. Kennedy, *The Great Arab Conquests* (Philadelphia: Da Capo Press, 2007), 238.

17. M. Shakir, *Et-Tarikh l-Islami*, 6th ed. (Bejrut: El-Mekteb l-Islami, 2000); A. Vambéry, *Tarikh Bukhara Mundbu l-Kidem Hatta l’Asr l-Hadir*, përkth. A. Sadati and

Kjo cilësi e favorshme e pasuroi rajonin me ekspozim ndaj kulturave dhe ideologjive të ndryshme. Ajo hapi derën për myslimanët që të ndërveprojnë me kulturat që nuk i kishin njohur në Gadishullin Arabik apo në Lindjen e Mesme. Kështu, vendndodhja gjeografike e Maturidiut e ekspozoi atë ndaj shumë qytetërimeve, kulturave, besimeve dhe traditave.

Dihet pak për familjen e Maturidiut. Studiuesit, biografët dhe hereziografët¹⁸ myslimanë dhe jomyslimanë kanë dhënë pak informacion për jetën e tij personale. Edhe prejardhja e tij etnike duket se është objekt debatesh dhe supozimesh mes biografëve dhe kronistëve. Zadeh (v. 1687 e.s.), një teolog mysliman Hanefi, Zebidi (v. 1790 e.s.), një gramatikan dhe historian shumë i shquar mysliman, dhe Aliu, një dijetar mysliman bashkëkohor, diskutuan për prejardhjen e Maturidiut dhe deklaruan se ai vjen nga një prejardhje arabe.¹⁹ Më

Y. Khashab (Kajro: Nahdat l-Shark, 1965); M. Narkhashi, *Tarikh Bukhara*, përkth. Nasrullah El Tarazi, 3rd ed., Dhakha'ri l-'Arab 40 (Kajro: Dar l-Ma'arif, 1956).

18. Personat që merren me studimin e herezisë dhe shkruajnë rreth kësaj fushe.

19. Zebidi, *Ithaf s-sadab l-Mutekkin bi sberhi Ihja'i 'Ulumi d-din*; Ahmad B. Zade, *Isbarat l-Meram min Ibarat l-Imam* (Bejrut: Dar l-Kutub l'Ilmijeh, 2007); M. Ejub 'Ali, *'Akidetu l-Islam ue l-Imam l-Maturidi* (Bangladesh: El-Mu'essesee l- Islamijeh, 1983).

saktësisht, ata argumentojnë se ai vjen nga pasardhësit e Ebu Ejub²⁰ El-Ensarit,²¹ një prej shokëve (sahabëve) të profetit Muhamed. Aliu konfirmon se pa referencën “*ensari*”, që do të thotë në arabisht “pasardhësit e ensarëve”, të shkruar në prejardhjen e Maturidiut në skajin e dorëshkrimit të librit të tij *Kitabu t-Teuhid* dhe është i bindur se ai është një nga pasardhësit e këtij sahabiu.²² Zadeh dhe Zebidi rendisin përshkrimin “*ensari*” në prejardhjen e Maturidiut, por nuk japin asnjë informacion për të mbështetur pretendimin e tyre.²³

Megjithatë, jo të gjithë biografët e mbështesin këtë mendim: Nasr dhe Mutahhari e përshkruajnë Maturidiun si një teolog mysliman

20. Ebu Ejub El-Ensari është Khalid bin Zejd nga fisi arab i khazrexhëve dhe nga familja e En-Nexhxhar, i cili është i afërt me Muhamedin a.s nga ana e nënës së tij. Kur Profeti a.s emigroi për në qytetin e Medinës ai e nderoi Ebu Ejubin duke qëndruar në shtëpinë e tij për disa muaj. Për më shumë të shikohet në M. Dhehebi, *Sijer A'lam en-Nubela*, 11th ed. (Bejrut: Resalah Publications, 1996).

21. El-Ensari rrjedh nga termi El-Ensari, i cili në terminologjinë islame është përdorur për të përshkruar “banorët e qytetit të Medinës nga fisi Eus dhe Khazrexh, të cilët pranuan Islamën dhe u zotuan të mbronin Muhamedin a.s. nga të gjitha rreziqet dhe e mirëpritën atë në qytetin e tyre.” Po aty.

22. M. Ejub 'Ali, *'Akidetu el-Islam uel-Imam el-Maturidi*, 262-63.

23. Zebidi, *Ithaf s-Sadab l-Mutekkin bi sberhi Ihja'i 'Ulumi d-din*; Zade, *Isbarat l-Meram Min Ibarat l-Imam*.

persian.²⁴ Në mënyrë të ngjashme, Fatima El-Khajmi, në komentin e saj mbi jetën e tij në hyrjen e librit të tij ekzegjetik “Te’uujlatu ehlu s-Sunneh”, aludon rreth kësaj mundësie duke iu referuar një libri që ai shkroi në persisht të titulluar *El-Feua’id*.²⁵ Ceric nuk e pranon as përsëkrimin “ensari” si të vërtetë absolute. Ai argumenton se ishte shtuar nga një palë e tretë në librin e Maturidiut dhe ai nuk e përfshiu atë personalisht.²⁶ Polemika rreth prejardhjes dhe origjinës etnike të Maturidiut bëhet e rëndësishme kur studiohen veprat e tij. Ceric kritikon rrjedhshmërinë e Maturidiut në arabisht dhe e përsëkruan stilin e tij të shkruarit në arabisht si “të vështirë, të paqartë dhe të vështirë për t’u ndjekur”.²⁷ Ai ia atribuon këtë dy faktorëve: faktit që arabishtja ishte gjuha e tij e dytë; dhe për shkak se “...ka shumë të ngjarë për faktin se ai ka menduar në turqisht ose persisht, por ka shkruar në arabisht...”²⁸ Nëse origjina arabe e Maturidiut mund të

konfirmohet, kjo kritikë do të bëhet e pabazë. Nëse jo, kjo mund të hapë derën për kërkime të mëtejshme në natyrën gjuhësore të veprave dhe stilit të shkruarit të tij.

Për sa i përket datës së lindjes së tij, asnjë nga historianët dhe biografët që shkruan për jetën e Maturidiut nuk jep datën e saktë. Ibrahimimi dhe Sejjid ‘Auadajn pohojnë, “Hulumtuesi i jetës së Maturidiut nuk do të jetë në gjendje të gjejë të regjistruar, datën e saktë të lindjes së tij...”²⁹ Si rezultat, disa studiues spekulojnë mbi datën e lindjes së tij dhe të tjerë përpiqen të nxjerrin përfundimin, atë nga faktorë të jashtëm. Një nga metodat e përdorura nga një numër dijetarësh, si Ibrahimimi dhe Sejjid ‘Auadajn dhe Aliu, ishte vlerësimi i datës së lindjes së tij përmes datave të vdekjes së mësuesve të tij. Ibrahimimi dhe Sejjid ‘Auadajni thonë: “Dhe sido që të jetë çështja, studiuesi(t) nuk mund t’i ikë studimit të biografive të mësuesve të tij për të vlerësuar periudhën e jetës së tij...”³⁰

Kjo metodë bëri që Ibrahimimi dhe Sejjidi të arrinin në përfundimin se Maturidiu kishte lindur para vitit 862 të erës sonë. Me fjalë të tjera, Maturidiu lindi gjatë sundimit të khalifit ‘abasid El-Muteuekkil, para lindjes së Ebu l-Hasan El-Esh’ariut (v. 936 e.s.), një nga teologët më

24. S. H. Nasr and M. Mutahhari, *The Cambridge History of Iran, the Period from the Arab Invasion to the Saljuqs*, vol. 4 (Cambridge: Cambridge University Press, 1975).

25. M. Maturidi, *Te’uujlat ehlu Sunneh*, vëll. 5 (Bejrut: Resalah Publishers, 2004).

26. Megjithatë, ky veprim nuk mund të jetë provë që mbështet ose përjashton korrektësinë e pretendimit. Është e mundur që ai që e vendosi ta këtë bërë këtë bazuar në provat që ata kanë që konfirmojnë prejardhjen e Maturidiut.

27. Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam*, 21-22.

28. Po aty.

29. M. Maturidi, *Te’uujlat ehlu Sunneh*, vëll. 1 (Kajro: El-Mexhlis l-A’la Li l-Shu’un l-Islamijeh, 1994), 11.

30. Po aty, 12.

të shquar myslimanë që themeloi shkollën sintetike të teologjisë esh'arite, për më pak se 25-27 vite.³¹ Ky është një zbulim domethënës për sa i përket evolucionit të teologjisë sintetike islame. Rahman pajtohet me zbritjen e tyre, por specifikon vitin 849 të erës sonë si datën e lindjes së Maturidiut, e cila është ende brenda mbretërimit të khalifit Muteuekkil.³² Në mënyrë të ngjashme, Aliu përafrohet se viti 852 e.s. është viti i lindjes së Maturidiut.³³ Aliu e dallon këtë datë nga datat e vdekjes së dy mësuesve kryesorë të tij: Razi vdiq në vitin 862 të erës sonë dhe Belkhi vdiq në 881 të e.s. Razi konsiderohet si një nga mësuesit kryesorë të Maturidiut dhe nuk është e mundur të supozohet se ai vdiq kur Maturidiu ishte më i ri se 10 vjeç, sepse Maturidiu nuk mund të kishte mësuar prej tij në një moshë të tillë.³⁴

Për sa i përket datës së vdekjes së tij, shumica e biografëve pajtohen se Maturidiu vdiq në vitin 944 të erës sonë dhe u varros në Samarkand.³⁵

31. Po aty.

32. Rahman, *Islam and Modernity*.

33. M. Ejub 'Ali, *Akidetu l-Islam ue l-Imam l-Maturidi*

34. Po aty.

35. Zada, *Isyarat el-Meram Min Ibarat el-Imam*; M. Khalifa, *Keshf edb-Dhunun 'an esami l-Kutub ue l-Funun* (Bejrut: Dar Ihja' el-Turath el 'Arabi, 1966); Ejub 'Ali, *Akidetu l-Islam ue l-Imam*; Maturidi, *Te'ujilat eblu Sunneb*; M. Ebu Zehra, *El-Akideb el-Islamijeb* (Kajro: Mexhma' el-Buhuth, 1969); M. El-Kureshi, *El-Xbenahir el-Mudi'ah fj tabakati el-Hanfijjeb* (Kajro: Haxhar, 1993); Ceric, *Roots*

Në radhë të parë, dallimi i opinioneve rreth datave të lindjes dhe vdekjes së Maturidiut mund të duket i parëndësishëm. Megjithatë, këto data janë vendimtare për të përcaktuar një sërë faktorësh të rëndësishëm, mes tyre periudha në të cilën ai jetoi, klima politike dhe akademike në të cilën u rrit, kalibri i studiuesve nga të cilët ai mori njohuri dhe zhvillimet akademike, polemikat e sfidat me të cilat ai, si dijetar në kohën e tij, u përball. Është gjithashtu e rëndësishme të përcaktohet nëse Maturidiu apo Esh'ariu ishte i pari që dha një bazë për teologjinë sintetike sunite.

Pavarësisht paqartësisë dhe mungesës së detajeve specifike për jetën e tij personale, informacioni në dispozicion rezulton konstruktiv. Është e qartë përmes deduksionit se Maturidiu jetoi gjatë sundimit të khalifit 'abasid Muteuekkil.³⁶ Kjo shënon një pikë qendrore në historinë e Islamit dhe evolucionin e disiplinave islame. Shumë historianë dhe biografë, si Ibn Ebi Ja'la (v. 1131 e.s.), një dijetar i famshëm mysliman Hanbelit, Ibn El-Ethir, Sujuti (v. 1505 e.s.), një dijetar i shquar mysliman dhe Uekil, një dijetar

of Synthetic Theology in Islam; Tash Kubra Zadeh, *Miftahu s-Se'adeh ue Misbabu s-Sijadeh; Tabakat el-Fukaha'*, 2nd ed. (Bejrut: Matba'at ez-Zehra' l-Haditha, 1961).

36. M Vekil, *El-'Asr edb-Dhebebi Li ed-Deule l-'Abasijjeb* (Damascus: Dar el-Kalam, 1998); Xh. Sujuti, *Tarikh el-Kbulafa'*, vëll. 1 (Bejrut: Dar el-Erkam Ibn el-Erkam).

musliman bashkëkohor, konfirmojnë se Muteuekkili është khalifi që i dha fund dominimit politik të mu'tezilitëve mbi qeverinë qendrore në Bagdad. Ai i dha fund gjyqit të "krijimit të Kur'anit" që u imponua në të gjithë botën islame, dhe e liroi Ahmed Ibn Hanbelin nga burgu dhe e nderoi atë.³⁷ Në të njëjtën kohë, kjo është epoka që dëshmoi fillimin e tradicionalistëve, të fushatës së tyre kundër-radikale ndaj mu'tezilitëve dhe shkaktoi migrimin e shumë prej këtyre të fundit në rajonin ku jetonte Maturidiu.

Një pasqyrë tjetër e vlefshme që dikush fiton nga datat është se Maturidiu ka lindur përafërsisht 25 vjet përpara lindjes së të njohurit Ebu l-Hasan El-Esh'ari, i cili themeloi shkollën e famshme teologjike sunite esh'ari.³⁸ Kjo më lejon të argumentoj se dijetari i parë që themeloi një shkollë teologjike sunite, debatoi dhe vendosi parimet e besimit sunit në një kornizë dialektike përballë mu'tezilitëve, filozofëve dhe lëvizjeve jomuslimane, në fakt ishte Maturidiu dhe jo Esh'ari.³⁹

37. A. Ibn el-Ethir, *El-Kamil fi t-Tarikh*, 1st ed., vol. 8 (Bejrut: Dar el- Kutub el-'Ilmijeh, 1987); Sujuti, *Tarikh el-Kbulafa'*; M. Ebu Ja'la, *Tabakat el-Hanabilah*, 2nd ed., 3 vëllime. (Rijad: Mektabat Melik Fahd el-Uatanijeh, 1999); Uekil, *El-'Asr edh-Dhebebi Li ed-Deule l-'Abasijeh*.

38. Maturidi, *Te'ujilat ehu Sunneh*.

39. Muteuekkili ishte gjithashtu khalifi i parë 'abasid që përqafoi shkollën e jurisprudencës shafi'i, e cila është shkolla

Përveç kësaj, viti i lindjes së Maturidiut është i rëndësishëm për të përcaktuar rolin e tij në evolucionin e disiplinës së ekzegjzës kur'anore. Data e lindjes së tij tregon se ai ishte një bashkëkohës i Taberiu, i cili është një nga ekzegjetët sunitë më të njohur. Taberiu lindi në vitin 838 të erës sonë dhe vdiq në vitin 922 të erës sonë.⁴⁰ Libri i tij, i titulluar *El-Bejan fi xhami' el-Kur'an*, është klasifikuar nga shumë studiues, si Katan, Dhehebi, Davudi, Sujuti, Adnauej, Bugha dhe të tjerë, si libri i parë gjithëpërfshirës i ekzegjzës kur'anore.⁴¹ Fakti që Maturidiu jetoi gjatë së njëjtës epokë me Taberiu tregon se ai jetoi gjatë një faze në zhvillim të ekzegjzës

e dytë më dominuese e jurisprudencës në botën sunite. Përveç kësaj, ai e nderonte pa masë Ahmed Ibn Hanbelin. Kjo mund të kishte kontribuar në anashkalimin e punës së Maturidiut pasi ai ishte larg qeverisë qendrore në Bagdad dhe ishte nga shkolla e jurisprudencës Hanefi.

40. Ibn Kethir, *El-Bidaje ue en-nibaje*, 2nd ed., 22 vëllime. (Damask: Dar Ibn Kethir, 2010); Dhehebi, *Sijer A'alam en-Nubela'*; J. Hamvi, *Irshad el-arib ila ma'rifet el-edib*, 1st ed., 7 vëllime. (Bejrut: Dar El-Gharb el-Islami, 1993).

41. M. Kattan, *Mebaiith fi 'Ulumi el-Kur'an* (Bejrut: Risalah Publishers, 1998); M. Davudi, *Tabakat el-Mufessirin*, 2 vëllime. (Bejrut: Dar el-Kutub el-'Ilmijeh, 1983); M. El-Bugha dhe M. Mistu, *El-Uadib fi 'Ulumi el-Kur'an* (Damask: El-Kelim et- Tajjib, 1998); M. Dhehebi, *Et-Tefsir ue l-Mufessirin*, vol. 2 (Kajro: 1976); Xh. Sujuti, *Tabakat el-Mufessirin* (Kuwait: Dar el- Neuadir, 2010); A. Adnauej, *Tabakat el-Mufessirin* (Medineh: Mektabat el-'Ulum ue l-Hikem, 1997).

kur'anore, e cila hap derën gjerësisht për të debatuar rreth natyrës së kontributeve të tij, vlerës së tyre dhe ndikimit të tij në disiplinën e ekzgjekës kur'anore, veçanërisht kur vërtetohet se ai ka shkruar një interpretim gjithëpërfshirës.

VEPRAT E MATURIDIUT

Përsosmëria e Maturidiut si teolog i lë në hije kontributet e tij të rëndësishme në disiplinën e tjera islame. Megjithatë, pasuria e veprës së tij tregon se ai kontribuoi në disiplinën kryesore themelore islame.

Një nga disiplinat themelore islame në të cilën shkroi Maturidiu është *Usulu el-fikh*. Khalifa, Tash Kubra, Lukneui, Baghdadi dhe Kutlubugha rendisin dy libra për Maturidiun në këtë disiplinë: *Kitabu l-Xhedel* (Libri i debatit) dhe *Ma'akbidhu l-Sheri'ah* (Metodologjitë e Sheriatit Islam).

'Ala'u ed-Din El-Bukhari (v. 1330 e.s.), një jurist i shquar Hanefi, tregon vlerën e këtyre dy librave në diskutimin e tij për llojet e veprave që dijetarët hanefi kanë shkruar në fushën e *Usulu el-fikhubut*:

...dhe veprat e shkruara nga kolegët tanë në *Usul el-Fikh* janë dy llojesh: Libra që janë shkruar në formën më të përsosur dhe ato shkencore, sepse ato janë shkruar nga dijetarë që shkëlqejnë në dijet që lidhen me shkencat themelore dhe të hollësishme të Islamit. Një shembull

i librave të një kalibri të tillë janë *Kitabu el-Xhedel* dhe *Me'akbidhu esh-Sheri'ah* nga El-Maturidiu.⁴²

Për më tepër, sipas Khalifes, këta dy libra u bënë referenca kryesore për dijetarët hanefi në fushën e *Usulu l-fikhubut* deri në shekullin e dymbëdhjetë.⁴³ Me fjalë të tjera, për më shumë se dy shekuj, dijetarët hanefi studiuuan, mësuan dhe u mbështetën në librat e Maturidiut për të formësuar të kuptuarit e shkollës Hanefite në disiplinën e *Usulu el-fikhubut* dhe si rrjedhojë në disiplinën e jurisprudencës islame. Kjo vërtetohet se dituria dhe rëndësia e Maturidiut nuk është dhe nuk mund të kufizohet në fushën e teologjisë. Më e rëndësishmja, tregon se Maturidiu ishte një dijetar kryesor që la gjurmë në çdo fushë që studioi. Fatkeqësisht, këta dy libra nuk ekzistojnë më.⁴⁴

42. M. Khalifa, *Keshf edh-Dhunun 'an esami l-Kutub ue l-Funun*.

43. Po aty, vëll. 1, 110.

44. Ceriç rendit dy libra shtesë dhe një variacion në emrat e dy librave të parë. Titujt shtesë që ai citon janë *Kitabu Me'akbidhu esh-Sheri'ah fi l-Fikh* dhe *Kitabu Usuli d-Din*. Asnjë nga biografët dhe studiuesit e tjerë nuk i përmend ato. Në lidhje me variacionin në emrat e dy librave të parë, *Kitabu l-Xhedel fi Usuli l-Fikh* dhe *Kitabu Ma'akbidhu esh-Sheri'ah fi l-Fikh*, vërehet se shtimi në emrat e dy librave të parë është i njëjtë – fi Usuli l-Fikh – që do të thotë “në disiplinën e Usul el-Fikhut”. Duket se kjo shtesë është rezultat i keqkuptimit të Ceriçit kur ai citon titujt nga libri i Ibn Kutlubughas, *Taxh et-Teraxhim*. Ai supozon se fraza *fi Usuli l-Fikh* është pjesë e një titulli të librave kur është pjesë e fjalisë

Pavarësisht përsosmërisë së Maturidiut në shkencat e ndryshme islame, fusha e teologjisë është ajo ku dikush gjen shumicën e veprave të tij. Është për kontributet e tij në këtë fushë që ai kujtohet dhe nderohet më shumë. Dallimi dhe erudicioni i tij në teologji është ajo që i dha atij epitetet dhe reputacionin që gëzon dhe e ktheu atë në një ikonë të botës sunite dhe një emërtues të shkollës teologjike, El-Maturidijeh.

Literatura teologjike e Maturidiut mund të ndahet në tri kategori kryesore:⁴⁵ *el-mekalat*, *err-rrudud* dhe *usul et-teuhid*. *El-mekalat* është një zhanër i librave teologjikë në të cilët studiuesit rendisin argumentet dhe provat e shkollave dhe orientimeve të ndryshme islame. Në zhanrin *usul et-teuhid*, studiuesit përvijojnë dhe shpjegojnë parimet e besimit dhe parimet e besimit islam sipas kuptimit të tyre. Nga ana tjetër, në zhanrin *err-rrudud*, studiuesit hedhin poshtë dhe u përgjigjen argumenteve të studiuesve që i përkasin një shkolle apo sekti tjetër.⁴⁶

Në zhanrin e *el-mekalat*, Maturidiu ka një libër me të njëjtin titull: *El-Mekalat*.⁴⁷ Fatima dhe

së autorit origjinal, Ibn Kutlubgha. Për më tepër, shih Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam*; M. Ibn Kutlubgha, *Taxh et-Teraxhim fi Tabakati el-Hanefijeh* (Bagdad: Matba'at el-'Ani, 1962).

45. Maturidi, *Të'ujilat eblu Sunneh*, 1st ed., 5 vëll. (Bejrut: Resalah Publishers, 2004).

46. Po aty.

47. I. Baghdadi, *Hedijetu el-'arifin fi esma'i*

Brockelmann thonë se libri gjendet si dorëshkrim në bibliotekën Köprülü në Stamboll, Turqi, me numrin 856.⁴⁸ Megjithatë, Ceric thotë se Tanci dhe 'Aliu e kundërshtojnë këtë pretendim dhe kanë qenë në gjendje të vërtetojnë nëpërmjet kontrollit të dorëshkrimeve të tjera në bibliotekën Fatih në Stamboll dhe bibliotekën 'Arif Hikmet në Medine se ky titull i përket Ebu Bekr Furak, një dijetar i shquar esh'arit, i cili vdiq në vitin 406 të e.s.⁴⁹ Pavarësisht pretendimit të Tancit dhe 'Aliut, Ceric pohon se nuk mund të injorohet mundësia që një titull i tillë mund t'i përkasë Maturidiut, por nuk ofron ndonjë dëshmi që e mbështet këtë mundësi.⁵⁰

Ndërsa Tanci dhe 'Ali mund të jenë të saktë në përfundimin e tyre se ky dorëshkrim specifik i përket Ebu Bekr Furakut, kjo në vetvete nuk mund të jetë një provë se një titull i ngjashëm nuk është shkruar nga Maturidiu, veçanërisht kur është e qartë se ky zhanër shkrimi ishte gjerësisht i përhapur dhe përdoret zakonisht nga studiues të ndryshëm në fushën e teologjisë, si *Mekalat el-*

el-mu'ellifin ue aitari el-Musanifin, 2 vëll. (Bejrut: Dar Ihja' et-Turath, 1957); Zebidi, *Ithaf s-Sadah l-Mutekkin bi sherhi Ihja'i 'Ulumi d-din*; Tash Kubra Zadeh, *Miftabu s-Se'adeb ue Misbahu s-Sijadeb*; El-Kureshi, *El-Xbenahir el-Mudi'ab fi tabakati el-Hanefijeh*.

48. Maturidi, *Të'ujilat eblu Sunneh*; C. Brockelmann, *Tarikh el-Edeb el-'Arabi*, 5th ed., 6 vëll. (Kajro: Dar el-Me'arif, 1959).

49. Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam*.

50. Po aty.

Islamijjin, shkruar nga bashkëkohësi i tij Ebu l-Hasan El-Esh'ari. Për më tepër, ajo që pohon praninë e një titulli të tillë për Maturidiun është fakti se më shumë se 11 nga biografët që kanë shkruar për jetën e Maturidiut e rendisin këtë titull si pjesë të veprave të tij.⁵¹ Jashtë kontekstit të këtij debati, En-Nesefiu konstaton pa dashje praninë e *Mekalatit* në librin e tij *Tebisiretu el-edil-leh fi Usul ed-Din* ndërsa citon prej Maturidiut në më shumë se një rast,⁵² duke zgjidhur kështu debatin dhe duke pohuar praninë e titullit *Mekalat* për Maturidiun.

Përveç kësaj, Maturidiu ka më shumë se shtatë tituj në zhanrin e *err-rrudud*, në të cilat ai hodhi poshtë argumentet e shkollave dhe grupeve kryesore teologjike në kohën e tij, si Karamitet, rafiditët dhe mu'tezilitët.⁵³

51. Khalifa, *Keshf edb-Dhunun 'an esami l-Kutub ue l-Funun*; Zadah, *Miftabu s-Se'adeb ue Mishabu s-Sijadeb*; Zada, *Isyarat el-Meram Min Ibarat el-Imam*; Baghdadi, *Hedijetu el-'Arifin fi Esma' el-Mu'el-lifin ue Athar el-Musanifin*; Ibn Kutlubgha, *Taxb et-Teraxhim fi Tabakit el-Hanefijeh*; Zebidi, *Ithaf s-Sadeb l-Mutekkin bi sherbi Ihja'i 'Ulumi d-din*; M. El-Lukneui, *El-Fena'id el-Bebijeh Fi Teraxhim el-Hanefijeh* (India: El-Matba' El-Mastafani, 1976); M. Ebu Zehra, *Tarikh el-Medbabib el-Islamijeh* (Kajro: Dar el-Fikr, 1934); Brockelmann, *Tarikh el-Edeb el-'Arabi*.

52. Nesefi, *Tebisiretu 'l-edil-leh fi Usul ed-Din*, vol. 2 (Kajro: El-Mektebah El-Azharijeh, 2011).

53. Baghdadi, *Hedijetu el-'Arifin fi Esma' el-Mu'el-lifin ue Athar el-Musanifin*; Ibn Kutlubgha, *Taxbu et-Teraxhim fi Tabakit el-Hanefijeh*; Brockelmann, *Tarikh el-Edeb*

Asnjë nga titujt që Maturidiu shkroi në këtë zhanër nuk kanë mbijetuar, por numri i librave që ai shkroi në këtë zhanër dëshmon për ndikimin dhe rolin e shumëllojshmërisë kulturore dhe intelektuale të rajonit në punën e tij akademike dhe thellësinë e angazhimit të Maturidiut në të.⁵⁴

Në zhanrin e *Usul et-Teuhid*, mund të gjendet një nga veprat më të shquara të Maturidiut në fushën e teologjisë: *Kitab et-Teuhid*. Me të drejtë, Ceric e quan atë “Summa Theologica”⁵⁵ e Maturidiut, sepse në të ai vendos themelet e një shkolle të

el-'Arabi; Zebidi, *Ithaf s-Sadeb l-Mutekkin bi sherbi Ihja'i 'Ulumi d-din*; El-Kureshi, *El-Xbenahir el-Mudi'ah fii tabakati el-Hanefijeh*; Khalifa, *Keshf edb-Dhunun 'an esami l-Kutub ue l-Funun*; Ebu Zehra, *Tarikh el-Medbabib el-Islamijeh*; Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam*.

54. Titujt janë: (1) *Err-Rredd 'ala el-Karamitah*; (2) *Rredd el-Usuli el-Khamseh*, një kundërshtim ndaj Ebu Umameh el-Bahili, i cili ka qenë një mu'tazilij; (3) *Rredd Ua'id el-Fussak*, i cili është një kundër përgjigje i librit të Ka'bit, i cili ishte mu'tazilij, i titulluar *Ua'id el-Fussak*; (4) *Rredd Ana'il el-edil-leh*, një kundërshtim i librit të Ka'bit të titulluar *Ana'il el-edil-leh*; (5) *Rredd Thadhib el-Xbedel*, i cili është një kundërshtim i librit të Ka'bit titulluar *Thadhib el-Xbedel*; (6) *Rredd el-Imameh*, një kundërshtim i sektit Rafidi; dhe (7) *Bejan uehm el-Mu'tezileh*, një kundërshtim i shkollës Mu'tezilite. Për më tepër, shih Baghdadi, *Hedijetu el-'Arifin fi Esma' el-Mu'el-lifin ue Athar el-Musanifin*; Ibn Kutlubgha, *Taxb et-teraxhim fi tabakit el-Hanefijeh*; Khalifa, *Keshf edb-dhunun 'an esami l-kutub ue l-funun*.

55. Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam*, 46.

zakonshme teologjike sintetike sunite që u përpoq të vendoste ekuilibrin midis metodave tradicionale dhe ultra-liberale të mu'tezilitëve nga njëra anë, dhe doktrinave islame dhe ideologjive të ndryshme që ekzistonin në rajon në kohën e tij nga ana tjetër. Përveç kësaj, libri është një referencë e pasur historike dhe akademike për mendimet e shkollave të ndryshme myslimane dhe shkollave jomyslimane që Maturidiu i përmendi dhe i hodhi poshtë në librin e tij, i cili ripohon përfundimet e mësipërme rreth angazhimit të tij dinamik në debatin akademik në rajonin ku jetoi dhe ndikimin në formimin e tij.⁵⁶

Përveç kësaj, ai ka shkruar traktate të tjera në të njëjtin zhanër, si *Risaleh fi l-Iman*,⁵⁷ *Risaleh fil 'Akideh*⁵⁸ dhe

56. M. Xuhani, *El-Mausu'ah el-Mujessere fi l-Edjan ue l-Medhabib ue l-Abzab el-Mu'asire*, 3rd ed., 2 vëll. (Rijad: Dar En-Nedua el-'Alamijeh lil Tiba'ah ue en-Neshr ue et-Teuzi', 1997); M. Khamis, "Maturidijeh Rabibat el-Kalabijje," *Mexhalat el-bubuth el-Islamijeh* 55 (1998); M. Bezdevi, *Usul ed-Din* (Kajro: Mektebeh Azhariyeh, 2003); Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam*.

57. Ebu Mu'in En-Nesefi në librin e tij *Et-Temhid* shkruan se Maturidiu ka një trajtesë të shkurtër të titulluar *Risaleh fi l-Iman*. Për më shumë, shiko Mejmun Nesefi, *Et-Temhid li Kaua'id et-Teuhid* (Kajro: Dar El-'Itiba'ah el-Muhammedijeh, 1986).

58. Është një trajtesë që ai e shkroi për besimin islam. Baghdadi dhe Sezgin e listojnë atë si një nga veprat e Maturidiut. Për më tepër, Subki (vd. 1370 e.s), një dijetar dhe historian shafi'i, ka shkruar një koment mbi të të titulluar *Es-Sejfu l-Meshbur fi sberbi Akideti Ebi Mensur*. Anasjelltas, Xuhani

Sberbu el-Fikhi l-Ekber.⁵⁹ Megjithatë, studiuesit kanë dallime nëse këto ishin të gjitha veprat e tij.

Në fushën e ekzgjegjës kur'anore, *Te'ujlatu Ehlu s-Sunneh*, një libër interpretimi, është një nga librat e paktë që është ruajtur nga veprat e Maturidiut dhe ka arritur deri në ditët tona i plotë. Shumica e studiuesve që diskutojnë jetën e tij dhe rendisin librat e tij, e konstatojnë këtë fakt.⁶⁰

dhe të tjerë argumentojnë se është punim i disa nxënësve të tij, por që gabimisht i është referuar atij. Për më shumë, shih Baghdadi, *Hedijetu el-'Arifin fi Esmat el-Mu'el-lifin ue Athar el-Musanifin*; F. Sazkin, *Tarikh et-Turath l-'Arabi*, përkth. Mahmud Hixhazi, 10 vëll. (Rijad: Imam Su'ud University, 1991); A. Subki, *Es-Sejfu l-Meshbur fi sberbi Akideti Ebi Mensur*, 1st ed. (Istanbul: Marmara University, 2000); Xuhani, *El-Mensu'ah el-Mujessere fi l-Edjan uel-Medhabib ue l-Abzab el-Mu'asire*.

59. Pretendohet se Maturidiu në këtë libër ka shpjeguar librin e Ebu Hanifes *El-Fikhu l-Ekber*. Megjithatë, Keutheri (v. 1952 e.r.), një dijetar kryesor mysliman, Brockelmann (v. 1956 e.r.), një orientalist gjerman, dhe Ebu Zehra bien dakord që kjo nuk mund të jetë nga veprat e Maturidiut. Ata rendisin një sërë arsyesh për mendimin e tyre. Midis tyre është fakti se ai kritikon disa nga mësimet e shkollës esh'arite, të cilat nuk u bënë të njohura vetëm pas vdekjes së Maturidiut. Për më tepër të dhëna, shih Ebu Hanife, *El-'Alim ue l-Mute'al-lim* (Kajro: Matba'at el-Enuar, 1948); Brockelmann, *Tarikh el-Edeb el-'Arabi*; Ebu Zehra, *Tarikh el-Medhabib el-Islamijeh*.

60. Tash Kubra Zadeh, *Miftahu s-Se'adeh ue Misbahu s-Sijadeh*; *Tabakat el-Fukah*; El-Kureshi, *El-Xhenabir el-Mudi'ah fji tabakati el-Hanefijeh*; Nesefi, *Tebsiretu el-edil-leh fi Usuli ed-Din*, vëll. 2; Baghdadi, *Hedijetu el-'Arifin*

Rudolph dhe Ceric e pohojnë këtë dhe ky i fundit pohon, “duket se ka një marrëveshje unanime në raportet historike mbi Maturidiun për vërtetësinë e *Kitabu t-Teubidit* dhe *Te’ujlatu Ehlu s-Sunneh*.”⁶¹

Është një nga veprat më domethënëse të Maturidiut që i mundësoi atij admirimin e një numri studiuesish në fushën e ekzegjzës kur’anore. Ebu Mu’in en-Nesefi, një dijetar Hanefi, dëshmon për madhësinë e këtij libri dhe e përshkruan atë si “një libër që asnjë libër tjetër nuk i afrohet atij në temën dhe përmbajtjen e tij apo në vlerën e tij akademike... në të ai zgjidhi shumë nga mendimet dhe konceptet e keqkuptuara të diskutueshme, në gjuhën më elokuate dhe në stilin më të përsosur.”⁶² Khalifa dhe dijetari mysliman El-Keutheri (v. 1952 e.s.) ndajnë të njëjtin mendim si Nesefiu. Ky i fundit, në hyrjen dhe komentin e tij për librin *Isharat el-Meram*, thotë: “Është një libër që

fi Esma’ el-Mu’el-lifin ue Athar el-Musanifin; Khalifa, *Keshf edh-Dbunun ‘an esami l-Kutub ue l-Funun*; T. Temimi, *Et-Tabakat es-Sunnijeh fi Teraxhim el- Hanefijeh*, 4 vëll. (Kajro: El-Mexhli el A’la Lil Shu’un el-Islamijeh, 1970); ‘Abdullah El-Maraghi, *El-Fethu l-Mubin fi tabakati el-Usulijin*, 2 vëll. (Kajro: Vizarat el-Avkaf, 1947); H. Ebi ‘Adhabeh, *Err-Rreudatu l-Babijeh fjma bejne El Esha’irah ue l-Maturidijeh* (Bejrut: Resalah Publishing, 1996).

61. Ceric, *Roots of Synthetic Theology in Islam*, 40.

62. Nesefi, *Tebsiretu el-edil-leb fi Usuli ed-Din*, vëll. 2, 220-21.

nuk ka të barasvlershëm në fushë”.⁶³

A është ky titull vepra e vetme e Maturidiut në fushën e ekzegjzës kur’anore? Khalifa argumentoi se Maturidi ka dy libra në këtë fushë me tituj të ngjashëm: *Te’ujlatu Ehlu s-Sunneh* dhe *Te’ujlatu l-Maturidijeh*. Sipas tij, e para u shkrua nga Maturidiu personalisht, ndërsa e dyta u përpilua nga nxënësit e tij ndërsa ai u mësonte atyre interpretimin e tij. Megjithatë, Ibrahimimi dhe Sejid ‘Auadejn e kundërshtojnë atë që argumenton Khalifa dhe sqarojnë se libri i dytë nuk është një përmbledhje e ekzegjzës së Maturidiut; përkundrazi, është një koment i shkruar nga studenti i tij ‘Ala’u d-Din es-Samarkandi mbi ekzegjzën e Maturidiut.⁶⁴

Komenti i Nesefiut, “...në të ai zgjidhi shumë nga mendimet dhe konceptet e keqkuptuara të diskutueshme, në gjuhën më elokuate dhe në stilin më të përsosur.”⁶⁵, paraqet dëshmi të mëtëjshme të përpjekjeve të vazhdueshme të Maturidiut për të shmangur shkrimin konvencional dhe për të sfiduar dhe përfshirë çështjet e diskutueshme të rajonit të tij pluralist.

Nga 17 titujt që shkroi Maturidiu në disiplinat islame të teologjisë, *usulu l-fikihut* (parimet e jurisprudencës

63. Zada, *Isharat el-Meram Min Ibarat el-Imam*.

64. Maturidi, *Te’ujlat ehlu Sunneh*.

65. Nesefi, *Tebsiretu el-edil-leb fi Usuli ed-Din*, vëll. 2, 220-21.

islame) dhe tefsirit (eksegeza kur'anore), vetëm dy tituj mbijetuan dhe pranohen nga të gjithë studiuesit si vepër e tij: *Kitabu et-Tenhid* dhe *Te'ujlatu Eblu s-Sunneh*.⁶⁶ Duke pasur parasysh mungesën e informacionit për jetën e Maturidiut, mund të propozohen një sërë faktorësh shkaktarë për të shpjeguar pse veprat e tij nuk u ruajtën aq shumë sa të dijetarëve të tjerë të shquar. Një nga arsytet është vendndodhja e tij gjeografike. Azia Qendrore ishte larg qendrës së khalifatit, Bagdadit; një qytet që ishte kryeqyteti akademik i botës myslimane. Si rezultat, shumë historianë, biografë dhe studiues nuk i kushtuan vëmendjen e duhur zhvillimeve akademike që ndodhën gjatë. Për më tepër, largësia e qytetit ku jetonte Maturidiu, në kontrast me rehatinë e Bagdadit si kryeqytet dhe në zemër të Lindjes së Mesme, e bënte jopraktike për studentët e huaj udhëtimin deri në Azinë Qendrore për të kërkuar njohuri. Pa dyshim, kjo do ta kishte kufizuar përhapjen e mësimave të tij në pjesë të tjera të botës islame dhe do ta kishte kufizuar ndikimin e tij vetëm në rajonin e tij të paktën për disa shekuj. Faktori i dytë që kontribuon është mungesa e mbështetjes politike për

66. El-Lukneui, *El-Feu'ad el-Behijeh fi Teraxhim el-Hanefijeh*; Khalifa, *Keshf edh-Dhunun 'an esami l-Kutub ue l-Funun*; Zada, *Isharat el-Meram Min Ibarat el-Imam*; Ibn Kutlubgha, *Taxh et-Teraxhim fi Tabekati el-Hanefijeh*; Baghdadi, *Hedijetu el-'Arifin fi Esma' el-Mu'el-lifin ue Athar el-Musanifin*.

shkollën e tij. Shkolla El-Maturidije ishte e njohur dhe e respektuar në Azinë Qendrore, por ajo nuk mori mbështetje të fortë politike deri në periudhën osmane (1299-1923 e.s.). Një periudhë relativisht e shkurtër në krahasim me esh'aritë të cilët gëzonin imunitet të plotë politik dhe promovim nga tre dinastitë kryesore myslimane: selxhukët,⁶⁷ ejubitë⁶⁸ dhe memlukët⁶⁹. Këto dinasti luajtën një rol themelor në përhapjen e mësimave të esh'arizmit për shekuj me radhë. Faktori i tretë që kontribuon është ndikimi i shkollave të jurisprudencës islame. Mësimet e Maturidiut u miratuan nga një shkollë e shquar e jurisprudencës

67. Tabib Rashid ed-Din et al., *The History of the Seljuq Turks from the Jami' at-Tawarikh: An Ilkhanid adaptation of the Saljuq-nama of Zahir al-Din Nishapuri* (Richmond, Surrey: Curzon, 2001); Stanford J. Shaw and Ezel Kural Shaw, *History of the Ottoman Empire and Modern Turkey* (Cambridge; New York: Cambridge University Press, 1976).

68. R. Stephen Humphreys, *From Saladin to the Mongols: The Ayyubids of Damascus, 1193-1260* (Albany: State University of New York Press, 1977); John Davenport, *Saladin* (Philadelphia: Chelsea House Publishers, 2003).

69. Reuven Amitai, *Mongols and Mamluks: The Mamluk-Ilkhanid War, 1260-1281* (Cambridge; New York: Cambridge University Press, 2004); Michael Winter and Amalia Levanoni, "The Mamluks in Egyptian and Syrian Politics and Society," (2004); David Nicolle, *The Mamluks, 1250-1517* (London: Osprey, 1993); Ebu Zehra, *Tarikh el-Medhabib el-Islamijeh*; M. Xuhani, *El-Mausu'ah el-Mujessera fi el-Edjan ue el-Medhabib ue el-Ahzaq el-Mu'asire*.

islame, ajo Hanefite. Ndërkohë, mësimet e Esh'ariut u përqafuan nga dy shkolla të shquara, Maliki dhe Shafi'i, dhe nga një pakicë dijetarësh Hanbeli. Në mjedisin konkurrues që dominonin shkollat e ndryshme, kjo do t'i dekurajonte studiuesit ose të paktën do t'i bënte ata të favorizonin interpretuesit e shkollave të tyre mbi ata që i përkisnin shkollave të tjera.

EDUKIMI DHE FORMIMI I MATURIDIUT SI NJË DIJETAR MYSLIMAN

Maturidiu kishte privilegjin të studioje nën një numër dijetarësh të shquar, të cilët shkëlqyen në shkenca të ndryshme islame, si jurisprudenca dhe teologjia.⁷⁰

Një nga mësuesit e hershëm të Maturidiut ishte Ebu Bekr Ahmed Ibn Ishak Ibn Subh,⁷¹ El-Xheuzexhani.⁷²

70. Ebu Zehra, *Tarikh el-Medhabib el-Islamijeh*; Zada, *Isharat el-Meram Min Ibarat el-Imam*; Khamis, "Maturidijeh Rabibat el-Kalabijeh"; El-Kureshi, *El-Xhenahir el-Mudi'ah fi tabakati el-Hanefijeh*; El-Lukneui, *El-Fena'id el-Behijeh fi Teraxhim el-Hanefijeh*; Tash Kubra Zadah, *Mijtabu s-Se'adeb ue Misbabu s-Sijadeb; Tabakat el-Fukaba'*.

71. Biografët dallojnë nëse emri i gjyshit të tij ishte Subh apo Sabih. Për më shumë, shih Baghdadi, *Hedijetu el-'Arifin fi Esma' el-Mu'el-lifin ue Athar el-Musanifin*; El-Kureshi, *El-Xhenahir el-Mudi'ah fi tabakati el-Hanefijeh*; El-Lukneui, *El-Fena'id el-Behijeh fi Teraxhim el-Hanefijeh*.

72. Temimi, *Et-Tabakat es-Sunnijeh fi Teraxhim el-Hanefijeh*; El-Kureshi, *El-Xhenahir el-Mudi'ah fi tabakati el-Hanefijeh*; Zebidi, *Ithaf s-sadeb l-Mutekkin bi sberhi Ihja' 'Ulumi d-din*.

Pak informacion gjejmë rreth jetës së tij personale, por ai ishte një nga të paktët dijetarë që vërtetoi rëndësinë e tyre në të gjitha shkencat. Ai ishte mësuesi kryesor i Ebu Nasr el-Tjadit, i cili ishte gjithashtu një nga mësuesit e Maturidiut. Duket se Maturidiu filloi të mësonte nga duart e Ebu Bekrit dhe më pas vazhdoi shkollimin e tij nën Ebu Nasrin.

Ebu Nasr Ahmed Ibn el-'Abbas el-Ensari⁷³ ishte një nga mësuesit kryesorë të Maturidiut. El-Kureshi flet për reputacionin e tij, "ai ishte një njeri që nuk ka të barabartë në tokë në dituri, devotshmëri, shkrime, këmbëngulje dhe guxim."⁷⁴ Nesefiu bën një përshkrim të ngjashëm "... për sa i përket dijes ai është një oqean që askush nuk mund të arrijë fundin e tij. Ai ishte një imam në të gjitha disiplinat."⁷⁵ Është interesante se Hamza es-Sehmi (v. 1036 e.s.), një historian mysliman, hedh dritë më tej mbi personalitetin e Ebu Nasrit dhe këshillon se ai është "nga shkolla e njerëzve të Re'jt."⁷⁶ Me fjalë të tjera, ai ishte nga shkolla e Ebu Hanifes. Në vazhdim, kjo tregon se Ebu Bekr el-Xheuzexhani është gjithashtu Hanefi, pasi ai ishte mësuesi i vetëm i Ebu

73. Ai është nga pasardhësit e njerit prej shokëve të respektuar të Profetit a.s., Sa'd Ibn 'Ubade El-EnSari. Për më tepër, shih El-Kureshi, *El-Xhenahir el-Mudi'ah fi tabakati el-Hanefijeh*.

74. Po aty.

75. Nesefi, *Tebisretu el-edil-leb fi Usuli ed-Din*.

76. El-Kureshi, *El-Xhenahir el-Mudi'ah fi tabakati el-Hanefijeh*.

Nasrit.

Et-Temimi (v. 1601 e.s.), një historian hanefi, dhe Ibn Kutlubugha (v. 1474 e.s.), një dijetar i shquar hanefi, ndër të tjera, e konsiderojnë Ebu Nasrin si mësuesin kryesor të Maturidiut.⁷⁷ Në fakt, ky i fundit nuk rendit asnjë mësues tjetër për Maturidiun. Deri më tani, mund të arrihet në përfundimin se Maturidiu gëzonte këshillimin me mësuesit më të shquar të kohës dhe rajonit të tij. Kjo do të kishte pasuruar njohuritë e tij dhe do të ndikonte në mënyrë të kuptueshme në kuptimin e tij për disiplinat e ndryshme të Islamit. Përveç kësaj, është e qartë se mësuesit e tij kryesorë e kanë ndjekur shkollën e jurisprudence Hanefi.

Një nga mësuesit e tjerë të rëndësishëm të Maturidiut ishte Muhammed Ibn Mukatil err-Rrazi.⁷⁸ Ai është një dijetar i mirënjohur mysliman, i cili lindi në shekullin e tretë hixhri në të njëjtin rajon me Maturidiun dhe vdiq atje në vitin 862 të erës sonë. Ai shkëlqeu në fushën e jurisprudence islame dhe konkretisht në shkollën Hanefi. Sajmari (v. 1045 e.s.), një jurist dhe historian hanefi, el-Lukneui (v. 1886 të e.s.), një dijetar i famshëm mysliman me prejardhje indiane, Zebidi, Bagdadi

77. Temimi, *Et-Tabakat es-Sunnijeh fi Teraxhim el-Hanefijeh*; Ibn Kutlubugha, *Taxb et-Teraxhim fi Tabakät el-Hanefijeh* (Bejrut: Dar El-Kalem, 1992).

78. El-Kureshi, *El-Xbeuhir el-Mudi'ab fj tabakati el-Hanefijeh*.

(v. 1920 e.s.), historian dhe shkrimtar mysliman, dhe Kureshi (vd. 1373 e.s.), ndër të tjera, konfirmojnë se Muhamed Ibn Mukatil ishte një nga nxënësit kryesorë të Esh-Shejbanit (v. 805 e.s.), figura e dytë më e lartë në shkollën Hanefi.⁷⁹ Ky është një zbulim shumë intrigues siç e vërteton se një nga mësuesit e Maturidiut mori njohuri nga autoriteti i dytë më i lartë në shkollën Hanefite. Nga ana tjetër, ai përforcon pikën e vendosur më parë në lidhje me ndikimin që shkolla Hanefite kishte në El-Maturid dhe rajonin e Azisë Qendrore. Është një shenjë dalluese në jetën e Maturidiut që shumica e mësuesve të tij kryesorë të kenë marrë njohuritë e tyre drejtpërdrejt nga literatura e Ebu Hanifes, në shkencat e ndryshme islame dhe nën udhëzimet e nxënësve të tij kryesorë.⁸⁰ Përveç kësaj, ajo hedh dritë mbi kalibrin e Maturidiut në qarqet akademike të rajonit, pasi të gjithë mësuesit e tij kishin një status të vlerësuar.

Ndikimi i shkollës Hanefi te Maturidiu sqarohet më tej nga thëniet e Ebu Zehras, të cilat konfirmojnë se Maturidiu i ka fituar dhe studiuar

79. El-Lukneui, *El-Feu'id el-Behijeh fi Teraxhim el-Hanefijeh*; H. Sajmari, *Akbbar Ebi Hanife ue As'babib*, 2nd ed. (Bejrut: 'Alem el-Kutub, 1985); El-Kureshi, *El-Xbeuhir el-Mudi'ab fi tabekati el-Hanefijeh*; Zebidi, *Ithaf s-Sadeh l-Mutekkin bi sherhi Ihja' Ulumi d-din*.

80. Mejmun Neseft, *Babru l-Kelam fi Usuli ed-Din* (Kajro: El-Mektebeh El-Azharijeh, 2011); Zada, *Isbarat el-Meram Min Ibarat el-Imam*.

librat themelorë të teologjisë që shkroi Ebu Hanife. *El-Fikhu l-Ebsat* (Fikhu i thjeshtuar), *Risaleh ila el-Bitti* (Letra drejtuar El-Bittit), *El-'Alim ue l-Mute'al-lim* (Dijetari dhe Nxënësi) dhe *El-Uasije* (Trashëgimia) janë titujt kryesorë të Ebu Hanifes që Maturidiu do t'i kishte mësuar nga mësuesit e tij në një zinxhir të lidhur transmetimi që nga Ebu Hanifja.⁸¹ Në fakt, Zade rendit zinxhirin e dijetarëve nga të cilët Maturidiu i mori librat e Ebu Hanifes. Ai shpjegon: "...Maturidiu i ka transmetuar këto libra, nga dy imamët Ebu Bekr Xheuzexhani dhe Ebu Nasr, të cilët i përvetësuan nga Ebu Sulejman Xheuzexhani, i cili e mori atë nga dy imamët, Ebu Jusufi dhe Muhamedi."⁸² Duke parë këtë zinxhir imamësh, vërehen emrat e Ebu Jusufit dhe Muhamed esh-Shejbanit, të cilët janë dy nxënësit kryesorë të Ebu Hanifes dhe ata që janë përgjegjës për themelimin e shkollës Hanefite.⁸³

Prandaj, shkolla Hanefite padyshim ndikoi te Maturidiu në fushën e teologjisë, ashtu siç bëri në fushën e jurisprudencës. Megjithatë, kjo ngre pyetje të tjera, a ishte Maturidiu thjesht një ndjekës i verbër i shkollës apo ai ndryshonte në mënyra

81. Ebu Zehra, *Tarikeh el-Medhabib el-Islamijeh*.

82. Zada, *Isharat el-Meram Min Ibarat el-Imam*, 11.

83. Sajmari, *Akbbar Ebi Hanijfe ve Ashabib*; El-Kureshi, *El-Xheuahir el-Mudi'ah fi Tabekati el-Hanefijjeh*; El-Lukneui, *El-Fena'id el-Behijjeh fi Teraxhim el-Hanefijjeh*; Kutlubgha, *Taxh et-Teraxhim fi tabekati el-Hanefijjeh*.

të rëndësishme nga ajo që mësoi Ebu Hanife? Nëse jo, pse një institucion teologjik është emëruar me emrin e tij dhe dallohet nga ai i Ebu Hanifes? Dhe, nëse po, çfarë ndryshimi ka dhe cila është natyra e tyre?

Është me rëndësi të madhe të hulumtohet nëse Maturidiu dha kontribut të rëndësishëm në disiplinat islame, veçanërisht teologjinë dhe ekzegjzën, të cilat janë të ndryshme me shkollën Hanefi. Ndërsa një numër dijetarësh myslimanë do të dëshironin ta shihnin Maturidion si një ndjekës aderues të shkollës së Ebu Hanifes, për të treguar se shkolla e tij është tradicionaliste⁸⁴ dhe ka rrënjë që rrjedhin nga dijetarët më të mëdhenj myslimanë, [si] Ebu Hanife, ka dijetarë të tjerë myslimanë që argumentojnë të kundërtën.⁸⁵ Sido që të jetë, kjo paraqet një tjetër terren pjellor për kërkime të mëtejshme mbi tradicionalizmin e veprave të Maturidiut në teologji dhe natyrëne marrëdhënieve ndërmjet shkollës së tij dhe asaj të Ebu Hanifes.⁸⁶

Përshtati Haki Sahitaj Vijon në numrin pasardhës.

84. Zada, *Isharat el-Meram Min Ibarat el-Imam*.

85. Xuheni, *El-Meusu'ab el-Mujessere fil-Edjan uel-Medhabib uel-Ahzaab el-Mu'asire*; Khamis, "Maturidijeh Rabibat el-Kalabijje".

86. Burimi: Aref Chaker. "The Life of Abu Mansur Al-Maturidi and the Socio-Political and Theological Context of Central Asia in the Tenth Century." *Australian Journal of Islamic Studies* 1, no. 1 (2016): 39-64.

Veprimtaria botuese e teologut boshnjak Enes Kariq e përkthyer në gjuhën shqipe

Azmir & Behrim Jusufi, Prizren

Abstrakt

Atë që Zoti i Plotfuqishëm e nderoi me urtësi, e nderoi me mirësi të madhe. Njeriun, në përgjithësi, gjatë jetës së tij e përcjell ndonjë ideal, pavarësisht nëse ai është feja, shkencë, apo diçka tjetër. Është e rëndësishme që ajo lidhje e njeriut me idealin e tij jetësor, është e padukshme, jo materiale dhe e fortë - e pamatshme, nga vetë fakti se ajo është lidhja me realitetin e tij të brendshëm, udhëtimin shpirtëror dhe përpjekjen dhe endjen për ta arritur...

Vepra e shkruar është një prej gjurmëve që mbeten edhe pas kalimit të njeriut në botën e Amsbueshme, kurse ndikimi i saj, është i gdhendur thellë në mbresën dhe qëllimin e të shkruarit të veprës. Në qoftë se një vepër shtrihet dhe dëgjohet larg, është një prej shenjave se qëllimi i të shkruarit të saj ishte në drejtimin e dubur. Nuk ka mirësi më të madhe sesa ajo që të mundëson që idealin e shpirtit, ndjenjat shpirtërore, të arrish t'i shkerish në letër dhe që pena në të njëjtën kohë të jetë një nga shokët më të dashur.

Ne të gjithë jemi e njëjta gjë, i njëjti umet, i njëjti realitet, e që myslimanët i lidh një fije e padukshme e fuqisë së pafundme të Zotit Fuqiplotë. Ne jemi, siç thotë Profeti ynë i dashur, sikurse një ndërtesë, nëse hiqet (bie) një pjesë e saj, rrënohet e

tëra. Prandaj, na ndjek apo gjithmonë duhet të na ndjekë një ideal, ideali i devotshmërisë, finesës dhe aspiratave të animit drejt mëshirës së pafundme të të Gjithëmëshirshmit në piedestale të pafundme kah Mëshira, Bujaria, dhe Dashuria e Tij.


Atë që Zoti i Plotfuqishëm

e nderoi me urtësi, e nderoi me mirësi të madhe. Njeriun, në përgjithësi, gjatë jetës së tij e përcjell ndonjë ideal, pavarësisht nëse ai është feja, shkenca, apo diçka tjetër. Është e rëndësishme që ajo lidhje e njeriut me idealin e tij jetësor, është e padukshme, jo materiale dhe e fortë - e pamatshme, nga vetë fakti se ajo është lidhja me realitetin e tij të brendshëm, udhëtimin shpirtëror dhe përpjekjen dhe endjen për ta arritur...

Vepra e shkruar është një prej gjurmëve që mbeten edhe pas kalimit të njeriut në botën e Amshueshme, kurse ndikimi i saj, është i gdhendur thellë në mbresën dhe qëllimin e të shkruarit të veprës. Në qoftë se një vepër shtrihet dhe dëgjohej larg, është një prej shenjave se qëllimi i të shkruarit të saj ishte në drejtimin e duhur. Nuk ka mirësi më të madhe sesa ajo që të mundëson që idealin e shpirtit, ndjenjat shpirtërore, të arrish t'i shkrish në letër dhe që pena në të njëjtën kohë të jetë një nga shokët më të dashur.

Në vazhdim, do të paraqitet prezantimi i librave, romaneve dhe përkthimit të Kur'anit në gjuhën shqipe, në bazë të kronologjisë kohore të përkthimit të tyre:

1. HYRJE NË SHKENCAT E TEFSIRIT¹



Që ndonjë person të fillojë me interpretimin e Kur'anit, është e nevojshme të dijë *Ulumu'l-Kur'an (Shkencat e Kur'anit)*, të cilat autori i këtij libri, dr. Enes Karić, i rendit shkëlqyeshëm në këtë libër. Një kategori shumë e rëndësishme, që profesionalisht dëshiron të ballafaqohet me shkencën e Kur'anit, janë studentët e Fakultetit të Studimeve Islame. Në këtë institucion arsimor islam të përmendur, bën pjesë edhe Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë.

Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë, ka filluar veprimtarinë në vitin 1991, kështu që ishte e nevojshme që të sigurojë literaturën e domosdoshme për lëndën e Tefsirit (interpretimit të Kur'anit). Duke marrë parasysh se kurrikula në

1. Titulli i origjinalit *Uvod u tefsirske znanosti, Hyrje në shkencat e tefsirit*, dr. Enes Kariq/dr. Enes Karić; [Përktheu nga gjuha boshnjake Rustem Spahiu] - Prishtinë, 1996 - 296 faqe; 21. cm., kapak i butë.


lëndën e Tefsirit është e ngjashme me atë në Fakultetin e Shkencave Islame në Sarajevë, dhe se mënyra më e lehtë për të siguruar literaturën e nevojshme është duke e përkthyer nga gjuhët e tjera, në këtë rast, mënyra më e lehtë ishte që të përkthehet nga gjuha boshnjake. Përkthyesi i librit të dr. Enes Karić, Rrustem Spahiu, mori përsipër këtë përgjegjësi dhe e përfundoi me sukses përkthimin e tij, i cili është një përpjekje dhe iniciativë që paraqitet si një nevojë jetike e studentëve të FSI-së në Prishtinë.

Ky libër e pa dritën e botimit në vitin 1996 dhe e gjithë kjo më së shumti i gëzoi studentët e FSI-së në Prishtinë. Kur e them këtë, e kam parasysh vetë përmbajtjen e këtij libri, e që mund të përkufizohet edhe nga fjalët e autorit të këtij libri, prof. dr. Enes Karić, i cili në hyrjen e këtij libri thotë: ”...Ky doracak është bërë enkas si propedeutik (instruksion) dhe fillimisht është i bazuar në detajet e një natyre të tillë. Ky lloj doracaku është absolutisht i nevojshëm që të shkrubet më shpesh, sepse literatura rreth Kur’anit dhe pranimet moderne të Kur’anit janë çdo ditë e më të shumta...”. Megjithatë, si çdo doracak dhe libër mësimor, edhe ky mund t’u shërbejë edhe lexuesve të tjerë të cilët kanë dëshirë për të mësuar më shumë në lidhje me shkencën e Kur’anit.

Së fundmi, është e rëndësishme të theksohet se para përkthimit të këtij libri në gjuhën shqipe, për këtë

tematikë, nuk është publikuar diçka e tillë.

2. SI TË KOMENTOHEJ KUR’ANI²



Kur’ani, Fjalimi më fisnik, Fjala e gjallë dhe e pa krijuar e Zotit të Madhërishëm, e shprehur në stilin e paimitueshëm të poezisë, ka tërhequr gjithmonë vëmendje të mendimtarëve islamë, elitës shkencore ndërkombëtare, si dhe gjithë popullsisë së këtij planeti. Në zinxhirin e atyre që janë të zhytur në thellësitë e bukurisë së të folurit Hyjnor bën pjesë edhe mendimtari i famshëm islam i trevave tona ballkanike, akademiku dr. Enes Karić. Mistikët islamë mendonin se janë në një botë të veçantë të Kur’anit të Shenjtë, e krahasuar

2. Titulli i originalit *Kako tumaçiti Kur’an, Si të komentohet Kur’ani (Hyrije në teoritë e komentimit të periudhës klasike)*, Enes Karić/Enes Karić; [Përktheu nga gjuha boshnjake Abdullah Hamiti - Prishtinë: Fakulteti i Studimeve Islame, 2008 - 389 faqe; 21 cm, kapak i fortë.

me lulishten aromatike përplot me lule të ndryshme, me ajër të pastër e rreze të buta dielli, gjelbërimin e natyrës, etj.

S'ka dyshim se gjithë këtë urtësi, mirësi, dhembshuri, harmoni, ofron Fjalimi i mrekullueshëm i këtij Libri Hyjnor. Megjithatë, pavarësisht nga fakti se nga shpallja e Kur'anit e deri më sot, mesazhet e fjalëve të tij mbeten mister i pa zbuluar, paragrafët e frazat, dhe duket se kjo do të mbetet kështu.

Libri “*Si të komentohet Kur'ani (Hyrije në teoritë e komentimit të periudhës klasike)*”, Enes Karić, është përkthyer në gjuhën shqipe në vitin 2008, në të njëjtin format si në origjinal. Ai në edicionin shqip, është botuar nga FSI në Prishtinë, për botuesin dr. Rexhep Boja. Nga gjuha boshnjake në gjuhën shqipe e përktheu dr. Abdullah Hamiti, ndërsa krahasimin me origjinalin e bëri dr. Imer Musliu.

Me siguri që dikush do të parashtronte pyetjen: “Përse libri ‘*Si të komentohet Kur'ani*’ në gjuhën shqipe?” Për këtë mund të nxjerrim disa vrojtime:

Libri “*Si të komentohet Kur'ani/ Kako tumačiti Kur'an*” është një libër i një rëndësie të madhe në fushën e tij kërkimore, siç qëndron edhe në kopertinat e pasme të përkthimit të tij në gjuhën shqipe: “Libri ‘*Si të komentohet Kur'ani*’, i autorit shumë të famshëm, akademikut Enes Karić, është një vepër e rrallë e ekzegjezës Kur'anore,

e mbështetur në detaje dhe shkencërisht, jep informacione për dhe rreth Librit hyjnor - Kur'anit.”

Nuk ka dyshim se kjo vepër e autorit me famë botërore dr. Enes Karić është me rëndësi të madhe për lexuesit shqiptarë, studiuesit, profesorët në Fakultetin e Studimeve Islame në Prishtinë, studentët, dhe masën e gjerë, e cila është e interesuar që të njihet me këto problematika.

3. FUNDAMENTALIZMI ISLAM - Ç'ËSHTË KY?³



Çfarë është saktësisht *fundamentalizmi*, dhe a ka ndërthurje me Islamin? Imazhet e botës së sotme rreth nesh, a janë të mishëruara me *fundamentalizëm*, dhe nëse po, *çfarë lloj fundamentalizmi* portretizojnë? Për të vazhduar edhe më tej me një fakt shumë të

3. *Fundamentalizmi islam - ç'është ky?* / *Islamski fundamentalizam - šta je to?*, Enes Karić - Nusret Čančar/Enes Karić - Nusret Čančar; [Përktheu nga boshnjakishtja: Nexhat Ibrahimij] - Shkup: LOGOS-A, 2011 - 295 faqe; formati A - 5, 21 cm, kapak i butë.

dhimbshëm: A ishim në gjendje që të parandalojmë atë që ndodhi me ne në ish-Jugosllavi? Në qoftë se mundëm, pse nuk e bëmë atë? A është koncepti i *fundamentalizmit* i shpikur qëllimisht? Këto dhe shumë pyetje të tjera mbeten enigma si të pazgjidhura që herë - herë do të paraqiten në mendjet tona dhe me pikëllim të madh, për shkak të zhurmës së përditshme dhe tërbimit.

Ajo çka mund të vërehet në këtë libër është ndërlikimi i katër fakteve kryesore dhe atë ekskluzivisht të ndërlidhura me situatën e atëhershme, apo preokupimin social:

Duket se, zhbalancimet e krijuara në vend, kërkojnë një zgjidhje, përveç asaj se mund të vërehen disa lëshime, si p.sh. *nacionalizimi i fesë*, përkatësisht popullsia myslimane, veçanërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë, e mori epitetin e nacionalizimit të fesë, dhe është formuar apo shpikur kombi ‘mysliman’.


Shoqëria jugosllave ka qenë gjithmonë e hapur me botën arabe, veç të tjerash, dhe për këtë arsye një pjesë e madhe e popullsisë i përkiste fesë islame, përkatësisht vetë numri i madh i myslimanëve në ish-Jugosllavi ishte përcaktues i të tilla raporteve me botën arabe. Pra, marrëdhëniet miqësore midis botës arabe dhe ish-Jugosllavisë, ishin në nivel të lartë, atëherë, prej nga lindi papritmas frika nga “*Fundamentalizmi islam*”?

Libri disi referon në një lloj *frike*, dhe përveç kësaj është e njohur

shumë mirë se në dekadën e dytë të shekullit XX dolën në dritë një numër i madh lëvizjesh reformiste në botën islame dhe arabe, me ç’rast mund të arrijmë në përfundimin se e gjithë kjo është pasqyruar në vendet e ish-Jugosllavisë, pikërisht për arsyet e lartpërmendura.

Megjithatë, edhe pse këto lëvizje reformiste kishin tendencat e modernizimit dhe anonin kah pikëpamjet ortodokse të jetës, dhe veçanërisht lëvizja reformiste islame “*Islab*”, ishte e qartë frika e qeverisë në popullsinë myslimane, për çka sugjeron edhe vetë mesazhi i librit.

4. SEKSUALITETI NË ISLAM / VRT MILOVANJA⁴



Janë shkruar romane voluminoze, koleksione, vëllime të librave..., penat janë tharë, zemrat u mpinë, sulltanët u nënshtruan,

4. *Seksualiteti në islam/Vrt milovanja*, Abd al-Wahab Bouhdiba; [Përktheu nga boshnjakishtja: dr. Selim Sylejmani] - Gjilan: “Drita e jetës” Gjilan, 2011- 320 faqe.

armiqtë u bënë miq, e gjithë kjo për shkak të asaj që e quajmë “dashuria”, shkëlqimi dhe tërheqja e gjinive të kundërta. Mënyra më bindëse për të dëshmuar atë janë vargjet delikate të fuqishme dhe prekëse të shtrydhura nga thellësia e zemrës, shkalla më e lartë e dashurisë është ajo në mos praninë, kurse prova më e dukshme e dëshmisë praktike është aderimi fizik në intimitet.

Shkencëtarët, poetët kanë qenë të magjepsur me manifestimin e saj, të gjithë janë përballur me të, në vetvete, përreth dhe jashtë vetes, kurse me mendjet e tyre të zemrës arritën të kuptojnë edhe atëherë kur ato u ndalën së menduari. Ajo është mrekullia e lidhjeve universale të vendosura në natyrë. Çdo gjë është në harmoni dhe përsosmëri hyjnore. Në lidhje me këtë flasin shumë ajete të Kur’anit Fisnik. Rreth vlerës dhe rëndësisë, të lejuarës dhe të ndaluarës, mënyrës së paraqitjes dhe mirësisë së përgjithshme, në mënyra të ndryshme, por koherente për të cilat flasin vetë ajetet kur’anore.

Sa i përket vetë titullit, mund të themi se përkthyesi i këtij libri në gjuhën shqipe bëri gabim që nuk e titulloi me “*Kopshti i përkëdheljes*”, siç është edhe titulli i librit të përkthyer në gjuhën boshnjake nga ajo angleze, edhe pse titulli origjinal i librit në gjuhën angleze është “*Sexuality in Islam*”. Në të janë të gërshetuara tema që janë unike për seksualitetin në Islam, duke filluar me: *Kur’ani*

dhe çështja e seksualitetit; ndalesat seksuale në Islam, femra e përjetshme dhe islame... deri te shkaqet e mirësisë dhe në perandorinë e nënave, ndërsa në fund: Përfundimi rreth krizës së seksualitetit dhe kriza e besimit në botën e sotme arabe-myslimane.

Libri *Seksualiteti në islam*, bart në vete një stil të larmishëm, ku është evidente qasja tradicionale dhe korpusi modern i nocioneve erotike, prandaj libri, përveç përshkrimit të përgjithshëm të koncepteve fetare të seksualitetit, thur edhe anën e kundërt e cila është ekskluzivisht e lidhur me ekstatën dhe orgazmën e pafundme.

5. IBN HALDUNI: JETA DHE VEPRA (HYRJE NË LEXIMIN E AL-MUQADDIMES)⁵



Trashëgimia

intelektuale

5. *Ibn Halduni: Jeta dhe vepra (Hyrje në leximin e Al-Muqaddimes)/Ibn Haldun: Život i djelo (Uvod u čitanje Al-Muqaddime)*, Enes Kariq/ Enes Karić; [Përktheu nga boshnjakishtja: Nexhat Ibrahimij] - Shkup: LOGOS-A, 2012 - 186 faqe; formati A-5, 21 cm, kapak i butë.

e Ibn Haldunit është unike në mesin e veprave të mendimtarëve myslimanë, e cila, pa marrë parasysh kalimin e shekujve, mban ende vlerën e saj edhe në mesin e mendimit bashkëkohor islam, kështu që ajo zë vend të veçantë në trashëgiminë intelektuale botërore. Por Ibn Halduni, veprën artistike dhe intelektuale të të cilit Perëndimi e zbuloi dhe analizoi, nuk është i vlerësuar plotësisht në Lindje, kujtimi dhe trashëgimia e tij është harruar dhe deri në kohët e fundit ishte e mbuluar me pluhurin e harresës. Në Perëndim janë shkruar libra të ndryshëm dhe studime kritike rreth tij dhe punës së tij shkencore, ndërsa në vendlindjen e tij dhe ambientin në të cilin dha kontributin intelektual e shkencor, pothuajse nuk është bërë asgjë. Ky, me të vërtetë, është një fakt i trishtueshëm dhe i dhimbshëm, ndërkohë që perëndimorët i njohën dhe përfituan prej margaritarëve të mendimit islam në veprat e Ibn Haldunit, myslimanët kanë fjetur në një gjumë të thellë mbi to.

Studimi i dr. Enes Kariq-it rreth ‘jetës dhe veprës së Ibn Haldunit’ në gjuhën boshnjake, shfaqet me edicionin e parë të plotë të Al-Muqaddimes, i botuar në dy vëllime të mëdha, që doli nga shtypi në fund të vitit 2007 nga shtëpia botuese “El-Kalem”, në përkthimin e dr. Teufik Muftić-it me rastin e festimit të 600 vjetorit të vdekjes së dijetarit dhe teoricienit më të madh të historisë, shoqërisë dhe

shtetit në botën myslimane, me një gjerësi të ndërhyrjeve kritike, dituri enciklopedike dhe talentin entuziast kërkimor, historian, politikan dhe filozof social.

Prof. Nexhat Ibrahimimi është një ndër personat me më shumë meritë për punën përkthyesë të literaturës islame boshnjake në gjuhën shqipe (nga viti 1990, deri më sot), i cili ishte shumë kureshtar dhe entuziast për përkthimin e veprave të autorëve boshnjakë (shumica shokë të tij nga ditët studentore në Fakultetin Teologjik Islam në Sarajevë) në gjuhën shqipe, me theks të veçantë në veprën profesionale e letrare të akademikut Enes Kariq.

6. NË KËRKIM TË THELLËSISË SË KALTËRSISË QIELLORE⁶



Nga zanafilla e njeriut, mendja e tij ishte e preokupuar me pyetjet

6. *Në kërkim të thellësisë së kaltërsisë qiellore/U potrazi za dubinama nebeskog plavetnila*, Enes Kariq/Enes Karić; [Përktheu nga boshnjakishtja: Nexhat Ibrahimimi] - Prishtinë: Instituti për shkencat humane “Ibni Sina”, 2014 - 224 faqe; formati A-5, 20 cm, kapak i butë.

thelbësore: në lidhje me origjinën e racës njerëzore, prej nga ekziston, qëllimit në këtë botë; pastaj: çfarë është e vërteta dhe realiteti, ku e çojnë suazat e jetës, dhe, në fund të fundit, cili është thelbi i jetës... Në këto dhe shumë çështje të tjera, “*njeriu natyror*” u përpoq të jepte përgjigje rreth *mrekullisë së natyrës së gjelbër, kaltërsisë qiellore, rrezeve të ngrohta të diellit, etj.* Është e pamundur të mos ndjejmë ngrohtësinë, harmoninë, magjepsjen dhe bukurinë që arrijmë në thellësinë tonë me anë të shqisave tona. Ne ndjejmë ngrohtësinë, marrim ajër të këndshëm në mjedisin aromatik, shikojmë në bukurinë e cila na magjeps, këpusim trëndafilin e butë dhe e ndjejmë butësinë e tij, shijojmë ujin e pastër dhe të ftohtë të natyrës me të cilin shuajmë etjen tonë në ditët me vapë dhe bëhemi të vetëdijshëm duke meditaruar se si e gjithë kjo është në harmoni hyjnore.

E si mos të jetë ashtu, kur syri nuk mund ta kthejë shikimin para ndriçimit të yjeve përpëlitës në qiellin e kaltër natën kur e gjithë bota bie në gjumë, dhe duke admiruar hënën e cila, lehtë e zbehtë, pasqyrohet në sytë e njeriut që vështron në të. E gjithë kjo e shpie njerëzimin të ngutet në përgjigjet e kërkuara për shumë pyetje që shpesh e çojnë në një gjendje të ekstazës dhe transcendencës së ndërjegjies së tij.

Libri: *Në kërkim të thellësisë së kaltërsisë qiellore (ese mbi fenë në shekullin XXI)*, është një kombinim mjeshtëror me faktin se në të ndërthuren delikatesa dhe materialja, shfaqjet metafizike

dhe fizike të kësaj bote - të lidhura veçanërisht me çështjet e fesë dhe besimit të njeriut në shek. XXI.

Në rreshtat e mëposhtëm, shkurtimisht, do të përmendim vëzhgimet tona në lidhje me preokupimet që autori përmend në këtë vepër:


Duket se autori dëshiron të tregojë, dallimin mes të ashtuquajturit “njeriut natyror” dhe “njeriut të kibernetikës”, dhe atë me pikëllim të madh, sepse ajo që dikur është nderuar dhe konsiderohej si vlerë, sot pothuajse nuk ekziston si një mënyrë e tillë jetese dhe vështrimi mbi natyrën dhe shenjat e saj, ndodhitë, bukuritë dhe çdo gjë tjetër që ishte cilësi e “njeriut natyror”, i cili e admironte kaltërsinë qiellore, dhe kërkonte përgjigje për shumë pyetje. Keqardhjen e tij autori e shpreh për arsye se sot kjo pothuajse nuk ekziston, ajri i pastër nga dendësia e trafikut dhe një numri të madh makinash, shumëllojshmëri gazrash dhe çdo gjë tjetër, që është cilësi e ‘njeriut teknik dhe teknologjik’ në epokën e kibernetikës.

Diskursi rreth Zotit dhe shpërdorimi i tij, përkatësisht, minimizimi i teologjisë në shoqëritë moderne Perëndimore Evropiane ku është marshuar si në epokën komuniste ashtu edhe sot me slogane se “*Zoti ka vdekur*” e të ngjashme, e që duket se autori paralajmëron se një qasje e tillë duhet të ndryshojë, dhe se si duhet të bëhet dialog, për mënyrat e reja produktive dhe të flitet me përgjegjësi për Zotin e për teologjinë në përgjithësi.

Që pritet e shkencizmit janë treguar objektive, dhe si të tilla nuk dhanë rezultate, siç përmendet edhe në përkthimin e këtij libri: “*Sipas Karen Armstrong, besimi në shkencizëm dhe shpresa se ai do ta tregojë rrugën, për më tepër do të sjellë deri te mirëqenia, në Perëndim sidomos, është lubatur me faktin e Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, përkatësisht të Holokaustit...*”.

Autori i këtij libri shpreh shqetësimin e “njeriut të dhunshëm”, i cili mund ta shkatërrojë civilizimin dhe atë që ne e njohim, përkatësisht shohim, dhe atë me shtypjen e një butoni, e që paraqet një kërcënim të madh për natyrën, për këtë arsye njeriu e tillë autori me të drejtë e quan “armik të natyrës”.

7. KUR’ANI - PËRKTHIMI I KUPTIMEVE⁷



Ky përkthim i Kur’anit i akademikut Enes Kariq, është

7. *Kur’ani - përkthimi i kuptimeve/Prijevod Kur’ana*, Enes Kariq/Enes Karić; [Përktheu nga gjuha boshnjake dr. Selim Sylejmani] - Gjilan: K.O. “KUR’ANI”, 2011 - 607+607 (teksti origjinal i Kur’anit në arabisht) faqe; formati A-5, kapak i fortë.

përkthyer nga gjuha boshnjake në gjuhën shqipe, siç u potencua më sipër, nga dr. Selim Sylejmani, me emërtimin *Kur’ani - përkthim i kuptimeve*. Doli nga shtypi në vitin 2011 në Prishtinë. Është botuar në formatin A5-, në 1000 kopje, me kapak të fortë.

Teksti i përkthimit bashkë me tekstin origjinal të Kur’anit në gjuhën arabe, fillon nga ana e djathtë në të majtë. Gjithsej ka 607 faqe të përkthimit dhe 607 faqe të tekstit origjinal të Kur’anit në arabisht. Në fillim të këtij përkthimi të Kur’anit pason: *Fjala e botuesit*, ku ndër të tjera thuhet se: “...synimi i stafit përkthyes ishte që veprimtaria kulturore islame të kurorezohej me Librin e shenjtë Islam - Kur’anin Fisnik, duke iu bashkuar karvanit të përkthimeve të mëparshëm të Kur’anit në gjuhën shqipe, duke u përpjekur që ky përkthim të ketë një stil të lehtë dhe të përshtatet me gjuhën moderne shqipe, të ruhet sa është e mundur, kuptimi origjinal i Kur’anit, megjithatë, se sa është arritur suksesi në këtë drejtim, u mbetet lexuesve që ta vlerësojnë vetë...”.

Sa i përket përkthimit të Kur’anit të dr. Enes Karić në gjuhën shqipe, besoj se me këtë gjest është bërë një përpjekje e mirë, duke nxjerrë në pah nevojën që kishte lexuesi shqiptar, për këtë arsye, e lus Zotin Fuqiptar, që ta shpërblejë mundin e përkthyesit dhe stafit të tij. Mirëpo, mendoj se ky përkthim i Kur’anit në gjuhën shqipe ka disa gabime të qarta, duke marrë parasysh edhe faktin se është një përkthim i përkthimit të Kur’anit.

8. ROMANI “KËNGËT E ZOGJVE TË EGËR”⁸



Romani “Këngët e zogjve të egër” i akademikut Enes Kariq, në gjuhën shqipe është përkthyer dhe botuar dy herë. Siç u përmend, për herë të parë u botua në vitin 2010 në Gjiilan nga: O.J.Q. “Drita” - Gjiilan, dhe e përkthyen në gjuhën shqipe: dr. Xhabir Hamiti dhe Musli Imeri. Ndërsa herën e dytë u botua në vitin 2015 në Tiranë nga “POETEKKA”, përkthyer nga: Don Andoni.

Shkrimtari bashkëkohor boshnjak, Enes Kariq, është një nga emrat më të njohur në hapësirën letrare të Ballkanit. Më në fund ai i shtohet gjerdanit të botimeve në Shqipëri me prozë bashkëkohore nga Ballkani.

Ndodhi të izoluar, pa peshë në shoqërinë me rrënjë të forta mirëkuptimi - të paktën në rrafshin religjioz - apo tregues që vënë në pikëpyetje themele dhe të bëjnë

8. Romani Këngët e zogjve të egër / *Pjesme divljih ptica*, Enes Kariq / Enes Karić; [Përkthyer nga boshnjakishtja: dr. Xhabir Hamiti dhe Musli Imeri] - Gjiilan: O.J.Q. “Drita” Gjiilan, 2010 - 348 faqe; formati A - 5, 21 cm, kapak i butë.

të kuptosh se historia na qenka njëmend ciklike, ku papajtueshmëritë rikthehen në mënyrë identike, duke prodhuar më pas konflikte? Kjo bën t’i kthehesh së shkuarës e ta gesh veten aty, në kërkim të një përgjigjeje të urtë, siç vjen edhe romani i shkrimtarit boshnjak Enes Karić “Këngët e zogjve të egër”.

Një fakt i rëndësishëm, që duam ta përmendim, i cili e lidh fijen e pa këputur të një tradite të njëjtë, multikulturore dhe multifetare, është bashkëjetesa mes feve dhe adhuruesve të tyre, e cila paraqet përditshmëri brenda komunitetit. Pra, një atmosferë e ngjashme me atë të përmendur në romanin e dr. Enes Kariq, mbretëronte, dhe ende mbretëron, në Shqipëri dhe në Kosovë. Një qytet si Sarajeva dhe Mostari në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe bashkëjetesa ndërfevare në to, mund t’i ngjajë Beratit në Shqipëri apo Prishtinës e Prizrenit në Kosovë, kështu që ka ngjashmëri thelbësore mes tyre; e që e gjithë kjo kishte rëndësi të veçantë që romani “Këngët e zogjve të egër” të përkthehet dhe të botohet në Kosovë dhe Shqipëri.


Panorama me sfond politik, kulturor, me pranim dhe përplasje mes dy qytetërimeve, që përplas fort mes tyre edhe njerëzit, e ku linja dashurie vetëdijë, rrëfëhet përmes një fëmije (Skender Humo) që rritet dhe vëzhgon se si përballë syve të tij gjithçka ndryshon me

vrull. Pasi ka studiuar dhjetë vjet në medresetë e Stambollit (1570-1580) dhe pesë të tjera në Firence (1580-1585), duke mësuar shkencën e astronomisë, ai kthehet në Sarajevë. Çfarë identiteti ka ky njeri i ushqyer prej dy burimeve të dijes? A ndihet i huaj, përballë kulturave? Si e perceptojnë atë njerëzit e tij pas kthimit nga Perëndimi? Ku fshihet dhe ku qëndron dallimi esencial mes dy dashurive: dashurisë për njeriun dhe dashurisë së pafundme për Zotin? A do të kishte mundësi që ky njeri të hidhte tulla dhe gurë ndaj kundërshtarëve? A do të jetë më i aftë të bjerë sërish në dashuri me kulturën, vendlindjen, njerëzit e tij?

Nga pyetjet e parashtruara, vërejmë dhe nxjerrim konkluzionin se këto çështje janë ende aktuale në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe Shqipëri. Në fakt, ekzistojnë dy diagonale të nënvizuara brenda këtyre shoqërive: **E para** është se myslimanët (boshnjakët dhe shqiptarët), kanë identitet Lindor (të lidhur me Perandorinë Osmane), ndërsa **e dyta** është se myslimanët e Ballkanit kanë identitet Perëndimor (të lidhur me Evropën). Për mendimin tim, të dy këto justifikime janë të gabuar. Myslimanët e këtij rajoni kanë një lidhje të pandarë me Osmanlinjtë, në fund të fundit, Islami si fe është përhapur në këtë rajon në përmasa të mëdha me ardhjen e Osmanlinjve, por, megjithatë,

myslimanët e Ballkanit, kanë dhe duhet të kultivojnë të njëjtën lidhje edhe me Evropën, në fakt, ata edhe jetojnë në Evropë.

9. ROMANI “VARREZA ÇIFUTE”



Në fillim, të sqarojmë vetë titullin e romanit “Varreza çifute”, - këtu nuk bëhet fjalë për vuajtjet e çifutëve, por vuajtjet e tyre historike sigurisht që kuptohen si një metaforë, si një paradigmë për rrethimin e Sarajevës, për të cilën edhe bëhet fjalë në këtë roman. Toponimi i varrezave të vjetra çifute të Sarajevës, gjatë rrethimit të Sarajevës, ishte një vend ku qyteti është bombarduar nga forcat e Radovan Karadžić-it, por, në roman, kjo nuk është temë kryesore. Në varrezat çifute, në fillim të luftës, në qytet hyjnë personazhet kryesore të romanit, katërmbëdhjetëvjeçari Sadik Dobrača dhe motra e tij Suada,

9. *Varreza çifute/Jevrejsko groblje*, akad. Enes Kariq/akad. Enes Karić; [Përktheu nga boshnjakishtja: Agim Leka] - Shkup: Shtëpia botuese LOGOS-A, 2016 – 623 faqe; formati A- 5, 20 cm, kapak i fortë.

të cilët u kapën nga forcat serbe në fshatin Vragollovi afër Rogaticës, me qëllim që të shkëmbehen me snajperin serb - kriminelin e madh çetnik e vrasës, i cili është kapur nga ushtria mbrojtëse e Sarajevës në një nga aksionet e saj. Dhe ngjitur me varrezat hebraike, në një bodrum, Sadiku dhe motra e tij Suada gjetën strehim.

Romani zhvillohet në dy plane kryesore - **i pari** është një luftë për mbijetesë e dy të zënëve rob, në ferrin e Sarajevës, ku në çdo hap është reflektuar kafshëria e shtazëria, por edhe humanizmi i vetë popullit; **plani i dytë** është një spektakël i çështjeve politike, teologjike dhe filozofike të mbijetesës së boshnjakëve dhe vetë Bosnjës, pyetjet që i kishte hedhur lufta shfarosëse, pyetje të cilave edhe sot e kësaj dite nuk është dhënë ndonjë përgjigje.

Tregimi i përgjithshëm i romanit është i vendosur në Leiden të Holandës, në kafe-librarinë “Erasmus Rotterdamus Bookstore”; ku flasin refugjatët boshnjakë Sadik Dobrača dhe shoku i tij, ish oficer i Unproforit, me emrin Kristijan. Bashkëbisedimi kthehet në një monolog të Sadikut, tregimit rreth fëmijërisë së tij dhe ditëve të mitura në fshatin e tij të lindjes në afërsi të Rogaticës, në lidhje me shkëmbimin e tij të pazakontë me snajperin serb, arsye kjo për të cilën edhe është “futur” në Sarajevën e përgjakur, për jetën në Sarajevën e gjatë luftës,

mërgimin e tij për në Holandë..

Nga kjo mënyrë, autori dëshiron që pamjen e vetë mjedisit të tij amë - rrymës dominuese të tij intelektuale dhe politike - ta zhvendosë në kufijtë e shoqërisë, pra, në atë hapësirë që (duhet) të natyralizohet vizioni i besueshëm tregimtar, si një vëzhgues neutral, dhe me këtë të japë një garanci të besueshme të verifikimit të idesë së mundur sakrocentrike të pajtimit social që promovon romani. Por që, duke pasur parasysht karakterin e vet por edhe vetë përmbajtjes, shtylla e plotë kurrizore e romanit paraqet një lloj kronike të ngjarjeve kyçe politike dhe historike, të zhvilluara kryesisht në qarkun e elitës intelektuale dhe të asaj politike sarajevase, në një nga hotelet e njohur të Sarajevës “Hollyday Inn”..., e gjithë kjo në verën e vitit 1993, ku u zhvillua takimi i rëndësishëm rreth fatit të vendit dhe popullit, përcaktohet strategjia ushtarake dhe e luftës politike, e vendoset rreth ndërrimit të emërtimit Myslimanë në Boshnjakë, etj.

Romani “Varrezat çifute” i akademikut të mirënjohur boshnjak, Enes Kariq, mund të karakterizohet si një sintezë e parë e madhe e therjes “vëllavrasëse”. Me paraqitjen brilante letrare, gjuhës së rafinuar, urtësisë së qetë dhe lirizmit të rastit, na paraqitet njëra nga pjesët më të përgjakshme të historisë së popullit boshnjak.

Në vend të përfundimit

Në Bosnjë dhe Hercegovinë, një ndër të paktët, prej bashkëkohësve është edhe akademiku Enes Kariq, puna shkencore e të cilit përkthehet, mes të tjerash, edhe në gjuhën shqipe, dhe atë me interes dhe kënaqësi të madhe. Me siguri dikë do ta stimulonte pyetja se: *Përse përkthehen veprat e akademikut Kariq në gjuhën shqipe? Ka disa arsye, ndër të cilat do veçonim vetëm tri:*

- *Nevoja e kohës;*
- *Ne “myslimanët” jemi një trup;*
- *Njohja e lexuesit shqiptar me punën e njërit prej mendimtarëve të rrallë islam sot, jo vetëm në Bosnjë dhe Hercegovinë, por dhe më gjerë.*

E para, dhe sigurisht më e rëndësishmja, është se në qoftë se vepra është e shkruar në frymën e kohës dhe i përmbush nevojat e myslimanëve në një kohë të caktuar, ajo përhapet me shpejtësi dhe shfaqet nevoja e përshpejtuar e përkthimit të saj në gjuhë të tjera. Këto kushte sigurisht që i plotësojnë veprat e dr. Kariq. Një korpus i gjerë, cilësi, analiza e thellë dhe paraqitja e thukët tërheq vëmendjen e lexuesve që ndjejnë kënaqësi me përmbajtjen,

shprehjet dhe stilin e pasur. Kjo vlen edhe për lexuesit e popullatës shqiptare, kudo që ata jetojnë dhe veprojnë. Sa i përket nevojës së përkthimit të veprave të akademikut Kariq në mesin e popullatës shqiptare sigurisht që zë një pozitë të rëndësishme, pa marrë parasysh për çfarë shtrese bëhet fjalë.

E dyta, pavarësisht nëse një mysliman jeton në Pakistan, Kazakistan, Bangladesh, Bosnje e Hercegovinë, Shqipëri e Kosovë, të gjithë ata i lidh i njëjti ideal i lidhjes shpirtërore. Deri në vitet 80 - 90 të shek. XX, Sarajeva ishte qendra islame në Ballkan dhe lidhja shpirtërore e myslimanëve të rajonit, dhe për këtë arsye lidhja mes myslimanëve të rajonit gjithmonë ka qenë e palëkundur dhe e fortë, e cila herë-herë ftohej, sidomos pas viteve 90 - të shekullit të kaluar.

Dhe e treta, ajo që është më e rëndësishme për çdo individ ose shoqëri, të kuptuarit e asaj çfarë lexojnë, efekti më i fortë dhe më i thellë për këtë arrihet kur një person e lexon në gjuhën e tij amtare. Prandaj, ky është një prej qëllimeve të përkthimit të veprave të Enes Kariq-it në gjuhën shqipe.

Haxhi Hafiz Mahmud Dashi (1873-1961)

I dekoruar për veprimtari patriotike

Abstrakt

Veprimtaria e Haxhi Hafiz Mahmud Dashit ishte shumë e gjerë. Në rrafshin pedagogjik ai la gjurmë të thella te shumë nxënës, mjaft prej të cilëve punuan e u afirmuan si personalitete të shquara kombëtare e fetare, arsimore e kulturore, në mes të cilëve shquhen studiues të shquar orientalistë si Vexhi Buharaja, teologë e studiues si Hasan Selami, Ejub Fashia, Haki Repishiti, studiues si Shaban Demiraj në fushën filologjike, etj.

Veprimtaria atdhetare e Mahmud Dashit është vlerësuar me dekoratën “për veprimtari patriotike”, për një aktivitet të pandërprerë në dobi të kulturës kombëtare.

Kështu, teologu dhe pedagogu i shquar ka hyrë me dinjitet në historinë e kulturës shqiptare e të arsimit në veçanti, duke mbetur një shembull i madhërisëm i edukatës dhe i kulturës shqiptare.

Shkenca e edukimit bashkëkohor, përfshirë edhe pedagogjinë, shkrijnë në një veprimtarinë edukative të teologut, pedagogut, didaktit, kur këto fusha janë zhvilluar në nivelin e duhur. Këto drejtime veprimtarie janë harmonizuar e shkrirë natyrshëm në personalitetin e Haxhi Hafiz Mahmud Dashit nga Tirana.

I lindur në Tiranë në vitin 1873,

Mahmud Dashi trashëgoi traditën e pasur të familjes e të paraardhësve të tij në fushën fetare e atdhetare, me aftësinë e theksuar rrezatuese te mikro e makromjedisi i tyre nëpërmjet fjalës së zgjedhur e të argumentuar, e cila natyrshëm shkonte drejt e në zemrat e mendjet e të pranishmëve. Ai ishte një interpretues i aftë i Kur’anit dhe i Hadithit. Punoi si profesor i jurisprudencës islame në Medresenë e



Përgjithshme të Tiranës deri në vitin 1961, kur ky institucion u mbyll nga regjimi monist, vit në të cilin ndërroi jetë edhe hafizi.

Mahmud Dashi i dha përparësi të veçantë punës edukative me njerëzit, duke nënvizuar se, nuk ka njeri të paedukueshëm, se me njeriun duhet menduar e gjetur gjuha, që edhe ujku të zbutet, e të mos mbetemi duke u marrë vetëm me qingjat.

Veprimtaria e tij ishte shumë e gjerë. Ai nuk mjaftohej vetëm me ngarkesën mësimore në Medresenë e Tiranës, por punoi edhe si predikues në xhaminë e rrugës së Kavajës, e cila sot quhet “Xhamia e Haxhi Hafiz Mahmut Dashit”.

Veprimtaria e tij pedagogjike la gjurmë të thella te shumë nxënës, mjaft prej të cilëve punuan e u afirmuan si personalitete të shquara kombëtare e fetare, arsimore e kulturore, në mes të cilëve shquhen studiues të shquar orientalistë si Vexhi Buharaja, teologë e studiues si Hasan Selami, Ejub Faslia, Haki Repishti, studiues si Shaban Demiraj në fushën filologjike, etj.

Veprimtaria atdhetare e Mahmud Dashit është vlerësuar me dekoratën “për veprimtari patriotike”, për një aktivitet të pandërprerë në dobi të kulturës kombëtare.

Kështu, teologu dhe pedagogu i shquar ka hyrë me dinjitet në historinë e kulturës shqiptare e të arsimit në veçanti, duke mbetur një shembull i madhërishtëm i edukatës dhe i kulturës shqiptare.

Ai në medrese jepte mësim lëndën e besimit, bazën e Fesë islame, themelin e saj, sepse çdo punë e veprimtari që bën njeriu gjatë gjithë jetës së tij, ngrihet mbi bazën e besimit të tij të sinqertë: Paqe me Zotin, me shoqërinë e vetveten.

Lëndën e besimit që ai ia mësonte nxënësve e shtrinte në tre plane:

a) Në planin vertikal - që përfshinte marrëdhëniet e njeriut me Krijuesin e gjithësisë. Si ta njohim, ta besojmë, falënderojmë e të punojmë me këshillat e Tij, t'i lutemi e adhurojmë vetëm Atë, vetëm tek Ai të mbështetemi, shpresojmë e pendo kemi.

b) Në planin horizontal, shpjegonte si duhet t'i ndërtojmë marrëdhëniet tona me shoqërinë, me komunitetin, me fqinjët, farefisën, prindërit, familjen, fëmijët.

c) Në planin vetjak. Mësimet e Fesë islame që i mësonte mësues H. Mahmud Dashi nxënësve, theksonin se, njeriu që lind, lind pa mëkate, nuk trashëgon e nuk përgjigjet për mëkatet e paraardhësve, qofshin prindërit; i mësonte atyre si të veprojnë me vetveten, si ta ruajmë trupin që Krijuesi i gjithësisë na e ka dhuruar të përsosur, na e ka dhuruar ta ruajmë, ta mbrojmë, ta vemë në dispozicion të shoqërisë, ta njohim botën, ta studiojmë atë, ta ndryshojmë në dobinë tonë, të veprojmë pozitivisht mbi të e jo ta shkatërrojmë.

Haxhi Dashi ishte fjalëpakët, fliste ngadalë, me zë të ulët, por fjala e tij ishte bindëse e zinte vend, sepse shqiptohej nga goja, por ajo dilte nga zemra, mendja e shpirti i tij; ishte fjalë e veprë, prandaj mësimet e Islamit që ai mësonte nguliteshin në mendjet e nxënësve.

Ai kishte marrëdhënie shumë të mira me nxënësit, shpjegonte qartë e kuptueshëm me shumë shembuj konkret. I inkurajonte ata gjithmonë, i afronte, kurrë nuk i ndëshkonte dhe i bënte për vete me respektin reciprok.

I pëlqenin aktivitetet kulturore e sportive që nxënësit zhvillonin në kohën e lirë. Nxënësit kishin gjithashtu grupin teatral dhe përgatisnin shfaqje, si historinë e Hz.

Jusufit, dramën Halili dhe Hajrija, elegji për Qerbëlanë, këndimin e Mevludit, etj. Ai i ndiqte me dëshirë shfaqjet që jepeshim në sallën e shkollës.

Sa i afërt ishte me nxënësit aq edhe autoritar ishte, por jo me imponim. Respektin e fitonte me qëndrimin e tij, me gatishmërinë e tij për t'i ndihmuar nxënësit në çdo gjë që ata pyesnin.

Gëzonte autoritet dhe respekt dhe ndaj kolegëve e pedagogëve të tjerë që jepnin mësim në medrese.

Bisedat e tij ditëve të premtë ishin të goditura dhe aktuale dhe dëgjoheshin me vëmendje nga xhemati dhe nga nxënësit që shpesh shkonin për të falur xhumanë atje.

Ai ishte i afërt me besimtarët që frekuentonin xhaminë dhe interesohej për ta, për nevojat e shqetësimet e tyre dhe shpesh i vizitonte ata dhe në shtëpitë e tyre. Nga të gjithë ishte i respektuar.

Botimi i librit “Haxhi Mahmud Dashi” nga z. Xhemal Balla është shumë kuptimplotë dhe një mesazh me vlera aktuale që na fton në besimin e Zotit të Vetëm-Krijuesit të gjithësisë, na fton të jetojmë në paqe, harmoni, ndershmëri, sinqeritet e devocion, larg çdo keqbërje, ngaqë kjo jetë është vetëm një provë.¹

1. Për më tepër shih: Balla, Xhemal, “H. H. Mahmut Dashi, jeta dhe vepra”, Tiranë, 2010.

Njeriu dhe Gjithsia

I

Abstrakt

Njeriu ka kapacitet me gjykue e me arsyetue; pra është i lirë me zgjedhë e me veprue e për këtë shkak është përgjegjës për veprën e tij.

Fisnikërin e një krijese nuk e shkaktojnë cilsit e përbashkëta qi e shoqërojnë me inferiorët e saja, por cilësija karakteristike qi e dallon nga këta inferiorë. Njeriu pra me fuqin e arsytimit e të vullnetit të lirë ka një jetë të mbrendëshme, një jetë tejsbqisore qi quhet “jeta njerzore”.

Në ka një të vërtetë të provueme edhe ajo është qi “as gjá në botë s’është kot më kot, por ka një qëllim” është destinue për një qëllim të parapamë mbas një projektit eternel.

Të gjithë dijetarët kanë pranue një të vërtetë, por janë ndà më dysh: disa pretendojnë se “e vërteta është dhe njeriu vetëm e zbulon” e disa të tjerë thonë se “e vërteta s’është por e krijon njeriu me mendjen e tij”.

E kuptojnë lexuesit e ndershëm vetvetiut se sa të drejtë ka pjesa e parë e sa gabim ka pjesa e dytë, sepse në goftë se nuk ka një të vërtetë atëherë edhe njeriu vetë është një gënjeshtër, një rrenë, një e pa vërtetë. E si bâhet pra, qi një i pavërtetë, një rrenë, një gënjeshtër të mundet me krijue një të vërtetë. Këjo gjá është absurd dhe ato qi janë në këtë mejtim kanë gabim.

Prandaj dalim në përfundim e themi se “e vërteta është dhe njeriu vetëm e zbulon”. Misioni i njeriut pra është vetëm “me zbulue të vërtetën qi është e qi ka qenë para se të dalë në shesh njeriu”.

Njjeriu, kreatyra mâ naltë në botë, qysh në fillim të jetës së njerzimit ka përpjekë përballë problemit enigmatik të vetvetes dhe të gjithësis. Ay ka pyetë vetvehten “Ç’jam unë?”,

“Ç’është gjithësija?” Këto dy pytje kanë fillue bashkë me njerzimin dhe vazhdojnë hala edhe sod. Përgjigjet e dhanuna drejt për drejt me anën e fuqis mendore nuk kanë mundë me e kënaqë ndërgjegjen e njeriut.

Mirpo njeriu paska pasë natyrë të çudiçme; aj pa u lodhë kërkon; kërkon me i u përgjegjë dy pyetjeve të më sipërme: “Ç’jam unë?” edhe “Ç’është gjithësija?”. Kërkon me zgjidhë këto dy problema.

Tue studjue vetvehten e tij njeriu përpjek në makinën e çudiçme të trupit të tij, makinë e gjallë e trajtueme prej elementeve fizike qi formojnë gjithësinë.

Njeriu tue pá ketë marredhanje të ngushtë qi ka me gjithësinë len mbas doret vetvehten dhe veshtron gjithësinë.

Kur veshtron gjithësin qi i themi natyrë, i duket se e gjeti formulën për me zgjidhë enigmat qi e mendojnë. Shef gjanat e natyrës dhe i krahason midis tyne; të gjitha i gjenë të traitueme prej të njajtat elemente fizike dhe i vetmi ndryshim qi shef ndër to është mënyra e formimit të tyne.

Kështu fillon dituri ja e njeriut qi quhet “Shkenca”, e cila tue marrë për bazë gjendjen e trupave i ndan këto në tri grupe të mëdha: a) Shtânge, b) lîngje, c) gaze.

Nji trup me anën e nji fuqije qi ndihet e nuk shifet e qi quhet nxehtësi ndryshon gjendjen e tij. Kur ngrihet grada e temperaturës shtângjet këthehen në lîngje e lîngjet në gaze e, kur ulet këjo gradë gazet këthehen në lîngje e lîngjet në shtângje.

Tue bâ këta studime njeriu zbulon ligjët e nxehtësinës; por vetë nxehtësina mbete gjâ e paspieguëshme; pse ajo duket nepër

landë, porse vetë nuk është landë. Mundohet shkenca me na e spiege, por gjithmon spiegon ligjët e saj e jo até vetë.

Deh more hall! Tue kërkue me zgjidhë dy enigmat e para na doli e treat e pzgjidhëshme! Hik të hikim e të këthehemi atje ku filluëm: “Ç’jam unë?” e “Ç’është gjithësija?”.

*

* *

Njeriu prapë s’rrin; kërkon me gjetë rrugë e me zgjidhë problemin qi e mundon. I merr përsëri nëpër dorë trupat e natyrës dhe i veshtron në nji pikpamje tjetër; mbas ndryshimit qi gjen midis tyne i grupon edhe nji herë me nji sistem tjetër: a) xehe, b) bimë, c) shtazë.

Xehet janë formue prej elementesh materjale të mbërthyeme midis tyne prej nji fuqije misterjoze qi vepron pa dá.

Këjo fuqí misterjoze bimëve i u shton nji gjâ të ré: *jetën organike*, me anën e së ciles ato ushqehen, rriten dhe e vijojnë farën e tyne.

Fuqija misterjoze qi vepron në natyrë, shtazëve i u shton edhe nji gjâ tjetër: *ndjenjën*, me të cilën shtazët ndijnë të kënaqunit e dhimbjen.

Kur vjen puna ke njeriu, këtë shofim se shtohet edhe nji kapacitet tjetër: *“gjykimi dhe arsyetim?”*.

Në këtë grupim të dytë i duket njeriut se e gjeti fijen e zberthimit të pyetjeve “Ç’jam unë?” e “Ç’është gjithësija?” edhe kështu vazhdon studimin e tij:

Shtazët me fuqit e ndjenjes, me anën e shqisave njoftin rrethin e tyne; mbajnë mend dhe sjellin ndër mend ata qi kanë ndi e qi kanë njoftë e, të shtymë prej tyne, vepronë: por veprën e tyne s'e kuptojnë marrëdhanëjet qi kanë gjânat e natyrës midis tyne për shtazët janë të pa njoftuna; ata s'kanë vetëdije.

Njeriu ka një pajë mâ të madhe, menden me të cilën ka kompetencë me njoftë e me dijtë marrëdhanëjet e gjânave; me hetue e me dhanë përfundime logjike; me çmue e me parapa; me kompozue propozita e me nxjerrë përfundime logjike, me kuptue nga të njoftunat e të panjoftunat.

Asht e vërtetë se edhe shtazët çfaqin shenja vullneti; kanë dëshira; zgjedhin e pëlqejnë. Por këjo gjâ është një instinkt e jo fryti i arsyes; ata vepronë nën influencën e rrethit e nuk kanë gjykim të vetin; prandaj shumë herë vepronë në dâm të vet.

Ky është shkaku për të cilin shtazët s'kanë responsabilitet.

*

* *

Kur vijmë ke njeriu ndryshon puna krejt. Njeriu ka kapacitet me gjykue e me arsyetue; pra është i lirë me zgjedhë e me veprue e për ketë shkak është përgjegjës për veprën e tij.

Fisnikërin e një krijese nuk e shkaktojnë cilsit e përbashkëta qi e shoqërojnë me inferiorët e saja, por cilësija karakteristike qi e dallon nga

këta inferiorë. Njeriu pra me fuqin e arsyetimit e të vullnetit të lirë ka një jetë të mbrendëshme, një jetë tejsHQisore qi quhet "*jeta njerzore*".

Në ka një të vërtetë të provueme edhe ajo është qi "as gjâ në botë s'është kot më kot, por ka një qëllim" është destinue për një qëllim të parapamë mbas një projektit eternel.

Xehet në realizimin e qëllimit, për të cilin janë destinue, s'kanë fuqit as me dhanë përkrahje as me kundërshtue; por qendrojnë ashtu si janë.

Bimët janë të shtrëngueme me thithë ushqimin qi u duhet, me u rritë e në fund me lanë farën e tyne për bimën e re.

Shtazët në ketë pikpamje kanë një pjesë mâ të madhe e mâ të randësishme: Ata kërkojnë atë qi është e dobishme, shtëmangen nga ajo qi i damton, ndijnë të kënaqun e dhimbje; por nuk e dijnë se janë të destinueme për një qëllim, as nuk e dijnë se për se janë destinue. Prandaj vepra e shërbimi i tyne rrjedhin vetvetiut e pa parapamje të tyne.

Vetëm njeriu u pajue me cilësin e natë qi t'a çmojë se është destinue për një qëllim e qi e ka detyrë me u përpyekë për të realizue ketë qëllim.

Cili është ky qëllim, të cilin duhet t'a realizojë njeriu? Cili është misjoni i njeriut?

* *

*

Si shifet, edhe sistemi i dytë i grupimit të gjânave të natyrës

e studimi i tyre nuk na i zgjidhën problemat që na u çfaqën në krye të herës: “Ç’jam unë?” e “Ç’është gjithësija?”.

Ky farë studimi veç që nuk na i zgjidhi dy problema, por na qiti edhe ky një problem të ri: “Cili është misjoni i njeriut?”.

Përpara këtij larbirinthe njeriu, në qoftë se hesht, ulet në shkallë të shtazëve. Prandaj heton, gjurmon, imton dhe kërkon me gjetë rrugë për të zbrërthye problemin që e mundon.

*

* *

Të gjithë dijetarët kanë pranue një të vërtetë, por janë ndà më dysh: disa pretendojnë se “e vërteta është dhe njeriu vetëm e zbulon” e disa të tjerë thonë se “e vërteta s’është por e krijon njeriu me mendjen e tij”.

E kuptojnë lexuesit e ndershëm vetvetiut se sa të drejtë ka pjesa e parë e sa gabim ka pjesa e dytë.

Se pse në qoftë se nuk ka një të vërtetë atëherë edhe njeriu vetë është një gënjeshtër, një rrenë, një e pa vërtetë. E si bâhet pra, që një i pavërtetë, një rrenë, një gënjeshtër të mundet me krijue një të vërtetë. Këjo gjâ është absurd dhe ato që janë në këtë mejtim kanë gabim.

Prandaj dalim në përfundim e themi se “e vërteta është dhe njeriu vetëm e zbulon”. Misjoni i njeriut pra është vetëm “me zbulue të vërtetën që është e që ka qenë para se të dalë në shesh njeriu”.

Cila është këjo *e vërtetë* dhe

a mundet njeriu t’a zbulojë me mendjen e tij?

Ky është problemi i madh që preokupon trût e njerzís qysh në fillim e deri sod e ka me e preokupue deri sa të soset jeta.

Për t’a diktue këtë pikë njeriu ka marrë në studim e në veshtrim dy gjâna: “Vetvehten” edhe “Gjithësin” edhe kështu ka parashture pyetjet “Ç’jam unë?” e “Ç’është gjithësija?”.

Kështu lindi ay produkt i mendes njerzore që quhet filozofi.

* *

*

Sistemet filozofike mâ të para

Tue studjue njeriu vetvehten edhe gjithësinë ka diktue dy duër ngjarjesh: a) Ndiijimet, me të cilat lidhet me botën e jashtme; b) ndjenjat e mbrendshme ase vetëdijen.

Ata dijetarë që morrën para sysh vetëm botën e jashtme i u dhane fuqí ndijimevet të jashtme dhe kujtuën se çdo gjâ qëndron vetëm në fuqín e shqisavet dhe kështu caktuën doktrinën e tyre që quhet “Sensualizëm”. Ata që ndjekin këtë sistem filozofik besojnë se krejt lëvizjet mendore e kanë burimin tek shqisat. Ky sistem filozofik i mbështetun vetëm në provën e ndijimit u quejt edhe *empirismë*, prej të cilës doli *materjalizma* që beson se veç materjes, veç lândës, nuk ka tjetër të vërtetë.

Kundra këtij sistemi revoltun një pjesë tjetër që merr para sysh ngjarjet origjinale të intelektit. Këjo pjesë

nuk merr fare para sysh ndijimet, por gjithë rëndësinë j'ua nep ngjarjeve origjinale të mendës. Këjo doktrinë quhet “*idealizëm*”, prej të cilës rrjedh (Spiritualizma e thjeshtë) qi mohon fare ekzistencën e materjes.

Sensualizma dhe idealizma me ekstremismën e tyre kundra njana tjetrës ranë në kundërshtim me një parti të tretë, e cila, për të shpëtue nga gabimet e së parave kapi rrugën e dyshimit dhe u quejt “*Sheptiqizëm*”. Këjo parti pretendon se nuk ka një të vërtetë të qartë e të padyshimtë.

Veç këtyne ka edhe një doktrinë tjetër, *pantheizma*, e cila e përcolli mendjen në një greminë, prej kah nuk delet më. Mbas kësaj doktrine e *sosmja* dhe e *pasosmeja* janë një substancë e vetme, edhe këjo është gjithësija.

Disa dijetarë të dishpëruëm nga gjithë këto kundërshtime mendore e tue p'a se të gjitha përpjekjet qi kanë b'at filosofët për të mbr'i të vërtetën nuk dhanë ndonji fryt pozitiv u tërhoqën me një anë dhe gjith fuqin e tyre j'ua dhanë kontemplimit, inspiratës e ekstazhit, tue besue se këjo është e vetmëja rrugë qi e përcjell njerinë ke e vërteta e amshueme. Këjo parti është partija e “*illuminismit*”.

Nga gjith këto sisteme filosofike lindën dega të dyta e të treta me doktrina të ndërlikueme e të ngatrueme, sa qi asnj'ana s'ka mundë me i shpëtue kritikës.

* *
*

Qi t'ua përmbledhim mendimin t'onë të përderdhun kaqë gjatë themi se:

Të gjithë filosofët pranojnë një fill të vërtetës, prej të cilit ka burue gjithësija dhe jeta.

Ç'është mbetet qi t'ua njofim këtë fill e kështu t'ua zgjidhim problemin e vështirë e t'i përgjigjemi pyetjeve “Ç'jam unë?” e “Ç'është gjithësija?”.

Ndër disa të rij shqiptarë mjerisht shofim një rrymë të re, rrymën atheiste; ata thonë se “Ç'na duhet ne të dijmë si ka fillue bota, mbassi këjo gj'at na përcjell në prehnin e fës e të klerit; feja është krijesa e fantazis njerzore dhe s'ka bazë të vërtetë; kleri është një turmë njerëz qi kërkojnë të ushqehen në kurriz të popullit; mësimet fetare janë të damshme dhe të rrezikëshme, pse mundohen t'ua mbajnë në një skëllaveri të përjetëshme njerzën e thjeshtë; qytetërimi i vërtetë mund të qendrojë vetëm n'ato vende ku ka liri mendimi...”.

Na vjen keq për këtë riní, në të cilën e ka mbështetë shpresën krejt kombi. Këjo djelmëni e re qi kërkon lirin e mendimit, për të cilën duhet t'ua lavdërojmë dhe e lavdërojmë me gëzim, për këtë dorë të rijsh pra na vjen keq, kur shofim se harrojnë qi në proporsion të liris së mendimit qi gëzojnë e qi gabimisht kujtojnë se i ua ka rrëmbye kush, kanë edhe detyra e përgjegjësí.

Me kërkue liri të pakufishme, don me thanë marrë për sipër detyra të pakufishme.

Harron djelmënija e ré se detyra mâ e parë e saj âsht me njoftë detyrat qi ka. Harron djelmënija e ré se, e vetmëja cilësi qi e dallon nga shtazët, âsht aftësija qi j'u dha njeriut për të kuptue se ka një misjon, drejt të cilit i drejton gjith veprimet e veta.

E dijmë fort mirë se krejt rinija nuk janë të këtij mejtimi; edhe ata qi janë të këtij mejtimi bile janë të gabue pse nuk i dijnë bazat e vërteta të fës hyjnore.

Feja mâ e pa njoftun ndër të rijt t'onë âsht ajo e Islamit; për ketë fé të naltë rinija shqiptare ka studjue vetëm kritikën e gabueshme dhe të pathemelta të kundërshtarëve të saj edhe gjendjen e disave prej klerit aktual t'elementit mysliman të soçëm. Harrojnë se tjetër gjâ âsht kleri dhe sjellja e tij e tjetër gjâ âsht feja.

* *
*

Mâ poshtë do t'i spiegojmë bazat esenciale t'Islamit e tash një herë po shofim gabimin e madh e të pafalshëm të rinis që përmblihet me këta dy fraza të shkurta:

“S’ka Zot; gjithësija ka qenë dhe rregullohet vetiut; njeriu âsht përmirsimi i një forme mâ të ulët qenëjeje; ç’na duhet ne të dijmë si filloi bota?...”

*
* *

Ç’âsht këjo babiloní mendore?
– Më një anë kërkohet lirí-mendimi e n’anë tjetër kërkohet shtrëngimi

i mendes qi mos të mejtohet mbi fillimin e botës!

Më një thohet se njeriu âsht përmirsimi i një forme mâ të ulët qenëjeje e m’anë tjetër pretendohet se do të vijë koha qi shkenca do të fabrikojë njerëz gjení!...

Ç’qenka këjo natyrë e çudiçme qi në fillim përmirsoi një formë mâ të ulët qenëjeje dhe e bâni njeri e tash e harroi ketë mjeshtëri, të cilën pa pandehun po e zavendëson me fabrikën qi do të produktojné njeri?

Po t’i thohet Atheistit se *disa materijale të grumbullueme në një fushë, vetvetiut u rregulluën dhe trajtuen një ndërtesë, nuk ka për të besue kurrë*, kurse më anë tjetër pretendon se gjithësija e bukur dhe e rregulltë u trejtue vetiut, e pra s’ka Zot krijuës!...

Ç’logjikë e ç’arsyetime gjeni në këto mendime, të ndershëm lexuës?...

E vetmëja provë, me të cilën afetarët kërkujné me vërtetue se “s’ka Zot”, âsht se, *sod shkenca ka çpikë teleskopë të mëdhej, me të cilët shifet mjaft thellë në kupë të qiellit, por der sod nuk âsht pá as Zoti, as fronti i tij qi pretendohet se e ka në qiell*.

Harrojnë këto afetarë të shkretë se Zoti s’ka vënd, âsht afër tyne dhe ku do; Ay s’ka nevoj për kurrëgjâ, pra as për vend; prandaj i thonë i Mbinatyrshëm.

Këta të rij të gabuëm duhet të studjojnë me kujdes e me duri Zotin si mbas instruksioneve të

Hazreti Muhamedit e pastaj të japin gjykim mbi fën Islame.

* *

*

Kompetenca e mendjes

Përpara se të flasim mbi bazat e fës Islame, duhet të flasim pak mbi kompetencën e mendes.

Si kur e vërtetojnë filosofët mâ të përmendun, mendja e njeriut është aktive e pasive. Aktiviteti i mendes shtrihet mbi gjana konkretet e evidente e mbi gjana abstrakte qi mund t'i përfshije nën kompetencën e saj. Por kur vjen puna për gjâna krejt abstrakte, mbi të cilat s'ka asnji njohuni, atëhere ka karakter pasif, qi merr e rrëmben, si xhami i fotografit, të vërtetat qi i parashtrohen, por gjithmonë mbassi t'i ketë shoshitë nëpër sitën e arsytimit e të mos gjejë kontrast si mbas parimeve e ligjëve të logjikës.

Për sa i u përket gjânave fizike mendja është aktive e për as i u përket gjânave metafizike mendja është pasive.

Faktet, ngjarjet dhe eksistencat si në natyrë, si edhe në tejnatyrën janë tri farësh: të domosdoshme, të mundëshme (posibël, kontigent) edhe të pamundëshme (imposibël).

Të domosdoshme e kanë quajhtë atë gjâ, qenëja e të cilës është vetvetiut, dhe s'është e bâme, s'ka nevojë për kurrëgjâ.

Nji qenjëje e domosdoshme që të qendrojë vetvetiut duhet të jetë e plotë në çdo pikpamje dhe mos të

ketë asnji të metë.

Njerzija qysh në fillim ka pranue një qenjëje të këtille të domosdoshme, të cilën shumica e quajnë Zot dhe disa, filosofët, e quajnë fill të gjithësis.

Tue pá se çdo gjâ në natyrë nuk është kot, por ka një qëllim të arsyeshëm, shtrengohemi t'a pranojmë qi filli i gjithësis ka dijeni të plotë, kompetencë të pasosun, pushtet të pambarueshëm. Sepse po t'i mungonte dijenija, kompetencadhe pushteti këtij filli do të ishte e pamundun rregulli i plotë qi shofim në natyrë.

Ky fill i parë duhet të jetë një i vetëm se përndryshe pushteti i tij nuk do të kishte autoritet, mbassi mund t'i kundërshtonin shokët, po të kishte shokë.

Prandaj është mâ mirë qi këtij filli t'i themi Perëndí, emën qi përfshin të gjitha cilësit e plota.

Perëndija është i mbinatyrshëm, pra, s'ka nevojë për vend të caktuëm e prandaj nuk shifet me teleskop, si duën me e pa atheistët, të cilët e mohojnë, pse s'e shofin me teleskop në qiell. Këta atheistë duhet t'a dijnë se froni i Zotit është në ndërgjegje të tyne; aty le t'a kërkojnë, se kanë për t'a gjetë sigurisht, në qoftë se e dijnë rrugën se si kërkohet.

Për ne nuk kanë faj keta atheistë të shkretë; për gabimin e tyne janë përgjegjës ata qi i u kanë predikue një Zot-njeri me fron në qiell. Për sa i përket një Zoti të këtille jemi d'akord me atá qi s'e pranojnë.

Por dahemi prej atheistëve për sa i përket Zotit të vërtetë.

Zoti i Vërtetë është i mbinatyrshëm, të cilin mendja nuk mund t'a njofë vetvetiut. Për sa i përket eksistencës së Zotit, mendja është aktive, d.m.th. e gjen vetiut se ka një Zot. Por për sa i përket njoftjes se këtij, mendja është pasive, dhe po t'i vjen një komunikatë hyjnore që t'ja spiegojë e pranon, për ndryshe s'pranon kurrëgjã.

Tani na mbetet puna të shofim nësi ka ardhë njerzisë komunikatë hyjnore.

Tue studjue këtë pikë shofim se në kohët e kalueme kanë ardhë njerëz që kanë pretendue se kanë ardhë në kontakt me Zotin, prej të cilit kanë marrë instruksione e njoftime mbi mënyrën se si do të jã njoftojnë njerzisë të mbinatyrshmin. Këta njerëz që e kanë bã këtë pretendim quhen profetë dhe instruksionet e tyre quhen Bibel, ase libra të shenjtë.

Si do t'i njofim profetet se janë të drejtë në pretendimin e tyre? Kjo gjã kryhet tue studjue dy pika:

Jetën e profetëve, b) Instruksionet e tyre.

Po të na mbushet mendja se profetët janë njerëz të naltë, të ndershëm, të ditur, e idealist, e jo gënjeshtarë, egoistë, ambiciozë e intrigantë; edhe instruksionet e tyre po të jenë kontingente që t'i pranojë mendja, atëhere është detyrë që t'u bindemi profetëve. Përndryshe flakim rrugën e tyre edhe kërkojmë

një rrugë tjetër për të gjetë të vërtetën, e cila duhet se duhet gjetur.

*

* *

Ne këtu nuk mundemi me përshkrue historinë e gjithë profitëve, vetëm pohojmë se të gjithë profitët pa përjashtim kanë qenë të ndershëm, të ditur e të pajuem me virtutet më të nalta. Gabimet trashanike që u atribuohen janë rrena e gënjeshtër.

Asht e vërtetë se disa ndër to si njerëz që kanë qenë kanë bã nga një rrëshqitje të vogël por këjo rrëshqitje s'ka ndodhë mbrenda misjonit Profetik e me gjithë këtë në realitet ka pasë një mister që spjegohet me hollësi vetëm në Kur-an.

* *

*

Cili është Hazreti Muhammeti?

Mbassi shkon gjatë me kallzue jetën e çdo profeti, ne këtu do të flasim vetëm mbi jetën e Hazreti Muhammetit shkurtazi.

Hazreti Muhammedi qysh tue qenë djal i ri, me gjithë se ishte rritë jetim, kishte një sjellje fisnike dhe një virtut të naltë, sa që tërhoq dashurin, simpatinë e besimin e gjithë popullit të vet e të atyne që e njoftën.

Hazreti Muhammedi Alejhisselam kurrë në jetën e tij nuk gënjeu, nuk rrëjti e nuk tradhtoi ndonjëhere e, prandej, populli i tij i pat dhanë mbiemnin "El-Emín = Besnik". Kurdoherë që ngatrrroheshin dy persona, ase dy parti e thirrshin këtë që t'u a zgjidhte konfliktin; vendimi që

epte ky i kënaqte të dy palët, të cilët pajtoheshin dhe grindja merrte fund.

Hazreti Muhammedi ishte idealist e s'kishte asnjë ambicje për pozita të nalta shoqërore, asë për interesa personale. Zotënija e tij për t'u shpëngue nga mejtimet e ulta të vulgut tërhiqesh në malin "Hira", ku jetojnte në vetmi dhe mejtonte për të zgjidhë problemin e njeriut e të gjithësisë. Ky djalosh idealist ishte analfabet dhe s'kishte pà fare shkollë. Me gjithë këtë ishte i arsyeshëm dhe me gjykim të mprehtë. Dinte me dallue të vërtetën prej gënjeshtres; prandaj qysh në riní shifte me vrejte dhe ironi fetiçizmin e kombit të tij dhe vetë kërkonte me zbulue rrugën qi të shkonte ke Krijuesi i Vërtetë e i Amshuëm.

Në kohën kur ky njeri i naltë po hynte në moshën e tij dyzet vjeçare, në atdhen e tij poezija dhe arti letrar kishte marrë një zhvillim të madh. Në tempullin e shenjtë të "Qabes" ekspozoheshin asë deklamoheshin veprat artistike të poetëve të famshëm. Në këtë kohë të konkurrencës së artistëve letrar, Hazreti Muhammedi Alejhisselam jetonte në vetmi në shpellën e malit "Hira" dhe aty kërkonte me zbulue rrugën qi do t'a përcillte tek e vërteta e amshueme. Këtu në këtë shpellë edhe Zotnija e Tij pyette gjithnjë vetvehten "Ç'jam unë, ç'është gjithësija?" përpiqeshm me zgjidhë këto dy problema; porse s'mund të caktonte asnjë drejtim, mbassi

s'kishte pà fare shkollë.

Tue ndejtë në këto mejtime, një ditë i çelet një panoramë e jashtëzakonëshme. U mbush me dritë fund e majë dhe s'e shifte mâ botën lëndore. Në këtë gjendje të lumnueshme i del para një mësues qi e kishte trupin krejt dritë dhe i thotë Hazreti Muhammedit Alejhisselam:

"Ikreë b'ismi Rabbiqe, el'ledhi khaleka, khaleka'l-insane min âlekin, ikreë ve Rabbuqe'l-eqremu'l-ledhi âl-leme b'il-kalemi, âl-leme'l-insane mâ lem jaâlem...!"

Ata qi e njoftin arabishten letrare e kuptojnë madhësinë e kësaj fraze e nëpër të edhe krejt filosofin islame në mënyrë lakonike. Për ata qi s'e kuptojnë arabishten do të përpiqemi këtu mâ poshtë me dhënë pak spjegime; por mâ përpara duhet të dijmë se në asnjë gjuhë tjetër nuk mund të shprehet plotësisht teksti i Kur-anit prandaj po e pohojmë edhe vetë se spjegimet qi do të japim nuk mund t'a kenë fuqin e origjinalit.

Mâ përpara t'a themi shkurtaz ç'i urdhënon Perëndija Hazreti Muhammedit me këtë pjesë të Kur-anit:

"Këndo me emnin e t'yt Zot qi krijoi, krijoi njerinë prej (âlek)-ut, këndo, yt Zot është mâ i madhi mirbâsë, i cili mësoi me pendë, i mësoi njëriut atë që s'e dijt!..."

Këjo kaptinë e naltë qi j'u kumtue për herën e parë Hazreti Muhammedit Alejhisselam, u ekspozue në Tempullin e *Qabes*. Porsa

e panë poetët e naltë qi konkurojshin shoq me shoq, mbetën të habitun nga elokuenca mrekulluëse edhe pohanë se ajo kaptinë e Kur-anit ishte një art i hyjnueshëm me të cilin s'mund të konkuronte asnjë poet. Prandaj të gjith u përulën dhe e pranuan dergatën e shenjtë të Hazreti Muhammedit Alejhisselam.

*

* *

Edhe ne po t'i vemë mendën dhe t'a studjojmë si duhet këtë pjesë të Kur-anit e marrim vesht fare lehtë se Cilit Zot i falen myslimanët.

Myslimanët adhurojnë njat Zot, i Cili urdhënin mâ të parë e nep për shkollë.

Urdhëni "këndo!" don të thotë bâhu i ditun. Pra Zoti qi na predikon feja islame mund të kuptohet vetëm me dituri. Atâ qi s'kanë dituri e njohuni mbi fën islame s'kanë të drejtë me mohue Zotin e vërtetë qi adhurojnë myslimanët, se mohimi i tyne rrjedh nga injoranca.

Për ata qi mohojnë Zotin pa ditur kështu urdhënon Perendija:

"Ve min'en-nasi men juxhádilu fi'l-láhi bi gajri ilmin ve jettebiû qulle shejtánin merídín. Qutibe alejhi ennehú men tevel-láhu fe innehú judil-luhú ve jehdíhi ilâ ádhábi'sseíri." Kur-an: "22-3,4"

Këto versete e kanë kuptimin:

"Ka disa njerëz qi pa qenë kompetent e pa pasë dituri luftojnë me Zotin; këta njerëz i shtrohen çdo djalli. Asht e shkruemë qi djalli t'i shtijë në

rrugë të prapë dhe t'i udhëheqë për në skëterrën përvëluese gjith ata qi bâjnë miqësi me tê."

Gjithashtu po për këta njerëz urdhënohet në një verste tjetër:

"Ve min'en-nasi men juxhádilu fi'l-láhi bi gajri ilmin ve lá huden ve lá qitabin muniír. Thánije itfíhi li judil-le an sebíli'l-láhi lehú fi'd-dunjâ khizjun ve nudhíkuhú jevm'el-kijâmeti adhâbe'l-hariki." "22-8,9"

"Ka disa njerëz qi pa qenë kompetentë, pa pasë dituri e libër luftojnë me Zotin; këta njerëz largohen prej fesë tue u hjedhë e tue u përdredhë me kreni qi t'ja prapsojnë rrugën njerzís; këta njerëz në dunjâ kanë mjerim e në Ahirët ditën e Kijametit do të shijojnë mundim qi djeg shumë."

Nga përmbajtja e këtyne verseteve kuptohet se ata qi s'i njohin parimet e fës së vërtetë nuk duhet t'a luftojnë Perëndín, por le të rrijnë me fajin e injorancës, faj qi shpresohet se e falën Perëndija, i cili ata qi e luftojnë me padituri do t'i ndeshkojë me rrebëti, sepse kanë kreni të kotë qi meriton të shtypet.

Le të këthehemi në themë:

Si shifet, i pari urdhën qi i u dha Hazreti Muhammedit âsht "Këndimi" i cili duhet të fillohet me emnin e Zotit, sikurse urdhënon Aj vetë. Edhe kjo pikë, për ata qi e marrin vesht, spiegon një hollësi tjetër. Në tekstin e Kur-anit urdhnohet "Këndo me emnin e *Rabbit* t'and". Fjal "*Rabl*" don të thotë Edukuës; merret vesht pra se Zoti nuk rrin në qiell i ulun në një fron si

pandehin disa, por vepron pa ja dá dhe merret me edukatën e krijesave qi ka gatue Vetë. Zoti i Vërtetë kudo ásht gati dhe administron gjithësin. Prandaj ka dije për çdo gjá qi báhet.

Zoti i Vërtetë krijoi dhe krijon çdo gjá me vullnet të vet. Aj krijoi edhe njerín në formën mâ te bukur; i dha gjith të mirat qi s'mund të numrohen kurrë. Pastaj e mësoi njerinë, j'a mësoi gjith atà qi njeriu s'i dinte. Pra Perëndija j'a dhâ njeriut edukatën fizik, edukatën mëndore dhe edukatën morale. Ky Zot i madh e vetëm Ky meriton t'adhurohet e të lavdrohet. Urdhnat e këtij Zoti meritojnë të respektohen.

Ketë Zot besojnë dhe adhurojnë muslimanët. Veç këtij Zoti s'ka Zot tjetër. Rrugën e këtij Zoti ka predikue Hazreti Muhammedi Alejhisselam.

*

* *

Mbas Kur-anit, *Qenje e amsbueme, pa fillim e pa mbarim, me pushted absolut, Krijues i gjithësis ásht vetëm All-llahu, e veç Tij s'ka tjetër Zot.*

Kur-ani e provon Perëndin me fenomenet e natyrës, me ngjarjet historike e me mrekullit. Fenomenet e natyrës e faktet historike edhe mrekullit e Profetëvet të naltë janë prova bindëse për ata qi mejtojnë e arsyejnë.

Mbas dispozitave të Kur-anit nuk ka obligim fetar i çmenduni, anormali edhe aj qi s'ka mbrí moshën madhore qi njëfjet me ligjët shtetnore. Pra naltsija e myslimanit shkon paralel me naltësin intelektuale.

“Foli botës si mbas kapazitetit

intelektual”, - urdhënon Profiti i Naltë i Muslimanëve. Feja Islame mund t'i përgjigjet nevojës së çdo personaliteti, vetëm duhet me kërkue prîsin e meritueshëm e të aftë për me zgjidhë problemat qi dikuj i duken t'errta e nuk ka ardhë në atë gradë qi të mund t'i bluajë.

Si mbas Kur-anit Diviniteti shkon baraz me diturin: “Me të vërtetë Perëndija ka dijení për çdo gjá” urdhnon Kur-ani.

Diturija e msheftësinavet d.m.th diturija e vërtetë i përket vetëm Zotit. “Çelsat e diturís sekrete janë në dorë të Zotit; misteret vetëm Aj i din; ç'ka në tokë e në det; po të këputet një fletë e të bije në tokë pa dyshim Aj do t'a dijë; nuk ka një kokërr drithë në errësinat e tokës, as ndonji grime tjetër të njomë a të thatë për pá qenë rregjistruet në Librin e qartë të Perëndis.” Kështu urdhënohet në Kur-an.

Shkurt, All-llahu ásht një qenje misterjoze qi ka pushtet të plotë, s'ka nevoj për kurrgjâ, kurse çdo gjá j'a ka nevojnë Atij, se përndryshe nuk qëndron; s'ka shembull e ásht i mbinatyrshëm; ásht e pamundun të shifet me syt e kësaj bote, mbassi këta sy nuk mund të qëndrojnë përpara Dritës së Zotit, me qenë se punojnë nën hijen e materjes. Në qoftë se ndonji sy njeriu mundet me e grisë ketë perde ka posibilitet qi t'a shofë Dritën e Bukurís Hyjnore.¹

1. Marrë nga revista “Zani i Naltë”, nr. 13-14, viti 9, shtator-tetor 1934, f. 406-440.

Abstracts in English

Editorial

1. Instead of farewell and on the eve of the 100th anniversary of the founding of the scientific journal “Zani i Naltë”

Dr. Genti Kruja

Islamic Sciences

2. Judicial system in Islam

Prof. Dr. Qazim Qazimi

God Almighty has created man as a social being who cannot live completely independently and isolated from others. The human being, in the circle where he lives, as such, lives in an interdependence that often causes quarrels and divisions, when personal interests collide. This also manifests itself with conflicts, the cause of which is the deprivation or violation of the rights of individuals or different groups.

The rule of law, as a principle, is accepted throughout the civilized world. However, if comparisons are made between different interpretations and implementations of the rule of law, significant juristic-legal differences can be observed between different states. Neither the Noble Qur’an nor the Prophetic Traditions define any particular form of government. Apart from the fact that it is required that the form chosen by the people is based on its work on justice or even better on the Laws of Allah (swt).

Legislative experts in contemporary governments take care to write and compile explanatory notes to clarify the general purpose of the law and the purposes of each article in particular. Precisely these explanatory notes, together with all the research and debates that are recorded in the case of the proposal and approval of a law, serve as an aid for lawyers and judges to understand the relevant law and to apply it. From these, we can

see that the interests of the Shari'ah are not only concerned with the personal aspects of religion or rites of worship, but deal with all aspects of life. The state that claims to be an Islamic state has an obligation to support the right and oppose the unjust. The Islamic state is responsible for the welfare of all its citizens, whether Muslim or non-Muslim. He must provide them with the basic needs of life. Today there is no ideal Islamic state, there are several models that are continuously making systematic efforts to build adequate Islamic systems, but, for now, there is no hopeful light on the horizon in this direction.

3. The influence of the Noble Qur'an on the Arabic language

Prof. Dr. Hfz. Hajredin HOXHA

Every language, as the researchers say, continues depending on its speakers; it rises with their rise and weakens with their weakening. This social image is subject to the law of evolution. History tells us about many languages and cultures that enjoyed the bitter fate of loss and extinction, which did not happen to Islamic culture and the Arabic language, which was preserved by the Noble Qur'an. Thus, the Arabic language remained the strongest language in endurance to challenges and difficulties, at the time when the Arabs mixed with foreigners, thanks to the cultural and civilizational elements it has acquired thanks to being the language of the Qur'an.

Thus, it can be concluded that the value of the Qur'an and its great influence was not only in the Arabic language and in its preservation and enrichment, but also in everything: the cosmos, creatures and the world.

Qur'an and Science

4. Commentary on Surah Fatiha by Albanian scholars H. Vehbi Dibra - H. Ibrahim Dalliu - H. Ali Korça

Explaining the word of Allah is a task beyond our power. I will try, - says Haxhi Vehbi Dibra, - to develop and improve what will be possible on the high meaning of this surah. After us, others will come and speak from generation to generation; life will come to an end and the interpretation of the Qur'an will never end, because it is the supreme word of God, and since God has no end, His supreme word also has no end. This shows the capacity needed to interpret and comment on the Qur'an.

Hafiz Ali Korça in his commentary says: This surah is very short in terms of words, but in terms of its content it is very deep. God in this surah shows the Ruler and the Benefactor of both lives. He with His greatness teaches us how we should praise Him; orders us to say: The good things You have given us are endless, they cannot be counted. Perpetual praise and general gratitude belong to You. You watch over and care for every

living thing.

In his *tafsir*, Hafiz Ibrahim Dalliu makes a longer comment about how we can accompany a work or action. This is the word *Bismil-lah* - **بِسْمِ اللّٰهِ** which means: In the name of Allah, the Most Beneficent, the Most Merciful we are reading...

Studies

5. Bediuzzaman Said Nursi, The wonder of the age II Dorian Demetja, Directorate of Culture, Albanian Muslim Community

Bediuzzaman Said Nursi was a high-calibre scholar of Kurdish origin, born in 1878 in Eastern Turkey. He lived in the last decades of the Ottoman Empire, experienced its collapse and disintegration after the First World War, and lived 37 years after the formation of the Turkish Republic in 1923. Being a person of high spirituality throughout his life and mission was as a result of acting in accordance with the Qur'an and Sunnah, as well as respecting reason and logic. He remained faithful to his cause with such nobility that he demanded nothing more than the opportunity to meet the minimum necessities of survival. Many publications and conferences have been devoted to Bediuzzaman's distinctive qualities; such as devotion to lofty ideals, his deep perception of the world today, simplicity, all-encompassing humanism, loyalty to his companions, chastity, modesty, humbleness and little self-sufficiency. .

Bediuzzaman Said Nursi has faced, throughout his life, the most difficult trials. This is because he confronted and tried to challenge anarchy, which was based on disbelief and atheism, defining it as the most significant problem that needed to be addressed urgently. He lived at a time when a good part of humanity was immersed in atheism, due to abuse of science and philosophy, and when the minds were brainwashed by communism. He hated disbelief, tyranny, and apostasy, so he fought hard against despotism. He says: "Before me is a great fire. Its flames are reaching the cup of heaven. In that fire my child is burning, my faith is on fire. I'm running to put out that fire and save the faith. Someone is blocking my foot in the street, what does it matter? In the face of this great fire, is this small event worth it?! Truncated thoughts! Narrow views ... "

Bediuzzaman analyzed three major factors that had to do with the essence of the problems of that time, but which remained the same in our time: Ignorance in the sense of indifference to God and the Prophet, poverty and social division. Bediuzzaman dedicated his life to the fight against this fatal virus. In his eye, the hope of salvation for the ummah would be in vain, as long as false and deviant ideologies would prevail and until society was enlightened with the light of systematic learning, knowledge and thought. He inspired the younger generations with the news of the rebirth and guided them to the paths that lead to Islamic thought. He always referred to knowledge and activation of the mind and worked

hard for the birth of a perfect and healthy society. To achieve such an ideal, Bediüzzaman thought that education was the main guide, which would include mosques, schools, garrisons, streets, playgrounds, and even prisons.

Bediüzzaman wrote many books, but the focus was on works entitled "Risale-i Nur" (Messages of Light). They are the fruit of serious efforts, which explain and present to today's man the basic principles of faith and the truths of the Qur'an. Bediüzzaman himself said in a lecture: "Now I see clearly that most of my life has been commanded and directed beyond the capacity of my perception, which would produce these messages to serve the cause of the Qur'an, as if my whole life as a scholar had been spent in preparation for these writings, which demonstrate the miracle of the Qur'an."

In the nineteenth and twentieth centuries, the various attacks on the foundations of faith undertaken by materialists, atheists, and others, in the name of science and progress, made Bediüzzaman understand the urgent and fundamental need, which consisted of preserving and strengthening faith. His method analyses belief and disbelief and demonstrates through clear logical arguments that, by following the method of the Qur'an, not only it is possible to reasonably prove all the truths of faith, but also demonstrate that these truths hold the only rational explanation for existence: man and the universe. With the method he developed, Bediüzzaman explained the truths of the faith in a language that can be understood by people of all walks of life, presenting the unity of mind, heart and feelings. Thus, by combining theology, mysticism, and the positive sciences, he presented a whole new perspective and aimed to eliminate the division of school, madrasa, and tekke. His works have been consistently read with great care, with sincere feelings of appreciation, and will continue to be of particular importance as time goes on.

Bediüzzaman believed that the source or the cause of man's problems that the Islamic world was currently facing, could be cured, in particular, only through the renewal of the faith. Thus, Bediüzzaman turned his back on the politics of the time and devoted all his efforts to this goal. With a deep knowledge of the religious and modern sciences, the new path to truth that Bediüzzaman opened with the works of the Risale-i Nur was so successful in preserving and strengthening the faith that it was accepted by many personalities as the reviver of the religion as promised by the Prophet Muhammad (pbuh) that he would come in every century in the well-known hadith: "Surely Allah will send to this ummah at the beginning of every century a mujtabid who will renew the affairs of the religion. "

6. An Islamic perspective on the preservation of material cultural heritage

Abdullah Bulku

Material cultural heritage is an existence that constitutes an important dimension of human existence and human society throughout history. On the other hand, man, as the

highest creature in this world, who is guided by religion as divine light, is a multi-dimensional being with the ability to perceive and create relationships with all other existences. Thus, the preservation of material cultural heritage as an important subject for human perception and a dimension of human society constitutes an essential and universal problem for human beings.

The efforts to create the new man, under the totalitarian regime, during the last century, and the confusion, the crisis of values, and other problems of the modern world, which have characterized the period of transition, have damaged the material cultural heritage as much as they have affected by the fading of our perceptive and cognitive ability regarding this existence. If contemplation and reflection is a precursor to action, then there is a need to define the meaning and importance that this existence has for us, based on the worldview that everyone perceives and builds his life.

In this paper, we have tried to provide a general approach to understand the importance of preserving material cultural heritage from the Islamic point of view. First, the concept of religion, culture and the relationship between them is addressed. In the following, some aspects and dimensions that unfold through material cultural heritage are addressed, which are: Knowledge of history, cultural diversity, cultural identity and collective memory. These principles constitute important dimensions of man and society as an existence, and their preservation is closely related to self-knowledge and the spiritual, intellectual and material emancipation of societies in full harmony with their nature and other existences. In the next part, we have tried to give an ethical approach to the preservation of material cultural heritage. First, an introduction was made regarding the ethical roots of this problem. In the following, an ethical approach is presented in the Islamic perspective, referring to the concept of man's responsibility as God's vicegerent on earth.

Translation

7. The life of Abu Mansur Al-Maturidi and the socio-political and theological context in Central Asia in the tenth century

Dr. Aref Chaker

Abu Mansur al-Maturidi is one of the most influential theologians in the Muslim World. He emerged in the tenth century in Central Asia and established his own theological school, alMaturidiyyah; a school that played and continues to play a pivotal role in the formation of the Sunni synthetic theological movement in the Muslim world. A review of the studies undertaken concerning al-Maturidi demonstrates the influence of the socio-political and theological context of Central Asia on al-Maturidi has not been studied, examined or analysed. This paper focuses on studying this overlooked aspect in Sunni theology. It evaluates the existence of any influence of the social, political, cultural and

religious factors on al-Maturidi's works and his academic identity. It examines the nature of these influences, positive or negative, by undertaking a qualitative content analysis of all biographical, historical and geographical literature relevant to al-Maturidi and Central Asia. The study uncovered the strong influence these factors had on al-Maturidi. These influences were all positive in many of his writings. More importantly, these factors helped shape the synthetic theological paradigm al-Maturidi adopted in much of his literature.

Recension

8. The publishing activity of Bosnian theologian Enes Kariq, translated into Albanian Azmir & Behrim Jusufi, Prizren

Whom the Almighty God honored with wisdom, he honored with great kindness. Man, in general, during his life is guided by some ideal, regardless of whether it is religion, science, or something else. It is important that that connection of man with his ideal of life, is invisible, immaterial and strong - immeasurable, by the very fact that it is the connection with his inner reality, the spiritual journey and the striving and weaving to achieve it...

The written work is one of the traces that remain even after the passage of man into the Eternal world, and its influence is deeply engraved in the impression and purpose of writing the work. If a work spreads and is heard far away, it is one of the signs that the purpose of writing it was in the right direction. There is no greater kindness than that which enables you to put the ideal of the soul, the spiritual feelings, on paper and that the pen, at the same time, is one of the dearest companions.

Personality

9. Haxhi Hafiz Mahmud Dashi - Decorated for patriotic activity

Haxhi Hafiz Mahmud Dashi's activity was very extensive. In the pedagogic field, he left a deep mark on many students, many of whom worked and became prominent national, religious, educational and cultural personalities, among whom stand out outstanding orientalist scholars such as Vexhi Buharaja, theologians and researchers such as Hasan Selami, Ejub Faslia, Haki Repishti, researchers like Shaban Demiraj in the field of philology, etc.

The patriotic activity of Mahmud Dashi has been awarded with the decoration for patriotic activity, for an uninterrupted activity for the benefit of the national culture.

Thus, the outstanding theologian and pedagogue entered with dignity the history of Albanian culture and education in particular, remaining a magnificent example of education and Albanian culture.

Retrospective

10. Man and the Universe

Man has the capacity to judge and reason; that is, he is free to choose and act, and therefore he is responsible for his actions.

The nobility of a creature is not caused by the common qualities that associate it with its inferiors, but by the characteristic qualities that distinguish it from these inferiors. Man, with the power of reasoning and free will, has an inner life, a transcendental life, which is called human life.

If there is a proven truth, it is that nothing in the world is in vain, but has a purpose, is destined for a predetermined purpose, according to an eternal design.

All scholars have accepted one truth, but they are divided into two parts: some claim that the truth exists and man only discovers it, and some others say that the truth does not exist but man creates it with his mind.

Honest readers automatically understand how right the first part is and how wrong the second part is, because if there is no truth then the person himself is a lie, an untruth. Then how is it that an untruth, a lie, can create a truth? This is something absurd and those who are of this opinion are wrong.

Therefore, we reach the conclusion and say that the truth is and man only discovers it. Man's mission is therefore only to discover the truth that is, and that was before man came to life.

Rregullat e shkrimit

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Artikulli duhet të jetë punë studimore e kërkimore, shkencore origjinale.
2. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që trajton. Ai nuk duhet të jetë më i gjatë se 35 karaktere.
3. Të vihet emri i autorit me gradën shkencore përkatëse. Poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.
4. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit, me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt, duke radhitur të gjitha nënçështjet.
5. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje, sipas tematikës që shtron.
6. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, ku të jepen qëllimi dhe objektivat që e kanë shtyrë autorin për ta shkruar atë dhe rëndësia e botimit të tij.
7. Të gjithë nëntitujt të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12” dhe të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.
8. Në fund të artikullit duhet të jetë një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerime a përfundime.
9. Artikull duhet të ketë në fund bibliografinë.
10. Artikulli duhet të ketë footnote-a dhe referenca në fund të faqes, për të treguar burimin e një citati a të një informacioni që jepet në tekst dhe duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, vitin dhe vendin e botimit, numrin e faqes nga është marrë citati. Shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë duhet të jenë në thonjëza.
12. Kur informacioni merret nga interneti, duhet shënuar data; p.sh., 10 maj, 2008. Në fund të footnote-s vihet pikë dhe ajo rregullohet me «Justify».
13. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.
14. Artikulli duhet të respektojë rregullat gramatikore të gjuhës shqipe standarde.
15. Shkrimi duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1”. Të mos mungojnë shkronjat “ç” dhe “ë”. I gjithë teksti të jetë “Justified”.

